

CANER TASLAMAN

**12 ARGUMENTE TË EKZISTENCËS SË
ALLAH-UT**

12 ARGUMENTE TË EKZISTENCËS SË ALLAH-UT

CANER TASLAMAN

E PËRKTHEU NGA TURQISHTJA:

BESIR ZENELI

TITULLI I ORIGINALIT:

CANER TASLAMAN,

ALLAH'IN VARLIĞININ 12 DELILI

PËRMBAJTJA:

PARATHËNIE

HYRJE.....

KAPITULLI I PARË

ARGUMENTET E GJITHËSISË.....

1. ARGUMENTI KOZMOLOGJIK I TEOLOGJISË....
2. ARGUMENTI I EKZISTENCËS SË LIGJEVE.....
3. ARGUMENTI I ZBULUSHMËRISË SË GJITHËSISË....
4. ARGUMENTI I POTENCIALIT TË GJITHËSISË.....
5. ARGUMENTI I LIGJEVE DHE RREGULLIMIT PRECIZ TË KONSTANTEVE....
6. ARGUMENTI I KONTROLLIT PRECIZ TË DUKURIVE FIZIKE.....
7. ARGUMENTI I DIZAJNIT-PROJEKTIMIT TË GJALLESAVE.....

KAPITULLI I DYTË

8. ARGUMENTI I DËSHIRAVE NATYRORE.....
9. ARGUMENTI I MORALIT.....
10. ARGUMENTI I ARSYES.....
11. ARGUMENTI I VULLNETIT....
12. ARGUMENTI I VETËDIJES DHE VETVETES....

PËRFUNDIM.....

BIBLIOGRAFI.....

PARATHËNIE

Përkundër diskurseve të ekzistencialistëve ateistë ose teistë, Hume, Kant, filozofisë marksiste, pozitivizmit, qasjeve post-moderniste dhe disa shkollave religjioze që nënçmojnë mendjen të cilat thonë se argumentet për ekzistencën e Zotit kanë zënë vendin në raftet me pluhur të historisë dhe janë të vjetruara, këtu unë argumentoj se këto pretendime janë naive dhe ato nuk qëndrojnë në baza të qëndrueshme. Unë paraqes detaje të pohimit tim të organizuar në dymbëdhjetë argumente. Disa nga argumentet janë paraqitur edhe më thellësisht në punimet e mia të tjera.

Gjykimi nëse Zoti ekziston apo jo, ka një ndikim të thellë në perceptimin tonë për veten, të dashurit tanë, tokën dhe tërë universin. "Pse ekzistoj?", "Nga erdhën të gjitha?", "Pse jemi ketu?", "Çfarë do të ndodhë me ne pasi të vdesim?", këto dhe të gjitha pyetjet e ngjashme ontologjike dhe ekzistenciale kanë përgjigje të lidhura me këtë gjykim. Ekzistenca e Zotit do të thotë që të gjitha krijesat dhe qeniet njerëzore janë krijuar me vetëdije, ekzistenca jonë ka një kuptim e qëllim dhe se jeta mund të ekzistojë pas vdekjes nëse Allahu dëshiron. Ndërsa lexoni këtë libër, gjithmonë mbani në mend se shqetësimi ynë kryesor është kjo temë kritike e ekzistencës së Zotit, si bazë e të gjitha pyetjeve ontologjike dhe ekzistenciale.

Falënderoj posaçërisht Nilgün Türkileri, Enis Doko, Alper Bilgili, Fatih Fidan, Fulya Özcanlı dhe Selen Fettahoğlu për leximin e kujdesshëm të librit tim dhe shumë sugjerime të zgjuara. Për komente, kritika dhe sugjerime ju lutemi vizitoni faqen time në internet www.canertaslaman.com, ku gjithashtu do të jeni në gjendje t'i gjeni edhe punimet e mia të tjera. Faleminderit ju, lexuesit e mi të çmuar, për leximin dhe interesimin tuaj për librin.

HYRJE

Diskutimet mbi argumentet për ekzistencën e Zotit janë po aq të vjetra sa historia e feve dhe filozofia. Në këtë libër, ne do të merremi me këtë çështje, e cila është me rëndësi të madhe për fenë dhe filozofinë. Në trajtimin tonë ne i kemi dhënë theks të veçantë kontributit të zbulimeve moderne shkencore për këtë temë. Fakti që shumë studime teologjike në mendimin islam fillojnë nga kjo temë, është një nga treguesit e rëndësisë së veçantë që i është dhënë kësaj çështje në mendimin islam. Reflektimi mbi krijesat dhe përsiatja për Krijuesin e tyre është një metodë e inkurajuar nga Kurani. Ka shumë vargje në Kuran që tregojnë universin, fenomenet në tokë, jetën dhe botën tonë të brendshme; dhe fton që të nxirren përfundime prej tyre duke përdorur arsyen.

Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det, që iu sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti, e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhap në te nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës, (në të gjitha këto) për një popull që ka mend ka argumente.¹

Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim, kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): Zoti ynë, këtë nuk e krijoje kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit!²

Thuaj: “Udhëtoni nëpër tokë e shikoni, se si filloi krijimi, pastaj Allahu e fillon krijesën tjetër (ringjalljen). Është e vërtetë se Allahu është i Plotfuqishëm për çdo send.³

Logjika nuk është burimi i vetëm i besimeve dhe mosbesimeve tona; faktorë psikologjikë dhe faktorë të tjerë gjithashtu luajnë rol kritik. Megjithatë, logjika është një pjesë integrale e natyrës njerëzore. Mosrespektimi i rëndësisë së logjikes/arsyes në besim do të ishte kontradiktor me natyrën njerëzore. Moskuptimi i rëndësisë së logjikes/arsyes në fe do të ishte kundërshtimi i krijimit dhe injorimi i shumë vargjeve të Kuranit që çojnë në përdorimin e logjikes/arsyes. Kurani nuk e hyjnizon mendjen, por në shumë vargje/ajete na mëson që përdorimi i arsyes do t'i shërbejë fesë. Në mënyrë që të vlerësojmë rëndësinë e argumenteve të bazuara në logjikë/arsye (konsiderata

¹ Surja El-Bekareh, 164.

² Surja Ali-Imran, 190.

³ Surja El-Ankebut, 20.

shkencore dhe filozofike të bazuara në arsytetime) për ekzistencën e Zotit, së pari duhet të kuptojmë siç duhet statusin e logjikes/arsyetimit në fe.

Shpesh hasim në pyetjen se si të kuptohet vërtetësia e shtyllave të besimit⁴ në Islam duke përdorur metoda të bazuara në arsye. Unë konsideroj dy mënyra të mundshme për krijimin e bazave racionale për shtyllat e besimit. E para është ajo që mund të quhet metoda "nga poshtë-lart". Në këtë rrugë së pari vërehet se përmbajtja e Kuranit nuk mund të jetë vepër e një personi ose e një grupi njerëzish; bazuar në këtë, ai/ajo përcakton se është një libër nga Zoti dhe të gjitha besimet themelore (përfshirë shtyllat e besimit) të përmendura në Kuran janë të vërteta. Në të vërtetë, Kurani i sfidon njerëzit për prodhimin e një libri të ngjashëm;⁵ dhe ky fakt mund të përdoret si një shenjë e qëndrueshmërisë së kësaj rruge me përmbajtjen e Kuranit. Në metodën e dytë, "nga lart poshtë", së pari përcaktohet ekzistenca e Zotit dhe eliminon mosbesimet filozofike dhe fetare; pastaj shkon drejt vlerësimit të çështjeve individuale në fe. Shumë vargje të përmendura më lart dhe të ngjashme që rekomandojnë nxjerrjen e konkluzioneve nga qeniet e krijuara mund të paraqiten si një bazë që kjo metodë është gjithashtu në përputhje me Kuranin. Sigurisht, është e mundur të miratohen qasje që i shohin këto dy metoda si plotësuese të njëra-tjetrës (megjithëse ky është qëndrimi që unë miratoj, sidoqoftë unë do i jap përparësi mënyrës së dytë). Në rrugën e dytë, pas vendosjes së argumenteve për ekzistencën e Zotit, qëndrimi ndaj fesë dhe zgjedhja midis feve vlerësohen duke përdorur përmbajtjen e Kuranit (si në metodën e parë). Faktori që e bën mënyrën e dytë të ndryshme është se përparësia i jepet argumentit të ekzistencës së Zotit në justifikimin racional. Meqenëse ekzistenca e Zotit është thelbësore për ontologjinë e Kuranit, argumente të tilla nuk janë të pavarura nga përmbajtja e tij. Sidoqoftë, kategorizimi ynë sqaron rrënjët e argumenteve të bazuara në arsye.

Argumentet për ekzistencën e Zotit nuk duhet të konsiderohen si themeli i thjesht për vetëm njërën nga shtyllat e Islamit. Kjo shtyllë është në të vërtetë shtylla kryesore që mbart të gjithë të tjerët. Le të kujtojmë këto shtylla të Islamit: Profetësia e Hz. Muhamedit, Kurani është Mesazhi i Zotit, ekzistenca e jetës pas vdekjes në Ahiret etj. Të kuptosh ekzistencën e Zotit do të thotë të kuptosh se profetësia është e mundur pasi që "Krijuesi i gjithçkaje" është në gjendje të japë

⁴ Këto janë shtylla themelore të besimit islam të pranuar nga të gjitha shkollat e Islamit duke përfshirë besimin në Zot, profetët e Zotit, Kuranin dhe Ahiretin

⁵ Shih: Surja El-Bekareh, 2 – 23, 24; Surja En-Nisa, 4 – 82; Surja Hud, 11 – 13, 14; Surja El-Isra, 17 – 88; Surja El-Ankebut, 29 – 50, 51.

përgjigje për “Nga vij unë?”, “Çfarë do të më ndodhë mua pas vdekjes?”, “Cila është përgjegjësia ime ndaj krijuesit?” etj., dhe profetësia është një mjet për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve. Ekzistenca e Zotit nënkupton mundësinë që Ai të dërgojë një lajmëtar/pejgamber për të mësuar një ontologji të përqendruar në Zot dhe të refuzojë çdo zot ose idhull tjetër, si dhe të dërgojë një shkrim të shenjtë që përmban detajet e mesazhit të dërguar njerëzimit. Kuptimi i ekzistencës së Zotit përfshin gjithashtu besimin në mundësinë e jetës në ahiret. Për një Zot të plotfuqishëm që e solli në ekzistencë këtë univers nga asgjëja, nuk është e vështirë të krijojë një të ri. Të kuptuarit e ekzistencës së Zotit do të thotë gjithashtu që është e mundur t’i bindemi disa parimeve morale, sepse nëse Zoti i cili krijoi qeniet njerëzore, diktoi disa parime me autoritetin e Tij, natyrisht që është e domosdoshme t’iu bindemi atyre.

Provimi i mundësisë së diçkaje nuk është i njëjtë me vërtetimin e ekzistencës së saj. Për çështjet e përmendura më lart, në mënyrë që të kalojnë nga mundësia në realitet, ose duhet të përdoret përmbajtja e Kuranit, ose duhet të vendosen argumente të pavarura nga ai. Kur të vërtetohen argumentet për ekzistencën e Zotit, mesazhi kryesor i Kuranit është ekzistenca e Zotit; bota dhe gjithësia me të gjitha përmbajtjet e tyre, njerëzimi dhe qeniet e tjera të gjalla, të gjitha këto të krijuara nga Zoti (elementet themelore të ontologjisë dhe kozmologjisë të mësuara nga Kurani) gjithashtu do të kuptohen duke plotësuar mesazhin mbizotërues të Kuranit. Për më tepër fillimi i argumenteve për shtyllat e tjera të besimit nga perspektiva e "mundësisë" së tyre ofron një avantazh të rëndësishëm. Për shembull, kur ekzistenca e Zotit argumentohet, do të kuptohet automatikisht se profecia është e mundur. Vlerësimi i profetësisë së Hz. Muhamedit pasi të keni zotërim të fortë të kësaj mundësie është dukshëm më i dobishëm krahasuar me argumentet pa një realizim të tillë.

I frymëzuar nga Kurani, unë i grupoj argumentet për ekzistencën e Zotit në dy kategori. Argumentet në grupin e parë përbëhen nga vëzhgimet tona të botës së jashtme, ndërsa ato në të dytën lidhen me argumentet që dëshmojmë brenda vetes (përmes introspeksionit). Unë e quaj grupin e parë "argumente nga universi" dhe të dytin "argumente nga natyra njerëzore (fitrat)"⁶, emërtimi i bazuar përsëri në frymëzimin e Kuranit, siç tregohet në vargjet vijuese:

⁶ Surja Er-Rrum, 30.

Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t'u bëhet e qartë se ai (Kurani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është Dëshmitar për çdo gjë?⁷

Edhe në tokë ka argumente për ata të bindurit. Po edhe në veten tuaj. A nuk jeni nga e shihni?⁸

Në pjesën e parë të këtij libri (argumente nga universi), unë do të paraqes shtatë argumente. Argumenti i parë, ai që përdoret më së shpeshti në historinë e teologjisë (islame), synon të tregojë se universi nuk është i përjetshëm. Këtu, unë do të përfshij gjetjet e shkencës moderne si argumente dhe do ta quaj këtë pjesë "argumenti i teologjisë kozmologjike". Pjesa e dytë është "argumenti nga ekzistenca e ligjeve natyrore" dhe bazohet në ekzistencën e ligjeve universale në natyrë. Këto ligje na mundësojnë të kuptojmë universin. E treta bazohet gjithashtu në një gjendje që i mundëson shkencës: Struktura matematikore dhe zbulueshmëria e universit; prandaj është emëruar "argumenti i zbulueshmëisë së gjithësisë". E katërta, "argumenti nga potenciali i universit" buron nga potenciali i pasur që zotëron universi, i shpjeguar më së miri nga krijimi i Zotit. Argumenti i pestë del nga gjetjet e shkencës moderne në lidhje me ekuilibrin e rregullimeve precize, duke e bërë të mundur jetën, në ligjet e brendshme të natyrës dhe konstantave fizike. Ky është "argumenti nga ligjet fizike dhe rregullimet precize të konstanteve". E gjashta lidhet gjithashtu me ekuilibrin e rregulluar mirë, përsëri duke mundësuar jetën; "argumenti nga rregullimi preciz i dukurive fizike". Pjesa e fundit vlerëson fenomenet në lidhje me jetën nën dritën e zbulimeve shtrirë në shkencën moderne dhe quhet "argumenti nga dizajni i jetës" (kjo pjesë do të përfshijë një diskutim të shkurtër nëse teoria e evolucionit paraqet një problem kundër ekzistencës së Zotit).

Në pjesën e dytë pesë argumente shtesë, "nga natyra njerëzore", do të diskutohen duke përmbushur dymbëdhjetë argumentet e këtij libri. Argumentet e paraqitura në këtë seksion bazohen në vetitë e brendshme të qenieve njerëzore, duke sjellë përfundime që mbështesin teizmin⁹ dhe dobësojnë ateizmin materialist¹⁰. Nënkapitulli i tetë, "argumenti nga dëshirat

⁷ Surja Fussilet, 53

⁸ Surja Edh-Dharijat, 20-21

⁹ Gjatë gjithë librit, "teizmi" është përdorur në mënyrë sinonime me "monoteizmin". Kjo terminologji i referohet besimit në Zotin, e Gjithëfuqishëm, e Plotfuqishëm, Krijuesi i Gjithëdijshtëm i gjithçkaje përveç vetvetes. Ateizmi, siç nënkupton vetë emri, i referohet refuzimit të ekzistencës së Zotit.

¹⁰ "Ateizmi" është mendimi filozofik që hedh poshtë ekzistencën e Zotit. "Natyralizmi" është mendimi filozofik që hedh poshtë ekzistencën e diçkaje tjetër përveç natyrës, domethënë materies, energjisë dhe hapësirë-kohës. Si

natyrore" është ndërtuar mbi dëshirat e brendshme të njeriut dhe pretendon se krijimi i vetëdijshëm i Zotit për këto dëshira është shpjegimi më i mirë për ekzistencën e tyre. Pika fillestare e pjesës së nëntë janë rezultatet e psikologjisë moderne dhe shkencave njohëse që tregojnë natyrën e lindur të moralit dhe etikës tek njerëzit. "Argument nga morali i lindur" pohon se vendosja e këtyre vlerave brenda natyrës njerëzore në mënyrë të vetëdijshme nga Zoti është shpjegimi më i mirë. I dhjeti është "argumenti i arsyes", i cili thotë se teizmi bën shpjegimin më të mirë të tiparit të përbashkët të arsyetimit në të gjithë njerëzit e shëndetshëm. Nënkapitulli i njëmbëdhjetë është mbi "argumentin nga vullneti" dhe shpreh shpjegimin më të mirë të vullnetit tek njeriu si të dhënë nga Zoti. Pjesa e fundit merr ekzistencën e Zotit si shpjegimin më të mirë për posedimin nga njerëzit të vetëdijes dhe vetvetes dhe quhet "argument nga vetëdija dhe vetja".

Unë do të doja të prekja shkurtimisht metodologjinë e arsyetimit që përdor për argumentet këtu. Një mënyrë mjaft themelore e arsyetimit që ne shpesh përdorim në jetën tonë të përditshme, si dhe në filozofi dhe shkencë, është të vlerësojmë të gjitha opsionet dhe midis tyre të zgjedhim më të përshtatshmet. Kjo metodë është e ngjashme me "konkluzionin për shpjegimin më të mirë" të përdorur në filozofinë e shkencës¹¹. Historia e mendimit paraqet dy linja kryesore të shpjegimit për të kuptuar ekzistencën e universit që jemi dëshmitarë, jetën dhe natyrën tonë. Sipas të parës, të gjitha qeniet ekzistencën e tyre, me të gjitha hollësitë dhe aspektet, ia detyrojnë Zotit. Nga galaktikat në tokë, nga bimët te kafshët dhe njerëzit, nga dëshirat e njeriut te vetëdija e tij, gjithçka është një produkt i krijimit të Zotit. Sipas të dytës, të gjitha ato që u përmendën më sipër shpjegohen përmes "rastësisë dhe domosdoshmërisë". Kjo pikëpamje e fundit është ajo e

pasojë, natyralistët e refuzojnë Zotin, pasi Ai nuk është një qenie fizike. Të gjithë natyralistët janë ateistë, por jo të gjithë ateistët janë domosdoshmërisht natyralistë, pasi ata mund të besojnë në ekzistencën e ndonjë fuqie tjetër mbi-natyrore. Në realitet, megjithatë, shumica e ateistëve janë gjithashtu natyralistë. "Materializmi" është mendimi filozofik se materia është blloku themelor i gjithçkaje në univers, përfshirë edhe proceset mendore dhe vetëdijen. Në këtë drejtim, materializmi është i lidhur ngushtë me natyralizmin, dhe megjithatë, edhe pse gati të gjithë materialistët janë gjithashtu ateistë, materializmi nuk e kërkon ateizmin. Dikush mund të besojë në Zot dhe të mbajë ende pikëpamjen se të gjitha proceset në univers janë materialiste. Meqenëse Zoti nuk është një qenie materiale, ky mendim i fundit rrallë është përvetësuar dhe pothuajse të gjithë materialistët e përcaktojnë veten si ateistë. Përkundër këtyre nuancave, termat ateizëm, natyralizëm dhe materializëm përdoren shpesh në mënyrë të njëjtë. Po kështu, pothuajse të gjithë ateistët e njohur në histori mund të vendosen në të tre këto kategori. Kështu, gjatë gjithë këtij libri, sa herë që përdorim termin materialist-ateizëm, lexuesi mund ta konsiderojë atë sinonim të natyralizmit.

¹¹ Shumë argumente të arsyetimit të tilla si "konkluzioni për shpjegimin më të mirë" dhe "rrëmbimi" i përdorur zakonisht në jetën e përditshme dhe shkencën bazohen në gjetjen e më të përshtatshmes midis alternativave. Për të lexuar më shumë rreth kësaj teme, referojuni: Peter Lipton, *Inference to the Best Explanation*, London, Routledge, 2001.

përvetësuar nga ateistët-materialistë. Implikimi themelor këtu është se universi dhe ligjet e tij kanë ekzistuar domosdoshmërisht në përjetësi, dhe nga galaktikat në tokë, nga bimët te kafshët dhe njerëzit, nga dëshirat e njeriut te vetëdija e tij, gjithçka është një produkt i rastësive që ndodhin në kornizë të ligjeve të natyrës¹². Ateistë të njohur të së kaluarës, si dhe neo-ateistë të kohës sonë, janë materialist-ateistë¹³. Pothuajse të gjithë agnostikët deklarojnë se është e paditur se cila nga këto dy pikëpamje është e vërtetë. Përcaktimi i së vërtetës së njërës prej këtyre dy pikëpamjeve e tejkalon agnosticizmin. Përgjatë këtij libri, këto dy pikëpamje do të krahasohen/ballafaqohen për secilin argument dhe do të përcaktohet "shpjegimi më i mirë". Sidoqoftë, do të doja të sqaroja një pikë para se të vazhdoja: unë nuk pretendoj se teizmi është vetëm më i mirë se ateizmi materialist. Pozicioni im kryesor në këtë libër është se teizmi është më i mirë se çdo pikëpamje tjetër dhe është shpjegimi më i mirë. Sidoqoftë, kur kemi parasysh argumente të ndryshme për mohimin e Zotit sot dhe në historinë e mendimit, materializmi duket se është e vetmja alternativë reale ndaj teizmit. Prandaj, unë demonstroj jo vetëm që teizmi është shpjegim më i mirë se materializmi, por gjithashtu se teizmi është shpjegimi më i mirë nga të gjithë.

Arritja e një përfundimi pas vlerësimit të të gjitha fakteve dhe provave nga fusha të ndryshme është një metodë ideale që përdoret jo vetëm në jetën e përditshme, por edhe në shkencë. Kjo metodë quhet "qëndrueshmëri e induksionit"¹⁴. Meqenëse ne përdorem argumente nga universi, ligje të natyrës, rregullime precize, dizajni i jetës, morali i lindur, vullneti dhe vetëdija etj., për të arritur në përfundime rreth ekzistencës së Zotit, ne në thelb do të përdorim qëndrueshmërinë e induksionit. Do të ishte e vlefshme të vlerësohej pamja e përgjithshme e argumenteve për ekzistencën e Zotit pasi secili argument në këtë libër të shqyrtohet veç e veç.

¹² Mund të ketë përjashtime në këto përkufizime teiste dhe materialiste-ateiste. Sidoqoftë, ne me lehtësi mund të themi se këto përkufizime përmbledhin shkurtimisht pikëpamjet e tyre të përgjithshme. Për diskutime të mëtejshme mbi shpjegimet "rastësi-fat" dhe "domosdoshmëri", shih, për shembull, Jacques Monod, *Chance and Necessity*, Vintage Books, New York, 1972.

¹³ Për shembull, ateistët e shquar bashkëkohorë si Richard Dawkins, Daniel Dennett, Sam Harris, Christopher Hitchens etj., të gjithë janë ateistë materialistë. Ka edhe pikëpamje që hedhin poshtë ekzistencën e Zotit pa përvetësuar ateizmin materialist. Shintoizmi, për shembull, i atribuon hyjninë Diellit dhe është një besim jashtë teizmit dhe ateizmit materialist. Sidoqoftë, edhe pse ka akoma ndjekës të kësaj tradite, nuk është e mundur të gesh ndonjë filozof që mbështet këto besime mbi baza racionale, pasi natyra e Diellit tani kuptohet mirë se është një yll i zakonshëm, me një fillim dhe jetë të caktuar. Shkurtimisht, edhe pse ka mendime jashtë teizmit dhe ateizmit materialist, asnjë prej tyre nuk mund të konsiderohet si një alternativë serioze.

¹⁴ Robert E. Butts, "William Whewell", *The Cambridge Dictionary of Philosophy*, Ed: Robert Audi, Cambridge, Cambridge University Press, 1999, f. 850- 851.

Argumentet e bazuara në arsye paraqesin një mundësi për besimtarët e Kuranit për të mbështetur dhe forcuar besimin e tyre dhe shërben si një ndërmjetës për komunikimin me jo-besimtarët, bazuar në argumente racionale. Përveç kësaj, këto qasje zbulojnë shembuj konkretë të përsiatjes dhe reflektimit mbi universin, jetën dhe botën tonë të brendshme, siç inkurajohet nga Kurani. Në historinë e mendimit shprehet se ekzistojnë dy libra që do të përdoren si burime për të soditur mbi Zotin; e para është shkrimi/et e shenjtë që përmban zbulesën e Zotit dhe e dyta është libri i universit. Frymëzuar nga vargjet/ajetet e përmendura më lart është e mundur të shtoni "natyrën njerëzore" si një libër të tretë. Konsistenca e konkluzioneve të arritura nga këta tre libra forcon përfundimet nga secili. Libri që keni përpara përqendrohet në përfundimet e arritura nga librat e universit dhe natyrës njerëzore; ndërsa përfundimet e arritura nga shkrimet e librave të shenjtë janë subjekt i studimeve të tjera.

KAPITULLI I PARË

ARGUMENTET E GJITHËSISË

NËNKAPITULLI I PARË

ARGUMENTI KOZMOLOGJIK I TEOLOGJISË

I.

ARGUMENTI KOZMOLOGJIK I TEOLOGJISË

Pyetja "Pse ka diçka në vend të asgjëje?" u parashtrua nga filozofi dhe matematikani i famshëm Leibniz, për të deklaruar se duhet të ketë një shpjegim për ekzistencën e universit dhe materies që na rrethon. Sipas argumentit kozmologjik kjo gjithësi/ ky univers ka nevojë për një shpjegim, mirëpo gjithësia këtë shpjegim nuk e përmban brenda vetes. Shpjegimi i gjithësisë mund të bëhet vetëm përmes një qenie të domosdoshme, ekzistenca e së cilës nuk varet nga asgjë, e kjo qenie quhet Allah. Në fakt, argumenti kozmologjik nuk është i formuluar në një mënyrë të vetme; përkundrazi do të ishte më e përshtatshme të flasim për ekzistencën e një bashkësie të argumenteve kozmologjike.¹⁵ Argumenti më i spikatur në mendimin islam, veçanërisht në fushën e teologjisë, ka qenë "argumenti i hudus-it*" që është një lloj i argumentit kozmologjik. Këtu koncepti i "hudus" përdoret në kuptimin e "ardhjes së diçkaje në ekzistencë nga asgjëja, ka një fillim të caktuar". Mendimtarë të rëndësishëm në historinë e mendimit islami si Kindi, Maturidi, Ibn Hazm dhe Ghazali kanë përdorur këtë argument, të cilin e hasim edhe tek teologët e shekullit të 2-të të Hixhrit. Për shembull, një pjesë e gjatë e veprës *Inkoherenca e Filozofëve* (Tehafut ul-Felasife) ka të bëjë me këtë çështje, e cila konsiderohet si një nga veprat më të rëndësishme të Gazaliut.¹⁶ Ky argument është nëndegë e familjes së argumenteve kozmologjike. Me këtë argumentim Ghazali u përpoq t'u përgjigjej me arsyetime filozofike të sofistikuara abstrakte dhe të nivelit të lartë (gjetjet shkencore të asaj periudhe nuk përmbanin të dhëna për origjinën e universit) atyre që pretendonin se përjetësia e universit shkon kundër ekzistencës së Zotit (ose i përjetshëm sikurse Allahu). Me studimet e bëra në botën perëndimore në shekullin e kaluar ky argumentim u ringjall; të dhënat e shkencës moderne u kombinuan me qasjet në teologjinë islame dhe ky argument u zhvillua nën agjendën e fushës së filozofisë së fesë me emrin "argumenti kozmologjik i Teologjisë (islame)". Këtë argumentim mund ta paraqes si më poshtë:

1. Nëse filozofia materialiste-ateiste është e saktë, atëherë gjithësia është e përjetshme, por nëse teizmi është i saktë, atëherë gjithësia ka një fillim.
2. Gjithësia ka një fillim; argumentet janë këto:

¹⁵ Mehmet S. Aydın, *Din Felsefesi*, İzmir İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları, İzmir, 1999, f. 41-56.

* Shënim i përkthyesit: ardhja në jetë, ardhja në jetë nga asgjëja; emri i dhënë një provë të përdorur për të vërtetuar ekzistencën e Allahut në shkencën e teologjisë islame.

¹⁶ Gazzali, *Filozofların Tutarsızlığı*, Çev: Mahmut Kaya ve Hüseyin Sarioğlu, Klasik, İstanbul, 2005.

- 2.1 Pretendimi se e kaluara e universit është "pafundësi aktuale" është kontradiktor; në këtë mënyrë, i pamundur. E kjo tregon që universi ka një fillim.
- 2.2 Ligji i Entropisë tregon që gjithësia ka një fillim.
- 2.3 Teoria e Big Bang tregon që universi ka një fillim.
- 3. Si rezultat, shpjegimi i teizmit duhet të përzgjidhet si më i saktë në raport me materializmin-ateizmin.

Këtu mund të themi padyshim se, shumica dërrmuese e materialisteve-ateistëve dhe teistëve do ta pranojnë pikën e parë. Kur shqyrtojmë historinë e mendimit, kuptojmë se mendimi i pafundësisë së universit është mendimi themelor i materializmit-ateizmit dhe se ata e shohin këtë si pikën kryesore të ndarjes prej teizmit, i cili e pranon Zotin si të përjetshëm. Për shembull, ateistët-materialistë si Marx dhe Engels deklaruan se pikëpamja/mendimi se a është pikëfillim Zoti apo materia/universi, është dallimi më thelbësor midis idealizmit/teizmit dhe materializmit.¹⁷ Për ata që e mohojnë ekzistencën e Zotit, duket se ekziston një alternativë tjetër: që është pretendimi se universi doli nga asgjëja. Mirëpo kjo na shpie të shprehim një nga pretendimet që bie më së shumti në kundërshti me arsyen e shëndoshë. Nëse gjërat mund të kishin dalë nga mosekzistenca, nuk do të ishte e çuditshme të shihje se si kompjuteri, makina apo elefanti shfaqen herë pas here. Nëse universet mund të vijnë në ekzistencë nga asgjëja, ato duhet që vazhdimisht të shpërfaqen, në çdo moment. Në të vërtetë, gjatë gjithë historisë, pozicioni kryesor i materialist-ateistëve ka qenë ta mbrojnë idenë e universit të përjetshëm/të pafund, e jo një universi të formuar nga asgjëja. Një qasje e pavënë re në këtë argumentim është pikëpamja e disa teistëve (si disa mendimtarë aristotelianë) të cilët deklarojnë se universi është i përjetshëm së bashku me Zotin. Ky është një pozicion i adoptuar nga pakica, por ekzistenca e një qasjeje të tillë nuk përbën problem për argumentet e paraqitura këtu. Nëse pranohet saktësia e argumenteve të paraqitura këtu, kësaj qasje i jepet përgjigje gjithashtu.

Propozimi kritik këtu është ai i dyti (se univrrsi ka fillim), të cilin ateistët-materialistë do ta kundërshtojnë. Si përfundim i kësaj, pasi të vërtetohen këto dy propozime, ekzistenca se universi ka fillim do të vijojë në mënyrë logjike. Shkurt, ajo që është e rëndësishme për sa i përket këtij argumenti është të konceptohet e vërteta se,"universi ka një fillim", siç jemi deklaruar në propozimin e dytë. Nëse mund ta demonstrojmë këtë, ne do ta kemi argumentin e teizmit në stadin

¹⁷ Karl Marx ve Friedrich Engels, Felsefe İncelemeleri, Çev: Sevim Belli, Sol Yayınları, İstanbul 1997, f. 22.

e "shpjegimit më të mirë" në raport me ateizmin-materializmin. Siç thuhet në argument ne do të përpiqemi të tregojmë në tre mënyra të ndryshme se universi ka një fillim. E para nga këto bazohet në arsyetim të pastër filozofik, ndërsa dy të tjerat pikënisjen e kanë në të dhënat e shkencës moderne (të tre këto pika do të përmbliidhen sa më shkurt dhe qartë që të jetë e mundur).

Vlerësimi i pikës 2.1: Pretendimi për përjetësinë e universit nënkupton “pafundësinë” e të kaluarës së tij. Për këtë arsye, nocioni “pafundësi” (infinite) meriton vëmendje të veçantë. Në univers, në të vërtetë nuk ka asnjë entitet që është i pafund. Pafundësia përfshinë hapërimin e vazhdueshëm, që s’ka fund. Pranimi i ekzistencës së "pafundësive të përfunduara (të kompletuara)" në univers është paradoksale. Për shembull, le të mendojmë pakës për sekuencën e numrave natyrorë (0,1,2,3,4). Kur themi se kjo sekuencë numrash shkon në pafundësi, nuk do të thotë se ato vërtetë i afrohen një caku të caktuar. Me këtë, më shumë nënkuptohet që sekuenca gjithmonë përparon me hapa të një njësie. Prandaj, ne kurrë nuk arrijmë në pafundësi duke numëruar një nga një; por gjithmonë ne vetëm përparojmë. Ndarja e sekuencës do të nënkuptonte fundin e saj, kurse kjo bie në kontradiktë me vet përkufizimin e pafundësisë.

Pas këtij përshkrimi ne duhet ta dallojmë pretendimin për pafundësinë e të kalurës nga pretendimi për pafundësinë e të ardhmes. Pretendimi për pafundësinë e ardhmërisë, për universin nënkupton që koha përparon vazhdimisht pa u ndalur, kështu që nuk ka ndonjë problem të dukshëm në këtë supozim. Një përparim i këtillë drejt së ardhmes ndonjëherë përmendet edhe si “pafundësi potenciale”. Ky përkufizim nuk ndryshon asgjë në lidhje me rezultatin që kemi shpjeguar. Megjithatë, unë preferoj të mos e përdor këtë përkufizim, pasi termi "potencial" ndjell edhe idenë e mundësisë (për ose ndaj diçkaje), kurse një proces i pafund duhet të mos ndalet asnjëherë. Pafundësia nuk arrihet kurrë, e as që ekziston diçka e tillë si “pikë e pafund”. Për këtë arsye themi se pafundësia nuk ka cak dhe është vetëm përparim i vazhdueshëm. Kudo që të ndalemi gjatë progresit të vazhdueshëm, në asnjë rast ajo nuk nënkupton "pafundësi të përfunduar ". Nga ana tjetër, ata që thonë se e kaluara e universit është e përjetshme, thonë se pafundësia është e kompletuar, pra koha e kaluar e universit është "pafundësi e përfunduar". Është më se e nevojshme ta theksojmë dallimin mes këtij pretendimi dhe pretendimit të mëparshëm. Këtu, pafundësisë i atribuohet edhe cilësia e konsumimit dhe shterjes, të cilat janë në kundërshtim me natyrën e pafundësisë. Paradokset që shfaqen si rezultat i pretendimeve të këtillë mund të tregohen në shumë mënyra. Le ta marrim këtë shembull: e kaluara, pra koha dhjetë vite para të tanishmes, ose qindra

e miliona vite para të tanishmes, të gjitha këto janë të kaluara infinite. Ne e dimë se kur pafundësisë i shtojmë numra fundor, ajo mbetet përsëri pafundësi (pra $8 + \text{pafundësi}$ është e barabartë me pafundësi). Kjo nënkupton se numrat e viteve nuk ndryshojnë duke shtuar dhjetë, qindra ose miliona, e që kjo është absurde. Pika kryesore këtu është që krejtësisht të kuptohet dallimi mes pafundësisë së kaluarës dhe të ardhmes. Shpeshherë kjo pikë kaq kritike kapërcehet nga shumë njerëz. Pretendimi për "të kaluarën e pafundme të përfunduar" është aq kontradiktor dhe absurd, saqë si dalje e vetme prej këtyre paradokseve rezultuese është pranimi se universi ka një fillim.¹⁸

Kur thuhet se jemi në kohën e tanishme, pra në "tani", pas kalimit të kohës së pafundme në të kaluarën, kjo lë të nënkuptohet se pafundësia mund të kapërcehet, e që kjo është një kontradiktë tjetër me vet definimin e termit në fjalë. Ata që nuk mund ta kuptonin se koncepti i pafundësisë nuk ka ekuivalencë në asnjë realitet në univers, gjithmonë e kanë anashkaluar këtë. Këtë mund ta tregoj shkurtimisht si më poshtë:

1. Universi ose ka një fillim ose ka një të kaluar të pafund.
2. Termi pafundësi i referohet përparimit (hapërim, vazhdimësi) të pafund dhe ky term nuk mund të kompletohet nga ky përparim.
3. Nëse universi ka një të kaluar të pafund, atëherë ekzistenca jonë në të tashmen do të kishte nevojë për domosdoshmërinë e kompletimit të pafundësisë.
4. Meqenëse pafundësia nuk mund të kompletohet/plotësohet me deficionin e mësipërm (sipas pikës numër 2) dhe meqenëse nuk mund ta mohojmë ekzistencën tonë, e kaluara në univers nuk mund të jetë e pafund.
5. Pra, universi ka një fillim (sipas pikave 1 dhe 4).¹⁹

Një implikim tjetër i rëndësishëm i argumentit tonë është se, ashtu si universi, edhe koha duhet të ketë një fillim. Për këtë arsye, Kindi dhe Ghazali vendosën theks të veçantë mbi këtë përfundim të rëndësishëm dhe thanë se Zoti është krijuesi edhe i kohës, edhe i universit.²⁰ Me pak

¹⁸ Ne lidhje me kete teme shih: William Lane Craig, **"Kelam Kozmolojik Kaniti"**, Allah, Felsefe ve Bilim, Ed: Caner Taslaman ve Enis Doko, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2015,

¹⁹ Caner Taslaman, **Big Bang ve Tanrı**, f. 79-80.

²⁰ Kindi, **"İlk Felsefe Üzerine"**, İslam Filozoflarından Felsefe Metinleri, Ed: Mahmut Kaya, Klasik, İstanbul, 2005, f. 17-26.

fjalë, Zoti është transcendent në kohë ashtu siç është në univers. Kjo pikë është mjaft e rëndësishme për të ndriçuar probleme të rëndësishme në fusha të tilla si teologjia dhe filozofia e fesë. Kjo çështje mund të kontribuojë në kuptimin e temave shumë të diskutuara si fati/kaderi. Gjithashtu pyetjet si, "Pse Zoti e krijoi universin më pas, e jo më parë?" ose "Pse Zoti priti miliarda vite për të krijuar njeriun?", bëhen të pakuptimta me ndriçimin e kësaj çështje. Meqë është e padiskutueshme që krijuesi i kohës t'i nënshtrohet kohës dhe pritjes, këto pyetje që i nënshtrohen kohës dhe pritjes, thjesht janë të pakuptimta dhe të palogjikshme për tu përdorur ndaj Zotit.

Si rezultat, ky argument përveç përgënjeshtërimit të tezës më themelore të ateizmit-materialist, pra përjetësinë e materies, nga ana tjetër i vë themelet e fuqishme të teizmit dhe të Zotit, si krijues i kohës dhe universit.

Vlerësimi i pikës 2.2: Mendimtarët më të njohur materialistë-ateistë gjatë historisë e kanë konsideruar përjetësinë e universit bazën e filozofisë së tyre.²¹ Nëse do të na kërkohej që ta reduktojmë debatin midis teizmit dhe materializmit-ateizmit në një problem të vetëm; e përmbledhur në një fjali hamletiane kështu do të ishte: "A është universi i përjetshëm, apo jo; kjo është e gjithë çështja!". Duke qenë se jo-përjetësia e universit nënkupton fillimin e tij, ne mund ta ripërmbledhim fjalinë e sipërm si më poshtë: "A ka universi një fillim apo jo; kjo është e gjithë çështja!" Pretendimi i teizmit për fillimin e universit nuk është se e dallon atë vetëm nga mbrojtësit e filozofisë materialiste-ateiste, por e dallon atë edhe nga fetë e tjera si: Hinduizmi, Budizmi, Taoizmi dhe filozofia e Greqisë së Lashtë. Ideja për ta kufizuar fuqinë e Zotit ose për ta konsideruar një univers të pavarur nga krijimi i Zotit, janë të papranueshme nga teizmi. Nga ana tjetër, për ata që e mohojnë ekzistencën e Zotit, pranimi i përjetësisë së universit duket se është alternativa e vetme serioze. Përveç këtyre, Kanti, i cili është një shembull i rëndësishëm i qasjeve agnostike, thotë se nuk mund të konfirmohet ose të përgënjeshtrohet teza nëse universi ka një fillim apo jo; dhe për këtë arsye, sipas tij, është e pamundur të vendoset një koncept i kozmologjisë racionale.²²

Siç e shohim, ideja që universi është krijuar dhe ka një fillim është konflikti më serioz i teizmit me agnosticizmin dhe filozofitë tjera. Para shekullit të 19-të, diskutimet mbi këtë çështje bazoheshin vetëm në argumente filozofike. Kontributi i parë në këtë çështje nga shkencat natyrore

²¹ Georges Politzer, **Felsefenin Başlangıç İlkeleri**, Çev: Enver Aytekin, Sosyal Yayınları, İstanbul, 1997, f. 24.

²² Immanuel Kant, **The Critique of Pure Reason**, Çev: J. M. D. Meiklejohn, William Benton, Chicago, 1971, f. 135.

erdhi me zbulimin e ligjit të entropisë. Për më tepër, ky ligj është një nga ligjet më thelbësore në univers dhe për saktësinë e tij nuk ekziston ndonjë dyshim në mendjen e asnjë shkencëtari; qoftë ai teist apo ateist.

Ligji i entropisë është i njohur edhe si ligji i dytë i termodinamikës dhe ai u prezantua posaçërisht nga vepra e Rudolf Clausius në gjysmën e dytë të shekullit XIX.²³ Ky ligj shpjegon se energjia vazhdimisht ndryshon, nga forma më e përdorshme (më e lartë) në atë më pak të përdorshme (më të ulët). Me pak fjalë, ky ligj thotë se, çrregullimi rritet vazhdimisht në univers dhe ky është një proces i njëanshëm, i pakthyeshëm. Ky proces përparon drejt ekuilibrit termodinamik (thermodynamic equilibrium) derisa më në fund lëvizja të ndalet. Fizikani i njohur anglez Arthur Eddington thotë se, ligji i entropisë është prej më të rëndësishmëve midis të gjitha ligjeve të natyrës. Sipas Eddington-it, një teori fizike mund të kishte qenë e saktë edhe nëse do të kontradiktohej me formulat e Maxwell ose me disa eksperimente tjera të observueshme, por nuk është e mundur të kishte qenë e vërtetë nëse do të kontradiktohej me ligjin e entropisë.²⁴

Proceset njëkahëshe janë paralajmëruese të fundësisë. Procesi i plakjes së njeriut dhe rritja e entropisë në univers, të dyja këto janë të pakthyeshme. Ne kemi kuptuar faktin se, sipas ligjit të entropisë, çrregullimi në univers rritet vazhdimisht dhe, ndërsa kjo rritje nuk mund të vazhdojë përgjithmonë, universi përfundimisht duhet të marrë fund. Në fakt ky rezultat gjithashtu do të thotë se universi duhet të ketë një fillim. Ndryshe, kjo gjë mund të vlerësohet edhe kështu:

1. Entropia në univers po rritet vazhdimisht në një mënyrë të pakthyeshme.
2. Prandaj, universi një ditë do ta arrijë ekuilibrin termodinamik, që ndryshe quhet si "vdekje e nxehtësisë". Me pak fjalë, universi nuk është i përjetshëm
3. Sikur e kaluara të kishte qenë e pafund, tani do të duhej të ishte arritur ekuilibri termodinamik në univers dhe lëvizja duhej të ishte ndalur.
4. Mirëpo ne jemi dëshmitarë se lëvizja ende vazhdon.
5. Kjo do të thotë se universi nuk mund të ekzistojë pafundësisht; pra universi ka një fillim.

²³ Michael Guillen, **Dünyayı Değiştiren Beş Denklem**, Çev: Gürsel Tanrıöver, TÜBİTAK Popüler Bilim Kitapları, Ankara, 2001, f. 171-222.

²⁴ Arthur Eddington, **The Nature of the Physical World**, Macmillan, New York, 1929, f. 74

Shkencëtarët janë përqendruar më shumë në implikimin e entropisë mbi fundin e universit, por nuk janë përqendruar sa duhet në implikimet e saj në fillimet e universit. Ndërsa në diskutimet filozofike, teologjike dhe kozmologjike, diskutimi se a ka pasur fillim universi është çështje më e rëndësishme. Paul Davies mbi këtë çështje, thotë kështu:

``Është e qartë se nëse universi po shkatërrohet në mënyrë të pakthyeshme me një shpejtësi të fundme, atëherë ai nuk mund të ketë ekzistuar përgjithmonë. Arsyeja është e thjeshtë: nëse universi do të ishte pafundësisht i vjetër, ai do të ishte shuar tashmë. Diçka që shkatërrohet me një shkallë të caktuar padyshim që nuk mund të ketë ekzistuar përjetësisht. Me fjalë të tjera, universi duhet të ketë ardhur në ekzistencë shumë kohë më parë. Është e jashtëzakonshme që ky përfundim i thellë nuk u kuptua siç duhet nga shkencëtarët e shekullit XIX-të.``²⁵

Vlerësimi i pikës 2.3: Një mbështetje tjetër e fortë shkencore për idenë se universi duhet të ketë një fillim erdhi me teorinë e Big Bang-ut, e cila u zbulua dhe u zhvillua në vitet 1920.²⁶ Vrojtimi i universit me këtë teori mundësoi llogaritjen e fillimit të kohës së gjithësisë dhe marrjen e hollësishme të informacioneve në lidhje me proceset e këtij fillimi. Llogaritjet matematikore tregojnë se ky fillim ishte 13.8 miliardë vjet më parë. Sipas kësaj teorie, universi filloi si një pikë shumë e nxehtë dhe shumë e dendur, më vonë pasi kjo temperaturë dhe dendësi u zvogëlua gjatë procesit të zgjerimit të vazhdueshëm u formuan galaktikat, yjet e planetët dhe ky proces po vazhdon ende.

Ata që përvetësojnë këndvështrimin materialist-ateist për universin kanë argumentuar gjatë gjithë historisë se universi nuk ka fillim dhe fund, për këtë arsye, që universi të vijë në ekzistencë, ai nuk ka nevojë për qenie transcendentë. Megjithatë argumentet e teorisë së Big Bang-ut u forcuan me kalimin e viteve dhe nuk kishte ndonjë alternativ serioze kundër kësaj teorie, ata që përvetësuan pikëpamjen materialiste-ateiste u përpoqën ta pajtonin këtë teori me qasjet e tyre. Nëse i shqyrtojmë pikëpamjet mbi universin të materialistëve-ateistëve përgjatë historisë, mund të kuptojmë se si kjo teori vërteton shkencërisht një univers krejtësisht të kundërt me pritjet materialiste-ateiste.

²⁵ Paul Davies, **The Last Three Minutes**, Basic Books, New York, 1994, f. 13

²⁶ Shih: Caner Taslaman, **Big Bang ve Tanrı**, 3, 4, 5. bölümler.

Ata që përvetësojnë kuptimin materialist-ateist përpiqen të zëvendësojnë Zotin me universin. Edhe pse universi është një grumbull i pavetëdijshëm i materies; ata duke i dhënë atij veti vet-rregulluese krijuan "perëndinë" e tyre dhe mbrojtën një univers të lavdishëm e të pavarur, i cili ka ekzistuar përgjithmonë përfshirë këtu miliarda trupa qiellorë, të pafillim dhe të pambarim. Sidoqoftë, me teorinë e Big Bang-ut, u kuptua se e kaluara e universit është një singularitet/tipar i veçantë më i vogël se një mermer; një pikë e vogël pa madhësi fillestare. Ky singularitet/tipar i veçantë natyrisht nuk jep një shpjegim të plotë se si ndodhi kalimi nga asgjëja në qenie; sepse asgjëja nuk është preokupim i shkencës, pra, nuk ka ndonjë të dhënë shkencore rreth kësaj. Meqë ky singularitet është i padefinuar në aspektin shkencor, ai mund të konsiderohet si joekzistencë. Në fillim të universit, në rastin e singularitetit, të gjitha ligjet fizike janë të pavlefshme; kështu që, të gjitha pyetjet mbi singularitetin nuk janë më fizike, por metafizike. Konsiderimi i singularitetit si "joekzistencë" nuk është aspak i vështirë, sepse, para së gjithash, nuk ka hapësirë dhe kohë në fazën e singularitetit dhe materia jashtë hapësirës dhe kohës nuk mund të ekzistojë. Së dyti, në të njëjtën fazë, ekuacionet e ligjeve fizike ndryshojnë deri në pafundësi; meqë asnjë sasi e vërtetë fizike nuk mund të jetë e pafund, kjo situatë mund të përshkruhet si mosekzistencë.

Teizmi madhështinë e universit e paraqet si krijimtari të krijuesit, e jo si zotësi të vet universit. E percepton universin si një entitet që i është dhuruar përkohësia (që ka fillim dhe mbarim) dhe lëvizja. Si rezultat, korniza historike e teizmit është përputhje me teorinë e Big Bang-ut. Nëse e pranojmë singularitetin në fillim të universit si një entitet, atëherë, në sajë të teorisë së Big Bengut, origjina e universit zvogëlohet në një pikë të vogël dhe ekzistenca e hyjnizuar e ateizmit-materialist zhvlerësohet dhe i afrohet mos-ekzistencës. Nëse dyshoni në këtë shpjegim mendoni pakës për miliarda yje në universit dhe pastaj për një pikë të vogël. Nëse në fillim të universit e konsiderojmë statusin ontologjik të gjendjes së singularitetit si ekuivalente me hiçin/mungesën, atëherë teoria e Big Bengut bëhet një teori që gjithashtu shpreh kalimin nga asgjëja në qenie. Në çdo rast, pavarësisht nëse e pranojmë singularitetin si një pikë të vogël ose si mungesë/hiç; duket se panorama/tabloja e universit e treguar nga teoria e Big Bengut e paraqitur në shekullin e XX-të është shumë më e pajtueshme me pritjet teiste sesa me ato materialiste-ateiste. Përkundër parashikimeve materialiste-ateiste, të cilët supozojnë se universi është i përjetshëm, (pak a shumë i njashëm me formën e tij aktuale), sot ekziston debati nëse statusi ontologjik i fillimit të universit korrespondon me një pikë të vogël apo me hiçin/mungesën.

Me pak fjalë: argumentet abstrakte matematiko-filozofike të parashtruara nga al-Kindi, al-Ghazali dhe filozofë të tjerë; ligji i entropisë, si një nga ligjet më themelore në fizikë, i zbuluar në shekullin e 19-të; dhe teoria e Big Bengut e shekullit 20, teoria më e rëndësishme e kozmologjisë në lidhje me rrënjët e universit; pra secila nga këto tre qasje pajtohet me përfundimin se universi ka një fillim. Të gjitha këto së bashku, përbëjnë argumentin kozmologjik të kelamit, si një provë e fuqishme për ekzistencën e Zotit.

NËNKAPITULLI I DYTË

ARGUMENTI I EKZISTENCËS SË LIGJEVE

II.

ARGUMENTI I EKZISTENCËS SË LIGJEVE

Përpyekjet shkencore synojnë t'i zbulojnë ligjet e natyrës dhe ta njohin universin në përputhje me këto zbulime (si synim i shkencës është edhe planifikimi i së ardhmes, sigurimi i rehatisë dhe sigurisë së njerëzve). Megjithatë, kjo përpjekje nuk tenton ta shpjegojë qëllimin e ekzistimit të ligjeve në natyrë. Në të vërtetë, shumica e shkencëtarëve i realizojnë studimet e tyre pa e kuptuar fare mundësinë e pyetjeve jetësore filozofike si "Pse kemi ligje, në vend të kaosit?" ose "Pse ligjet e natyrës janë të njëjta në çdo pjesë të universit?" Shumica e shkencëtarëve e pranojnë në heshtje se ekzistojnë ligje që ia vlen të zbulohen dhe i përvishen punës e duke pasur parasysh këtë presupozim.

Në këtë kapitull, ne do të sqarojmë se kur krahasohet me materializmin, paradigma e teizmit është shumë më e suksesshme në shpjegimin se pse ka ligje (që e bëjnë të mundur shkencën, madje edhe jetën tonë të përditshme) në vend të kaosit. Për shembull, le ta fillojmë me shqyrtimin e përshkrimeve shkencore rreth atomit. Përshkrimet shkencore na japin informacione se atomi përbëhet nga grimca të tilla si protonet e neutronet dhe këto grimca përbëhen nga grimca më të vogla të quajtura kuarka (quark). Përshkrimi shkencor mund ta tregojë strukturën e atomeve dhe proceset me të cilat u formuan atomet e ndryshme në tabelën kimike. Por asnjëra nga këto përshkrimet, nuk është përgjigje e pyetjes "Pse ka ligje të natyrës, e jo kaos?". Përshkrimi shkencor tregon se forca e fortë bërthamore i mban sëbashku protonet të cilat e zbrapsin njëra-tjetrën në bërthamë, por ky përshkrim nuk e kuptimëson praninë e materia në univers dhe nuk e shpjegon arsyen se përse ajo u bindet ligjeve që e rregullojnë funksionimin e një force të tillë. Pavarësisht rëndësisë së madhe shpesh ndodhë që të neglizhohet dallimi midis përkufizimit të një ligji dhe shpjegimit (kuptimësimit) se përse ekziston ai ligj. Duhet të theksohet se shkenca vetëm e përshkruan universin, por nuk e "shpjegon" (kuptimëson) atë. Kur duam ta gjejmë shpjegimin (kuptimësinë) e ekzistencës së ligjeve në univers, ne duhet të lëvizim nga kufijtë e shkencës eksperimentale dhe vëzhguese në fushën e vlerësimeve filozofike. Ligjet e natyrës, mund t'i shpjegojmë vetëm duke iu referuar një ontologjie gjithëpërfshirëse ndaj universit. Kur bëjmë një vlerësim të tillë ne duhet të krahasojmë fuqinë shpjeguese midis teizmit dhe ateizmit-materialist, si dy pikëpamje rivale në shpjegimin e ekzistencës së ligjeve në univers. Unë pretendoj se një

krahasim i tillë sjell argumente për ta preferuar teizmin para ateizmit materialist. Argumenti im mund të përshkruhet si më poshtë. Ky argument mund të tregohet si më poshtë:

1. Natyra ka ligje.
2. Shpjegimi për arsyen e ekzistimit të këtyre ligjeve mund të bëhet ose nga teizmi, ose nga materializmi-ateizmi.
3. Teizmi arsyen e ekzistencës së këtyre ligjeve e shpjegon më mirë sesa ateizmi-materialist, sepse:
 - 3.1 Ekzistenca e një ligjvënësi racional, të vetëdijshëm, të vullnetshëm (Alim, Kadir) e shpjegon më mirë ekzistencën e ligjeve në përputhje me arsyen.
 - 3.2 Një ligjvënës i vetëm (Vahid) e shpjegon më mirë vlefshmërinë e ligjeve të njëjta në hapësira të ndryshme.
 - 3.3 Për shkak se fenomeni i sprovës, i cili është një element i rëndësishëm i paradigmes së feve teiste, është i mundur vetëm në një univers ku ekzistojnë ligjet, kështu që ekzistenca e ligjeve është më e përputhshme me këtë paradigmë.
4. Si rezultat, shpjegimi i teizmit duhet të përzgjidhet si më i saktë në raport me atë të materializmit-ateizmit.

Pika e parë e këtij argumenti vërtetohet nga të dhënat shkencore dhe nga përvojat tona të përditshme. Përveç asaj që shkenca thotë për forcën e gravitetit, fakti se uji ngrohet sa herë që e vendosim në një vend më të ngrohtë sesa që është temperatura e tij, tregon për strukturën ligjore të natyrës. Një nga qëllimet kryesore të përpjekjes shkencore është zbulimi i ligjeve prapa ndryshimit të fenomeneve. Fenomeni i ekzistencës së ligjeve të natyrës përfshin edhe ligjet e domosdoshme (deterministike), edhe ligjet probabilistike, siç është ekuacioni Schrödinger. Madje në këtë rast as ligjet probabilistike nuk nënkuptojnë rastësi. Pika e parë e argumentit të parashtruar, është një propozim i cili do të pranohet lehtë nga materialistët-ateistë dhe nuk do të përballet me ndonjë kundërshtim serioz.

Historia e mendimit, shkencës dhe filozofisë paraqet teizmin dhe ateizmin-materialist si dy pikëpamje kryesore të kundërta për shpjegimin e universit dhe ligjeve në të. Qasja të cilën e përdorin më shpesh përvetësuesit e materializmit-ateizmit për të shpjeguar ekzistencën e ligjeve është se, ligjet e universit janë të përjetshme së bashku me universin material dhe se këto janë

veçori të brendshme të materies; dhe se nuk ka nevojë për shpjegim tjetër të tyre sepse ato kanë ekzistuar gjithmonë. Ndërsa shpjegimi teist është se, ligjet e universit janë të krijuara nga Zoti, ashtu si dhe universi, domethënë këto ligje janë rezultat i vullnetit dhe qëllimit të Zotit. Fakti që kundërshtimet më serioze kundër ateizmit-materialist vijnë nga qarqet teiste dhe kundërshtimet më serioze ndaj qarqeve teiste vijnë nga qarqet materialist-ateiste tregon se këto janë dy qasjet kryesore rivale për të shpjeguar këtë çështje. Me pak fjalë, mund të thuhet se nuk do të bëhet asnjë kundërshtim serioz për pikën e dytë të argumentit të paraqitur.

Objekti ndaj të cilit do të adresohen kundërshtimet e ateistëve-materialistë në këtë argumentim është pika e tretë. Nga këndvështrimi materialist-ateist, ndërsa dy pikat e para pranohen drejtpërdrejt, e treta është e pamundur të pranohet. Si rezultat, pika e tretë, që është më kritikja, do të mbrohet duke u bazuar në tri nënpikat e shprehura në argumentin 3 (të njohura si 3.1, 3.2 dhe 3.3). Kur të tregohet vlefshmëria e pikës së tretë, rezultati "se shpjegimi i teizmit duhet të përzgjedhet si më i saktë në raport me atë të materializmit-ateizmit " do të rrjedhojë logjikisht.

Vlerësimi i pikës 3.1: "Pse ka ligje të natyrës, e jo kaos?" është pyetja në të cilën duhet të përqendrohemi së pari.²⁷ Nga perspektiva e logjikës, universi mund të ketë ekzistuar po kaq mirë edhe pa praninë e ligjeve; prania e ligjeve nuk është domosdoshmëri logjike (vëreni dallimin midis domosdoshmërisë logjike dhe domosdoshmërisë fizike). Nga aspekti logjik nuk ka ndonjë kontradiktë ekzistenca e një universi ku nuk ka asnjë ligj. Shumë shkencëtarë përqendrohen vetëm në vetëm ekzistimin e ligjeve në univers dhe kurrë nuk e parashtrojnë pyetjen se përse ato ekzistojnë. Megjithatë, ka shembuj të tillë si Ajnshtajni, i cili pat theksuar për gjendjen e jashtëzakonshme të të kuptuarit të universit dhe pat thënë se gjëja më e pakuptueshme rreth universit është se ai është i kuptueshëm. Sipas Ajnshtajnit, kuptimi i universit dhe mundësia e mendjes për ta kuptuar atë, janë manifestime të Zotit.²⁸ (Kur e ka shprehur këtë Ajnshtajni, nuk e kishte trajtuar këtë çështje në një format të tillë të argumentimit si ky.)

²⁷ Termi "**kaos**" këtu nuk duhet të ngatërrohet me "teorinë e kaosit", e cila ka qenë në rendin e ditës që nga gjysma e dytë e shekullit të XX-të. Me "kaos" këtu nënkuptohet situata në të cilën asnjë ligj natyror nuk është i vlefshëm.

Me "teorinë e kaosit", shqyrtohen proceset jolineare që zhvillohen brenda kornizës së ligjeve ekzistuese të natyrës.

²⁸ Ian G. Barbour, **When Science Meets Religion**, Harper Collins Publishers, New York, 2000, f. 52-53.

Nëse universi do të ishte i çrregullt dhe kaotik, nuk do të kishim dalë kurrë nga konfuzioni i fëmijërisë. Nëse universi do të ishte i rregulluar, por me një strukturë shumë më të komplikuar sesa aftësia e perceptimit të mendjes njerëzore, do të ishte akoma e pakuptueshme. Ne e kuptojmë universin përmes ekzistencës së ligjeve të natyrës dhe kuptueshmërisë së tyre. Ekzistenca e këtyre ligjeve është një nga parakushtet "e jashtme" të kuptimit të universit nga mendja.²⁹

Sikur mollat papritmas të shndërroheshin në një copë shkëmbi, sikur objektet në tokë papritmas të fluturonin në drejtim të qiellit, sikur në mëngjes çdoherë të zgjoheshim në një vend të ndryshëm, sikur uji në dhomë papritmas të fillonte të avullohej, sikur sendet tona befasisht të fillonin të zhdukeshin, ose thënë shkurt, sikur të jetonim në një univers ku s'ka ligje të natyrës, atëherë mendja nuk do të mund ta përdorte një mjet siç është gjuha, përmes së cilës ajo e realizon mendimin dhe racionalizimin. Nëse do t'i jepnim emër një objekti me një gjendje të caktuar (p.sh. formë), por ajo gjendje do të ndryshonte në mënyrë të paparashikueshme, në këtë rast "emërtimi" do të bëhej i pakuptimtë. Po kështu, nëse rezultati i veprimeve tona do të ndryshonte sa herë që i kryenim ato, shprehja e veprimit verbalisht do të bëhej e pamundur. Në një botë kaq kaotike, induksioni, deduksioni dhe arsyetimi racional nuk do të mund të ekzistonin.

Siç u pa edhe më lartë, përputhshmëria e universit me ligjet e natyrës na mundëson bërjen e shkencës dhe kuptimin e saj; pra, këtë e mundëson struktura e universit që është në përputhje me racionalitetin. Meqenëse teizmi e pranon Zotin si Krijuesin racional, të vetëdijshëm dhe të fuqishëm të universit, struktura rationale e universit mund të kuptohet lehtë. E vetmja gjë që një materialist-ateist mund të thotë si shpjegim është se, materia gjithmonë i ka pasur këto veti. Sidoqoftë, siç është rënë dakord nga ateistët materialist, thelbi i materies nuk ka asnjë lidhje me racionalitetin; prandaj, nuk ka asnjë arsye për të pritur që një njësi e tillë të ketë një strukturë rationale. E armatosur me arritjet shkencore në shfaqjen e këtij rendi spektakolar në univers, qasja teiste përdor ligjet e natyrës për të arritur në "çështjen" më të thellë prapa këtij rendi. Si përfundim, ndërsa teizmi shpjegon ekzistencën e ligjeve të natyrës që e bëjnë universin një strukturë të përshtatshme për racionalitetin, ateizmi-materialist nuk mund të sigurojë një shpjegim të kënaqshëm për këtë çështje.

²⁹ Ndërsa tipare të tilla të universit janë kushtet "e jashtme" që mendja të kuptojë universin, vetitë e mendjes që do të diskutohen nën titullin "argumentet e natyrës (njerëzore)" në faqet vijuese (shih sidomos argumentet 10, 11 dhe 12) janë kushtet "e brendshme" që mendja të kuptojë universin.

Vlerësimi i pikës 3.2: Një pikë tjetër që duhet të shpjegohet është se ligjet e natyrës janë universale në çdo pikë të botës dhe të njëjtat ligje janë të vlefshme në të gjitha hapësirat e ndryshme të universit. Besimi se ligjet e natyrës janë të vlefshme në vende të ndryshme të universit, pra, edhe në të kaluarën, edhe në të ardhmen, është një nga elementet më themelore të shkencës. Kjo veti e ligjeve të natyrës na jep mundësinë që nëpërmjet zbulimeve shkencore, të mund të bëjmë parashikime për të kaluarën dhe të ardhmen. Siç theksoi filozofi i Oksfordit, Richard Swinburne, nëse të gjitha monedhat e gjetura në një sit arkeologjik kanë të njëjtat shënime ose nëse të gjitha dokumentet në një dhomë janë shkruar me të njëjtin shkrim dore, ne do të kërkonim një shpjegim që do të na çonte në zanafillën e përbashkët për këtë situatë.³⁰ Duhet të ketë një shpjegim të përbashkët për këtë rregullsi, e cila është e vlefshme në mënyrë të njëjtë në të gjithë universin dhe është e vlefshme tani, ashtu siç ishte dje. Pra, ajo shfaqet në një hapësirë të gjerë dhe brenda një periudhe të gjatë kohore. Imagjinoni për grimcat themelore siç janë kuarkat, shumica e të cilave është shumë herë më e madhe sesa kuadrilion herë kuadrilion dhe të gjitha i binden të njëjtave ligje. Thjesht është e pamundur që e gjithë kjo ekzistencë t'i atribuohet rastësisë. Materialistët-ateistët përveç pretendimit se kjo "domosdoshmërisht" duhet të jetë kështu, nuk është se kanë ndonjë zgjidhje tjetër. Por, vetëm duke deklaruar se kjo është një "domosdoshmëri", në të vërtetë asgjë nuk sqarohet. Këtu "domosdoshmëria" konsiston vetëm me përpjekjen për të mbuluar/fshehur diçka. Brenda paradigmës materialiste-ateiste nuk gjejmë dot përgjigje të kënaqshme rreth asaj se çfarë e bënë këtë të domosdoshme.

Një prej elementeve qendrore në teizëm është besimi në ekzistencën e vetëm një Zoti (Wahdaniyyah). Ky botëkuptim ontologjik paraqet një lehtësim për të kuptuar se përse të njëjtat ligje janë të vlefshme në fusha të ndryshme, sepse sipas kësaj, krijuesi i të gjitha pikave të ndryshme dhe të largëta është Zoti, kështu që nuk ka asgjë të papritur dhe të habitshme në këtë situatë. Kurse nga ana tjetër, materializmi-ateizmi nuk mundet dot ta shpjegojë arsyen se përse kjo është kështu. Edhe sistemet e besimeve politeiste, të cilat ne nuk i konsiderojmë si një alternativë serioze kundër teizmit në këtë libër, nuk është se mund të japin shpjegime se si bëhet që të njëjtat ligje të zbatohen kudo në univers; përkundrazi, ato ia atribuojnë fuqinë pjesëve të ndryshme të natyrës duke e përjashtuar unifikimin e ligjeve. Në fakt, sipas logjikës së besimit të tyre, do të duhej që ligjet e ndryshme të mbizotërojnë në pjesë të ndryshme të universit dhe botës, ose do të

³⁰ Richard Swinburne, **Tanrı Var mı?**, Çev: Muhsin Akbaş, Arasta Yayınları, Bursa, 2001, f. 44

duhej që të krijohej kaos për shkak të konfliktit ndërmjet fuqive.³¹ Prandaj, asnjë ontologji tjetër përveç teizmit nuk e shpjegon siç duhet vlefshmërinë e ligjeve të natyrës në vende dhe kohë të ndryshme të botës.

Vlerësimi i pikës 3.3: Një nga elementet më të rëndësishme të sistemit (paradigmës) të paraqitur nga fetë teiste është se, ato shpjegojnë një mjedis ku njerëzit mund të zgjedhin midis së mirës dhe së keqes me vullnetin e tyre dhe që Zoti nuk e detyron ndokënd të besojë, pasi kjo botë është një botë e sprovave. Një nga pretendimet më të rëndësishme të këtyre feve është se njerëzit janë përgjegjës për veprimet e tyre. Vargu/ajeti vijues i Kuranit është shembull i vargjeve që përshkruajnë këtë situatë:

“Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën për t’ju provuar, se cili prej jush është më veprmirë. Ai është Ngadhënjyesi, Mëkatfalësi.”³²

Me besimin se "kjo botë është një vend sprove" jepen përgjigje për shumë pyetje ekzistencialiste, si dhe me këtë ngulitet një pikëpamje shumë themelore për veprimet e besimtarëve, për të cilat "do të jenë përgjegjës para Zotit". Se si kjo çështje e rëndësishme e fushave si morali dhe filozofia ekzistencialiste ndërlidhet me shkencat natyrore (veçanërisht fizikën dhe ligjet natyrore në përgjithësi), mund të duket shumë e vështirë në shikim të parë. Ne mund t’i parashikojmë rezultatet e veprimeve tona vetëm në një mjedis të rregulluar nga ligjet, dhe ne mund të jemi përgjegjës për veprimet tona vetëm nëse mund t’i parashikojmë rezultatet e tyre. Le të mendojmë rreth këtij shembulli:

Nëse dikush e shtyn një person të pafajshëm në buzë të një shkëmbi të lartë, lehtë mund të konkludojmë se veprimi i shtytësit është i gabuar. Si qenie njerëzore ne mund ta dënojmë këtë sjellje dhe nëse jemi të kualifikuar për të qenë gjykatës, mund ta gjykojmë lehtësisht personin që e bën këtë vepër. Por përpiquni për një moment ta imagjinoni një botë pa ligje të natyrës: një botë ku njerëzit njëherë shtyhen përpara, e njëherë tjetër prapa, njëherë fluturojnë papritmas, e njëherë tjetër shpartallohen; kur bijnë nga shkëmbi njëherë u bëhen organet më të fuqishme, e njëherë tjetër në vend të dhimbjes, ndjejnë kënaqësi. Meqë në një botë të këtillë është e pamundur për shtytësin ta parashikojë se çfarë do të ndodhë me personin po e shtyn, ai nuk mund të jetë

³¹ Në ajetin 21 të sures El-Enbija, tërhiqet vëmendja mbi këtë çështje.

³² Surja El-Mulk, 2.

përgjegjës për këtë veprim. (Siç u theksua edhe më parë, fakti që duhet të ketë ligje të natyrës nuk do të thotë që këto ligje duhet të jenë të domosdoshme. Ligjet e natyrës mund të kenë gjithashtu një natyrë të mundshme/probabiliste, por kjo strukturë probabiliste nuk duhet të krijojë një strukturë kaotike në të cilën nuk mund të parashikohen pasojat e veprimeve.)

Në fakt në një ambient ku mbizotëron kaosi, e jo ligjet e natyrës, nuk do të ishte e mundur as jeta dhe as mësimi i ndonjë gjuhe; nuk do të ishte e mundur as edhe arritja e një niveli të mjaftueshëm të inteligjencës për t'u sprovuar. Me ndryshimin e pasojave që shkaktajnë veprimet dhe me ndryshimin e sendeve pas emërimit të tyre do të pamundësohej përcaktimi i tyre se çfarë janë. Le ta përkujtojmë se në tekstet e feve teiste përmendet veçanërisht aftësia për të folur si një nga vetitë më të rëndësishme të hazreti Ademit; "njeriu si përgjegjës" ka zënë vendin e tij në botë me aftësinë e tij për të folur gjuhë (të mund të flasësh gjuhë në një mjedis ku ka ligje të natyrës është vetëm një nga kushtet e nevojshme për të jetuar).³³

Me pak fjalë, pretendimi themelor i feve teiste se "ne jemi në një botë testimi/sprove dhe jemi përgjegjës për veprimet tona" mund të realizohet vetëm në një mjedis ku ka ligje të natyrës. Ekzistenca e ligjeve natyrore është një situatë që pritet nga teistët, por nuk ka asnjë element që e bën një fenomen të këtillë të zbatueshëm në ateizmin materialist. Kjo çështje (e theksuar te pika 3.3) është se, struktura rationale e universit shpjegohet më mirë përmes ekzistencës së një Zoti racional, të vullnetshëm, të vetëdijshëm i cili qëndron prapa ligjeve të natyrës (shënuar në pikën 3.1). Gjithashtu, kombinimi i vlefshmërisë së ligjeve të njëjta të natyrës në hapësira të ndryshme të universit dhe në periudha të ndryshme kohore përmes shpjegimit të teizmit mbi besimin në një Zot (shënuar në pikën 3.2), na dërgon në përfundimin se ekzistenca e ligjeve të natyrës na shtynë deri te preferimi i shpjegimit teist para atij ateist-materialist.

³³ Shih: Surja El-Bekareh, 31.

NËNKAPITULLI I TRETË

ARGUMENTI I ZBULUSHMËRISË SË GJITHËSISË

III.

ARGUMENTI I ZBULUESHMËRISË SË GJITHËSISË

Ne nuk kemi kontroll vullnetar të rrahjeve tona të zemrës, por mendja jonë mund të arrijë yjet. Ne jemi si një pikë e vockël në krahasim me pafundësinë, megjithatë jemi në gjendje ta shqyrtojmë plotësisht kuptimin e pafundësisë. Në këtë gjërësi të universit, sistemi ynë diellor është si një pikë; toka jonë është në këtë sistem dhe ne në të jemi si pika gjithnjë e më të vogla. Pavarësisht nga dobësia e tyre e madhe, është e pamundur të mos habitesh nga njeriu i cili dërgon automjete në qiell dhe prodhojnë teori për fillimin e universit siç është Big Bangu, si dhe nga aftësia e tyre për të menduar dhe reflektuar mbi mendimin e tyre, i cili depërton edhe në mikro botë siç janë qelizat dhe atomet e tyre. Mahnitja jonë do të rritet vazhdimisht ndërsa reflektojmë gjithnjë e më shumë në elementet që i bëjnë të mundshme të gjitha këto.

Shumë shkencëtarë e kanë eksploruar universin pa menduar mbi fenomenin e mundësisë së zbulueshmërisë së vetë universit, siç ishte rasti me ekzistencën e ligjeve të natyrës të diskutuara në titullin e mëparshëm. Shkencëtarët me këtë gjendje janë si këngëtarët që këndojnë pa menduar për litarët e tyre vokale ose atletët që vrapojnë pa menduar për këmbët e tyre; ata shpesh përqendrohen aq shumë në këndimin dhe vrapimin e tyre, saqë as nuk mendojnë se çfarë i bën të mundura ato. Kur kordat/litarët e tyre vokale sëmuren ose këmbët e tyre dëmtohen, ata mendojnë për to, por ky është më shumë një objektivizim që synon të përpiket ta shërojë sëmundjen. Nuk është qëllimi i këtij objektivizimi të kuptuarit se si kordat/litarët e zërit krijojnë tingullin ose detajet e fiziologjisë së këmbës ose si i posedojnë këto karakteristika. Në mënyrë të njëjtë, kur shkencëtarët përpiqen të zbulojnë veçori në univers, ata synojnë vetëm t'i zbulojnë ato; fizikani kërkon të mësojë për ekzistencën e grimcës Higgs (e quajtur edhe si grimca e Zotit) ose të zbulojë funksionimin e organeleve brenda qelizës biologjike. Por janë të pakët (madje edhe në mesin e shkencëtarëve teist) pyetësit e pyetjeve, "Si është e mundur që matematika që mundësoi zbulimin e kësaj grimce të përshtatet me universin?" ose "Si është e mundur që ne jemi në një univers të tillë që na mundëson të prodhojmë mikroskopin dhe të zbulojmë organelet qelizore falë ligjeve të optikës?".

Nëse nuk do të ishte mundësia për zbulueshmërinë e universit krahas ekzistencës së ligjeve të natyrës, përsëri ne nuk do të ishim në gjendje të bënim shkencë. Në kapitullin e mëparshëm, ne u nisëm nga pyetja se si janë të mundshme ligjet e natyrës, kurse këtu fokusi ynë do të jetë në zbulueshmërinë e universit. (Ekzistenca e ligjeve të natyrës është gjithashtu një nga parakushtet

që të zbulueshmërisë së universit; meqenëse kjo çështje u trajtua më parë, parakushte të tjera përveç kësaj do të diskutohen këtu.) Angazhimet shkencore bëhen me përpjekjen për ta zbuluar universin. Mirëpo, rezultatet e përpjekjeve shkencore tregojnë vetëm atë që mund ta zbulojmë në univers dhe nuk japin përgjigje ndaj pyetjeve se si bëhet që universi ka strukturë të zbulueshme. Kur e shqyrtojmë këtë çështje duhet të dalim jashtë kufijve të shkencës eksperimentale dhe vëzhguese dhe të hyjmë në fushën e filozofisë. Këtu do të jap një argument se pse pikëpamja e teizmit duhet të përzgjidhet si më e saktë në raport me atë të ateizmit-materialist në shpjegimin e fenomenit të zbulueshmërisë së universit :

1. Pavarësisht nivelit shumë të lartë të pafuqisë, qeniet njerëzore bëjnë zbulime shumë të rëndësishme në univers.
2. Teizmi ose ateizmi-materialist mund ta shpjegojnë fenomenin e mundësisë së zbulueshmërisë së universit.
3. Teizmi shpjegon mundësinë e zbulimit të universit më mirë sesa ateizmi-materialist, sepse:
 - 3.1 E shpjegon më mirë përshtatshmërinë e matematikës me universin, që është një element i rëndësishëm i zbulueshmërisë së universit.
 - 3.2 E shpjegon më mirë ekzistencën e ligjeve që e bëjnë të mundur hulumtimin/zbulimin e universit.
 - 3.3 E shpjegon më mirë jetesën në një univers ku mund të bëhen mjete përmes të cilave është i mundur hulumtimi i gjithësisë.
 - 3.4 E shpjegon më mirë ekzistencën e të dhënave dhe evidencave të rëndësishme që e mundësojnë zbulimin/hulumtimin e universit.
4. Si rezultat, shpjegimi i teizmit duhet të përzgjidhet si më i saktë në raport me atë të materializmit-ateizmit.

Teistët dhe ateistët-materialistë do të bien dakord lehtësisht në pikën e parë të këtij argumenti. Kushdo që shqyrton pozicionin njerëzor dhe strukturën biologjike të qenieve njerëzore përballë përmasave të universit, mund ta kuptojë lehtësisht pafuqinë e qenies njerëzore. Nga ana tjetër, arritjet shkencore siç është mundësia për të ekzaminuar se çfarë po ndodh në univers miliarda vite drite larg dhe duke klasifikuar miliona gjallesa në botë janë gjithashtu arritjet e këtij njeriu të pafuqishëm.

Aftësia për të objektivizuar dhe ekzaminuar miliona gjallesa nga një distancë e largët prej miliarda viteve drite, aftësia për të depërtuar në këto hapësira me teori, për të bërë hulumtime me teleskop në makro-gjithësi dhe vëzhgimin e mikro-botës me mikroskop –që do të thotë zbulimi/hulumtimi i universit, pra aftësia për të bërë shkencë– kanë nevojë për një shpjegim. (Gjithashtu, përveç faktit që universi është i zbulueshëm, është gjithashtu e rëndësishme se si njeriu ka kapacitet për ta kryer këtë veprim. Kjo çështje e rëndësishme do të diskutohet në titullin "argumentet e natyrës së njeriut", veçanërisht në titujt që lidhen me mendjen, vullnetin dhe vetëdijen.). Vetëm shpjegimet gjithëpërfshirëse që përfshijnë një strukturë të tillë të të gjithë universit mund të konsiderohen të shpjegueshme dhe të mjaftueshme. Edhe këtu, hasim në dy kandidatë kundërshtarë për këtë shpjegim: teizmin dhe ateizmin materialist.

Në këtë argument, pika e tretë është objekti ndaj të cilit do të kenë kundërshtime ateistët-materialistët. Nuk është e mundur që një materialist-ateist të pranojë çështjet e renditura në pikën e tretë. Sepse kur këto pranohen, rezultati i argumentit do të rrjedhë si një përfundim logjik. Pika kritike e argumentit të paraqitur këtu është pika e tretë dhe katër nën-pikat (specifikuar në 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4) kritike që e përbëjnë atë. Kjo na çon në përfundimin të pika e katërt e argumentit se, "shpjegimi i teizmit duhet të përzgjidhet para atij ateist-materialist".

Vlerësimi i pikës 3.1: Falë strukturës matematikore të universit janë bërë shumë zbulime të rëndësishme shkencore dhe shpikje teknologjike, siç është aftësia për të diskutuar rreth fazave të hershme të universit, përdorimit të kompjuterëve, funksionimit të telefonave celularë dhe dërgimit të satelitëve në hapësirë. Përputhshmëria e matematikës me universin ka një rol vendimtar në zbulimin e universit. (Në fakt, gjithashtu është e mundur që kjo çështje të trajtohet si argument i veçantë). Ky fenomen shpesh u ka shpëtuar prej syve shumë fizikantëve që janë preokupuar me matematikë. Edhe pse disa prej tyre e kanë tejkaluar këtë gjë, shumë filozofë, matematikanë dhe fizikanë të caktuar e kanë çmuar rëndësinë e pyetjeve themelore pas zbatueshmërisë së matematikës në strukturën e universit.. Matematikani dhe fizikani i famshëm Eugene Wigner shprehu habinë e tij për këtë fenomen duke thënë, "*Mrekullia e përshtatshmërisë së gjuhës së matematikës për formulimin e ligjeve të fizikës është një dhuratë e mrekullueshme që as nuk e kuptojmë dhe as nuk e meritojmë.*"³⁴ Antony Flew, i cili tregohet si ateisti më i sofistikuar i

³⁴ Eugene Wigner, "**The Unreasonable Effectiveness of Mathematics in the Natural Sciences**", Communications in Pure and Applied Mathematics, Vol: 13, No: 1, Şubat 1960

shekullit të XX-të, harmonin në mes të natyrës dhe matematikës e llogariti si një nga arsyet e braktisjes së ateizmit dhe fillimit të besimit në ekzistencën e Zotit.³⁵ Emrat më të rëndësishëm të revolucionit shkencor të shekullit të XVII-të si Dekarti, Kepler, Galileo, Leibniz dhe Njutoni e kanë parë matematikën si gjuhën në të cilën Zoti shkroi universin.

Mund të merren dy qasje themelore të ndryshme rreth vetë matematikës. E para nga këto është qasja eksploruese; sipas kësaj të vërtetat e matematikës ishin të vlefshme edhe përpara se universi të ekzistonte dhe matematika është e vlefshme në çdo univers të mundshëm, d.m.th., thënie të tilla si " $3 + 7 = 10$ " dhe "11, 13, 17 janë numra natyral" shprehin të vërteta universale. Qasja tjetër është qasja shpikëse; që e sheh matematikën si një produkt të mendjes njerëzore. Ne bëjmë matematikë nëpërmjet aksiomave, prandaj është e pakuptimtë të flasësh për të si diçka që është transcendentë në univers. Këto qasje shkaktojnë mosmarrëveshje serioze midis matematikanëve dhe filozofëve të matematikës. Këtu, unë nuk do të mbroj ndonjë nga këto dy pikëpamje.

Nëse qasja eksploruese është e saktë, atëherë matematika është e vlefshme pavarësisht nga universi. Këtu lind pyetja se si është e mundur që objektet matematikore, të cilat janë objekte abstrakte, janë në harmoni me universin. Ekzistimi i të vërtetave matematikore dhe përshtatshmëria e universit me strukturën e matematikës (e cila është shumë e rëndësishme për mundësinë e zbulueshmërisë së universit) janë fenomene të pavarura nga njëra tjetra. Objektet matematikore janë abstrakte nga përkufizimi dhe një nga tiparet më të rëndësishme të strukturave abstrakte është se ato nuk hyjnë në një lidhje shkakësore. Për shembull në ekuacionin " $3 + 7 = 10$ ", as numri 3 as 7, e as operacioni i mbledhjes dhe as numri 10 nuk përcaktojnë shkakësisht diçka në univers. Vetë numrat nuk ju japin 3 ose 7 dollarë, ose nuk ju jalin shumën e tyre 10 dollarë. Nëse matematika abstrakte nuk përcakton strukturat në univers, atëherë pse universi (një entitet i pavarur nga matematika) është i përshtatshëm me të? Ateizmi materialist nuk i jep asnjë përgjigje kësaj pyetjeje dhe përgjigja e "rastësisë fatlume" nuk është aspak e kënaqshme. Nga ana tjetër, teizmi mund të shpjegojë përshtatshmërinë e matematikës me universin duke thënë se Zoti e krijoi universin në përputhje me strukturën e tij matematikore dhe kështu bëri të mundur hulumtimin/zbulimin.

³⁵ Antony Flew, **There Is A God: How The World's Most Notorious Atheist Changed His Mind**, Harper Collins, New York, 2007, f. 96-112.

Nëse qasja shpikëse është e saktë, kjo qasje mund të thotë që matematika është një shpikje e mendjes njerëzore, por sigurisht nuk mund të thotë se universi është një shpikje e mendjes njerëzore. Nëse matematika është thjesht një shpikje e mendjes njerëzore, koherenca e saj me universin është e papritur po aq sa akordimi i shfaqur nga loja e shahut (gjithashtu produkt i mendjes njerëzore)?³⁶ Atëherë si lindi kjo përputhje e cila e mundësoi zbulueshmërinë e shkencës dhe universit? Fuqia e matematikës e mundësoi propozimin e grimcave të Higgs shumë më përpara zbulimit të saj eksperimental. Nën udhëheqjen e kësaj teorie dhe pas shpenzimit të miliarda dollarëve për studime, 48 vjet më vonë, grimca Higgs u zbulua mu ashtu siç tregonte teoria.³⁷ Nëse materialistët-atëistë si përvetësues të qasjes shpikëse, ia atribuojnë rastësisë fatlume “fenomenin e përshtatshmërisë” së matematikës me universin, a do ta vlerësonit këtë qasje të shpjeguar mirëmjaftueshëm? Koherenca e këtillë dhe aftësia konsekuente për të bërë parashikime gjithëpërfshirëse nuk mund të shpjegohen vetëm përmes koincidencës ose duke e konsideruar çështjen si diçka që nuk ia vlen të shpjegohet. Teistët, të cilët përvetësohen me qasjen shpikëse, e shohin pikëtakimin e universit me matematikën si rezultat të Zotit dhe nuk kanë asnjë problem për të shpjeguar këtë fenomen të rëndësishëm. Si përfundim, përshtatshmëria e matematikës me universin, i cili është një fakt shumë i rëndësishëm për zbulimin e universit, mund të shpjegohet më me sukses nga teizmi sesa ateizmi-materialist pavarësisht nëse ajo miraton një qasje eksploruese apo shpikëse të matematikës.

Vlerësimi i pikës 3.2: Lidhur me zbulimin e natyrës, disa ligje të fizikës janë të domosdoshme dhe pa to zbulimi i universit do të ishte krejtësisht i pamundur. Edhe ligjet e optikës që e bëjnë të mundur shikimin janë shembull për këtë. Ka edhe ligje të tjera të caktuara, pa të cilat vetëm një pjesë e zbulimeve do të kishin qenë të pamundura; në këtë rast Efekti Doppler mund të jepet si shembull.

Syri i njeriut është disa centimetra katrorë, por me këtë sy ne e vështrojmë universin e gjerë. Sytë tanë të vegjël përshkojnë yje shumë më të mëdhenj sesa dielli ynë. Sigurisht, nuk ka asgjë magjike në lidhje me këtë, falë ekzistencës së ligjeve të optikës të përshkruara nga fizika, struktura shumë të mëdha mund të bëhen të dukshme për syrin tonë të vogël. Vini re se fizika përshkruan ligjet e optikës, por nuk shpjegon pse jemi në një univers ku ekzistojnë ligjet e tilla.

³⁶ Caner Taslaman ve Enis Doko, **Kuran ve Bilimsel Zihnin İnşası**, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2015, f. 79.

³⁷ Caner Taslaman, “**Tanrı Parçacığı: Felsefi Bir Değerlendirme**”, Felsefe Dünyası, No: 56, 2012, f. 78-93

Asnjë zbulim shkencor nuk do të ishte i mundur pa ligjet e optikës, madje edhe mbijetesia e specieve njerëzore nuk do të ishte e mundur, sepse pa këto ligje nuk do të kishte shikim. Këto ligje dhe aftësia rezultuese e të parit janë pjesë të faktorëve që e lejojnë njeriun të reflektojë mbi universin e gjerë, megjithë vogëlsinë e tyre ekstreme. Një univers alternativ ku një pikë kaq e vogël nuk mund ta vëzhgojë të gjithë hapësirën është logjikisht i mundur; sepse logjikisht, ligjet e natyrës nuk detyrohen të ekzistojnë në këtë mënyrë. Në të vërtetë, në një univers pa dritë nuk mund të flitet për ligje të optikës dhe të gjithë e dimë që ekzistenca e dritës nuk është logjikisht e domosdoshme. Falë pranisë së valëve, Efekti Doppler na lejon të zbulojmë lëvizjen relative. Me këtë efekt ne mund ta kuptojmë nëse burimi i një tingulli largohet apo jo; madje mjetet e policisë rrugore matin shpejtësinë e automjeteve bazuar në këtë efekt. Informacionet e përfituara në lidhje me zgjerimin e universit, i cili është një nga zbulimet më të rëndësishme të kozmologjisë, mundësoi konstatimin se falë këtij efekti galaktikat që janë miliarda vite dritë në distancë largohen nga njëra-tjetra. Duke përdorur ligje të tilla, akumulimi i dijeve shkencore dita ditës po shtohet, por për zbulime të tilla shkencore rreth universit paraprakisht duhet të ekzistojnë ligje të tilla. Ata që ndjekin studime shkencore hasin në shumë shembuj të ekzistencës së ligjeve të tilla që bëjnë të mundur zbulimin/hulumtimin e universit.

Sipas paradigmës së teizmit Zoti e ka bërë universin në një strukturë të mundshme për tu zbuluar/hulumtuar, sepse shërben për ta kuptuarit fuqinë dhe artin e Tij; dhe nuk është për t'u habitur që në këtë model ligjet optike dhe efekti Doppler i shërbejnë këtij qëllimi. Mirëpo brenda paradigmës materialiste-ateiste fakti që universi e ka këtë strukturë nuk vlerësohet si produkt i ndonjë qëllimi, sepse ligjet dhe proceset e universit nuk kanë ndonjë qëllim. Atëherë jemi përballë dy opsioneve: ose kaq shumë ligje të ndryshme i shërbejnë zbulimit të universit si një rregullim i qëllimshëm siç shpreh teizmi, ose e gjithë kjo është një rastësi fatlume siç thuhet nga materialistët-ateistët. Ne mund t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje duke iu përgjigjur pyetjes së mëposhtme: A duhet të befasohet një teist apo një ateist-materialist që ligjet e përmendura shërbejnë kaq shumë për zbulimin/hulumtimin e universit? Cilado paradigmë që e sheh situatën aktuale më pak të habitshme është më afër të vërtetës. Nuk ka asgjë konfuze për sa i përket teistit dhe kjo situatë është shumë befasuese për pikëpamjen ateiste-materialiste që, për njeriun me një paaftësi/pafuqi të tillë ekzistokan kaq shumë mundësi për të bërë zbulime shumë të rëndësishme për universin. Ndërsa paradigma teiste jep shpjegime të arsyeshme për ta kuptuar faktin madhështor se, zbulimi i universit varet nga ekzistenca e shumë ligjeve të tilla natyrore dhe se këto ligje ekzistojnë dhe

kontribuojnë shumë në zbulimin/hulumtimin e universit, nga ana tjetër paradigma materialiste nuk mund të ofrojë një shpjegim të tillë.

Vlerësimi i pikës 3.3: Përveç faktit se përputhja në mes matematikës, universit dhe ligjeve të natyrës ofron shumë mundësi për të zbuluar universin, një tjetër element shumë i rëndësishëm që bën të mundur zbulimin e universit janë mjetet e përdorura në aktivitetet shkencore. Për shembull, të shqyrtojmë teleskopin dhe mikroskopin: me anë të teleskopit u bë e mundur të merren informacione për vendet shumë të largëta, së pari u bë objekt i zbulimeve shkencore sistemi ynë diellor dhe më pas pjesët më të largëta të universit. Ndërsa me anë të mikroskopit u bë i mundur depërtimi në mikro botën dhe mund të thuhet se shpikja më e rëndësishme që bëri të mundur biologjinë moderne është mikroskopi.³⁸

Një nga instrumentet më të rëndësishme që bën të mundur hulumtimin/zbulimin e universit është prodhimi i mjeteve të tilla. Por zbulimi i këtyre mjeteve është i mundur edhe falë strukturës së universit. Pavarësisht se sa inteligjentë janë njerëzit, pavarësisht sa e përshtatshme është matematika për universin, pa marrë parasysh sa ligje ndihmojnë në zbulimin e universit; nëse universi nuk do të kishte përmbajtur lëndët e para për prodhimin e teleskopëve dhe mikroskopëve, prodhimi i këtyre instrumenteve nuk do të ishte i mundur.. Përveç kësaj nëse lëndët e para të universit nuk do të ishin të favorshme për prodhimin e mjeteve tjera, nuk do të kishte as kompjuterë, as satelitë, as përsheptues të grimcave... Këtu duhet të shtrojmë pyetjen vijuese: si ndodh që erdhëm në një univers të këtillë, në të cilin lëndët e para dhe potenciali i tij na favorizojnë të krijojmë mjete shumë të rëndësishme për të eksploruar universin? Për sa i përket pikëpamjes së ofruar nga teizmi, nuk është për t'u habitur mundësia e ndërtimit të mjeteve që mundësojnë zbulimin e universit. Ndërsa për sa i përket ateizmit-materialist, kjo është gjithashtu një rastësi fatlume. Në një univers me kushte të përshtatshme për të bërë shkencë, misterin e jetesës sonë teizmi e shpjegon më mirë se materializmi-ateizmi.

Vlerësimi i pikës 3.4: Një faktor tjetër i rëndësishëm që e bën universin të mundshëm për t'u zbuluar është se, shumë të dhëna dhe prova të rëndësishme që do të çojnë në zbulime të mëdha

³⁸ Shih: Catherine Wilson, **The Invisible World Early Modern Philosophy and the Invention of the Microscope**, Princeton University Press, Princeton, 1995.

presin të zbulohen diku në univers. Unë mund të jap si shembull rrezatimin e sfondit kozmik, radiokarbonin dhe izotopin e atomit të karbonit të pranishëm në trupin e qenieve të gjalla.

Rrezatimi i sfondit kozmik u zbulua në shekullin e XX-të; ky rrezatim është i përhapur në të gjithë universin, kështu konfirmon teoria e Big Bang (Shpërthimit të Madh) dhe siguron informacione të rëndësishme për fazat e hershme të universit. Pasja e një të dhëne të këtillë luajti rol të rëndësishëm për faktin se njeriu, i cili është si një pikë në univers, mund të flasë për origjinën e tërë universit dhe të bëjë zbulime për periudhat e tij të hershme. Radiokarboni është një izotop i atomit të karbonit që gjendet në trupin e gjallesave dhe falë vetive fizike të këtij izotopi është e mundur të datohen fosilet e kafshëve, bimëve, pjesëve të pemëve dhe të lëkurës të gjetura në gërmimet arkeologjike. Ky proces datimesh ka luajtur një rol të rëndësishëm për të kuptuar se sa vite më parë speciet e gjalla jetonin në botën tonë dhe sa vite më parë ishin në skenën botërore civilizimet e gjetura në gërmimet arkeologjike. Shumë të dhëna të ngjashme me këto janë vlerësuar në procesin e zbulimit të universit. Shkenca lëviz drejt qëllimit të saj bazuar në këto të dhëna por, "Pse ka të dhëna të tilla?" është një pyetje që pret përgjigje pa i përdorur këto të dhëna. Ne mund të shtrojmë pyetjen tonë si më poshtë: cili është shpjegimi për ekzistencën e të dhënave dhe argumenteve që na mundësojnë të bëjmë zbulime shumë të rëndësishme mbi universin, pavarësisht se jemi një specie shumë e pafuqishme? Duke parë këtë situatë si rezultat i një rregullimi të vetëdijshëm, në këtë drejtim teizmi ofron një shpjegim më të suksesshëm sesa ateizmi-materialist.

Me pak fjalë zbulueshmeria e universit bëhet e mundshme nga kombinimi i shumë fenomeneve sikurse; përputhja/harmonia e matematikës me universin (3.1), fakti që disa ligje të natyrës i bëjnë të mundshme zbulimet (3.2), që ne jetojmë në një univers ku mund të prodhohen mjetet që mundësojnë hulumtimin e universit (3.3) dhe ekzistenca e shumë të dhënave e argumenteve që mundësojnë këto zbulime (3.4). Ndërsa ky fenomen është i papritur për sa i përket ateizmit-materialist për teizmin nuk ka asgjë të papritur, i cili thotë se ekuilibre të tilla krijohen me vetëdije. Qindra vargje/ajete të Kuranit që na nxisin të mendojmë për universin janë shembujt më të mirë se pse zbulimi i universit pritet, madje është i dëshirueshëm për sa i përket teizmit. Duhet të kujtojmë gjithashtu se në periudhën kur këto vargje u drejtoheshin njerëzve, një kulturë shkencore që i kushton rendësi zbulimit të universit nuk ishte e përhapur. Një shembull i ajeteve të Kuranit që inkurajon njerëzit të reflektojnë rreth universit dhe të nxjerrin konkluzione:

“A nuk shikojnë ata me vëmendje kah qielli, se si mbi ta kemi ndërtuar atë, e kemi zbukuruar atë duke mos pasur në të ndonjë zbrazëti. Edhe tokën se si e kemi shtrirë, e në të kemi vendosur kodra përforcuese dhe kemi bërë që në të të mbijnë gjithfarë bimësh të bukura.”³⁹

Teizmi duhet të përzgjidhet para ateizmit-materialist sepse ofron një shpjegim më të mirë të çështjes se si mund të zbulohet/hulumtohet universi (mundësia për të bërë shkencë). Njohuritë tona në rritje tregojnë fuqinë tonë, por në të njëjtën kohë vënë në pah edhe pafuqinë tonë; argumenti i paraqitur këtu shpjegon se pse kjo nuk është paradoksale. Jemi të pafuqishëm përballë fuqisë së pakufishme të Zotit dhe krijimeve madhështore të Tij, por ne në të njëjtën kohë pavarësisht nga vogëlsia dhe pafuqia jonë në gjithë këtë univers të jashtëzakonshëm jemi në gjendje ta zbulojmë atë sepse krijuesi ynë e bëri universin të tillë.

³⁹ Surja Kaf, 6-7.

NËNKAPITULLI I KATËRT

ARGUMENTI I POTENCIALIT TË GJIHËSISË

IV.

ARGUMENTI I POTENCIALIT TË GJIHËSISË

Pavarësisht se sa jeni të aftë, ju mund të ndërtoni vetëm atë që jua lejon potenciali i diçkaje. Potenciali i një gjëje i referohet të gjitha gjendjeve të saj të mundshme që mund të ndodhin. Për shembull mendoni legot⁴⁰ që dalin nga një kuti; nga këto lego ju mund të bëni një makinë lodër, një shtëpi ose një gjirafë, por edhe nëse të gjithë njerëzit më të zgjuar në botë mbledhen së bashku ata nuk mund të krijojnë një makinë, një shtëpi, një gjirafë të vërtetë nga këto lego. Ato nuk kanë potencial të mjaftueshëm për të qenë përbërëse e gjërave më madhore. Pavarësisht në sa mënyra mund t'i kombinoni këto lego, asnjë prej tyre nuk korrespondon me një makinë, shtëpi ose gjirafë të vërtetë. Në të njëjtën mënyrë, nuk është e mundur të dalë në pah diçka që nuk është në potencialin e universit në të cilin jetojmë.

Ajo që ne perceptojmë me shqisat tona na mundëson të mësojmë rreth potencialit të universit në të cilin jemi duke jetuar; rreth yjeve, planetëve, ujit, qindra mijëra specieve bimore, llojeve të peshqve, zogjve, insekteve, makinave, kompjuterëve, llojeve të ndryshme të muzikës dhe qebapëve. Nëse këto nuk do të ekzistonin në potencialin e universit, ne nuk do të ishim në gjendje t'i shikonim, t'i dëgjonim, t'i shijonim ose t'i ndjenim ato. Sipas tablos së paraqitur nga fizika, universi përbëhet nga grimcat kuarkë dhe me bashkimin e këtyre formohen elementet e sistemit periodik në kimi, numri i të cilave është më pak se 120 (disa prej tyre nuk gjenden natyrshëm, ato janë prodhim laboratorik). Gjithçka në univers, nga yjet e deri te zhanret e muzikës, përbëhet nga grimcat që u çekën më lartë. Këto elementë janë blloqet në kutinë Lego dhe me procese si kombinimi, ndarja, rikombinimi, ndryshimi i fazës, etj gjithçka që vëzhgojmë në univers formohet. Edhe pse kësaj pike nuk i është kushtuar shumë vëmendje, pyetja "si ndodhi që universi posedon një potencial kaq të madh" është një çështje e thellë. Nëse lënda e parë në univers nuk do të kishte potencialin për të zbuluar të gjitha këto, asnjëra prej tyre nuk do të kishte ekzistuar.

Prandaj përballemi me një pyetje shumë të rëndësishme këtu: cili është shpjegimi për një larminë, bukurinë dhe inteligjencën kaq të madhe të potenciali të universit? Unë besoj se diskutimet e bëra mbi këtë potencial të universit do të na çojnë drejt një argumenti shumë të rëndësishme në lidhje me ekzistencën e Allahut. Një tipar i rëndësishëm i këtij argumenti është se,

⁴⁰ Lego është një linjë e lodrave plastike të ndërtimit.

Ai është i pavarur nga çdo zbulim shkencor. Me fjalë të tjera edhe nëse supozojmë se çdo teori: teoria kuantike, teoria e relativitetit dhe teoria e evolucionit janë plotësisht të falsifikuara ose i janë nënshtruar ndryshimeve të rëndësishme, ky argument mbetet i paprekur. Argumentet në këtë pjesë janë krejtësisht filozofike, e jo shkencore. Ekzistenca e tokës, çajit tonë ose muzikës së Mozartit nuk ndikohet nga e vërteta ose e pavërteta e ndonjë teorie. Për shembull, edhe nëse teoria e relativitetit do të falsifikohej, përsëri mund të themi se universi ka potencial për ekzistencën e çajit ose muzikës së Mozartit.

Pamundësia e shfaqjes së diçkaje përtej potencialit të universit është parakusht i logjikës. Të gjitha gjërat që ne i perceptojmë me shqisat tona na tregojnë për potencialin e universit. Edhe nëse dikush pretendon çuditshëm se perceptimi ynë nuk është më shumë se një iluzion, mbetet ende e mistershme çështja se nga buron potenciali që i lejon mendjet tona të bëjnë një imagjinatë kaq të komplikuar. Aspekti që i jep veçanti këtij argumenti është si vijon: edhe në një situatë ekstreme fiktive ku të gjitha ligjet e natyrës janë të pavlefshme dhe i gjithë universi është një iluzion i thjeshtë, argumenti këtu mbetet akoma i vlefshëm. Tani le ta përmbledhim këtë argument, të cilin unë e quaj "argumenti i potencialit të universit":

1. Universi ynë ka potencial ta mundësojë zbulimin e qenieve të pajetë dhe të gjalla; ka potencial të mundësojë prodhime teknologjike dhe artistike.
2. Fenomeni i potencialit të universit, mund të shpjegohet ose nga teizmi, ose nga ateizmi-materialist.
3. Teizmi e shpjegon potencialin e universit më mirë sesa ateizmi-materialist:
 - 3.1 Për shkak se në teizëm është e pritshme që universi të ketë një potencial kaq të lartë të larmisë.
 - 3.2 Për shkak se në teizëm është e pritshme që universi të ketë potencial të përmbajë strukturat dhe veprat artistike të cilat ne i quajmë si "të bukura".
 - 3.3 Për shkak se në teizëm është e pritshme që potenciali i universit të përmbajë strukturën racionale dhe përputhshmërinë me mendjen njerëzore.
 - 3.4 Për shkak se në teizëm është e pritshme që potenciali i universit të ketë vullnet dhe vetëdije.
4. Si rezultat, shpjegimi i teizmit duhet të përzgjedhet si më i saktë në raport me materializmin-ateizmin.

Pika e parë e këtij argumenti i referohet një fenomeni të vëzhgueshëm nga të gjithë. Në univers të gjithë e vëzhgojmë larminë e gjërave jo të gjalla si mineralet; larminë e qenieve të gjalla si kafshët; larminë e prodhimit teknologjik si pajisjet elektronike dhe larminë e veprave artistik si këngët. Është dakordim i përbashkët mes materialistëve-atelistëve dhe teistëve se të gjitha këto nuk do të ishin formuar nëse universi ynë nuk do të kishte potencialin për t'i krijuar. Prandaj mund të themi se, pika e parë e këtij argumenti është një supozim që nuk mund të jetë pikë kontestimi midis materialist-atelistëve dhe teistëve.

Ekzistenca e kësaj larmie të gjerë gjërash në univers është një fakt i jashtëzakonshëm. Të gjitha këto të cilat i përjetojmë vet, nga zogjtë që fluturojnë përreth nesh, nga xhami e deri te gota në dorën tonë, nga telefoni në xhep e deri te melodia e Mozartit në sfond, kanë ardhur në ekzistencë falë potencialit të universit që i bën ato të mundshme. Siç e pamë në argumentet e mëparshme, vetëm qasjet gjithëpërfshirëse janë ato që mund ta shpjegojnë një çështje kaq thelbësore. Pika e tretë është ajo që materialistët-atelistët do ta kontestojnë në këtë argument, sepse nëse kjo pikë është e saktë, si rezultat, shpjegimi teist duhet të përzgjidhet si më i saktë në raport me atë materialist-atelist. Siç mund të shihet këtu, pika e tretë e paraqitur në këtë argumentet është pika më kritike që duhet të përqendrohemi dhe pretendimi ynë do të mbrohet duke i shqyrtuar katër nën-pikat (të paraqitura në 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4) e shprehura.

Metodologjia e përdorur në këtë argument është një tip arsyetimi të cilin shpesh e përdorim në jetën e përditshme. Në këtë qasje, si supozim më i saktë merret ai që është më afër rezultatit dhe të vërtetës. Për shembull, imagjinoni që Albani dhe Besarti hynë në një garë shumë të rëndësishme dhe ju keni ardhur në zonën e garës menjëherë pasi gara të ketë mbaruar; nëse e shihni Albanin shumë të lumtur dhe Besartin të trishtuar ju mund të gjykoni pa e parë garën se Albani ka fituar, sepse ju e dini që Albani pritet të jetë i lumtur nëse fiton garën dhe Besarti të jetë i trishtuar nëse humbet, kurse në rast të kundërt Albani pritet të jetë i trishtuar dhe Besarti i lumtur. Me këtë njohuri kur ta shihni se Albani është i lumtur ndërsa Besarti i trishtuar, do të arrini në përfundimin se Albani fitoi garën. Arsyetimi i përdorur këtu në fakt është një nga arsyetimet të cilin ne e përdorim shpesh; pra, një pikëpamje është e vërtetë bazuar në faktin se është mundësia që të jetë rezultati më i pritur në një situatë të caktuar.

Vlerësimi i pikës 3.1: Ekziston një numër i madh i galaktikave dhe yjeve në univers, si dhe disa miliona specie të qenieve të gjalla (aq sa dijmë deri tani). Ekzistojnë opsione dhe larmi të

shkëlqyera në strukturat e trupit, ne sjelljet, në mënyrën e të ushqyerit dhe në mekanizmat mbrojtëse të këtyre krijesave. Edhe prodhimi teknologjik njerëzor është gjithashtu shumë i larmishëm, duke filluar nga pajisjet më të thjeshta shtëpiake e deri te mjetet më komplekse të transportit. Përveç këtyre, të gjithë jemi dëshmitarë të larmisë së veprave në degë të ndryshme të artit, që nga piktura dhe kinematografia, e deri te drama edhe muzika.

Le të supozojmë për një moment se nuk e dimë që në këtë univers ekziston kaq shumë larmi dhe le të bëjmë pyetjen vijuese: a pritet më shumë nga perspektiva materialiste-ateiste apo nga ajo teiste që të jemi në një univers me kaq shumë larmi? Ne mund të konkludojmë se, cila nga këto pikëpamje ka më shumë gjasa ta mbështesë ndodhjen e një larmie të këtillë, ajo pikëpamje duhet të përzgjedhet si shpjegimi më i saktë në raport me tjetrën. Sipas teizmit, Zoti i ka dhënë universit potencialin që ka, domethënë nuk është për t'u habitur që ky univers përmban potencial për të lejuar që të ndodhë një larmi e tillë, sepse ai u krijua me qëllim. Falë potencialit të universit, ekzistojnë argumente të fuqisë dhe krijimtarisë artistike të Zotit në univers dhe gjithashtu njerëzit mund të bëjnë prodhime teknologjike dhe artistike që janë pjesë e bekimeve dhe sprovave për ta. Por nga ana tjetër sipas pikëpamjes materialiste-ateiste të universit, materia është një qenie pasive dhe e paqëllimtë; prandaj edhe nuk ka ndonjë arsye për ta pritur shfaqjen e ndonjë larmie të tillë. Në të vërtetë, në këtë argument, sipas materializmit nuk është e domosdoshme të pritet aq shumë potencial të universit për sa i përket larmisë; kurse nga ana tjetër, në argumentin në fjalë, ka elemente të mjaftueshme për të treguar se ky potencialitet larmik pritet në teizëm. Diversiteti që vëzhgojmë në univers përbën një argument në favor të teizmit, pasi është e qartë se nga pikëpamja materialiste-ateiste potenciali i universit nuk pritet ta mundësojë formimin e një larmie të tillë.

Vlerësimi i pikës 3.2: Ekzistenca e shumë strukturave në potencialin e universit që ne i quajmë "të bukura" është një fenomen interesant që meriton fokus të veçantë. Qeniet që ne i quajmë "të bukura" shfaqen në një gamë të gjerë fushash, nga ngjyra te krahët e fluturave dhe vazhdon deri te veprat artistike të njerëzve. Këtu le të vëmë re se, për sa i përket këtij argumenti veprat artistike të njerëzve nuk ndryshojnë nga bukuritë në natyrë. Nëse potenciali i universit nuk do të lejonte, krahu i fluturës nuk do të ishte shfaqur, madje as kompozimet e Beethoven-it nuk do të ekzistonin nëse nuk do të ishin notat muzikore në potencialin e universit. Për ta kuptuar më mirë se çfarë kuptojmë me "të bukur", ne duhet të përqendrohemi në gjërat që ne i quajmë "të bukura" dhe t'i marrim parasysh karakteristikat e tyre. Një "entitet i bukur" është diçka që na tërheq, që ne

e konsiderojmë si të çmuar dhe e vlerësojmë krijuesin e saj. Definicioni i saktë i "të bukurës" është një diskutim i vështirë filozofik të cilën nuk mund ta shtjellojmë këtu. Megjithëse është një koncept kaq i vështirë për t'u kuptuar, ne përsëri e përdorim konceptin "e bukur" gjatë selektimit të bashkëshortit/-es, gjatë selektimit të ushqimit, të rrobave ose mobiljeve... (Fakti që ne e përdorim konceptin e vështirë kaq lehtë është një tregues që natyra njerëzore është krijuar për ta përdorur këtë koncept).

Le ta shtrojmë pyetjen tonë si më poshtë: në cilën ontologji, në ate teiste apo në atë materialiste-ateiste, është më e pritur shfaqja e kaq shumë gjërave që ne i përshkruajmë si "të bukura"? Le ta trajtojmë muzikën, si një nga degët më me ndikim të artit. Në pyetjen nëse kompozimet e Beethovent-it apo Mozartit mund të kishin lindur rastësisht (pa qenë produkti artistik i qëllimshëm i një mendjeje), të gjithë ata që përdorin intuitën e tyre artistike do të japin përgjigjen "Jo!" në refren. Pra, ekzistenca e notave në potencialin e universit e mundëson ekzistencën e muzikës, ose thënë më ndryshe, në potencialin e këtyre notave ekziston një potencial që mundëson shfaqjen e kompozimeve të ndryshme të Beethoven-it, Mozart-it dhe mijëra artistëve tjerë; por, se a shpjegohet kjo situatë më mirë brenda kornizave të një krijimi të vetëdijshëm të propozuar nga teizmi apo brenda pikëpamjes së rastësisë së ateizmit materialist? Këtu, intuita jonë e cila nuk ia atribuon rastësisë formimin e një përbërjeje të vetme të Beethoven-it, në asnjë mënyrë nuk duhet t'ia atribuojë rastësisë potencialin e universit që mundëson shfaqjen e një fryti të këtillë madhështor. Sipas pikëpamjes teiste është i mundur konsiderimi se Zoti vendosi një potencial të tillë në univers në mënyrë që njerëzit të mund t'i shijojnë të mirat e tilla siç është muzika. Më e rëndësishme se kjo, është vendosja e kaq shumë "bukurive" në univers (bashkë me perceptimin për "të bukurën" në natyrën njerëzore), përmes të cilave individët mund ta vlerësojnë dhe njohin Krijuesin e tyre. Mos harroni se bukuria konsiderohet e çmuar dhe e nxit vlerësimin e Krijuesit të saj. Por në këndvështrimin materialist-ateist nuk pritet mundësia e shfaqjes së kaq shumë qenieve të ndryshme në univers të cilat ne i vlerësojmë si "të bukura".

Vlerësimi i pikës 3.3: Në univers ekziston një strukturë e përputhshme me mendjen njerëzore e cila prodhon gjëra të mahnitshme. Siç u pa më parë, struktura e përshtatshme për tu kuptuar nga mendja njerëzore u formua falë ekzistencës së ligjeve natyrore, kurse ekzistenca e ligjeve është gjithashtu rezultat i potencialit të universit. Unë nuk do ta përsëris se pse kjo situatë mbështet teizmin pasi ajo është theksuar në pikën 3.1 të seksionit mbi "argumentet e ekzistencës

së ligjeve". Sidoqoftë unë e theksova edhe këtu këtë pikë për të treguar se është e mundur të merret në konsideratë kjo situatë në termat e "potencialit të universit".

Përveç kësaj, ekzistenca e mendjes njerëzore dhe aftësia e saj për të krijuar kaq shumë teori shkencore dhe prodhime teknologjike falë potencialit të universit. Nga teoremat për numrat natyror në matematikë e deri te teoria kuantike, nga kompjuterët me kapacitet të lartë deri te satelitët e dërguar në hapësirë, nga teknologjitë e ndërtimit e deri te teknologjitë mjekësore, të gjitha prodhimet e njerëzimit ekzistojnë falë potencialit të universit që i bënë ato të mundshme. Asgjë që nuk është në potencialin fillestar të universit nuk mund të ekzistojë; këtu përfshihen sikurse yjet neutronike dhe fluturat, ashtu edhe teoremat tona për numrat e thjeshtë. Ne përqendrohemi aq shumë në zbulimet dhe shpikjet që njerëzit i bëjnë me mendjet e tyre (sipas kësaj qasjeje, secila "shpikje" është zbulimi i potencialit që ekziston) saqë e anashkalojmë atë më të rëndësishmen: se të gjitha këto produkte janë dhurata të universit, të cilat i arrijmë falë potencialitetit të tij.

Është shumë e rëndësishme t'i përgjigjemi pyetjes kryesore: "Si arriti ta ketë universi një potencial të tillë për kapacitetin e mendjes?" Kur e marrim parasysh atë që mund ta prodhojë intelektin e njeriut, pavarësisht nga dobësia e tij, ne mund të dallojmë një pamje të mrekullueshme. Sipas teizmit, meqë Zoti është qenie e përjetshme dhe e arsyeshme, atëherë edhe arsyeja është një element i përjetshëm. Zoti e ka vendosur potencialitetin në univers aty ku mund të shfaqet aftësia e arsyes. Për Zotin, nuk është i vështirë krijimi i njeriut me kapacitet intelektual (i cili është i krijuar po nga lënda inorganike e universit). Për më tepër, krijimi i universit me potencial të tillë është një situatë që pritet nga këndvështrimi teist, sepse aftësia mendore e njeriut e bën të mundur njohjen e ekzistencës së Zotit, fuqinë e Tij dhe gjendjen e të qenit i sprovuar. (Meqë argumenti i 10-të i librit në seksionin mbi natyrën, "argumenti i arsyes" lidhet me këtë çështje, ai seksion gjithashtu duhet të lexohet në lidhje me këtë.) Mirëpo, sipas ateizmit materialist, ekziston një vështirësi e madhe në shpjegimin e ekzistencës së potencialit për arsyen njerëzore në univers, pasi universi është vetëm një entitet pasiv. Si rezultat, përshtatshmëria e potencialit të universit për të përmbajtur arsyen njerëzore dhe shfaqja e kësaj arsye nga ky potencial i universit, shpjegohen më mirë në teizëm sesa në ateizëm materialist.

Vlerësimi i pikës 3.4: Vullneti dhe vetëdija janë veçori që e bëjnë njeriun njeri; për një ateist-materialist ekzistojnë vështirësi të mëdha në shpjegimin se si potenciali i universit mundëson praninë e këtyre veçorive, por teistët as këtu nuk përballen me ndonjë vështirësi, sepse

e shohin vullnetin dhe vetëdijen si veçori të përjetshme të Zotit të amshueshëm. Meqenëse kjo çështje do të trajtohet në argumentet e 11-të dhe 12-të të këtij libri, unë po i tejkaloj për momentin për të mos u përsëritur dy herë. Por dua të theksoj se kjo pikë gjithashtu lidhet me potencialin e universit.

Përveç strukturave në natyrë një aspekt tjetër i rëndësishëm i argumentit aktual është se ai i konsideron prodhimet shkencore, teknologjike dhe artistike të njeriut si elemente të argumentit për ekzistencën e Zotit, pasi që këto produkte bëhen të mundshme falë përfshirjes së tyre në potencialin e universit; sepse siç thamë më herët, këto produkte i bën të mundshme potenciali i universit (krijimi i universit me këtë potencial). Në këtë mënyrë njerëzit janë në gjendje t'i prodhojnë ato. Kjo qasje nuk i zbehë aspak veprat e shkencëtarëve dhe artistëve por përkundrazi ua rrit vlerën atyre, sepse nga ky këndvështrim ata me çdo vepër na ndihmojnë ta zbulojmë pasurinë që Zoti potencialisht e ka vendosur në univers. Me çdo vepër, me ose pa vetëdije, ata kontribuojnë në këtë drejtim. Zoti është pronari i përjetshëm i të gjitha projekteve, Ai është krijues dhe projektues; kurse shkencëtarët dhe artistët janë dizajnerë dhe shpikës.

Me pak fjalë, gjithçka që dëshmojmë në univers ekziston falë potencialit të saj për të ekzistuar. Diversiteti i mrekullueshëm në univers, me të gjitha aspektet –nga krijesat që ne i quajmë "të bukura" e deri te veprat artistike, nga arsyeja njerëzore me kapacitetin e tij, e deri te vullneti dhe vetëdija e saj– janë të mundshme falë potencialitetit të universit. Në teizëm është i pritshëm një potencialitet i tillë, kurse në pikëpamjen materialiste-ateiste ekziston asnjë element që do ta bënte të mundshme atë. Kjo na çon në përfundimin e argumentit se, ne duhet të përzgjedhim shpjegimin e teizmit para atij ateist-materialist.

NËNKAPITULLI I PESTË

ARGUMENTI I LIGJEVE DHE I RREGULLIMIT PRECIZ TË KONSTANTEVE

V.

ARGUMENTI I LIGJEVE DHE I RREGULLIMIT PRECIZ TË KONSTANTEVE

Duke u nisur nga vetitë e qenieve si qëllimi dhe rregulli, me argumentin e Dizajnit/Projektit (të cilit në teologji gjithashtu i referohet si inayet/mirësi apo ihtira/shpikje) arrijmë të njohja e Projektuesit/Dizajnuesit të këtyre qenieve dhe të cilësitë e Tij: fuqia, njohuria dhe mbizotërimi. Argumenti i Dizajnit/Projektit i thelbëson/esencializon shumë attribute të Zotit. Universi madhështor në të cilin jetojmë është vendstrehim i shumë llojeve të qenieve dhe fenomeneve të ndryshme, duke nisur nga galaktikat e deri te planetët, nga atmosfera e deri te erërat, nga lulet e deri te peshqit, nga zogjtë e deri te insektet. Kjo metodë, bazuar në të gjitha këto qenie dhe fenomene në univers, është përdorur një kohë të gjatë për të argumentuar ekzistencën e një Krijuesi të vetëdijshëm që i ka krijuar ato. Përgjatë historisë mijëra vjeçare kjo qasje gjithashtu ka pasur dhe kritikët e vet sikurse Epikurus dhe Lucretius-in në kohërat antike dhe Hume e Kant-in në epokën e fundit. Nga ana tjetër shumë mendimtarë të njohur që nga Platoni te Ibn Rushd-i, nga Thomas Aquinas te Leibniz dhe Newton-i, i kanë mbrojtur këto argumente në mënyra të ndryshme. Duke u nisur nga llojllojshmëri e qenieve dhe krijimtarisë; dhe kur kujtojmë që qindra vargje/ajete të Kuranit na shtyjnë të mendojnë dhe prej tyre të nxjerrim konkluzione, argumentin e dizajnit i cili thelbëson ekzistencën dhe cilësitë e Allahut mund ta quajmë "argumenti i Kuranit" ashtu siç e cilëson edhe Ibn Rushdi.

Me përhapjen e ateizmit materialist, argumenti i dizajnit kishte humbur popullaritetin e tij; në vend të kësaj, pikëpamja që pretendonte pavlefshmërinë e argumentit të dizajnit dhe se universi është i formuar rastësisht fitoi një përmasë të madhe mbështetësish. Mirëpo në shekullin e XX-të, veçanërisht zhvillimet shkencore në fushën e fizikës shkaktuan ringjalljen e këtij argumenti. Me të dhënat e shkencës moderne mësuam se krijimin e jetës në tokë ia detyrojmë akordimit/rregullimit shumë preciz (fine tuning) në univers. Argumentet e dizajnit të bazuara në këto të dhëna të reja nuk mbështeten vetëm në analogji (krahasime), por gjithashtu është e mundur t'i shprehim ato edhe përmes qasjeve matematikore, siç janë llogaritjet probabilitare.⁴¹ Në këtë pjesë të librit duke e kthyer vëmendjen kah rregullimet precize dhe ndërlidhjet e tyre me ligjet e natyrës dhe konstantet, do të prezantohet "argumenti i ligjeve (natyrore) dhe i rregullimit preciz të

⁴¹ Caner Taslaman, **Evrenden Allah'a**, Etkileşim Yayınları, İstanbul, 2013, f. 11-20, 44-51.

konstanteve". Meqenëse rregullimet precize të diskutuara këtu janë veçori të qenësishme të universit dhe janë të njëjta në çdo hapësirë të universit; vijmë në përfundim se meqë cilësi të tilla janë dizajnuar/projektuar, do të thotë që vetë universi është i dizajnuar, pra domethënë është i krijuar. Ky argument mund të shtrohet kështu:

1. Formimi i jetës në univers varet nga kontrolli shumë preciz i ligjeve natyrore dhe konstanteve.
2. Ekzistencën e këtyre rregullimeve precize në ligjet e natyrës dhe konstantet, mund ta shpjegojë ose teizmi, ose ateizmi-materialist.
3. Teizmi i shpjegon rregullimet precize në ligjet natyrore dhe konstantat më mirë sesa ateizmi-materialist.
4. Si rezultat, shpjegimi i teizmit duhet të përzgjidhet si më i saktë në raport me ateizmin-materialist.

Le të shqyrtojmë së pari propozimin në pikën e parë të argumentit i cili shpreh se ka rregulla shumë precize në ligjet natyrore dhe konstante. Falë zhvillimeve shkencore në shekullin e XX-të, u mësua ekzistenca e rregullimeve precize të sipërpërmendura. Pesë pikat e mëposhtme janë shembuj të rregullimeve precize në ligjet natyrore dhe në konstantet:

1. Nëse forca e gravitetit nuk do të ekzistonte si ligj, jeta nuk do të kishte ekzistuar. Gjithashtu, nëse forca e gravitetit (konstanta universale e forcës gravitacionale e shprehur me shkronjën "G") do të ishte më e fortë, të gjithë yjet do të shndërroheshin në vrima të zeza përpara se t'i rezistonin kësaj force. Nëse kjo forcë do të ishte më e dobët, nuk do të kishte yje që do të mundësonin formimin e shumicës së elementeve në tabelën e kimisë. Në secilin rast gjallëria nuk do të ishte e mundur.
2. Forca e fortë bërthamore mban protonet dhe neutronet së bashku në bërthamë. Nëse kjo forcë nuk do të kishte ekzistuar as jeta nuk do të ekzistonte; gjithashtu nëse kjo forcë do të kishte qenë pak më e dobët, asnjë atom tjetër përveç hidrogjenit, madje as jeta nuk do të ekzistonte. Intensiteti i ndryshëm i kësaj force do të prishte të gjithë procesin.
3. Nëse forca elektromagnetike do të ishte më e fortë, kjo do të shkaktonte probleme në formimin e lidhjeve kimike. Nëse do të ishte më e dobët formimi i lidhjeve kimike, do të ishte problematike, aq sa edhe atomet e nevojshëm për jetën nuk do të ishin formuar.

4. Nëse forca e dobët bërthamore do të ishte pak më e fortë, proceset e nevojshme për jetën do të ndikoheshin negativisht. Nëse kjo forcë do të ishte pak më e dobët, formimi i elementëve të rëndë në yje do të ndikohej negativisht dhe jeta nuk do të kishte ndodhur.
5. Dy nga atomet më të rëndësishëm për jetën janë karboni dhe oksigjeni. Nëse raporti i karbonit me rezonancën e atomit të oksigjenit do të ishte më i lartë ose më i ulët se këto atome, atomet e oksigjenit dhe karbonit që janë të domosdoshme për jetën nuk do mund të ishin formuar për shkak të problemeve që do të lindnin në yje gjatë proceseve të formimit të këtyre atomeve.⁴²

Ligjet e natyrës dhe konstantet janë karakteristika të universit që zbatohen në mënyrë të njëjtë në të gjithë universin, domethënë ato janë karakteristika të qenësishme të çdo hapësire të universit. Vetëm qasjet gjithëpërfshirëse të cilat ofrojnë shpjegim për mënyrën se si universi erdhi në ekzistencë, mund ta shpjegojnë se si ekzistojnë këto karakteristika të qenësishme të universit. Dy pikëpamje rivale për këtë çështje, të cilat i kemi parë edhe më parë dhe janë shprehur në pikën e dytë të këtij argumenti, janë teizmi dhe ateizmi-materialist.

Në këtë argument pika të cilën ateistët-materialist do të kundërshtojnë është pika e tretë. Nëse tregohet saktësia e saj, logjikisht do të vijojë që " shpjegimi i teizmit është më i saktë në raport me ateizmin-materialist ", siç edhe thuhet në përfundimin e pikës së katërt. Për të shfaqur saktësinë e pikës së tretë, mjafton të kuptojmë se nëse teizmi është i vërtetë, atëherë pritet rregullimi preciz i universit; ndërsa nëse ateizmi-materialist është i vërtetë, atëherë nuk ka asnjë element që do ta mundësonte shfaqjen e një rregullimi të tillë preciz.

Para së gjithash për të kuptuar ndikimin e të dhënave në këtë temë, është e rëndësishme të kuptohet se sa precize janë këto rregullime. Për shembull, një ndryshim shumë i vogël, prej 1 në 10^{100} në forcën e dobët bërthamore, e cila është vetëm një nga rregullimet kaq precize, e bën të pamundur formimin e molekulave të nevojshme për ekzistencën e jetës. Meqë ra fjala, nëse nuk e kuptoni se me çfarë korrespondon numri 10^{100} , nuk mund ta kuptoni se sa preciz është ky rregullim. Në një zonë të vogël prej një centimetër katror ndodhen me miliarda atome dhe brenda

⁴² Shih: John Barrow-Frank Tipler, **The Anthropic Cosmological Principle**, Oxford University Press, Oxford, 1996; Paul Davies, *The Accidental Universe*, Cambridge University Press, Cambridge, 1982; John Leslie, *Universes*, Routledge, New York, 1989.

këtyre atomeve janë protonet, neutronet dhe elektronet; nga këtu mund të imagjinoni se sa prej këtyre grimcave janë në botën tonë. Për më tepër, një yll mesatar është shumë herë më i madh se planeti ynë dhe në galaktikën tonë ekzistojnë qindra miliarda yje të tilla dhe trilionat planetet rreth tyre. Gjithashtu, imagjinoni se ekzistojnë qindra miliarda yje në galaktikën tonë dhe më shumë se njëqind miliard galaktika në univers dhe të gjitha këto përbëhen prej atomeve dhe se këto atome përbëhen nga grimcat si: protonet, neutronet dhe elektronet. Raporti prej 1 në 10^{100} , që përdoret për të shprehur vetëm një nga rregullimet precize, i referohet një raporti numri i të cilit është shumë herë më i madh sesa shuma e të gjitha protoneve, neutroneve, elektroneve, madje edhe e fotoneve (grimca drite) në univers. (domethënë numri 10^{100} është shumë herë më i madh se krejt grimcat e universit, pra, vetëm një ndryshim i vogël i njëres pjesë të 10^{100} në forcën e dobët bërthamore, do ta pamundësonte jetën) Vetëm nëse e kuptojmë si duhet këtë, mund ta kuptojmë se për çfarë rregullimi jashtëzakonisht preciz bëhet fjalë. Më lejoni përmes një shembulli ta shpjegoj se çfarë do të thotë një probabiliteti i këtillë: një person ka vendosur ta fshehë një kokërr të rërës në kokrrat e rërës që ndodhen brenda të gjitha shkretëtirave, plazheve dhe oqeanëve të botës dhe një ditë rastësisht e tërheqë një kokërr rëre nga të gjitha ato rëra. Tani, a mund ta paramendoni se sa i ulët është probabiliteti për ta gjetur atë kokërr të vetme të rërës? Le ta përfytyrojmë se shpërfaqja e jetës i ngjason gjetjes së një grimce të hedhur midis tërës këtyre grimcave të protoneve, neutroneve, elektroneve dhe fotoneve në hapësirë. Atëherë, probabiliteti që jeta të shfaqet rastësisht, është edhe më i lartë se raporti mes numrit 1 dhe 10^{100} . Numri në fjalë është vlerë shprehëse e precizitetit të fuqisë së dobët në bërthamën e atomit. Por le të mos harrojmë se probabiliteti prej 1 në 10^{100} tregon vetëm për njërin nga shumë rregullimet precize aktuale. Duhet të theksohet se jeta është e mundur në univers vetëm kur të realizohen përnjëherë të gjitha këto rregullime precize aktuale; edhe pse vetëm mungesa e njëres nga këto është e mjaftueshme për ta bërë të pamundur formimin e jetës. Sa i përket llogaritjeve të probabilitetit, nuk duhet të harrojmë se në raste të tilla, shumëzimi i të gjitha gjasave jep probabilitetin e realizimit të qëllimit.

Dikush mund të pyesë nëse rregullimi preciz që e përshkruajmë këtu është rezultat i një domosdoshmërie fizike. Le ta trajtojmë përsëri forcën e dobët bërthamore. Siç u shpjegua më lart, një ndryshim i vogël në forcën e dobët do ta bënte jetën të pamundur. Nga ana tjetër, dikush (ndonjë fizikant) mund të imagjinojë rreth ndonjë universi të qeverisur nga të njëjtat ligje, por me konstanta të ndryshme fizike. Vlerat aktuale të këtyre konstanteve nuk janë të detyrueshme siç janë domosdoshmëritë fizike. Por edhe nëse do të thuhej se këto vlera janë domosdoshmëri fizike,

kjo nuk do të ishte arsye për ta refuzuar argumentin e paraqitur këtu. Shpjegimi se domosdoshmëria e dizajnit fizik është bërë në mënyrë të vetëdijshme, mbështetet në atë se nga bashkësia e shumë vlerave, universi ka përfituar konstanta shumë precize të cilat logjikisht e bëjnë të mundur ekzistencën e jetës.

Kohë pas kohe është tentuar që ndaj argumenteve të ndryshme të dizajnit të jepen përgjigje të llojit se, nëse jeta nuk mund të shpërfaqej në këtë botë, ajo mund të shpërfaqej në një botë tjetër. Madje ka pasur edhe përgjigje tjera se, ndoshta ndonjë formë tjetër e gjallë për të cilën ne nuk dijmë mund të formohet në ndonjë planet tjetër të hapësirës. Sidoqoftë, duhet të theksohet se kjo përgjigje është e pavlefshme kundër këtij argumenti. Për shembull, me prishjen e rregullimit preciz të forcës së gravitetit, as yjet dhe as planetët nuk do të mund të formoheshin. Meqë yjet nuk do mund të formësoheshin, si pasojë as kimia nuk do mund të ekzistonte, sepse të gjithë atomet në tabelën e kimisë, përveç hidrogjenit dhe heliumit, mund të formohen vetëm përmes proceseve të zhvilluara brenda yjeve. Edhe forma më e thjeshtë e gjallesave, në një mënyrë të caktuar duhet ta përmbajë mekanizmin e përdorimit të energjisë dhe reagimit ndaj mjedisit të saj, sepse edhe për aktivitetet më të thjeshta kërkohet prania e molekulave të cilat e mundësojnë jetën, ndërsa pamundësia për ta formuar kiminë do të thotë që edhe atomet si blloqe ndërtuese të një molekule të thjeshtë nuk do të mund të formoheshin; kështu që as që mund të imagjinohet për mundësinë e formimit të ndonjë forme të gjallë në univers.

Pikëpamja se këto rregullime precize janë krijuar qëllimisht është një shpjegim shumë më i mirë sesa pikëpamja që thotë se ekzistenca e këtyre rregullimeve precize (të theksuara në kapitullin e 6-të dhe në këtë kapitull) ka ardhur në një mënyrë të rastësishme. Për një teist nuk ka asgjë për t'u habitur për ekzistencën e këtyre rregullimeve precize, sepse është një Krijues madhështor që i rregullon këto me vetëdije dhe i mundëson rregullimet precize që të jenë veçori e universit në të cilin ndodhin krijimet e qenieve të gjalla. Për një ateist-materialist është befasuese dhe e papritur që probabiliteti i jetës të varet nga veçoritë e rregullueshme me kaq precizitet të madh. Nëse universi në vetvete nuk ka qëllim që ta mundësojë shfaqjen e jetës, njëjtë siç e mundëson dhënien e frutave, është e pamundur që një veçori e rëndësishme siç është jeta (e shfaqur në këtë univers), të varet nga një probabilitet aq i vogël. Nga përvoja e përditshme të gjithë ne e dijmë se ekziston një vetëdije prapa zgjedhjes së probabiliteteve të vogla që mundësojnë qëllim kuptimplotë. Për shembull, imagjinoi një kasafortë që ka një fjalëkalim aq kompleks, saqë nuk

ka gjasa që ajo të hapet me një hyrje të rastësishme. Nëse dikush e hap këtë kasafortë, ne menjëherë do ta dimë se ai person e ka futur fjalëkalimin e saktë me një qëllim të caktuar, e kjo domethënë se procesi i futjes së këtij fjalëkalimi nuk është i rastësishëm. Ne nuk presim që kjo të realizohet rastësisht, por nga ana tjetër, pa marrë parasysh komplekitetin e fjalëkalimit, ne nuk do të çuditeshim nëse pronari (si i vetëdijshëm dhe qenie me qëllim) do ta hapte kasafortën. Me fjalë të tjera, ne e dimë nga përvoja se ekziston një qenie e vetëdijshme e cila i ka zgjedhur këto mundësi të vogla për një qëllim. Si përfundim qasja logjike që ne përdorim në këtë argument nuk ndryshon nga qasjet logjike që përdorim në jetën e përditshme.

Ekzistenca e këtyre rregullimeve precize përveç që e mundësoi ekzistencën e gjallesave dhe qenieve njerëzore, tërhoqi vëmendjen e shkencëtarëve në shekullin e XX-të dhe kjo situatë është quajtur Parimi Humanistik (Anthropic Principle). Termi Parim Humanistik u përdor për herë të parë nga Brandon Carter në vitin 1974 dhe që prej asaj kohe ka qenë subjekt i shumë polemikave në shkencë, filozofi dhe teologji.⁴³ Materialistët-ateistët janë përpjekur ta interpretojnë Parimin Antropik ndryshe nga argumenti i dizajnit, në mënyrë që ta shmangin mbështjetjen e të dhënave moderne shkencore ndaj argumentit të dizajnit. Ky lloj i interpretimit të Parimit Antropik është përpjekur të mbrohet duke u bazuar në Parimin e Dobët Antropik (Weak Anthropic Principle). Sipas këtij variacioni parimor, vendi ynë në univers është domosdoshmërisht i privilegjuar dhe ne, si vrojtues që jemi, e vështrojmë ekzistencën tonë bashkë me këtë pozicion të privilegjuar. Kur interpretohet kundër argumentit të dizajnit, ky parim tregon se ne mund t'i vëzhgojmë vetëm kushtet të cilat na krijuan neve; prandaj nuk duhet të habitemi nga këto kushte dhe t'u atribuojmë kuptime atyre. Më lejoni të përmend një shembull të bukur që John Leslie e përdor kundër atyre që e interpretojnë Parimin Antropik në këtë mënyrë:⁴⁴ Imagjinojeni veten përpara një ekipi pushkatarësh. Ekipi në fjalë përbëhet prej njëqind snajperistëve. Të gjithë ata gjuajnë me disa plumba nga një distancë e afërt, por ju nuk vdisni. Në një situatë kaq të vështirë, a do të thoshit “Pasi jam gjallë, s’ka diçka për t’u habitur; po të isha i vdekur, nuk do ta vëzhgoja këtë”? Apo më saktë, do të thoshit “Nëse njëqind snajperistë më gjuajnë disa herë nga një distancë e afërt, e nuk mund të më vrasin, atëherë me siguri ata nuk gjuajnë me plumba të vërtetë”? Mundësia që

⁴³ Brandon Carter, “**Large Number Coincidences and the Anthropic Principle in Cosmology**”, Ed: John Leslie, Physical Cosmology and Philosophy, Macmillan Publishing, New York, 1990.

⁴⁴ Shembulli është ndryshuar pakëz nga ai origjinal: John Leslie, “**Anthropic Principle, World Ensemble, Design**”, American Philosophical Quarterly, No: 19, 1982, s. 141-151.

konstantat e akorduara mirë ta shkaktojnë jetën në mënyrë të rastësishme, është shumë më e vogël se mundësia që ata qindra gjuajtës të spikatur ta huqin objektivin e tyre. Nëse në këtë rast, e konsideroni absurde rastësinë e mbijetesës suaj pas tërë atyre gjuajtjeve të skuadrës, atëherë njëjtë do të duhet ta konsideroni edhe pakuptimësinë e Parimit të Dobët Antropik, e cila precizitetin e jashtëzakonshëm të ardhjes sonë në ekzistencë e ndërlidhë me rastësinë.

Kriteri i përmendur më parë është një përgjigje për këtë qasje; ne mund t'i vëzhgojmë vetëm kushtet që na sjellin në ekzistencë, por kjo nuk do të thotë se ne duhet të presim që kushtet të cilat e mundësojnë ekzistencën tonë dhe jetën, të jenë të varura nga një probabilitet shumë i ulët (rregullimi preciz). Siç u theksua edhe më parë, për një teist nuk ka asgjë të habitshme gjatë përballjes me ekzistencën e këtyre rregullimeve precize, ndërsa për një materialist nuk ka asgjë që e bën të pritshëm këtë fenomen dhe kjo është shumë e habitshme. Përveç kësaj, universi jonë ka më shumë rregulla nga ç'është e mjaftueshme për ekzistencën tonë. Ky argument do ta humbte fuqinë, nëse do të ekzistonim në një univers më të vogël dhe me më pak specie të gjalla. Ne duhet ta pranojmë faktin se ne observojmë një rregullshmëri shumë më të madhe sesa që nevojitet minimalisht për ekzistencën tonë.

E meta logjike prapa shpjegimit të rregullit preciz në univers bazuar vetëm në pozitën e njeriut si vëzhgues është një gabim që quhet si "konfirmim i pasojës". Në këtë lajthitje, pararendësi në një konditë supozohet të jetë i vërtetë, sepse pasoja është e vërtetë; me fjalë të tjera, renditjet e shkakut dhe pasojës ose shpjegimit dhe të shpjeguarat janë të kundërta. Një shembull për ata që e kryejnë këtë gabim logjik: në fillim bëhet propozimi "Nëse ka rënë shi, atëherë rrugët janë të lagura", pastaj nga kjo fjali vijon përfundimi se "rrugët janë të lagura" sepse "ka rënë shi". Edhe nëse dy propozimet e para në shembullin e mësipërm janë të vërteta, kjo nuk tregon për saktësinë e rezultatit, sepse rrugët mund të jenë të lagura edhe nga larja e komunës dhe nga plasja e ndonjë tubi. Ky është gabimi logjik në të cilin bëhet "konfirmimi i pasojës". Edhe nëse shiu është shpjegimi i vërtetë i lagështisë së rrugëve, pretenduesi gabimisht supozon se lagështia e rrugëve është shpjegim për rënien e shiut. Ata që mendojnë se statusi vëzhgues i njeriut është i mjaftueshëm për t'i shpjeguar rregullimet precize, e bëjnë të njëjtin gabim logjik. Përshtatshmëria e universit për jetën është shpjegim për vet ekzistencën e jetës. Megjithatë, nuk mund të supozojmë se përshtatshmëria e universit për jetën është e domosdoshme për ekzistencën e jetës; dhe për këtë përshtatshmëri nuk ka nevojë për asnjë shpjegim tjetër.

Me pak fjalë, rregullimet precize të konstanteve dhe ligjet në natyrë të treguara nga shkenca e shekullit të XX-të, të cilat janë të domosdoshme për ekzistencën e jetës, mundësuan që argumenti i dizajnit i cili është më i përdorur gjatë gjithë historisë argumentuese të ekzistencës së Zotit, të mbështetet nga një model matematikor dhe nga të dhënat e shkencës moderne. Këto pretendime, të cilat tentojnë ta nënvlerësojnë këtë argument, duke e veshur pretendimin me rastësi, me status vëzhgimor dhe me universe të shumta, nuk është se do të kenë shumë sukses. Nga këndvështrimi i teizmit nuk ka asgjë për t'u habitur në ekzistencën e rregullimeve kaq precize, pasi Zoti krijoi universin me qëllim që të shpërfaqen gjallesat. Përkundrazi, situata është krejtësisht e papritur nga këndi materialist ateist. Ky fakt në vetvete siguron arsye të mjaftueshme për të preferuar teizmin mbi ateizmin materialist.

NËNKAPITULLI I GJASHTË

ARGUMENTI I KONTROLLIT PRECIZ TË DUKURIVE FIZIKE

VI.

ARGUMENTI I KONTROLLIT PRECIZ TË DUKURIVE FIZIKE

Në argumentin e mëparshëm u shtjelluan kontrollimet precize dhe ligjet që e bëjnë të mundur ekzistencën e jetës në univers. Veçori e tyre është se, që nga fillimi i universit ato janë të qenësishme kudo dhe të vlefshme në të njëjtën mënyrë. Përveç këtyre, ekzistojnë kontrollime precize të cilat e bëjnë të mundur ekzistencën e jetës pa qenë pjesë e qenësishme e strukturës së universit. Këto rregullime precize kanë luajtur rol kritik që nga procesi i fillimit të universit e deri në shfaqjen e jetës (rregulla që e mundësojnë ekzistencën e jetës); këto mund t'i quajmë rregullime precize të dukurive fizike. Për shembull, në një univers me ligje të njëjta fizike, nëse entropia fillestare do të ishte shumë më e lartë, si pasojë do të pamundësohej formimi i jetës. Ose, nëse nuk do të formoheshin Zonat e Vendbanueshme Galaktike (Galactic Habitable Zone), shfaqja e jetës do të ishte e pamundur. Kushte të këtilla që e bëjnë të mundur ekzistencën e jetës duhet të konsiderohen në një kategori të veçantë, pasi ato nuk janë veçori të qenësishme brenda materies. Megjithatë, argumenti i rregullimit preciz që do të paraqitet bazuar në këto fenomene fizike ka shumë të përbashkëta me ato që i kemi shprehur në kapitullin e mëparshëm.

Përfaqësues të famshëm të linjës materialist-ateiste, të tillë si Richard Dawkins dhe Jacques Monod, argumentojnë se të gjitha qeniet e gjalla së bashku me ligjet e natyrës mund të shpjegohen nga kombinimi i "domosdoshmërisë" që buron nga ligjet e natyrës dhe faktori i " gjasës" (rastësisë), me fenomenet e botës materiale ku veprojnë këto ligje. Në kapitullin e mëparshëm, u tregua se, "argumenti i rregullimit preciz të konstanteve dhe ligjeve të natyrës" dhe ajo të cilën ata e konsiderojnë si "domosdoshmëri" të qenësishme të universit, mund të shpjegohet më së miri përmes dizajnit inteligjent (dizajni i vetëdijshëm). Në këtë pjesë do të tregohet se ajo që Monod dhe Dawkins e shohin si "rastësi" mund të shpjegohet më së miri nga një model i vetëdijshëm/inteligjent i dizajnit. Argumentin do ta paraqes si më poshtë, "argumenti i rregullimit preciz të dukurive fizike":

1. Shfaqja e jetës në univers varet nga rregullime shumë precize të disa dukurive fizike.
2. Ekzistenca e rregullimeve precize në këto dukuri fizike mund të shpjegohet edhe nga teizmi, edhe nga materializmi-ateizmi.
3. Teizmi i shpjegon rregullimet precize në fenomenet fizike më mirë sesa ateizmi-materialist.

4. Si rezultat, shpjegimi i teizmit duhet të përzgjidhet si më i saktë në raport me materializmin-ateizmin.

Ne do të rendisim shkurtimisht pesë shembuj për rregullimet precize në fenomenet fizike, të cilat e bëjnë të mundur ekzistencën e jetës në univers:

1. Nëse në fillim të universit dendësia kritike e materies do të ishte pak më e vogël, e gjithë materia në univers do të ishte shpërndarë. Nëse dendësia kritike e materialit do të ishte më e lartë, e gjithë lënda do të shembej menjëherë. Pra, në secilin rast nuk do të formoheshin as galaktikat, as yjet, as bota jonë dhe as gjallesat.

2. Gjithashtu, edhe struktura fillestare homogjene e universit është një parakusht për formimin e galaktikave. Një ulje e lehtë e homogjenitetit fillestar nuk do të lejonte që galaktikat të formoheshin dhe do të rezultonte që e gjithë lënda të kthehej në vrima të zeza dhe atëherë nuk do të kishim ekzistuar ne.

3. Entropia rritet vazhdimisht në univers. Kjo do të thotë që duhet të ketë pasur një entropi shumë të ulët në fillim të universit. Pa këtë rregullim preciz në entropinë fillestare, jeta në univers nuk do të kishte ekzistuar.

4. Protonet, antiprotonet, neutronet dhe anti-neutronet e çliruara pas Big Beng-ut e asgjësojnë njëra-tjetrën. Që jeta të krijohej, numri i protoneve duhej të ishte më i lartë se anti-protonet dhe numri i neutroneve më i lartë sesa ai i anti-neutroneve dhe vërtetë kështu ndodhi.

5. Ekzistenca e jetës varet nga shfaqja e Zonave të Vendbanueshme të Galaktikës të cilat ofrojnë kushte të caktuara në galaktikë. Edhe këto zona veçse u formuan.⁴⁵

Të gjitha këto pesë pikat e dukurive fizike janë të domosdoshme për formimin e jetës. Nëse e ndryshojmë qoftë edhe njërin nga këto, kjo do ta bënte të pamundur ekzistencën e jetës. Në të vërtetë duhet të merret parasysh se, ashtu si këto ka edhe shumë kushte të tjera të domosdoshme për formimin e jetës dhe duhet të kihet parasysh se pesë shembujt e dhënë janë një pjesë e vogël e një bashkësie të madhe. Si rezultat, për ta përllogaritur më mirë probabilitetin e shfaqjes së jetës nga rastësia, probabilitetet e shtjelluara në kapitullin e mëparshëm në lidhje me precizitetin e

⁴⁵ Në lidhje me këto shembuj shih: Michael J. Denton, **Nature's Destiny**, The Free Press, New York, 1998; John Barrow-Frank Tipler, *The Anthropic Cosmological Principle*; John Leslie, *Universes*; Paul Davies, *The Accidental Universe*, Paul Davies, *God and the New Physics*, Simon and Schuster, New York, 1984.

ligjeve dhe konstanteve të cilat e mundësojnë shfaqjen e jetës, duhet të shumëzohen me probabilitetet për fenomenet fizike të diskutuara këtu. Më lejoni ta ilustroj precizitetin marramendës në fenomenet fizike duke u përqëndruar në një shembull të veçantë: entropinë fillestare të universit. Sipas ligjit të entropisë, entropia totale (masa e çrregullimit) në univers rritet vazhdimisht, në mënyrë lineare (të njëdrejtimshëm) dhe të pakthyeshme. Kjo do të thotë që nëse kthehemi kah fillimet e kohës dhe universit, entropia duhet të zvogëlohet vazhdimisht. Fillimi i universit me entropi të ulët është parakusht i domosdoshëm për formimin e galaktikave, sistemit tonë diellor dhe jetës. Ekzistenca e ligjit të entropisë është gjithashtu një parakusht i domosdoshëm për ekzistencën e gjallesave. Por vet ekzistenca e këtij ligji është e pavarur nga domosdoshmëria e ulët e entropisë fillestare, pra ekzistenca e këtij ligji nuk e shkakton domosdoshmërisht entropinë e ulët gjatë fillimit të universit. Në rradhë të parë vjen dizajnimi ose ekzistimi i ligjit, kurse pastaj rregullimi preciz i kushteve fillestare (nëpër situatat fizike); të dyja janë parakushte të detyrueshme për jetën.⁴⁶

Roger Penrose i Universitetit të Oksfordit, një nga matematikanët dhe astrofizikanët më të njohur në botë, shprehet se asnjë e dhënë nga fizika nuk mund t'i përafrohet përshkrimi matematikor të rregullimit preciz të entropisë fillestare në univers (e llogaritur nga vet Penrose). Rregullimi preciz i entropisë fillestare të universit është llogaritur bazuar në entropinë e ndonjë skenari të mundshëm përfundimtar (sa për ilustrim). Në fakt, nëse universi do ta kishte pasur këtë entropi përfundimtare (të ilustruar) që në fillimet e tij, si pasojë as galaktika jonë, as bota jonë dhe as ai që e shkruan apo ata që e lexojnë këtë artikull nuk do mund të ekzistonin. Penrose duke e llogaritur rregullimin preciz të entropisë fillestare të universit vjen në një konkluzion si më poshtë: "Të gjitha të dhënat tregojnë se me sa përpikshmëri Krijuesi e zbatoi qëllimin e tij; kjo përpikshmëri mbështetet në vlerën numerike të saktësisë prej : 1 në $10^{10^{123}}$ "⁴⁷ Kjo është një shifër marramendëse! Ky numër është aq i madh, sa që nëse do ta shkruanim atë pa eksponentë (pra vetëm duke vendosur zero prapa numrit 1), edhe të gjitha lëndët e universit nuk do të mjaftonin. Për ta shkruar këtë numër pa eksponentë, edhe sikur t'i kishim shkruar katër trilion (10^{15}) zero pas secilës prej grimcave në univers, pra pas secilit proton, neutron, elektron dhe foton (që numri i këtyre

⁴⁶ Caner Taslaman, "Din Felsefesi Açısından Entropi Yasası," Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, Sayı: 30, İstanbul, 2006.

⁴⁷ Roger Penrose, *Kralin Yeni Usu 3: Us Nerede*, Çev: Tekin Dereli, TÜBİTAK Popüler Bilim Kitapları, Ankara 2003, f. 50-51; Roger Penrose, *The Road to Reality*, Jonathan Cope, Londra (2004), f. 728.

grimcave është rreth 10^{90}); prapseprapë, edhe me ato nuk do të mund të shkruanim më shumë se 10^{105} zero. Kurse për t'i shkruar 10^{123} zero do të duhet t'i kemi një milion herë nga trilion më shumë universe si ky i joni dhe do të duhet t'i përdorim protonet, neutronet dhe fotonet e atyre universeve si fletore për t'i shkruar të gjitha katërt-trilion zerot. Ky numër marramendës shpreh rregullimin preciz të entropisë fillestare në univers. Nëse e vlerësojmë si të pamundur shkrimin e këtij numri (duke vendosur zero prapa 1) që shpreh rregullimin preciz të entropisë fillestare, nga kjo ne mund të konkludojmë se sa është i papranueshëm pretendimi që entropia fillestare të ekzistojë "si pasojë e një rastësie fatlume". Vetëm ky precizitet i jashtëzakonshëm i entropisë fillestare është e dhënë e mjaftueshme për të treguar se çfarë rregullime precize të universit e bëjnë të mundur ekzistencën e gjallesave. Ata që e shohin universin si një qenie që s'ka Dizajnuar/Projektues të vetëdijshëm (inteligjent) dhe të fuqishëm, duhet të presin një univers kaotik, në të cilin nuk ka asnjë rregull të vetëm. Megjithatë, faktet aktuale tregojnë për rregullime të jashtëzakonshme, të cilat si gjëra të pazakonshme që janë, mund t'i tregojmë edhe përmes saktësive matematikore.

Vëzhgimi i ngjarjeve specifike (që përputhen me "modele të pavarura") dhe me probabilitete të ulëta (ose komplekse) tregojnë për ekzistencën e dizajnit të vetëdijshëm, të cilin e njohim edhe si "kompleksitet të specifikuar".⁴⁸ Në argumentin e paraqitur këtu, pamë se rregullimet precize me probabilitete jashtëzakonshme të ulëta rezultojnë me ngjarje të "specifikuara", siç është shfaqja e gjallesave. Për këtë shkak, argumenti jonë këtu, i përmbush kriteret e duhura për ta bërë shfuqizimin e "rastësisë fatlume". Me përdorimin e këtij kriteri unë mund të jap edhe një shembull tjetër jashta atij të rregullimeve precize, përmes të cilit do të mund ta kuptojmë të vërtetën e dizajnit (inteligjent): libri që po e lexoni aktualisht është shkruar me vetëdije (është produkt dizajni). Për ta kuptuar se fjalët nuk janë formuar rastësisht njëra pas tjetrës dhe përmes derdhjes së rastësishme të bojës/ngjyrës; ose për ta kuptuar probabilitetin e ulët të lidhjes se këtyre fjalëve në mënyrë rastësore, mjafton ta përkujtojmë faktin se fjalët dhe rregullat gramatikore të gjuhës shqipe edhe pse përputhen me fjalët dhe rregullat e përdorura në këtë libër, ato nuk janë bashkuar në mënyrë të rastësishme. Është e pamundur që aq shumë fjalë dhe fjali të përputhshme me gramatikën dhe vokabularin e gjuhës shqipe të formohen nëpërmjet derdhjes së rastësishme të ngjyrës dhe shypjes së rëndomtë të fletave në shtypshkronjë. Ekzistojnë fjalë dhe

⁴⁸ William A. Dembski, **No Free Lunch**, Rowman and Littlefield Publishers, Lanham, 2002.

rregulla gramatikore të gjuhës shqipe "që janë të pavarura" nga ky libër, domethënë ekziston një synim "specifik i pavarur" i tyre (meqë çdo fjalë dhe rregull përmban qëllim specifik të përdorimit) dhe probabiliteti është tepër i ulët që fjalët në këtë libër të bashkohen në një mënyrë të rastësishme. Për shkak se fjalët dhe fjalitë këtu mund të përshtaten me atë synim (të fjalëve), kjo nuk e fuqizon rastësinë, prandaj edhe lehtë mund të themi se ky libër nuk është formuar prej proceseve të rastësishme (pra duhet të ekziston një vetëdije e cila i vendos ato sipas një qëllimi të caktuar). Si rezultat, ajo që po lexoni tani (libri në dorën tuaj) është një shembull konkret se përse koncepti kryesor, "ngjarja specifike" dhe ngjarja me probabilitet jashtëzakonisht të ulët (d.m.th. kompleksiteti i specifikuar), të kombinuara së bashku, mbështesin argumentin e dizajnit.

Filozofët ateistë zhvilluan skenaret e ashtuquajtura " universet e pafundme ose universet e shumëfishta (multiverse)" pasi kuptuan se nuk mund ta refuzojnë argumentin e dizajnit duke pretenduar se vëzhguesit mund të vëzhgojnë vetëm kushtet që i krijuan ato (siç tregohet në Kapitullin 5). Ata janë përpjekur ta zgjidhin problemin e probabilitetit jashtëzakonisht të ulët duke inkadruar opzione të pafund (ose shumë të mëdha) përzgjedhjesh. Thënë shkurtimisht, nëse ka universe të shumëfishta, nuk duhet të habitemi për rregullimin preciz në njërin prej tyre, sepse nuk është e habitshme të ndodhë një gjë e tillë prej shumë opcioneve. Richard Swinburne thotë në lidhje me këtë pikë: "*Të supozosh trilionat e tjera të pafund në vend të Zotit për të shpjeguar rregullsinë e universit tonë, duket se është niveli më i lartë i jo racionalitetit*".⁴⁹ Kjo qasje nënkupton gjithashtu edhe ikjen e ateizmit nga argumenti i dizajnit, sigurisht duke paguar çmimin e divorcit prej partnerit të saj të kahmotshëm: natyralizmit. E gjithë kjo, sepse qëllimi i filozofisë dhe metodës natyraliste është ta shpjegojë natyrën (me natyrë ka për qëllim universin në të cilin ndodhemi) duke i përdorur vetëm gjërat brenda universit, pra, duke mos i përdorur entitetet dhe hipotezat metafizike. Kurse qasja se ka pafund ose trilionat e tjera universesh nuk bazohet në ndonjë vëzhgim, eksperiment apo të dhëna serioze. Në fakt ajo që nënkuptohet është kjo: "Nëse nuk doni të pranoni ekzistencën e një Zoti që krijoi dhe projekttoi këtë univers, ju duhet të pranoni ekzistencën e shumë-universeve, sepse rregullimet precize në këtë univers mund të zbehen vetëm kur krahasohen me shumë-universe dhe kështu pasojat e argumentit të dizajnit (inteligjent) mund të shmangen". Në fakt kjo situatë në të cilën ka rënë ateizmi është shumë ironike. Derisa nga njëra anë përpiqeshin t'i iknin ontologjisë me Zotin si epiqendër, nga ana tjetër tentativa për tu

⁴⁹ Richard Swinburne, **Tanrı Var mı?**, f. 60.

mbështetur te "gjetja e strehimit në ontologjinë metafizike e bazuar në skenarë të shumë-universeve", si duket u ka mbetur si alternativa e vetme. Në fillim, përpjekja për ta shpjeguar shpërfaqjen e jetës bazuar vetëm në mundësitë e kësaj bote, pastaj përpjekja për ta shpjeguar shpërfaqjen e jetës vetëm nëpërmjet probabiliteteve të universit dhe së fundi, strehimi në një grumbullim probabilitetesh të cilat supozojnë për ekzistencën e katër-trilion universeve, në të vërtetë tregon për "plasmanin" e vërtetë në rënie të ateizmit-materialist.

Tendenca e përgjithshme e disa ateistëve përkrahës të hipotezave të shumëfishta është të përpjekja për ta zbehur rregullimin preciz, i cili është indikator kryesor për ekzistimin e një "krijuesi në univers". Me këtë, për të shpëtuar nga problemet e konstantave të mirë-rregulluara në univers, ata fillojnë ta parashtrajnë probabilitetin e prodhimit të universeve të pafund (nga i njëjti "mekanizëm prodhues i universit"). Numri i universeve të nevojshme për të siguruar konstante të përpikta është jashtëzakonisht i madh dhe do të kërkohej një sasi tepër e madhe e energjisë. Nuk ka ndonjë përgjigje se nga vjen kjo energji. Gjithashtu, që të përputhen me konstantat e kërkuara, ka nevojë edhe për një mekanizëm që i modifikon vazhdimisht konstantet. E cili është ky mekanizëm? Nëse do të ekzistonte një mekanizëm i tillë, a nuk do të duhej që edhe ai të ishte i përpiktë? Por në këtë mënyrë, duke e hedhur vazhdimisht topin te skenarët imagjinarë të shumë-universeve, nuk është e mundur të shpëtohet nga pasojat e rregullimeve precize.⁵⁰

Dua të ilustroj me një shembull se, çfarë mund të bëjnë ata që dolën me skenarin e universeve të pafund për t'i shpëtuar/ikur argumentit të rregullimit preciz: imagjinoni se jeni në një kazino ku ka me mijëra tavolina me ruletë. Unë ju them se të gjitha lojërat me ruletë janë me hile (paraprakisht rezultati është i rregulluar) dhe si argument paraprakisht ju tregoj rezultatin e qindra mijëra lojërave në mijëra tryeza. Kur rezultatet që kam thënë dalin të sakta, ju jeni të bindur se rezultati i lojërave të ruletës dihej (është i rregulluar) më parë dhe i tregoni dikujt për këtë incident. Për habinë tuaj, shoku juaj përgjigjet duke ju thënë se kjo mund të ndodhë krejt rastësisht; nëse pjesa dërrmuese e njerëzve aty supozojnë, me siguri njëri prej tyre mund t'i parashikojë rezultatet saktësisht. Kur argumentoni se kjo është një probabilitet shumë i ulët, shoku juaj duke ngritur hipotezat argumenton se mund të ketë pafundësisht shumë planetë me pafund shumë kazino dhe lojtarë të fatit në to; kështu që pretenduesi i tabelave të fiksuara është një gënjeshtar. Cili do të

⁵⁰ Shih: Robin Collins, "**Tanrı, Tasarım ve İnce Ayar**", Allah, Felsefe ve Bilim, Ed: Caner Taslaman ve Enis Doko, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2014, s. 44-53.

ishte reagimi juaj ndaj këtij shoku? Supozoni për një moment se keni pranuar argumentin e pafund të kazinove. Në këtë rast, “supozimin tim” të saktë të mijëra rezultateve të ruletës, vallë a do ta konsideroni akoma si rastësi?⁵¹

Gjithashtu, duhet të theksohet se për dikë që beson në ekzistencën e Zotit është krejt në rregull pranimi i ekzistencës së shumë universeve. Sigurisht, për ata që e pranojnë se ky univers u krijua nga Zoti, është e mundur që Zoti të krijojë edhe universe të tjera, mirëpo hipoteza e shumë-universeve nuk mund të jetë një strehë për të shpëtuar nga manifestimi i fuqishëm i dizajnit (inteligjent) në këtë univers.

Me pak fjalë, rregullimet precize në fenomenet fizike që dolën në pah me përparimet në shkencën moderne tregojnë se proceset nga fillimi i universit e deri në formimin e gjallesave janë projektuar nga një vetëdije dhe fuqi superiore. Përgjigjet kundër këtyre argumenteve, kryesisht janë të bazuara në rastësi, në observimin e kushteve jetike për ne dhe në universet e shumëfishta. Ashtu siç u theksua në këtë kapitull dhe në atë të mëparshmin, të gjitha përpjekjet për tu ikur të vërtetës që shfaq dizajni i rregullimeve precize kanë qenë të pasuksesshme. Sipas paradigmës së ateizmit-materialist është mjaft e habitshme dhe e papritur që fenomenet fizike, të cilat s’janë të habitshme për sa i përket paradigmës së teizmit, kanë një rregullim kaq preciz. Kjo nga ana tjetër siguron argumente shtesë për shpjegimin se teizmi duhet të përzgjedhet si më i saktë në raport me materializmin-ateizmin.

⁵¹ Caner Taslaman, **Evrenden Allah’a**, f. 136-137

NËNKAPITULLI I SHTATË

ARGUMENTI I DIZAJNIT-PROJEKTIMIT TË GJALLESAVE

VII.

ARGUMENTI I DIZAJNIT-PROJEKTIMIT TË GJALLESAVE

Karriera ime akademike, nga niveli master në profesor, është përqendruar pothuajse tërësisht në ndërlidhjet shkencë-filozofi-fe. Disertacioni im i doktoratës ka të bëjë me teorinë e evolucionit. Bazuar në të gjithë përvojën time mund t'ju siguroj se deri tani tema më e diskutueshme e marrëdhënieve midis shkencës dhe fesë është evolucioni. Kur diskutohet mbi atë nëse jeta është rezultat i dizajnit apo jo, teoria e evolucionit menjëherë hyn në lojë dhe shpesh pretendohet se ajo tregon që jeta nuk është projektuar/dizajnuar ose edhe më tej se nuk ka Zot. Përgjigja ime (unë personalisht) e shkurtër për pyetjen, "A e mbështet teoria e evolucionit ateizmin?" është "absolutisht jo!". Argumentet rreth teorisë së evolucionit, pra, se a është e vërtetë apo jo kjo teori është temë e studimeve të tjera. Por le të supozojmë (qoftë edhe imagjinarisht) për një moment se kjo teori është e saktë dhe në këtë rast le të shqyrtojmë nëse kjo teori e kundërshton besimin në Zot.

Teoria e evolucionit shpjegon se të gjitha gjallesat në botën tonë u krijuan përmes një procesi gjatë të cilit ndryshimet në prejardhjen e një krijese njëqelizore janë trashëguar brez pas brezi . Në këtë proces mekanizmat si seleksionimi natyrorë, mutacioni dhe seleksionimi seksual kanë luajtur një rol shumë kritik.⁵² Sidoqoftë, është mirë ta theksojmë se biologjia nuk merret me definimin nëse këto procese janë plane të Zotit apo thjeshtë pasoja të rastësisë, sepse qëllimi i vetëm i biologjisë është t'i përshkruajë gjallesat dhe procesin e formimit të tyre ashtu siç thonë të dhënat përgjatë vëzhgimit. Pa marrë parasysh profesionin e pyetësit, qoftë ai biolog, antropolog apo paleontolog, në momentin që e parashtrojmë pyetjen "A është ky proces rezultat i një dizajni të vetëdijshëm?", ne kalojmë nga sfera e biologjisë në atë të filozofisë. Shkurtimisht, interpretimi/konsiderimi i teorisë së evolucionit si mbështetës i ateizmit-materialist nuk është biologjike, por filozofike dhe më e rëndësishmja, është interpretim i gabuar! Shumë biologë të shquar, si mbështetës të kësaj teorie, manifestuan qartë mendimin e tyre se nuk ka konflikt midis evolucionit dhe besimit në Zot. Botanistja e Universitetit të Harvardit Asa Gray që e bëri të njohur teorinë e Darwinit në Amerikë, Theodosius Dobzhansky të cilin mund ta quajmë babai i teorisë së evolucionit (i njohur si Neo-Darvinizëm), Francis Collins i cili ka qenë shefi i Projektit të Gjenomit

⁵² Shih, burimi kryesor i teorisë së evolucionit është: Charles Darwin, **The Origin of Species**, Penguin Classics, Londra, 1985.

Njerëzor për shumë vite, i cili ndoshta është projekti më i rëndësishëm i biologjisë gjenetike të kohës sonë dhe emra tjerë të famshëm si Simon Conway Morris, që është një nga shkencëtarët më të rëndësishëm të fosileve të kohës sonë, shpjeguan se nuk ka asnjë konflikt midis besimeve të tyre në Zot dhe teorisë së evolucionit. Edhe filozofi i famshëm ateist i shkencës dhe biologjisë, Michael Ruse, deklaroi se nuk ka asnjë konflikt midis besimit në Zot dhe pranimin të teorisë së evolucionit. Askush nuk mund ta vë në dyshim ekspertizën e këtyre figurave në lidhje me teorinë në fjalë. Të gjithë ata e favorizojnë harmoninë midis teorisë dhe besimit fetar duke e bërë të qartë se lidhja midis ateizmit dhe teorisë nuk buron nga përmbajtja e vetë teorisë. Nga ana tjetër, një nga ateistët më të shquar të epokës sonë dhe biologu evolucionar Richard Dawkins, u përpoq ta instrumentalizonte teorinë e evolucionit për t'i mbrojtur pikëpamjet e tij ateiste.⁵³ Të gjitha këto emra janë në konsensus për implikimet paleontologjike, gjeologjike, gjenetike dhe biologjike të teorisë së evolucionit. Divergjencat në pikëpamjet e tyre buron nga interpretimet filozofike të rezultateve shkencore, e jo nga pikëpamja e tyre shkencore.

E meta kryesore në pretendimin e lidhjes midis teorisë së evolucionit dhe ateizmit buron nga argumentet e "Zotit të boshllëqeve". Këto argumente janë mjaft kritike në filozofinë e fesë dhe ato janë burimi i shumë keqkuptimeve dhe spekulimeve. Mbrojtësit e argumenteve të tipit si "Zoti i boshllëqeve" pretendojnë se argumenti më i fortë për ekzistencën e Zotit janë të panjohurat në lidhje me universin dhe jetën, dhe se këto boshllëqe duhet të plotësohen nga Zoti. Por nëse nuk ka mbetur asnjë boshllëk i bie që nuk ka asnjë arsye për të besuar në Zot! Në të vërtetë disa teistë i shprehin pretendimet e tyre në këto vija: "Ne nuk e kuptojmë hollësisht se si funksionon syri, prandaj ai duhet të jetë krijuar nga Zoti" ose "Ne nuk e dimë se si u formuan bretkosat, kështu që Zoti i krijoi ato". Sidoqoftë pothuajse asnjë nga filozofët dhe teologët teistë të kohës sonë nuk e pranon "Zotin e boshllëqeve" si një argument mbështetës për ekzistencën e Zotit. Në vend të kësaj ata janë të mendimit se njohuria (jo injoranca) që fitojmë rreth syrit ose bretkosave na bën të jemi dëshmitarë më të mirë të artit të Zotit. Interpretimet moderne të argumenteve kozmologjike dhe të dizajnit (përfshirë ato që jemi duke i diskutuar në këtë libër) bazohen në zbulimet e shkencës moderne; e jo në injorancën tonë.

⁵³ Shih: Richard Dawkins, **Kör Saatçı**, Çev: Feryal Halatçı, TÜBİTAK, Ankara, 2002; Richard Dawkins, *Climbing Mount Improbable*, W. W. Norton, New York, 1997.

Prandaj, ata që pretendojnë se rezultatet e teorisë së evolucionit e përmbushin këtë boshllëk dhe se nevoja për ekzistencën e Zotit është eliminuar (ose reduktuar) kryejnë një gabim të përbashkët e të njohur në literaturën e logjikës, që njihet si "falsiteti i njeriut kashtë" (straw man fallacy). Autorët e "falsitetit të njeriut kashtë" injorojnë argumentet kryesore të pikëpamjes kundërshtare; dhe në vend të kësaj, ata i drejtojnë kritikën e tyre –sikur të ishte pozicioni i vërtetë– kundër një shembulli të keq-paraqitur ose të ekzagjeruar të këndvështrimit të kundërt. Midis tyre ka edhe biologë të famshëm evolucionistë si Dawkins të cilët qasjen e "Zotit të boshllëqeve" e përshkruajnë si gjënë më kryesore të teizmit dhe si pasojë e bëjnë "falsitetin e njeriut kashtë". Është e rëndësishme të theksohet se jo të gjitha deklaratat e fizikanëve dhe biologëve kanë të bëjnë me fizikën dhe biologjinë; ata ndonjëherë kalojnë prej aty në fushat e filozofisë dhe teologjisë. Mirëpo, audienca e tyre (shpesh bie në grackë nga titujt akademikë të tyre) ndonjëherë nuk arrin ta bëjnë dallimin midis rezultateve shkencore e eksperimentale dhe interpretimeve personale filozofike.

Në tekstet e feve monoteiste, Zoti nuk paraqitet vetëm si fuqia që realizon krijime të jashtëzakonshme (mrekulli). Përkundrazi, dukuritë siç është fillimi i universit ose disa situata të jashtëzakonshme të demonstruara nga profetët (këto në literaturë trajtohen nën titullin "mrekulli") janë pakicë në procesin e përgjithshëm të krijimtarisë së Zotit.⁵⁴ Gjithmonë shumica e krijimeve manifestohen përmes kauzalitetit dhe proceseve të vazhdueshme natyrore. Për shembull sipas këtyre përshkrimeve hyjnore Zoti krijon shiun, bën që fara të mbin, ushqen njeriun dhe krijon çdo person. Për më tepër, është rënë dakord gjithashtu që shiu formohet nga avullimi i ujit dhe shpërndarja e reve, njeriu krijohet nga bashkimi i nënës dhe babait dhe proceset pasuese në barkun e nënës. Me fjalë të tjera, fetë monoteiste e pranojnë lehtësisht se "Zoti krijon përmes proceseve" ose "krijon duke përdorur mjete shkakësore". Meqenëse Zoti është Krijuesi i vetëm i të gjitha proceseve, Ai lehtë mund të referohet rezultateve të krijimeve të Tij, madje ndonjëherë edhe i kapërcen ato procese. Piktori kur thotë "Unë e bëra këtë pikturë" ai rrallë herë flet qartë rreth planifikimit të tij fillestar mendor: zgjedhjen e ngjyrave, skicat e provës, etj. Megjithatë, ne përsëri nuk dyshojmë se ai është piktori i asaj pikturë (pavarësisht faktit se piktori nuk është "krijuesi" i bojës, kanavacës ose mendjes së tij). Si Krijues i vetëm i të gjitha fazave të çdo procesi, Zoti natyrshëm mund të flasë për rezultatet e krijimit të Tij, pa iu referuar fare fazave të ndërmjetme. Në fakt, krijimi i çdo qenieje në univers varet thelbësisht nga Big Beng-u dhe proceset pasuese

⁵⁴ Në lidhje me këtë temë shih: Caner Taslaman, *Kuantum Teorisi, Felsefe ve Tanrı*, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2015, s. 121-168

duke shkaktuar formimin e grimcave nën-atomike dhe më pas të atomeve. Nëse do të ishte e nevojshme të shpjegohej çdo proces që nga fillimi, do të na duhej që prej Bing Beng-ut e deri tani tu përgjigjeshim pyetjeve "Si është shtypur ky libër?" ose "Si është bërë ajo tryezë?". Është e qartë se, kur themi se diçka është bërë (si në proceset e krijimit të Zotit ashtu edhe në proceset e prodhimit njerëzor), ne zakonisht kapërcejmë shumë detaje të procesit. Në fakt kur flasim për një entitet ose fenomen do të ishte e pamundur të përshkruhen të gjitha detajet. Kushdo që është mirënjohës për ushqimin që ha dhe e pranon veten si një qenie të krijuar nga Zoti, do të thotë se ai miraton pikëpamjen e "krijimit përmes procesit". Atëherë si mund që teoria e evolucionit (edhe nëse hipotetizohet e zëmë si të saktë), si një përshkrim i proceseve që ndodhin gjatë formimit të specieve, të bie ndesh me besimin në Zot? Besimi në pikëpamjen se Zoti e krijoi njeriun nuk do të thotë se nuk ka asnjë proces në këtë krijim. Është e qartë se teoria e evolucionit si një përshkrim i zhvillimit të jetës, si dhe Teoria e Big Beng-ut si një përshkrim i fillimit të universit, nuk kanë asnjë konflikt me besimin se Zoti është Krijuesi i universit dhe jetës.⁵⁵

Ekziston një pyetje tjetër kritike në lidhje me temën e këtij libri: a përben teoria e evolucionit kërcënim kundër argumenteve që mbështesin ekzistencën e Zotit? Në fakt kapitujt e mëparshëm të librit japin përgjigje për këtë pyetje. Argumentet e renditura më parë kanë të bëjnë me parakushtet për shfaqjen e ekzistencës së jetës. Për shembull, në kapitullin e parë ne u morëm zanafillën e universit; në kapitullin e pestë kemi parë që rregullimi preciz në disa procese të brendshme të universit përshkruhet më së miri përmes ekzistencës së Zotit. Këto argumente qëndrojnë të vlefshme pavarësisht nga pikëpamja për fillimin e jetës (evolucioni ose krijimi i pavarur). Në të njëjtën mënyrë, pesë argumentet që ne do t'i përshkruajmë në pjesën e II-të (argumente të natyrës njerëzore) nuk kërkojnë refuzimin apo pranimin e evolucionit si parakusht, prandaj evolucioni nuk paraqet asnjë kërcënim për to (edhe nëse e zëmë si të saktë evolucionin). Prandaj, do të ishte e gabuar të pohohet se teoria e evolucionit përben kërcënim kundër argumenteve të paraqitura në këtë libër.

Ekziston një pyetje tjetër lidhur me këtë: edhe pse evolucionin nuk përbën një kërcënim për argumentet e tjera në lidhje me ekzistencën e Zotit, a paraqet ai një kërcënim kundër argumenteve të bazuara në ekzistencën e jetës? Përgjigja është se, do të kishte paraqitur kërcënim vetëm nëse argumenti për ekzistencën e jetës bazohet në supozimin (e panevojshëm) se secila specie është

⁵⁵ Caner Taslaman, **Evrîm Teorisi, Felsefe ve Tanrı**, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2014, 4. Bölüm, f. 276-388.

formuar në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra. Është krejtësisht e mundshme që vetëm duke u bazuar në fenomenin e lidhur me jetën të zhvillohen argumente mbështetëse të ekzistencës së Zotit. Argumenti që paraqes në kapitullin aktual është një shembull i tillë. Kështu është përmbledhja e tij:

1. Vëzhgojmë larmi të jashtëzakonshme dhe veti shumë interesante të jetës në tokë; të cilat manifestohen në botën mikro dhe makro, por edhe në strukturat e trupit dhe në sjelljet e tyre.
2. Ekzistenca e kësaj larmie dhe e këtyre vetive mund të shpjegohet ose nga teizmi ose nga ateizmi-materialist.
3. Teizmi i shpjegon këto larmi dhe karakteristika më mirë sesa ateizmi-materialist, sepse:
 - 3.1 E shpjegon më mirë ekzistencën e potencialit, i cili bën të mundur ekzistencën e tyre.
 - 3.2 E shpjegon më mirë kompleksitetin në mikro botën.
 - 3.3 E shpjegon më mirë konvergjencën/convergence (rishfaqja e veçorive shumë të komplikuara pa ndërprerë) në botën makro.
4. Si rezultat, shpjegimi i teizmit duhet të përzgjidhet si më i saktë në raport me materializmin-ateizmin.

Kushdo që i ndjekë zhvillimet në shkencën moderne, do ta pranojë lehtësisht pikën e parë të këtij argumenti. Mund të themi se nuk do të ketë asnjë problem midis teistëve dhe ateistëve-materialistë në pranimin e kësaj pike. Carl von Linnaeus, i konsideruar si babai i taksonomisë (metodologjia për sistematizimin e gjallesave) njihte afërsisht 6,000 specie bimësh (në vitin 1753) dhe vlerësoi se totali ishte rreth 10,000. Në vitin 1758, ai renditi 4,000 specie kafshësh dhe përsëri e vlerësoi totalin si 10,000.⁵⁶ Ky klasifikim u bë jashtëzakonisht i vështirë për tu vazhduar me zbulime të reja në lidhje me botën e insekteve dhe organizmave mikroskopikë. Sot numri i specieve të zbuluara është disa milion. Nga mikro-bota te strukturat makroskopike të trupit të tyre, këto miliona specie shfaqin një larmi dhe kompleksitet të jashtëzakonshëm. Zoologët dhe botanistët kanë zbuluar veti shumë interesante në sjelljet si ushqimi, gjuetia, mbrojtja, bashkëpunimi dhe çiftëzimi. Mrekullitë e shkencës dhe teknologjisë moderne siç janë mikroskopët dhe mikro-kamerat i kanë lehtësuar edhe më shumë këto zbulime.

⁵⁶ Ernst Mayr, **The Growth of Biological Thought**, The Belknap Press of Harvard University Press, Cambridge, 1982, f. 172.

Diversiteti te gjallesat, nga kafshët te bimët, ka qenë gjithmonë një fokus i rëndësishëm interesi. Gjatë gjithë historisë së biologjisë formimi i jetës në tokë është shpjeguar përmes proceseve si gjenerimi spontan dhe evolucioni.⁵⁷ Përveç këtyre qasjeve, gjithashtu ekzistojnë dy pikëpamje kryesore alternative në historinë e mendimit si, pikëpamja e teizmit se jeta është krijim i vetëdijshëm nga Zoti dhe pikëpamja materialiste-ateiste se formimi i jetës është përmes rastësive në kuadrin e proceseve natyrore. Shkurtimisht, siç thuhet në pikën e dytë të argumentit, teizmi dhe ateizmi materialist shfaqen si dy qasje rivale në shpjegimin e proceseve që rezultojnë në formimin e qenieve të gjalla.

Kundërshtimi i një ateisti materialist do të jetë në pikën e tretë, e cila është kritike në argumentimin tonë. Prandaj ne do t'i trajtojmë pikat (3.1, 3.2 dhe 3.3) veç e veç më poshtë. Mbani në mend se trajtimi më poshtë është vetëm një përmbledhje e shkurtër në lidhje me gjerësinë e fenomeneve të lidhura me jetën. Kur vërtetohet vlefshmëria e pikës së 3-të, pika përfundimtare, pra teizmi, duhet të përzgjidhet para ateizmit-materialist.

Vlerësimi i pikës 3.1: Argumenti i paraqitur më parë nga "potenciali i universit" dhe kjo çështje aktuale kanë thelbin e njëjtë. Sidoqoftë, shumëllojshmëria dhe vetitë interesante që vëzhgojmë në botën e qenieve të gjalla janë aq të mëdha saqë potenciali i universit që e mundëson ekzistencën e botës së gjallesave mund të zhvillohet si një argument më vete. Siç u përmend më parë, çfarëdo që del nga ndryshimi i qenies X, tregon potencialin e X. Nëse qenia X nuk do të kishte përmbajtur këtë potencial, nuk do të kishte ndodhur gjëja e dalë. Logjikisht, asgjë nuk mund të dalë nga diçka përtej potencialit të saj. Pavarësisht nga ndryshimet që ndodhin në teoritë tona shkencore, ne gjithmonë mund të pohojmë se qeniet e gjalla nuk do të kishin shfaqur larminë dhe vetitë e tyre nëse universi nuk do ta kishte përmbajtur atë potencial. E vërteta ose e pavërteta e teorisë së evolucionit, pranimi i evolucionit Lamarckian ose Darwinist, modifikimi i roleve të dhëna të mutacionit dhe seleksionimi natyror... të gjitha këto mund ta ndryshojnë mënyrën e të kuptuarit tonë mbi atë se si erdhën në ekzistencë delfinët, milingonat ose bimët e kakaos në tokë; por sidoqoftë, ato nuk do ta ndryshojnë faktin se delfinët, milingonat ose bimët kakaos nuk do të kishin ekzistuar nëse universi nuk do ta posedonte atë potencial.

⁵⁷ Caner Taslaman, *Evrin Teorisi, Felsefe ve Tanrı*, f. 76-79.

Nuk kemi nevojë për rezultate moderne shkencore për të mbështetur pikën 3.1. I njëjti pohim mund të ishte bërë një mijë vjet më parë bazuar në njohuritë e kohës. Sidoqoftë, me rezultatet e shkencës moderne, larmia dhe vetitë e jetës kuptohen më mirë se kurrë më parë në histori: duke zgjeruar njohuritë tona mbi potencialin e universit në nivele të papara. Pra, kemi më shumë të dhëna se në çdo periudhë tjetër në histori për të kuptuar vlerën e këtij argumenti. Jeta, aftësia maskuese, gjenerimi i dritës, sistemet e radarëve, etj., të gjitha ekzistojnë falë potencialit të universit. Pavarësisht nga roli që ka luajtur seleksionimi natyrorë apo ai seksual në shfaqjen e tyre, ato nuk do të mund të shfaqeshin nëse universi nuk do ta kishte paraqitur dhuratën e tij (potencialin) që nga fillimi. Le të shqyrtojmë për një moment vetitë e qenieve të gjalla siç janë kamuflimi, gjenerimi i dritës dhe metodat e migrimit dhe të bëjmë pyetjen vijuese: A është ekzistenca e potencialit që lejon gjenerimin e një larmie kaq të madhe dhe një game kaq të gjerë meritash, një situatë më e pritur nga perspektiva teiste apo nga ajo materialiste-ateiste? Për ekzistencën e potencialit që mundëson shfaqjen e miliona specieve me veti të jashtëzakonshme, a është më e arsyeshme të pohojmë se ky potencial është bërë me vetëdije, si në këndvështrimin teist, apo është më e arsyeshme të supozohet se ekziston nga një rastësi fatlume si në këndvështrimin materialist-ateist?

Në besimin teist, Zoti është i plotfuqishëm dhe i gjithëdijshëm, fuqia e të cilit nuk zvogëlohet duke krijuar. Krijimi i universit nga Zoti me potencial për të larmishëm dhe vetitë interesante të vëzhguara në qeniet e gjalla, nuk është aspak e habitshme, sepse Ai e krijoi këtë potencial për njerëzit (ose qenie të tjera të vetëdijshme), ashtu që ata t'i vëzhgojnë rezultatet. Në këndvështrimin materialist-ateist të universit, materia është pasive dhe e pavetëdijshme, dhe kështu nuk mund të ketë një qëllim (pasi qëllimi mund të ekzistojë vetëm në qeniet e vetëdijshme). Për këtë arsye, gjithçka që shfaqet në botën e gjallesave janë formime të rastësishme që u shfaqën brenda kornizës së ligjeve të materies dhe nuk ka asnjë element që do ta bënte universin të mbartte këtë potencial dhe as të bënte të favorshme që gjallesat të shfaqeshin me të gjitha këto tipare. Vëzhgimi i një diversiteti/larmie kaq të madh dhe një game kaq të gjerë zgjidhjesh të krijuara për të mbijetuar, është krejtësisht befasuese në ateizmin-materialist. Meqë kjo situatë i përshtatet paradigmës teiste, ne kemi arsye objektive për ta përzgjedhur teizmin para ateizmit-materialist. Shpjegimi i "rastësisë fatlume" nuk është aspak i kënaqshëm, ndërsa paradigma teiste ofron një pasqyrë të qëndrueshme; prandaj "shpjegimi i teizmit duhet të përzgjidhet si më i saktë në raport me materializmin-ateizmin".

Vlerësimi i pikës 3.2: Për mijëra vite njeriu nuk ishte në dijeni për hendekun e madh midis gjërave të gjalla dhe të pajeta. Një tregues i këtij fakti është besimi për një kohë të gjatë në krijimin e jetës përmes brezit spontan (spontaneous generation). Sipas kësaj hipoteze, jeta mund të formohet nga përbërja e substancave të pajetë pa nevojën e riprodhimit nga prindërit. Disa madje shkuan aq larg sa filluan të përgatisnin receta për krijimin e bletëve, mizave ose minjve duke përzier substanca të caktuara. Kishte pasur ide për të prodhuar/gjeneruar nga mbeturinat ose nga kufomat e kalbura të kafshëve të ngordhura.⁵⁸ Aristoteli besonte se mizat dhe bimët gjeneroheshin nga gjërat e kalbura.⁵⁹ Me futjen e mikroskopit në fushën e biologjisë në shekullin e 17-të, diskutimet rreth "brezit spontan/vetë-derivimit" (spontaneous generation) fituan një dimension të ri. Ishte bërë pothuajse e pamundur të mbrosh ide si brezi spontan/vetë-derivimi i bletëve ose mizave dhe kështu është kuptuar se ndryshimi midis një gjëje të pajetë dhe të gjallë është më i madh seç është imagjinuar. Çuditërisht nocioni i brezit spontan u përtëri shumë shpejt si një shpjegim i formave njëqelizore të jetës të vërejtura në mikroskop. Me përparimet në teknologjinë mikroskopike, gozhda e fundit në arkivolin e brezit spontan u godit në shekullin e XIX-të, duke e zgjeruar më tej hendekun midis qenieve të gjalla dhe të pajetë; saqë nuk mbeti asnjë shkencëtar që pranon se edhe organizmat me një qelizë mund të formohen nga "brezi spontan".⁶⁰

Në fillimet e shekullit të XX-të, pavarësisht të gjitha kuptimeve të dallimeve midis të gjallës dhe të pajetës, qeliza ishte ende e imagjinuar si një "glob homogjen i plazmës" ("homogeneous globule of plasm"), i përbërë prej komponentëve kimike të thjeshta. Me fjalë të tjera, kompleksiteti në mikro-botë nuk ishte kuptuar ende plotësisht. Zhvillimet e mëtejshme në vitet 1950 në teknologjinë mikroskopike, e revolucionarizuan tejmas biologjinë e qelizave. U kuptua se qelizat përbëhen nga molekulat komplekse siç janë proteinat. Ndoshta më e rëndësishmja, zbulimi i ADN-së përmirësoi ndjeshëm njohuritë tona se si qeliza funksionon dhe riprodhohet vetë. Kurse tani e kuptojmë se qeliza funksionon si një fabrikë e sofistikuar. ADN-ja rregullon proceset si një super kompjuter në qendër të qelizës; ARN-ja funksionon si punëtorët; mitokondria prodhon energjinë e qelizës; proteinat janë makina që kryejnë operacione të ndryshme; membrana qelizore është mbrojtja kufitare, duke lejuar kalimin vetëm të asaj që nevojitet brenda.

⁵⁸ Elizabeth Gasking, **Investigations into Generations**, Hutchinson and Co Publishers, Londra, 1967, f. 18.

⁵⁹ Erik Nordenskiöld, **The History of Biology**, Çev: L. Bucknall Eyre, Tudor Publishing, New York, 1920, f. 430.

⁶⁰ Catherine Wilson, **The Invisible World Early Modern Philosophy and the Invention of the Microscope**, Princeton University Press, Princeton, 1995.

Pamja e qelizës e treguar nga shkencë moderne është shfaqje e qartë e hendekut midis të gjallës dhe të pajetës. Kjo pamje bëhet edhe më magjepsëse kur kemi parasysh faktin se në disa centimetra të një trupi të gjallë, ka mijëra qeliza. Tani, a është kjo pamje më e përputhshme me pritjet teiste apo materialiste-ateiste? Para zhvillimeve në shkencë, për një kohë të gjatë në histori, paradigma materialiste-ateiste priste që afërsia midis të gjallës dhe të pajetës të bëhej më e dukshme me gjetjet e reja të shkencës. Zgjerimi i hendekut mes tyre erdhi si një befasi e papritur. Nga këndi teist, as afërsia as largësia në mes të së gjallës dhe të pajetës nuk është problematike. Zoti është Krijuesi i botës mikro dhe makro; Ai është i plotfuqishëm; Ai mund ta shfaqë fuqinë e tij përmes strukturave komplekse që Ai krijon në mikro-botë. Shfaqja e strukturave kaq komplekse madhështore përmes evolucioneve kimike –edhe pse proceset ende nuk janë kuptuar plotësisht– nuk e lë në hije madhësinë e Zotit dhe një shfaqje e tillë nuk e ndryshon faktin: pamja komplekse e qelizës është shumë më e pritshme nga teizmi sesa nga materializmi-ateizmi.

Le të përpiqemi të hulumtojmë më tej në kompleksitetin e qelizës përmes studimit të një proteine. Edhe llojet më të thjeshta të qelizave përbëhen nga qindra proteina. Në mënyrë që ato të funksionojnë si duhet në qelizë, aminoacidet (blloqet ndërtuese të proteinave) duhet të renditen si duhet në një proteinë. Edhe ndryshimet e vogla në rregullimin e aminoacideve mund të shkaktojnë mosfunksionim të proteinave. Biologu evolucionar dhe biokimisti Steven Rose, shpreh disa fakte të mrekullueshme në lidhje me proteinën si më poshtë:

“...Për një proteinë relativisht modeste –me një peshë molekulare 10^{300} dhe me 10^{280} aminoacide, por e përbërë nga vetëm 12 aminoacide të ndryshme nga 20 të mundshme– numri i izomereve (stereo-konstrukione) është 10^{300} . Nëse vetëm një molekulë e secilit izomer do të ekzistonte, masa totale do të ishte rreth 10^{280} gram. Meqenëse pesha e tokës është vetëm 10^{270} gram, është shumë e qartë se ekziston vetëm një pjesë e vogël e këtyre izomereve.”⁶¹

Me fjalë të tjera sikur ta shndërronim të gjithë materien e universit në aminoacide dhe t'i përdornim ato si lëndë të parë, të krijojmë një sistem që ndërton kombinime të rastësishme të tyre, të krijojmë një sistem tjetër që filtronte disa proteina që na duhen, probabiliteti i marrjes së proteinës së synuar do të ishte pothuajse i pamundur.

⁶¹ Steven Rose, **Lifelines**, Oxford University Press, Oxford, 1998, f. 255.

Sinteza e proteinave është e nevojshme edhe për paraardhësin më të thjeshtë të qelizave. Edhe për krijimin e një organizmi të thjeshtë fiktiv mikroskopik, do të duheshin qindra proteina të organizuara sipas një rendi të caktuar. Numri minimal i mundshëm i proteinave të nevojshme për ekzistencën e jetës është një çështje e diskutueshme; sipas një studimi edhe qeliza më e thjeshtë duhet të përmbajë të paktën 387 proteina (edhe pse ky numër është i diskutueshëm, edhe numri më i ulët i vlerësuar në të gjitha këto punime është gjithmonë më i madh se 200, i cili është një numër mjaft i lartë veçanërisht duke marrë parasysh strukturën komplekse të një proteine të vetme).⁶² Seleksionimi natyror nuk mund të japë shpjegim për formimin e këtyre proteinave. Seleksionimi natyror hyn në lojë si rezultat i konkurrencës për mbijetesë dhe mund të veprojë vetëm për riprodhimin e formave të jetës; mekanizmi i seleksionimit natyror është jo-material para ekzistencës së vetë jetës. Mbrojtja e ekzistencës së një mekanizmi të tillë para se të ekzistojë jeta, është në kundërshtim me përshkrimin e mekanizmit të seleksionimit natyror.

Disa studime sugjerojnë shfaqjen e qelizave të para të bazuara në ARN (modeli njihet si ARN-Botë).⁶³ ARN-ja është molekulë mjaft e komplikuar, prandaj edhe proceset pas shfaqjes së parë nuk janë kuptuar ende plotësisht. Edhe nëse supozojmë se këto procese do të kuptohen plotësisht një ditë, nuk duhet ta presim atë ditë për tu ballafaquar me botën komplekse të qelizës dhe proceset madhështore që ndodhin brenda saj, pasi gjetjet e shkencës moderne tashmë ofrojnë të dhëna përkatëse. Ateizmi-materialist e konsideron natyrën si një fazë të ngjarjeve pa vetëdije, jo të qëllimshme. Në këtë këndvështrim, vëzhgimi i molekulave të shumta të komplikuara (ndërsa kombinimet e rastësishme të lëndëve të para në univers japin shumë pak mundësi madje për formimin edhe të një molekule të tillë) dhe funksionimi i këtyre molekulave në mënyra të caktuara është diçka krejt e papritur (edhe nëse ato vëzhgime rezultuan nga procese të brendshme për natyrën). Ndërsa ky vëzhgim nuk paraqet ndonjë befasi për teizmin dhe kjo pamje e paraqitur në botën e mikro gjallesave nga shkenca siguron një arsye tjetër se pse duhet përzgjedhur shpjegimin e teizmit si më të saktë në raport me materializmin-ateizmin.

Vlerësimi i pikës 3.3: Një fakt mjaft i veçantë në botën e qenieve të gjalla është shfaqja e vetive të ngjashme në speciet që nuk vijnë nga e njëjta trashëgimi. Këto veti njihen si "konvergjente" në biologji. Një shembull i mirënjohur është aftësia për të fluturuar, e vërejtur te

⁶² Glass J. I. ve , "Essential Genes of a Minimal Bacterium", Proceedings of the National Academy of Sciences, 103/2, 2006, f. 425-430.

⁶³ Leslie Orgel, "Evolution of the Genetic Apparatus", J Mol. Biol, 38/3, 1968, f. 381–393.

zogjtë, insektet, gjitarët (p.sh. lakuriqët e natës) dhe pterosaurët (tani janë zhdukur/zvarranikët e zhdukur). Kjo aftësi është rënë dakord të ketë dalë në mënyrë të pavarur në këto specie. Konvergjencia mund të manifestohet si në kafshë ashtu edhe në bimë, por edhe në vetitë e sjelljes dhe të nivelit molekular. Ekzistojnë qindra shembuj të njohur të konvergjencës në biologjinë moderne; në të gjitha ato raste veçoritë nuk trashëgohen nga një paraardhës i përbashkët.⁶⁴ Disa shembuj të tjerë të konvergjencës janë ekolokacioni* (echolocation) në delfinët dhe lakuriqët e natës; prodhimi i lehtë i xixëllonjave dhe specieve të caktuara të peshqve të ujërave të thella; dhe lundrimi përmes pozicionit të diellit nga disa specie zogjsh dhe insektesh.

Siç u përmend më lart, qeniet e gjalla shfaqin një nivel mahnitës të kompleksitetit në nivelin mikroskopik. Karakteristikat e konvergjencës që sapo përmendëm kryhen përmes veprimeve të koordinuara të shumë molekulave në nivelin mikroskopik. Pyetja kritike këtu është "Si ndodhin vetitë e tilla të komplikuar konvergjente pa pushim?" Nëse forca shtytëse prapa diversitetit është mutacioni në gjen, nuk ka asnjë ligj në natyrë që i thotë mutacioneve të veprojnë drejt një qëllimi të caktuar. Kështu që askush nuk duhet të presë shfaqjen/ndodhjen e strukturave (secila ka një probabilitet jashtëzakonisht të ulët për t'u formuar) pa pushim dhe në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Sipas Stephen Jay Gould, nëse do të ishim në gjendje të ktheheshim në kohë në fillim të tokës, gjithçka do të ndodhte ndryshe.⁶⁵ Nga ana tjetër, Simon Conway Morris përdor argumente të konvergjencës dhe mban mendimin se jeta do të ishte mjaft e ngjashme me atë që është tani. Sepse nëse shumë tipare në këtë botë zhvillohen të pavarura nga njëra-tjetra dhe nëse bota është krijuar përsëri në të njëjtat kushte, atëherë format e jetës me tipare të ngjashme duhet të pritet që të ndodhin përsëri. Nëse i konsiderojmë mutacionet e rastësishme dhe përzgjedhjen natyrore (për zgjedhjen e rezultateve të mutacioneve) si mekanizma shkaktarë të diversitetit, pritshmëria e Gould do të ishte më e logjikshme (duhet të presim një skenë krejtësisht të ndryshme të jetës, nëse toka do të rifillonte). Sidoqoftë, nëse marrim parasysh vetitë e vëzhguara të konvergjencës (Gould ishte i vetëdijshëm për to), pasi që veti të ngjashme janë shfaqur në mënyrë të pavarur shumë herë në tokë, do të ishte më e racionale të prisnim (siç bën Morris) shfaqjen e një skenar mjaft të ngjashëm.

⁶⁴ Simon Conway Morris, **Life's Solution: Inevitable Humans in a Lonely Universe**, Cambridge University Press, Cambridge, 2005; Simon Conway Morris, **The Deep Structure of Biology**, Templeton Foundation Press, Pennsylvania, 2008.

*Vendndodhja e objekteve nga tingulli i reflektuar, në veçanti ai i përdorur nga kafshët si delfinët dhe lakuriqët e natës.

⁶⁵ Stephen Jay Gould, *Wonderful Life*, W. W. Norton and Company, New York, 2007.

Më e rëndësishmja, duhet të vëmë re se mutacionet e rastësishme dhe seleksionimi natyror nuk japin shpjegime të kënaqshme për kaq shumë veti konvergjente. Cili është shpjegimi për shfaqjen/ndodhin e përsëritur të tipareve që nuk ka gjasa të shfaqen/ndodhin kurrë edhe një herë? Meqenëse vëzhgojmë evolucione të pavarura konvergjente, trashëgimia nga një paraardhës i përbashkët nuk është përgjigja këtu. Për më tepër, përgjigje të ngjashme me ato që kemi diskutuar më parë në kapitullin për rregullimet precize në fizikë, të tilla si “Sikur të mos ekzistonin këto ligje, ne nuk do të ishim këtu për t’i respektuar ato; prandaj nuk duhet të habitemi për probabilitetet jashtëzakonisht të ulëta në rregullimet precize”, nuk do të ishte e pranueshme. Ne mund të kishim ekzistuar edhe pa konvergjencë. Ne do të ishim ende gjallë edhe nëse lakuriqët e natës dhe delfinët nuk do të kishin ndarë ekolokacionin*⁶⁶ (ose edhe nëse këto specie nuk do të kishin ekzistuar fare). Shfaqja e sjelljeve të tilla të komplikuar pa ndërprerë është për sa i përket probabilitetit e pamundshme (mbani mend pamjaftueshmërinë e lëndëve të para në univers për të formuar qoftë edhe një proteinë të vetme për një funksion specifik).

Të gjitha këto probleme lindin nga supozimi materialist-ateist i një procesi krejtësisht të rastësishëm të evolucionit. Nëse proceset në natyrë vlerësohen si rezultate të një dizajni të vetëdijshëm, të gjitha këto probleme zhduken. Nuk ka asgjë të habitshme që Zoti i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm të krijojë përmes proceseve të instaluar në qeniet e gjalla pa pushim (në një mënyrë konvergjente). Për ta arritur këtë, Zoti mund të kishte përdorur një mekanizëm sikurse manipulimi i mutacioneve si dhe të kishte krijuar forma të tjera të ligjeve të brendshme (ende nuk janë zbuluar) të natyrës për të kryer procese konvergjente. Në çdo rast teizmi e shpjegon më mirë se ateizmi-materialist tiparin e konvergjencës, e cila është një nga fenomenet më interesante të botës së gjallë.

Shkurtimisht, teoria e evolucionit nuk paraqet ndonjë kërcënim për teizmin. Deri tani bota e qenieve të gjalla shfaq një mori informacionesh për të zhvilluar argumente që favorizojnë teizmin. Ka shumë fenomene që mund të konsiderohen si shembuj. Vetëm disa pika do të përmend këtu në formë përmbledhëse: potenciali i universit për të formuar larminë e jashtëzakonshme në jetë (3.1), hendekun e madh midis qenieve të gjalla dhe të pajetë, siç kuptohet progresivisht gjatë gjithë historisë së biologjisë, strukturat komplekse në mikro-botë duke shkaktuar këtë boshllëk (3.2), dhe

^{66*} Vendndodhja e objekteve nga tingulli i reflektuar, në veçanti ai i përdorur nga kafshët si delfinët dhe lakuriqët e natës.

konvergenca e vetive me shumë shembuj të zbuluar në biologjinë moderne (3.3) të gjitha shpjegohen më mirë nga teizmi sesa-ateizmi materialist. Këto fakte priten shumë më shumë nga paradigma teiste sesa ajo materialiste-ateiste. Prandaj, shembujt nga jeta të shënuar në këtë kapitull mbështesin argumentet e deklaruara më parë për të përzgjedhur shpjegimin e teizmit si më të saktë në raport me atë ateist-materialist.

KAPTIULLI I DYTË

NËNKAPTIULLI I TETË (VIII)

ARGUMENTI I DËSHIRAVE NATYRORE (DËSHIRAT E NATYRSHME)

VIII

Argumenti i dëshirave natyrore

Disa mendimtarë teistë pretendojnë se te njerëzit ekzistojnë dëshira të cilat në një çfarë mënyre kanë veti orientuese drejt Zotit. Shumë pak prej tyre e kanë vlerësuar këtë si argument për ekzistimin e Zotit, madje një shumicë tjetër nuk e kanë konsideruar as edhe si pjesë të këtij argumenti. Për shembull, pretendime të këtilla vërejmë edhe në shkrimet e Paskalit :

“ Të gjithë njerëzit e kërkojnë lumturinë. Kjo është diçka që nuk don përjashtim...Të gjithë njerëzit ankohen; princërit, shërbëtorët, elitat, populli, të vjetërit, të rinjtë, të fuqishmit, të dobëtit, të edukuarit, injorantët, të shëndoshët, të sëmurit, pra fenomeni i njëjtë është prezent thuajse në çdo shtet, në çdo kohë, në çdo periudhë, në çdo standart... Më kot njeriu mundohet ta mbushë zbrazëtirën e tij përmes gjërave përreth, ngase asnjëra prej atyre gjërave nuk i ndihmon atij. Kjo zbrazëti mund të përmbushet vetëm përmes diçkaje të pafundshme dhe të pandryshueshme, pra mund të përmbushet vetëm përmes Allahut.”⁶⁷

Edhe nëse e zëmë se ekziston në natyrshmërinë e njeriut një zbrazëti (dëshirë) e këtillë për tu plotësuar; besimtarët të cilët besojnë në Zotin lirshëm mund të thonë “Unë i jam drejtuar Zotit, kam shpëtuar nga zbrazëtira brenda meje, i kam plotësuar dëshirat e mia, sepse objekt i dëshirave të mia të brendshme paska qenë Zoti”. Mirëpo eksperiencat e këtilla subjektive të besimtarëve është e pamundur t’i shndërrojmë në argumente objektive dhe t’i përdorim si të tilla përpara jobesimtarëve. Për këtë arsye shumë ateistë dhe agnostikë e mohojnë ekzistimin e një dëshirë të këtillë. P.sh John Beversluis kur e kritikon këtë qasje, thotë se është e pamundur ekzistenca e një dëshirë si kjo. Në literaturë kur përmendet “argumenti për dëshirat” (the argument from desire), në fakt bëhet fjalë për qasjet e këtij lloji.

Këtu, ndryshe nga ajo lartë, duke u bazuar në faktin e dëshirave të natyrshme, do të mundohemi ta mbrojmë një argument autentik të cilin e pranojnë edhe vet ateistët. Dëshirat tona të natyrshme janë veçori të cilat neve na bëjnë ne, ekzistencën e të cilave mund ta vërtetojmë përmes një observimi të vogël kushtuar brendësisë sonë (introspektivës). Dëshirat tona natyrore

⁶⁷ Blaise Pascal, **Pensees**, Përkth: A.J Krailsheimer, Penguin Classics, Londra 1966 f.74-75.

siç janë: nevoja për ushqim, për pije, për jetesë dhe për lumturi, janë gjëra të cilat na shoqërojnë që prej momentit të lindjes. Nevoja për të gjetur një shpjegim rreth asaj se si ndodhi që i gjithë ky grumbuj dëshirash të jetë pjesë e jona, është një pikë e rëndësishme që shumë njerëz e kanë anashkaluar. Ne shpeshherë jemi të pavetëdijshëm ndaj këtyre fenomeneve, njëjtë siç janë të pavetëdijshëm peshqit për praninë e ujit; madje bëjmë sikur nuk i shohim të gjitha këto dhe vetëm duke i konsideruar si të domosdoshme, tërë këtë pikëpyetje të madhe e përfundojmë duke thënë “Po s’kishte si të ishte ndryshe”. Të qenit dëshmitar për të njëjtin lloj dëshirash te çdo njeri, nga më injorantët e deri te më të diturit, shpesh e pengon vlerësimin e faktit mbresëlënës të ekzistencës së këtyre dëshirave. Prezenca e këtyre fenomeneve te çdo njeri, nuk e ul vlerën tyre, por përkundrazi e ngrit atë. Për ta përvetësuar edhe më shumë këtë madhësi, përveç nevojës për një introspektive të fuqishme, nevojitet edhe një vlerësim serioz dhe filozofik mbi tërësinë e universit. Edhe pse në nivelin atomik ndajmë përbërje të njëjtë, a thua vallë çfarë i bën bimët, dheun dhe ujin që të mos kenë dëshira të tilla? Në këtë libër, përveç plotësimit të këtyre zbrazëtirave të lartëpërmendura, duke e marrë për bazë natyrshmërinë e qenieve, do të prezentohen argumente në favor të teizmit. Ky argument mund të prezentohet në këtë mënyrë:

1. Dëshirat tona të natyrshme dhe thelbësore janë këto :

1.1 Jeta

1.2 Shuajtja e frikërave

1.3 Kërkimi i qëllimit të jetës

1.4 Lumturia

1.5 Mësimi larg dyshimeve

1.6 Trajtimi i mirë nga të tjerët

2. Secila prej këtyre dëshirave natyrore dhe themelore, të cilat nuk mund të reduktohen në njëra-tjetrën, edhe pse kanë lidhje me njëra-tjetrën, mund të përmbushen vetëm me praninë e Zotit.

3. Ekzistojnë dy pikëpamje themelore alternative të cilat e sqarojnë mënyrën se si u shpërfaqën këto dëshira të natyrshme dhe themelore :

3.1 Këto dëshira janë shpërfaqur në mënyrë të rastësishme dhe të domosdoshme; pikëpamje që parashikohet nga ana e ateistëve-materialistëve.

3.2 Këto dëshira i ka krijuar Zoti; pikëpamje e besimit teist.

4. Fakti që dëshirat e ndryshme natyrore dhe themelore të sipërpërmendura (pika 1) kanë nevojë për një ontologji të njëjtë (pika 2); tregon se ekzistenca e Zotit dhe krijimi i këtyre dëshirave nga ana e Tij, janë më racionale se alternativa tjetër e besimit, ateizm-materializmi.
5. Si rezultat, themi se teizmi duhet të preferohet para ateizmit-materializmit.

Fillimisht, e shoh të dobishme t'i përgjigjem një kritike që i drejtohet argumentit për dëshirën në formën e saj të lartëpërmendur, sepse mund të ketë nga ata që përpiqen ta sjellin të njëjtën kritikë ndaj argumenteve që jemi duke i shtjelluar këtu. Ata që e bëjnë këtë kritikë thonë se prej dëshirave të tyre është posedimi i një Ferrari, por nuk e kanë atë; gjithashtu thonë se dëshirojnë të shkojnë në botën e përrallave, por në realitet nuk mundën⁶⁸. Ata duke u shprehur kështu theksojnë se ekzistenca e dëshirave nuk e bën të domosdoshme ekzistencën e objektit të këtyre dëshirave. Peter Kreft i përgjigjet kësaj kritike duke e bërë ndarjen e dëshirave në “ natyrore “ dhe “ artificiale “. Ai thotë se dëshirat natyrore vijnë nga “brenda”, ndërsa dëshirat artificiale vijnë nga “jashtë, nga shoqëria, nga reklamat ose trillimet” dhe tërheq vëmendjen për dallimin midis të mos qenit në gjendje të shkosh në botën e përrallave dhe të mos flesh fare. Dallimi kryesor është se dëshirat natyrore janë të zakonshme për të gjithë ne, ndërsa dëshirat artificiale ndryshojnë nga personi në person.⁶⁹ Njëra nga arsyet se përse në pikën e parë të argumentit i cilësoj këto dëshira si “ natyrore ” dhe “ themelore “, është mbyllja e derës së kundërshtimeve të këtilla që nga fillimi.

Një pjesë e madhe e ateistëve dhe agnostikëve pa asnjë kundërshti e kanë pranuar se te njerëzit ekzistojnë gjashtë dëshirat që i numëruam në pikën e parë. Madje ateistët më të famshëm në histori, janë shprehur se për t'i plotësuar dëshirat e këtij lloji është e domosdoshme ekzistenca e Zotit, ashtu siç edhe e kemi potencuar në pikën e dytë. Mirëpo ata me këtë u përpoqën të thoshin se ekzistenca e Zotit është diçka e shpikur pasi që plotësimi i këtyre dëshirave kishte nevojë për ekzistencën e Zotit. Një nga elementet më kritike të këtij argumenti qëndron në këtë pikë: pranimi i pikës fillestare të materialistëve-ateistëve, por duke demonstruar se është më racionale të arrihet e kundërta e konkluzionit të tyre, pra se Zoti nuk është shpikje, por vërtet ekziston. Së pari, duke i

⁶⁸ John Beversluis, **C.S Lewis and the Search for Rational Religion**, f.47.

⁶⁹ Peter J.Kreeft and Ronald K.Tacelli, **Pocket Handbook of Christian Apologetics**, InterVarsity Press, Downers Grove, 2003, f.26-27.

shtjelluar tre nga dëshirat e lartpërmendura (jetën, shuarjen e frikërave dhe qëllimin e jetës) do të mundohem ta tregoj formën se si këto dëshira i detyrohen ekzistencës së Allahut dhe këtë do ta bëj duke iu referuar disa mendimtarëve shumë të famshëm ateistë.⁷⁰

Vlerësimi i dëshirës për të jetuar: “Dëshira për të jetuar” është njëra prej dëshirave më themelore dhe natyrore që zë vend në brendinë e çdo njeriu normal dhe të shëndoshë. Kjo dëshirë është aq themelore, saqë për hir të saj mund të sakrifikohen shumë dëshira të tjera natyrore. P.sh le të mendojmë pak për ata njerëz në plazhë që eten për ujë, uriten për bukë dhe kanë nevojë seksuale ndaj bashkëshortëve të tyre. Këto njerëz, në rastin e parë që kuptojnë se zonën e tyre do ta pushtojë një cunami ose që e vërejnë nga larg ardhjen e cunamit, do të iknin nga ajo zonë pa menduar fare për plotësimin e dëshirave tjera natyrore. Schopenhaueri është njëri nga filozofët e famshëm ateistë që ka vendosur theks të veçantë mbi “dëshirën për të jetuar”. Sipas tij kjo dëshirë ose intuitë është më themelorja se gjithçka tjetër. Schopenhauer thotë se edhe vetëvrasja nuk ka të bëjë me refuzimin “ e dëshirës për të jetuar”, por ka të bëjë me dhimbjet dhe kushtet jetësore.⁷¹ Mendja njerëzore për dallim nga të gjitha gjallesat tjera është e aftë të mendojë dhe të krijojë lidhje të ndryshme me të kaluarën dhe të ardhmen. Mendja që është e programuar të krijojë lidhje ndërmjet ndjenjës së brendshme “ të dëshirës për të jetuar “ dhe ardhmërisë, është e pamundur të mos mendojë për jetën e amshueshme (ahiretin). Nuk mendoj se kjo botë është e mjaftueshme për ta bërë të kënaqur atë që e dëgjon zërin e brendshëm të “ dëshirës për të jetuar.” Të dhënat shkencore tregojnë për pashmangshmërinë e përfundimit të tërë universit nëpërmjet njërës prej dy alternativave : “Krizë e madhe “ (Big Crunch) dhe “ Ngrirja e Madhe “ (Big Chill); sigurisht e tërë kjo pritet të ndodhë nëse nuk shfaqen skena të tjera.⁷² Atëherë, bazuar edhe në këto të dhëna, ne mund të themi se realizimi i objektit të dëshirës sonë themelore, që është ahireti; është i mundshëm vetëm nëpërmjet Zotit, i cili është i ditur dhe i fuqishëm në realizimin e kësaj; i cili aq sa është transcendent, aq është edhe imanent ndaj asaj që ndodhë në Univers. Edhe nëse i lëmë menjatë të dhënat shkencore, për një qenie të gjithëfuqishme dhe të gjithëdijshme i cili ka dituri madje edhe rreth dëshirave tona, nuk është e vështirë ripërtërirja ose ringjallja e trupave. Siç

⁷⁰ Për vlerësim të mëtutjeshëm të këtyre gjashtë dëshirave shfletojeni librin në të cilin kemi parashtruar më shumë detaje rreth këtij argumenti : Caner Taslaman, **Arzulardan Allah’a Ulaşmak (Ta gjejmë Allahun përmes dëshirave)**, Etkileşim Yayınları, İstanbul, 2014.

⁷¹ Arthur Schopenhauer, **The World as Will and Representation**, Vol: 2, Çev: E. F. J. Payne, Harper and Row, New York, 1966, f. 8

⁷² 72. Paul Davies, **The Last Three Minutes**, Basic Books, New York, 1994, f. 67-81.

kuptohet nga e gjithë kjo, të gjithë njerëzit që nga lindja – a priori – kanë veçori të të menduarit për të ardhmen dhe “dëshirë për të jetuar”. Nga e gjithë kjo mund të përfundojmë se gjendja njerëzore në këtë botë është e paraprogramuar që të mbarojë me vdekje; pra njeriu është i vdekshëm. Për fund mund të themi se këto situata përveç që janë pjesë e pandashme e natyrës sonë, nga ana tjetër tregojnë se për realizimin e dëshirave tona kemi nevojë për ekzistencën e Zotit. Të qenit në vetëdije ose jo, kjo nuk e ndryshon këtë situatë. Kjo gjendje i ngjanë shembullit të ekuacionit matematikor $(a+b)^2$, i cili pa pasur nevojë të përkrahjes eksperimentale dhe vëzhgimore është e barabartë me $(a^2 + 2ab + b^2)$ dhe fakti që ne mund të mos e dijmë këtë ekuacion, nuk e ndryshon esencën dhe rezultatin. Mund të ketë nga ata që i dalin kundër personit që beson në Zotin, duke thënë se nuk e ndejnë fare ekzistencën e një dëshire të drejtpërdrejt për Zotin. Por pika nga ku ne duhet të nisemi është “dëshira për të jetuar”, së cilës nuk mund t’i parashtrohet asnjë kundërshtim nga askush. Ndërsa të kuptuarit se plotësimi i kësaj dëshire është i mundur vetëm nëpërmjet ekzistimit të Zotit, nuk është diçka e vështirë për tu përvetësuar.

Vlerësimi i dëshirës për t’i shuar frikërat : Nevoja për ekzistencën e Zotit e “dëshirës për t’i shuar frikërat”, edhe pse mund të shikohet edhe nga këndi i frikës për të vdekur, përsëri nuk është e kufizuar me kaq. Njeriu duke e kuptuar madhësinë e universit, në fakt e kupton vogëlsinë e tij para kësaj madhësie, kurse e gjithë kjo shkakton te ai frikëra. Frikërat e kësaj natyre mund të shuhet vetëm duke u mbështetur tek Zoti; tek Ai që sundon me të gjithë Universin. David Hume ka bërë një korelacion mes ndjenjës së frikës dhe ekzistimit të feve.⁷³ Frojdi, një nga ateistët më të shquar dhe me ndikim të madh në histori, në lidhje me fetë të cilat ai i sheh si "përmbyshje dëshirash" (wishfulfillment), thotë kështu:

“.... Botëkuptimet fetare bashkë me produktet tjera qytetërimore kanë dalur në skenë prej nevojave të njëjta themelore; kanë dalur në skenë nga domosdoshmëria për ta mbrojtur veten prej fuqisë shtypëse të natyrës.”⁷⁴

⁷³ David Hume, **Dialogues and Natural History of Religion**, Ed: J.A.C. Gaskin, Oxford University Press, Oxford, 1993, f. 176.

⁷⁴ Sigmund Freud, **The Standard Edition of the Complete Psychological Works of Sigmund Freud, Vol: XXI (1927-1931): The Future of an Illusion, Civilization and its Discontents, and Other Works**, The Hogarth Press and the Institute of Psychoanalysis, Londra, 1961, f. 21.

“... Edhe njeriu i periudhave të ardhshme, edhe njeriu i së tashmes posedon përmasa të njëjta të sjelljeve. Është fëmijëror dhe gjithherë ka nevojë për mbrojtje; madje edhe kur të zhvillohet. Njeriu është i prirë të mendojë se nuk mund të bëjë asgjë pa ndihmën e Zotit të tij.”⁷⁵

Përkushtimi i vëmendjes që bën Frojdi mbi shprehjet si “ domosdoshmëria për vetëmbrojtje ” dhe “ nevoja për mbrojtje ”, mbase mund të lexohen edhe si përpjekje të fesë për ta përmbushur “ dëshirën për t’i shuar frikërat ”. Si pasojë, me qëllim që të shpëtohet nga frikërat më themelore, mund të themi se ateistët dhe teistët lehtë mund të dakordohen mbi pashmangshmërinë e nevojës së ekzistimit të Zotit. Këtu dilema më e rëndësishme qëndron në përcaktimin se kjo dëshirë, a e përkrah ateizmin apo teizmin? Këtu unë do të mundohem të parashtroj argumente në favor të së dytës. Ndjenja e frikës dhe “ dëshira për t’i shuar frikërat ” si elemente që janë pjesë e njeriut që nga lindja, kur të bashkohen me aftësinë e të menduarit reth të ardhmes, universit dhe vetes sonë, të cilat gjithashtu i kemi pjesë e jona që nga lindja; përpara na del fenomeni i posedimit të dëshirave që varen nga ekzistimi i Zotit.

Vlerësimi i dëshirës për qëllimin (në jetë): Sipas hulumtimeve të bëra në fushën e psikologjisë u zbulua se fëmijët parashkollorë gjatë kuptimit dhe shpjegimit të fenomeneve natyrore kishin treguar tendencë/kahje teleologjike* të observimit. Ky hulumtim tregoi se – apriori- ne jemi të lindur me një aftësi të këtillë.⁷⁶ Kurse ateisti më i madh i epokës sonë Richard Dawkinsi, tendencën e fëmijëve për shpjegime teleologjike e sheh si shkak që shumë njerëz besojnë në Zot dhe me këtë pikëpamje është munduar ta mbrojë doktrinën ateiste (duke aluduar se Zoti nuk është më shumë sesa iluzion) :

“ Teleologjia është t’i atribosh qëllim çdo gjëje që ekziston. Fëmijët janë teleologjik nga vet natyra e tyre dhe një pjesë dërrmuese e njerëzve asnjëherë nuk mund të dalin nga kjo gjendje fëmijërore... Qartazi vërehet se teleologjia fëmijërore është ajo që ka shkaktuar

⁷⁵ Sigmund Freud, **The Origins of Religion**, Penguin, Londra, 1991, f. 376

⁷⁶ Deborah Kelemen, “Are Children Intuitive Theists? Reasoning about Purpose and Design in Nature”, **Psychological Science**, No: 15/5, 2004; Deborah Kelemen, “The Scope of Teleological Thinking in Preschool Children”, **Cognition**, No: 70, 1999, f. 241-272.

*Doktrinë që shpjegon dhe arsyeton mbi gjërat dhe qeniet duke vënë theks të veçantë mbi qëllimin final të tyre. Gjithçka që shohim në botë duhet ta ketë një qëllim se përse ekziston.

shfaqjen e fesë. Nëse gjithçka ka një qëllim, i kujt është ky qëllim? E kujt tjetër, përveç se i Zotit.”⁷⁷

Njeriu i cili tërë ekzistencën përreth tij e komenton me prirje teleologjike, kur të kthehet kah universi dhe më e rëndësishmja, kah vetja; sigurisht se do të dëshiron ta mësojë qëllimin e ekzistencës së vetes dhe universit. Por kuptimi ose qëllimi i universit dhe njeriut mund të jetë i mundur vetëm nëse ekziston një Qenie e vetëdijshme që krijoi universin dhe njeriun me një kuptim dhe qëllim. Sipas qasjes materialiste-ateiste universi ekziston vetvetiu dhe njeriu është krijuar si rezultat i bashkimit të rastësisë dhe domosdoshmërisë. Në një tablo botëkuptimore ku mungon qenia e Zotit, është e pamundur që njeriu dhe universi të kenë një qëllim; përveç kësaj është e pamundur edhe plotësimi i “dëshirës për ta gjetur qëllimin e jetës” dhe si pasojë, rezultati përfundimtar logjik i tërë kësaj paqëllimshmërie sigurisht se i hap rrugë “dëshpërimit të pashmangshëm”. Këtë mund ta kuptojmë edhe prej deklaratave të ateistit më të famshëm të shekullit të kaluar, Bertrand Russel:

“Botën të cilën na e ka ofruar shkenca është edhe më zyrtë dhe e pakuptimtë.... Sipas kësaj i bie që njeriu të jetë produkt i shkaqeve të papërcaktueshme; njeriu nuk është më shumë sesa grumbullim i atomeve, i besimeve, i dashurive, i frikërave, i shpresave dhe i zhvillimeve në një vend të përbashkët.... Kështu që siguria vendbanuese e shpirtit mund të garantohet vetëm mbi këto të vërteta dhe themele përplot zyrtësi.”

Meqë në këtë libër të gjitha 12 argumentet janë shtjelluar në mënyrë përmbledhëse, nuk u paraqit nevoja që të shtjellohen edhe 3 argumente tjera. Një pjesë e madhe e ateistëve siç është rasti i Feuerbach, i cili thotë se “Teologjia është antropologji”, kanë konstatuar se dëshira për lumturi (dëshira e katërt, të cilën nuk e kemi shtjelluar këtu) ka nevojë për ahiretin, kurse ahireti ka nevojë për ekzistencën e një Zoti. Mirëpo të gjitha këto konstatime të tyre i kanë parë si shkaqe të iluzioneve të njerëzve për besimin në ekzistencën e ahiretit dhe Zotit.⁷⁸ “Dëshira për mësim larg dyshimeve”, që është prej argumenteve të pashtjelluara këtu, ndërlihet ngushtë me “argumentin e arsyes”- argumenti i 10-të në këtë libër, si dhe “trajtimi i mirë nga të tjerët”

⁷⁷ Richard Dawkins, **The God Delusion**, Black Swan, Londra, 2007, s. 210.

⁷⁸ Ludwig Feuerbach, **Lectures on the Essence of Religion**, 1851, (<http://www.marxists.org/reference/archive/feuerbach/works/lectures/lec30.htm>)

ndërlidhet ngushtë me “argumentin e moralit”- argumenti i 9-të në këtë libër. Sa i përket këtyre 3 dëshirave si dhe pretendimve që parashtrohen në këtë argument, ne themi se pa qenë ekzistenca e Zotit, të gjitha këto dëshira të cilat janë pjesë e natyrshmërisë sonë që nga lindja (ose me terminologjinë islame, pjesë e “ftratit” tonë) nuk mund ta gjejnë përmbushjen e duhur duke u mbështetur vetëm në bazamente materiale dhe fizike.

Deri këtu e bëra vlerësimin e dy pikave të para të argumentit. Pika e tretë e argumentit tim ndoshta do të jetë pika që do të kundërshtohet më së paku; sepse këtë e pranojnë edhe ateistët, edhe teistët. Nëse i hedhet një sy edhe historisë së filozofisë, por edhe filozofisë aktuale, do të shohim se qasja materialiste-ateiste dhe qasja teiste qëndrojnë kundër njëra-tjetrës dhe lehtësisht mund të themi se përgënjeshtrimi i njërës prej këtyre pikëpamjeve pranohet si verifikim i tjetrës. Ndërsa në qasjet agnostike në vend të një shpjegimi të tretë, kemi më shumë deklarata që pretendojnë se është e pamundur të dihet e vërteta. Në rast se pranohet pika e katërt, që ateistët dhe agnostikët do ta kundërshtojnë më shumë në argumentin që kam paraqitur, atëherë automatikisht kjo na shpie në rezultati se teizmi është triumfues.

Nëse dëshirat rreth të cilave biseduam deri më tani nuk janë shpërfaqur si pasojë e ndonjë plani të vetëdijshëm të Zotit, atëherë duhet të jenë shpërfaqur ashtu siç thonë materialistët-ateistët, pra se janë produkt anësorë i evolucionit dhe selekcionimit natyrorë. Në fillim është mirë ta qartësojmë një gjë; se këtu jemi duke bërë fjalë për dëshirat më thelbësore. Gjithashtu, kur jemi te kjo, është mirë të kuptohet se këtu nuk mund të tregohet ndonjë listë tjetër si alternativë, me dëshira themelore dhe natyrore të cilat mund ta ndryshojnë rezultatin e nxjerrë këtu. Sigurisht, bashkë me dëshirat e lartpërmendura ekzistojnë edhe dëshirat për ushqim, për pije, për seks dhe për gjum; të cilat luajnë mjaft rol të rëndësishëm për vazhdimësinë e ekzistencës sonë. Mirëpo këto nuk mund ta ndryshojnë përfundimin që kemi nxjerrë këtu, madje ekzistimi i objekteve të këtyre dëshirave (ekzistimi i ushqimit ndaj dëshirës së të ushqyerit dhe ekzistimi i ujit ndaj dëshirës për të pirë ujë) e mbështet edhe më shumë argumentin tonë. Sepse nëpërmjet këtyre mund ta shohim se ekziston një objekt në kuadër të kësaj bote për secilën dëshirë natyrore dhe themelore. Kurse e gjithë kjo na bën që t’i drejtojmë sytë kah transcendentia (kah ajo përtej kësaj bote) dhe na jep kurajo që të besojmë në ekzistimin e Zotit, si qenie që është objekt i dëshirave tona natyrore dhe themelore.

Këtu nuk do të flas rreth diskutimeve mbi teorinë e evolucionit; vetëmse dua ta potencoj se edhe ‘nëse’ e pranojmë si të saktë teorinë e evolucionit, nuk është se do ta ndryshojë rezultatin tonë. (Këtë çështje e kemi diskutuar në argumentin e 7-të në këtë libër.)⁷⁹

Nëse pranohet se këto dëshira janë formuar gjatë procesit të evolucionit; a nuk nënkupton kjo dakordim me pretendimet e atyre që edhe evolucionin dhe selekcionimin natyrorë e shohin si mjet përmes të cilit Zoti i ka krijuar gjallesat? Nëse këto dëshira natyrore dhe themelore që janë pjesë e natyrshmërisë sonë janë si pasojë e ekzistencës së një Zoti transcendent në këtë univers, a nuk do të thotë se evolucionin dhe përzgjedhja natyrore na bëjnë që t’i drejtojmë sytë drejt Zotit? Në këtë rast, nga Pierre Teilhard de Chardin e deri te Dobzhansky dhe Mohammed Iqbal-i, a nuk i bie që po gjen mbështetje qasja e atyre të cilët e shihnin evolucionin si metodë e Zotit në procesin e krijimtarisë - edhe pse mes tyre kishte dallime të rëndësishme? Fakti që të gjitha këto dëshira të pavarura nga njëra-tjetra kanë nevojë për një ontologji të njëjtë, nuk mund të shpjegohet vetëm nëpërmjet mekanizmit të rastësishëm të selekcionimit natyrorë, që bën përzgjedhjen e individëve bazuar në jetesën dhe kapacitetin riprodhues të tyre. Nëse i analizojmë gjërë e gjatë dëshirat tonë, në fund do të kuptojmë se ato janë diçka përtej jetës dhe kapacitetit riprodhues. Këtë do të përpiqem ta tregoj në lidhje me tre dëshirat themelore dhe natyrore që i kemi shtjelluar më parë.

Dëshira për të jetuar: Nga vet emri mund të nënkuptohet se kjo është dëshira që më së shumti kontribon në vazhdimësinë e jetës dhe shumimit tonë. Por fakti që ndryshe nga llojet/gjallesat tjera, mendja njerëzore mund të krijojë lidhje me të kaluarën ose të ardhmen e gjatë dhe të dëshirojë të jetojë më shumë seç na mundëson organizmi jonë biologjik, nuk është diçka që ndërlidhet me jetën dhe kapacitetin riprodhues në këtë botë.

Shuarja e frikërave: Frikësimi prej shtazëve të egra ose prej rrëzimit nga ndonjë vend i lartë, sigurisht se është mekanizëm mbrojtës (algoritëm, refleks) që kontribon në vazhdimësinë e jetës dhe shumimit tonë në këtë botë. Ndërsa ndjenja e frikës kur njeriu e kupton pafuqinë e vet dhe pafundësinë e Universit dhe drejtimi i vetes së tij për t’i shuar frikërat kah Qenia që ka fuqi të ndikojë mbi të gjitha proceset në univers, nuk është diçka që ndërlidhet me jetën dhe riprodhimin në këtë botë. Ne dijmë për shumë lloje që ndjejnë frikë prej gjallesave tjera të egra dhe vdekjeprurëse; por nuk dijmë deri më tani lloje ose gjallesa tjera (përveç njeriut) që përmes të

⁷⁹ Teorinë e evolucionit e kam shtjelluar në detaje në librin tim “Teoria e Evolucionit, Filozofia dhe Zoti”

mbështeturit në një ekzistencë transcendentale, t'i shuajë frikërat e shfaqura si pasojë e kuptimit të pafuqisë së tij në raport me madhësinë e universit.

Dëshira për ta gjetur qëllimin në jetë: Mendimi teleologjik i njerëzve, përveç që siguron përparësi në rrugën për t'i kuptuar gjallesat tjera, nga ana tjetër që në këtë botë mund t'i shërbejë edhe dëshirës për të jetuar dhe shumim. Mirëpo dëshira e njerëzve për ta gjetur qëllimin-kuptimin në jetë dhe prirja e tyre për ta gjetur qëllimin e ekzistencës së universit, nuk është diçka që ndërlidhet me jetën dhe shumimin në këtë botë. Në lidhje me 6 dëshirat që folëm më herët, prania e të cilave te njeriu është vërtetuar edhe nga ana e disa atëistëve, është mirë të ripotencohet nevoja e Zotit dhe fesë për përmbushjen e këtyre dëshirave. Ateistët besimin në fe dhe Zot e kanë vlerësuar si mjet për plotësimin e dëshirave. Por kjo pikëpamje mund të jetë e vlefshme vetëm nëse e pranojmë materializmin-ateizmin si filozofi plotësisht të saktë. Nëse e lëmë menjatë këtë pranim, do të shohim që ateistët të cilët merren me qasjen për “plotësimin e dëshirave”, janë duke e bërë njërin prej gabimeve më të mëdha logjike, që është “lajthitja zanafillore” (genetic fallacy). Personi që bën “lajthitje zanafillore” mendon se e ka vërtetuar saktësinë e një gjëje duke u bazuar në zanafillën e saj. Konkluzioni i personit që bën lajthitje zanafillore mund të jetë edhe i saktë, edhe i vërtetë; por është përpjekje e kotë nëse mënyra e arsyetimit përmban gabime logjike. Për shembull në fjalinë “Aliu formën e Tokës e mësoi nga familja e tij, kështu që informata e tij rreth kësaj teme është gabim” nuk është aq me rëndësi përfundimi i konkluzionit, sepse mënyra arsyetuese e të atyre që vijnë në konkluzione të këtilla përmban “lajthitje zanafillore”, pra në rastë të këtilla zanafilla e konkluzioneve e shfuqizon përfundimin. Gjithashtu, ashtu siç disa pretendojnë për “përmbushjen e dëshirave”, p.sh siç është rasti i Frojdit, i bie që dëshirat të jenë zanafilla e besimit në fe dhe Zot. Megjithatë, ata bëjnë gabim “logjik zanafillorë” në atë moment kur përmes tregimit të zanafillës së Zotit dhe fesë pretendojnë të thonë se Zoti dhe feja janë shpikje njerëzore. Kurse sa i përket vendosjes së këtyre dëshirave brenda nesh, ndoshta Zoti ka dashur të na orientojë neve drejt tij; ose siç ka thënë Augustini: “Neve na krijoi për shkak të Tij.”⁸⁰ Këtu, edhe në lidhje me këtë argument mund të parashtrohet pyetje se a mos vallë është bërë ndonjë lajthitje zanafillore. Nëse në këtë argument do të ishte thënë se duhet të besojmë në ekzistencën e Allahut për shkak që dëshirat tona të natyrshme na orientojnë drejt Tij, atëherë do të bëhej gabim i një lloji të ngjajshëm

⁸⁰ Steven Jon James Lovell, Philosophical Themes from C. S. Lewis, Department of Philosophy University of Sheffield, PhD Thesis, August 2003, f. 95, 154

me të Frojdit dhe të tjerëve. Ndërsa këtu ne po mundohemi të mbrojmë mendimin se në fillim të gjitha këto dëshira kanë nevojë për ekzistencën e Allahut, kurse pas kësaj e shqyrtojmë edhe mënyrën se si këto dëshira erdhën në ekzistencë.

Krejt në fund të këtij shqyrtimi pretendojmë se teizmi e bën sqarimin më të saktë të mënyrës se si u shpërfaqën dëshirat. Argumenti që kemi parashtruar këtu, nuk është prej atyre që bën përndjekjen e dëshirave (duke i shtyrë në lajthitje zanafillore) dhe kështu të arrijë deri te qëllimi, por është një argument që arrin te qëllimi duke u bazuar në shpjegime më të sakta për mënyrën se si dëshirat erdhën në ekzistencë. Përgjigja "Për shkak se Zoti i krijoi të gjitha" e pyetjes shumë të rëndësishme "Pse dëshirat tona të ndryshme janë të atilla që të na bëjnë neve të besojmë në ekzistencën e Zotit?", e shpjegon këtë njëshmëri të Zotit, më mirë dhe më bindshëm sesa qasja materialiste-ateiste e bazuar vetëm në rastësinë dhe shkak-pasojën e ligjeve natyrore. Sipas paradigmës teiste meqë gjithçka, përfshirë këtu edhe dëshira, është krijuar nga Allahu, atëherë edhe prirja e dëshirave të ndryshme drejt qëllimit të njëjtë është pjesë e planit të krijuesit të dëshirave. Kështu që nuk ka diçka për tu çuditur nëse dëshirat e ndryshme i shtojnë njerëzit drejt Zotit. Për dikë që mendon se dëshirat kanë lindur rastësisht, si duket nuk ka asnjë shpjegim logjik rreth faktit se këto dëshira të formuara rastësisht në universin material na drejojnë drejt një fuqie superiore përtej materies.

Pra shkurtimisht, ateistët më të njohur në histori kanë tentuar ta paraqesin ekzistencën e Zotit si nevojë për përmbushjen e dëshirave të nejrëzve, kurse ekzistencën e e vërtetë të Zotit si shpikje që u shërben njerëzve për plotësimin e këtyre dëshirave. Ndërsa këtu u përpoqa ta tregoj se pika në të cilin filozofët ateistë janë fundosur është deti i quajtur "jetë". Shpjegimi më i qartë në lidhje me nevojën për ekzistencën e Allahut në mënyrë të njëjtë nga dëshirat tona të ndryshme dhe të pareduktueshme në njëra tjetrën është; 'Se këto janë të instaluar te njerëzit nga ana e Allahut'. "Përse dëshirat tona të ndryshme na orientojnë në atë mënyrë që ta besojmë Allahun", kjo pyetje me rëndësi të jashtëzakonshme përgjigjen e vetme racionale mund ta gjëj vetëm në botëkuptimin teist. Nevoja e të gjithë dëshirave të lartpërmendura për ta pasur një botëkuptim të njëjtë ontologjik, e bën teizmin më racional dhe më të preferueshëm në raport me botëkuptimin materialist-ateist.

NËNKAPITULLI I NËNTË (IX)
ARGUMENTI I MORALIT

IX

Argumenti i moralit

Megjithëse në fe dhe filozofi çështja e moralit për mijëra vite ka qenë në qendër të vëmendjes, nuk vërejmë diku tjetër praninë e ndonjë pretendimi para shekullit të 18-të që ta konsideron moralin si pikënisje dhe argument për ekzistencën e Zotit. Njëra prej këtyre arsyeve është se shumë teistë meqë ekzistencën e Zotit e kanë besuar në mënyrë fideiste (mënyrë e imanit/besimit që nuk varet prej argumenteve empirike) nuk e kanë parë të nevojshme nevojën e ndonjë argumenti; ndërsa ata që u referohen argumenteve janë mjaftuar me argumentin e vetëdijes dhe argumentin kozmologjik. Këtu ne do të paraqesim një argument sa i përket kësaj çështje, ngase ende mund të thuhet shumë për provat morale që nuk janë hasur para shekullit të 18-të dhe të cilat janë shndërruar “në terrene pothuajse të braktisura”⁸¹ të filozofisë pas fillimit të shekullit të 20-të. Dita ditës morali është duke u bërë objekt i observimit të fushave ndërdisiplinore; ku përveç filozofisë dhe fesë, shtjellimin e kësaj çështjeje janë duke e bërë edhe shkencat si psikologjia, shkencat kognitive, neurologjia, antropologjia, biologjia evolucionare dhe zhvillimi i fëmijëve.⁸² Nëse do të thuhej diçka rreth moralit mendoj se duhet të kihen parasysh edhe konkluzionet e dalura prej këtyre punimeve. Filozofët e famshëm si Gottfried Leibniz (1646-1716)⁸³, Lord Shaftesbury (1671-1713)⁸⁴, Francis Hutcheson (1694-1746)⁸⁵, Thomas Reid (1710-1796)⁸⁶ dhe Adam Smithi⁸⁷ kanë tërheqë vëmendjen rreth raportit të ngushtë të moralit me natyrshmërinë tonë. Kështu që konsiderimi im se të gjithë njerëzit shprehin veçori morale që në lindje (morali si pjesë e natyrshmërisë sonë), është diçka që pranohet nga shumë teologë dhe filozofë. Kësaj qasjeje veçantinë ia shton edhe fakti që prirjet e lindura morale janë bërë një pikënisje nga ku është ngritur argumenti moral i ekzistencës së Zotit dhe se ky pretendim historik do ta gjejë mbështetjen edhe

⁸¹ Robert Adams, “Moral Arguments for Theistic Belief,” **Rationality and Religious Belief**, Ed: C. Delaney, University of Notre Dame Press, Notre Dame, 1979, f. 116.

⁸² Christopher Suhler ve Patricia Churchland, “The Neurobiological Basis of Morality,” **The Oxford Handbook of Neuroethics**, Ed: Judy Illes ve Barbara J. Sahakian, Oxford University Press, Oxford, 2011, f. 33.

⁸³ G. W. Leibniz, **New Essays on Human Understanding**, Ed: Peter Remnont ve Jonathan Bennett, Cambridge University Press, Cambridge, 1996.

⁸⁴ Lord Shaftesbury, **Characteristics of Men, Manners, Opinions, Times**, Ed: Lawrence Klein, Cambridge University Press, Cambridge, 2001, f. 163-230.

⁸⁵ Francis Hutcheson, **A System of Moral Philosophy**, Continuum International Publishing Group, New York, 2005.

⁸⁶ Thomas Reid, **Inquiry and Essays**, Ed: R. E. Beanblossom ve K. Lehrer, Hackett Publishing, Indianapolis, 1983.

⁸⁷ Adam Smith, **The Theory of Moral Sentiments**, Liberty Classics, Indianapolis, 1976.

prej të dhënave të fundit nga shkenca moderne. Argumentin rreth kësaj çështje mund ta paraqes në këtë mënyrë:

1. Njerëzit kanë prirje morale që nga momenti i lindjes.
2. Për sqarimin e kësaj i kemi në dispozicion dy shpjegime alternative:
 - 2.1 Prirjet tona morale (prej lindjes) janë shpërfaqur rastësisht dhe domosdoshmërisht - ashtu siç parashikojnë materialistët-atëistët.
 - 2.2 Prirjet tona morale (prej lindjes) janë krijuar nga ana e Allahut- ashtu siç besojnë teistët.
3. Teizmi, shpjegimin e (pranisë së) prirjeve tona morale (prej lindjes) e bën më mirë se materializmi-atëizmi, sepse:
 - 3.1 E shpjegon më mirë prirjen tonë për “vetëdije morale”.
 - 3.2 E shpjegon më mirë arsyen se përse prirjet tona morale (prej lindjes) fitojnë racionalitet vetëm përmes ekzistencës së Allahut.
4. Kështu që teizmi është më i preferueshëm në raport me materializmin-atëizmin.

Pika e parë e këtij argumenti ndërlidhet me një çështje që ka qenë shumë e diskutueshme gjatë historisë së mendimit njerëzorë. Pikëpamja që thotë se mendja është tabelë e boshatisur (*tabula rasa*) është mbrojtur edhe nga teistët, edhe nga atëistët. John Locke është njëri prej teistëve që e ka bërë popullarizimin e nocionit të tabelës së boshatisur (*tabula rasa*). Locke përveç që doli kundër pikëpamjes së vërtetave të përpunuara në mendjen njerëzore, ai gjithashtu doli edhe kundër pikëpamjes që thotë se prirjet morale janë pjesë e jona që nga lindja.⁸⁸ Mos ekzistimi i prirjeve tona që nga lindja, është një pozicion që shumë është përvetësuar nga ana e atëistëve. Pjesa dërmuese e atyre që e mbrojnë këtë pikëpamje praninë e strukturimit moral të njerëzit e shpjegojnë duke e marrë për argument aspektin sociokulturor; dhe sipas tyre nevojat shoqërore janë ato që e bëjnë përcaktimin e vetëm të fenomenit të moralit i cili ekziston ndërnjerëz. Durkheimi është njëri prej përfaqësuesve më të rëndësishëm të kësaj qasjeje. Sipas tij te njerëzit nuk ekzistojnë prirje të lindura, sepse natyra e individit merr formë vetëm nëpërmjet faktorëve shoqërorë.⁸⁹ Ekzistimi i

⁸⁸ John Locke, **An Essay Concerning Human Understanding**, Prometheus Books, New York, 1995. Kapitulli 1 dhe 3

⁸⁹ Donald Black, “On the Origins of Morality,” **Evolutionary Origins of Morality: CrossDisciplinary Perspectives**, Ed: Leonard Katz, Imprint Academic, Thorverton, 2000, f. 109.

prirjeve morale të lindura është refuzuar edhe nga ana e një pjese të madhe të qasjeve postmoderniste të shekullit të 20-të (me shqetësimin se këto prirje mund t'i ndërtojnë themelet e pretendimit se ekzistojnë vlera morale universale-të përbashkëta për të gjithë). Si rezultat, njëjtë sikur në shekullin 20, shumë njerëz teistë dhe ateistë ende janë të mendimit se njerëzit nuk kanë prirje morale prej lindjes.⁹⁰ Fakti që çdo person i shëndetshëm konceptet të cilat e formojnë bazën e moralit, siç janë "e mirë- e keqe, e saktë - gabim, e drejtë – e papadrejtë" mund t'i përdorë në një mënyrë shumë komode, pavarësisht nga fakti se ato janë shumë komplekse në thelb, tregon se aftësia për t'i përdorur ato është diçka e dhuruar që në lindje. Sipas mendimit tim, kjo është një çështje që mund të mbrohet edhe pa iu referuar kërkimeve shkencore, mirëpo për këtë kërkohet një analizë më gjithëpërfshirëse kushtuar koncepteve themelore të moralit. Megjithatë hulumtimet dhe studimet e fundit në fushën e psikologjisë dhe shkencave kognitive tregojnë se shumë prej prirjeve që ndërlidhen me moralin shfaqen që në fazën e foshnjërisë. Siç ka thënë edhe Jonathan Haidt, gjykimet morale ndodhin automatikisht, spontanisht dhe pa pasur nevojë për ndonjë proces arsyetimi; madje edhe shpjegimet rreth kësaj vijnë në formë të tentativës për ta legjitimuar veprën menjëherë pas mbarimit (post hoc).⁹¹ Le t'i shohim disa hulumtime rreth gjërave që folëm më lartë. Sipas disa eksperimenteve të bëra, është vërejtur se si foshnjët mund të qajnë, të shfaqin shenja mërzie dhe të ushqehen me më pak gjë kur i dëgjojnë foshnjët tjerë duke qarë. Për ta kuptuar nëse këto reagime ishin kundër të qarit apo kundër zërit që vjen, foshnjeve të sapolindura iu është mundësuar dëgjimi i inçizimit të britmave dhe qarjeve të foshnjeve tjerë me po të njëjtin intenzitet dhe si rezultat ato nuk e treguan reagimin e njëjtë sikurse ndaj foshnjeve që me të vërtetë qanin.⁹² Shumë ndjenja jetësore të njerëzve si zemërimi, frika, mërzia, gëzimi, dhimbja, epshi, fajësia dhe turpi, janë ndjenja që kuptohen përmes empatisë. Empatia është një ndjenjë komplekse dhe shumë shtresore, mungesa e së cilës të çon deri në psikopati.⁹³ Fakti që një prirje kaq e rëndësishme siç

⁹⁰ Derisa jam duke shpjeguar për argumentin e ekzistencës së moralit që nga lindja, e shoh të nevojshme ta potencoj faktin se nuk e refuzoj tërësisht rëndësinë e ndikimit të faktorit të jashtëm mbi strukturën morale të njeriut. Nuk dua të keqkuptohem.

⁹¹ J. Haidt, "The Emotional Dog and Its Rational Tail: A Social Intuitionist Approach to Moral Judgment", **Psychological Review**, No: 108, f. 814-834.

⁹² M.L. Simner, "Newborn's Response to the Cry of Another Infant," *Developmental Psychology*, No: 5, 1971, f. 136-150; M. Dimion, F. Simion ve G. Caltran, "Can Newborns Discriminate Between Their Own Cry and the Cry of Another Newborn Infant," **Developmental Psychology**, Vol: 35/2, 1999, f. 418-426

⁹³ Tania Singer, "The Neuronal Basis and Ontogeny of Empathy and Mind Reading: Review of Literature and Implications for Future Research," **Neuroscience and Biobehavioral Reviews**, No: 30, 2006, f. 857-858.

është empatia, është prezente te njeriu që në fazën e hershme të foshnjërisë, tregon se në natyrshmërinë tonë kemi një sistem moral të cilin duhet ta përvetësojmë.

Shembuj tjerë që i ngjajnë këtij verzioni janë eksperimentet me kukullat. Në një eksperiment, foshnjeve iu është mundësuar ta shikojnë një skenë ku një kukull luan futboll me dy kukulla, ndërsa një kukull tjetër e merr topin dhe fillon të ikë. Me tu sjellur përpara foshnjeve kjo kukull plaçkitëse, është parë se si foshnjët tentojnë ta dënojnë atë, duke e goditur me duar në kokë. Në një eksperiment tjetër ku ishin vendosur kukullat e mira dhe të këqija, janë vëzhguar foshnjët 21 muajshe: në këtë ambient foshnjët 21 muajshe, u futën në një gjendje dhe pozicion të atillë që kukullave tu japin diçka si shpërblim ose prej tyre të marrin diçka si dënim. Është vërejtur se kur foshnjëve iu kërkua të merrnin diçka, ata e merrnin atë nga kukulla e keqe dhe ia jepnin atë kukullave të mira. Ndërsa në një eksperiment tjetër foshnjët 8 muajshe, ato që u jepnin shpërblim kukullave të mira i preferonin para atyre që u jepnin dënim; kurse ende më e rëndësishmja është se ato që i dënonin kukullat e këqija i preferonin para atyre që i shpërblenin ato.⁹⁴ Shpërblimi i të mirës dhe dënimi i së keqes ka rëndësi dhe vend të posaçëm nga aspekti i konceptit të drejtësisë. Fakti se këto eksperimente janë realizuar dhe fakti se edhe fëmijët që nuk kanë mësuar të flasin mund të bëjnë vlerësime të tilla, e mbështesin pikëpamjen se ne kemi lindur me një strukturë të gatshme për të përdorur dhe vlerësuar koncepte që ndërlidhen me moralin. John Rawls deklaroi se konceptet themelore si " e drejta" dhe "e padrejta" të cilat mund t'i përdorim me një larmi gjykimesh jashtëzakonisht komplekse dhe potencialisht të pakufizuara, si dhe gjykimet tona morale të bazuara në to, mund të kuptohen me një qasje të ngjashme si të Chomsky-t me teorinë mbi gjuhën (në lidhje me kapacitetin tonë të lindur).⁹⁵

Ashtu siç e pamë, tërë kjo na lë të kuptojmë për vërtetësinë e pikës së parë, që pretendon se te njerëzit ekziston një strukturë morale prej lindjes. (Këtu dua të tërheq vëmendjen për një dallim të vogël; ne po themi se bazat që e mundësojnë mësimin e sistemit moral janë të lindura, jo i tërë sistemi moral). Nëse vijmë te pika e dytë e argumentit; sqarimin e mënyrës së ardhjes në ekzistencë të këtij tipari në natyrën e njeriut më së miri mund ta bëjnë pretendimet të cilat përmbajnë qasje më gjithëpërfshirëse ndaj natyrës së njeriut. Siç e kemi cekur edhe më herët, në këtë çështje ekzistojnë dy pikëpamje rivale me njëra tjetrën, materializmi-ateizmi dhe teizmi. Argumentin tonë do ta pranojnë shumë materialistë-ateistë, por nga ana tjetër do të pretendojnë se

⁹⁴ Paul Bloom, "The Moral Life of Babies", **The New York Times**, 5 Mayis 2010.

⁹⁵ John Rawls, **A Theory of Justice**, The Belknap Press of Harvard University Press, Massachusetts, 1999, s. 41.

çështjen aktuale paradigma e tyre e sqaron më mirë. Nëse përmes arsyetimeve të përmendura në pikën e tretë të argumentit, arrihet të tregohet se teizmi e shpjegon më mirë ekzistencën e themeleve të lindura morale, atëherë logjikisht i bie që teizmi duhet të preferohet para materializmit-ateizmit. Pika kritike në këtë argument është pika e tretë, prandaj më poshtë do të vlerësohen dy nënpikat e kësaj pike:

Vlerësimi i pikës 3.1: Si fillim dua ta theksoj përputhshmërinë e argumentit të parashtruar këtu me pikëpamjen që i konsideron si shkaqe mekanizmat evoluese gjatë procesit të formimit të prirjeve tona morale. Në përgjithësi sipas besimi monoteist, njerëzit janë ndryshe prej kafshëve dhe bimëve për shkak se kanë përgjegjësi morale. Njeriu, edhe pse tregon sjellje altruiste njëjtë si bletat dhe milingonat, veçohet dhe dallohet prej të gjitha gjallesave tjera me të ashtuquajturën “vetëdije morale” (moral awareness). Sakrifikimi i shpirtit për hir të tjetrit, siç është rasti me altruizmin e lartë e shfaqur te bletat, edhe pse si sjellje është e njëjtë me atë që shfaqet te njeriu, përsëri ekzistojnë mjaftë dallime në mekanizmat të cilat i shkaktjnë këto sjellje. Shkenca e metodologjisë së sjelljes nuk mund të tregojë fotografinë e vërtetë se pas sjelljeve të njëjta të individëve qëndrojnë burime me zanafilla të ndryshme. Vërtetimi i ekzistimit të vetëdijes morale te njeriu mund të bëhet përmes një qasjeje hermeneutike dhe introspektuese (duke observuar mbi botën e brendshme të subjektivitetit të njeriut).

Në këtë mënyrë mund të kuptohet dallimi mes mekanizmave të cilat në pamje të jashtme shkaktjnë sjellje të njëjta, por në esencë nuk kanë lidhje me “vetëdijen morale”. Ndihma ndaj një individi që i takon llojit të njëjtë, si sjellje që paraqitet edhe te bleta edhe te njeriu, do të tregonte dallim të madh nëse shikohej nga këndi i kryerjes së veprës me ose pa vetëdije morale. Sjelljet altruiste të bletave që janë të gatshme ta sakrifikojnë jetën e tyre, nuk realizohen as përmes “gjykimeve morale” dhe as përmes ndjenjave “të vetëdijshme” për të përzgjedhur ndërmjet të mirës-të keqes ose të drejtës-të padrejtës, por realizohen përmes një zbatimi “të pavetëdijshëm” të një kodi që ndodhet në gjenet tyre. Në rast se bletat do të mund të bënin përzgjedhje morale përmes “vetëdijes morale”, siç ka potencuar edhe John Hick, me shumë gjasa do ta kishin preferuar “sakrifikimin e jetës së tyre.”⁹⁶ “Prirjet morale të lindura” të njerëzve mundësojnë që njerëzit të kenë një potencial për të bërë një përzgjedhje morale me “vetëdijen” e koncepteve themelore si “e mira – e keqja, e drejta - e gabuara, e thjeshta - e padrejta”. Richard Swinburne, i cili vë theks të veçantë mbi “vetëdijen morale” thotë kështu:

⁹⁶ John Hick, **Arguments for the Existence of God**, Herder and Herder, New York, 1971, f. 63.

“Njerëzit kur të japin vendime të rëndësishme për një çështje të caktuar duhet t’i përvetësojnë konceptet morale si mirësia dhe keqbërja..... Ekzistenca e Zotit, nëse do të na takon me opsionet e rëndësishme që duhet të zgjedhim, me shumë gjasa do të sigurojë zhvillimin e llojit të këtillë të vetëdijes. Por nëse nuk ka Zot, sa është probabiliteti që qeniet trupore me inteligjencë të arrijnë në këtë nivel? Këto krijesa mund ta ndihmojnë njëri tjetrin, siç është rasti me disa grupe shtazore. Mirëpo konsiderimi i këtyre veprimeve si të mira nga ana morale është më shumë sesa të jesh altruist. Pra meqë është fenomen i pritur që Zoti t’u dhurojë disa krijesave të tij vlera morale të nevojshme për tu bërë individë të lirë, nuk ka asnjë arsye të presim që vlerat morale të shfaqen si rezultat i ndonjë procesi tjetër. Këtë gjë e tregon edhe ky fenomen: Për shumë kafshë që janë të prirura tu ndihmojnë individëve nga lloji i tyre nuk ka vlera morale; gjithashtu nuk ka asnjë arsye për ta pranuar se luani dhe tigri kanë vlera morale ose se mund t’i zhvillojnë këto vlera.... **Si përfundim, vendimet morale kanë nevojë për ekzistencën e vetëdijes morale.**”⁹⁷

Pretendimi i materialistëve-ateistëve për shfaqjen e rastësishme të “vetëdijes morale” te njeriu, si një veçori sa komplekse, aq edhe e vlefshme për të, nuk duket se është shpjegim shumë i arsyeshëm. Në të njëjtën mënyrë, edhe pretendimi se një proces tjetër i rastësishëm e solli në ekzistencë “vetëdijen morale”, nuk është i arsyeshëm sa duhet. Ndërsa në teizëm ekzistojnë arsyetime të mira rreth urtësisë së vendosjes së këtyre vetive te njeriu. Teizmi nga njëra anë e përjashton rastësinë, kurse nga ana tjetër i atribuon kuptime të veçanta “vetëdijes njerëzore morale” si diçka që është pjesë e planit të Zotit. Përveç kësaj, teizmi e shpjegon shumë më mirë shfaqjen e koncepteve si "e mira dhe e keqja" në universin material; koncepte që si duket janë të parëndësishme për vetitë e materies dhe fizikën (për aq sa na përshkruan fizika). Nëse pikëpamja se Zoti i krijoi qeniet njerëzore është e vërtetë, atëherë do të ishte shumë normale që vetitë e “vetëdijes morale” të ekzistojnë falë themeleve morale me të cilat njerëzit lindin; kurse nëse ateizmi është i vërtetë, atëherë nuk do të ishte normale shfaqja e këtyre prirjeve morale. Përgjigjet e paradigmës teiste ndaj pyetjes se “Përse ka vetëdije morale, e jo mungesë morale” janë më të suksesshme se përgjigjet e paradigmës ateiste.

⁹⁷ Richard Swinburne, **The Existence of God**, 2. Baski, Clarendon Press, Oxford, 2004, f. 216-217.

Vlerësimi i pikës 3.2: Funkcionimi i një sistemi moral sigurisht se është i mundur edhe pa besimin në Zotin (siç janë të tillë shumë ateistë), mirëpo sistemet morale të cilat përbëhen prej ligjeve që janë të obligueshme dhe që kërkojnë prej njerëzve të sakrifikojnë interesat e tyre personale kur është e nevojshme, nuk mund të kenë një bazë racionale pa besimin në Zotin. Shumë ateistë të famshëm e kanë vërtetuar këtë gjë. Për shembull filozofët e famshëm ateistë si Nietzsche dhe Sartre, rreth paradigmave që u mungon besimi në Zotin, kanë tërhequr vëmendjen për mungesën e saktësisë së vlerave morale. Fjalët e Nietzsches flasin për këtë klonkludim:

“ Nëse e merrni një koncept themelor prej sistemit moral dhe e largoni atë prej besimit në Zotin, ju e shkatërroni tërësinë: tanimë asgjë e domosdoshme nuk qëndron në duart tuaj..... Koncepti mund të fitojë vlerë të saktë vetëm nëse ekzistenca e Zotit është e vërtetë; ai (koncepti) qëndron në këmbë vetëm me Zotin, kurse shkatërrohet pa të.”⁹⁸

Qasjen e njëjtë e vërejmë edhe te fjalët e Sartres:

“Nga ana tjetër, është shqetësuese ideja e mosekzistimit të Zotit për një ekzistencialist, sepse pa Zotin zhduket mundësia e gjetjes së një themeli racional për shpjegimin e vlerave. Për shkak se me këtë nënkuptohet mosekzistimi i një vetëdije të pafundshme dhe të mrekullueshme, atëherë i bie që edhe mirësia nuk ekziston. Vetëm ngaqë jemi në një tokë të banuar me njerëz; askund nuk shkruan se ekziston e mira, se duhet të jemi të drejtë dhe se nuk duhet të jemi gënjeshtarë. Dostojevski pat thënë: nëse nuk do të ekzistonte Zoti, gjithçka do të ishte e lejuar; e pikërisht kjo është pikënisja e ekzistencializmit. Me të vërtetë pa Zotin gjithçka është e lejuar dhe si rezultat i kësaj njeriu nuk ka pikë për tu mbështetur.”

99

Pretendimet e materialistëve-ateistëve si Michael Ruse dhe Edwarg Wilson në lidhje me domosdoshmërinë për t'i kuptuar si iluzione prirjet morale të lindura, vërehet edhe në fjalët e tyre të mëposhtme:

⁹⁸ Walter Kaufmann, **Portable Nietzsche**, The Viking Press, New York, 1954, f. 515-516.

⁹⁹ Jean-Paul Sartre, **Basic Writings**, Ed: Stephen Priest, Routledge, Londra, 2001, f. 32

“ Nëse do ta përdornim një shprehje të popullarizuar të këtij shekulli, e thënë nga filozofi Kambrixhian G.E. Moore, i cili shprehet se etika evolucionare kryen “lajthitje natyraliste” duke u përpjekur ta përkthejë “është” në “duhet”.

Morali është një iluzion përmes së cilës bëjmë lëvizje të përbashkëta dhe është një instrument që gjenet e përdorin për të na mashtruar neve. Nuk ka asnjë mbështetje të jashtme ontologjike. Morali është shfaqur si rezultat i evolucionit; por evolucioni nuk e justifikon atë. Morali nuk ka vlerë objektive; por struktura jonë biologjike është ajo që na ka shtyrë të mendojmë ashtu.”¹⁰⁰

Kur të mendojmë rreth intuitave tona për “mirëbërje-keqbërje” si gjëra të lindura dhe që e ndërtojnë themelin e gjykimit moral, do ta kuptojmë se “mirëbërja-keqbërja” kanë një pozicion ontologjik më tepër sesa përfitimet dhe pasionet personale, kurse kjo është njëra prej gjërave më bazike sa i përket moralit. Të qenit e ligjeve morale “urdhëra të Allahut” e siguron themelin e duhur racional sa i përket kësaj çështjeje, sepse sipas ontologjisë teiste Zoti është qenia për të cilën kemi nevojë dhe si krijues që ka mjaftueshmëri të bëjë gjithçka, urdhërat e Tij (ligjet morale) janë më të rëndësishme se çdo lloj pritshmërie shoqërore dhe përfitimi personal. Mirëpo, në paradigmen materialiste-ateiste, intuita rreth "së mirës-së keqes" përbëhet prej strukturave biokimike siç janë nukleotidet, të cilat janë të formuara nga procese të rastësishme dhe të cilat nga ana tjetër janë forcat themelore që e përbëjnë universin përmes vetive të materies; si forcat e shtytjes-tërheqjes dhe fenomenet e grimcave-valëve. Nëse siç parashikon ateizmi-materialist, ekzistenca përbëhet vetëm nga materia, atëherë nuk mund të ketë një bazë rationale për intuitën tonë rreth "së mirës-së keqes", si diçka që duhet të ketë vlerë përtej interesave personale dhe pasioneve materiale. Duke e parë shfaqjen e kësaj situate në paradigmen e filozofisë materialiste, ateistët si Ruse dhe Wilson e konsideruan këtë intuitë (dmth. Moralin) si "iluzion". Në ontologjinë ateiste, si duket është e pamundur të gjehet ekzistenca e një baze rationale që mund ta arsyetojë faktin se njerëzit, për të cilët mendohet se janë formuar përmes ndërthurjeve dhe proceseve natyrore të rastësishme, janë qenie me prirje morale të ndryshme nga kafshët. Për shembull le të mendojmë për humbjen e parave të një të pasuri; paratë e të cilit i gjejmë ne dhe nëse nuk ia kthejmë këto para atij, pjesën e

¹⁰⁰ Michael Ruse ve Edward O. Wilson, “The Evolution of Ethics,” **Philosophy of Biology**, Ed: Michael Ruse, Prentice Hall, New Jersey, 1989, f. 314-317.

mbetur të jetës e kalojmë në bollëk të plotë, kurse për marrjen e këtyre parave nga ne le të mos e dijë askush. Në këto raste, ku është vështirë të zbatohet sanksioni shoqëror, përcaktues i të mirës ose të keqes mbetet morali jonë i brendshëm. Mund të ketë nga ata që thonë se kthimi i parave është "i mirë" dhe jo "i keq" duke iu referuar, ose një morali deontologjik¹⁰¹ Kantian të bazuar në arsyetimin apriori, ose një morali utilitar¹⁰² Millist të bazuar në arsyetimin induktiv. Sidoqoftë, qasjet e lartpërmendura nuk mund të shpjegojnë se përse rregullat deontologjike ose qasjet utilitare janë "të mira" dhe të preferueshme. Me fjalë të tjera, ato janë të paaftë t'i ndërtojnë themelet racionale të moralit pa u referuar në urdhërat e Zotit.

E mira është një standard që i tejkalon interesat personale të njerëzve. Në sistemin moral autonom të Kantit, njerëzit supozohet se arrijnë një standard të moralit (domosdoshmëri kategorike) duke marrë parasysh arsyetimin e të gjithëve dhe duke e mbajtur atë mbi interesin vetjak; mirëpo nuk duket se ka ndonjë bazë racionale në lidhje me këtë përpjekje..¹⁰³ Në sistemin e Kantit nuk ndodhet ndonjë përgjigje e logjikshme ndaj pyetjes se “përse është e mirë” bindja ndaj domosdoshmërisë kategorike (si diçka që është produkt i bashkimit të mendjeve njerëzore) dhe përse nuk është e tillë bindja ndaj pasioneve dhe interesave personale të njerëzve?”. Ata që e konsiderojnë moralin dhe racionalitetin (arsyeshmërinë) e lindur si produkt të proceseve të rastësishme natyrore dhe e konsiderojnë moralin si iluzion, duhet t'i konsiderojnë si iluzione edhe ndjenjat e "domosdoshmërisë dhe detyrimit", të cilat rrjedhin nga racionalitetet e përbashkëta. Mungesë të përgjigjeve racionale ka edhe për pyetjet themelore që ndërlidhen me bazat e moralit utilitar, siç është pyetja “Përse nuk e cilësojmë si të mirë mendimin mbi lumturinë tonë, por mbi lumturinë e më shumë njerëzve?”

Shkurtimisht, se njerëzit kanë prirje morale të lindura, kuptojmë nga punimet e bëra në fushën e psikologjisë moderne dhe shkencave kognitive, ku është vërtetuar se njerëzit mund të përdorin koncepte themelore dhe komplekse morale që nga mosha e hershme e fëmijërisë. Falë prirjeve të lindura bëhemi prej atyre që posedojnë “vetëdije morale”, e cila është specifike për llojin njerëzorë. Shfaqja e një tipari kaq kompleks dhe specifik tek njerëzit; përderisa është një

¹⁰¹ Immanuel Kant, **Fundamental Principles of the Metaphysics of Morals**, Çev: Thomas Kingsmill Abbott, Chicago, William Benton, 1971, s. 253-287; Immanuel Kant, **The Critique of Practical Reason**, Çev: Thomas Kingsmill Abbott, Chicago, William Benton, 1971, f. 291-361.

¹⁰² John Stuart Mill, **Utilitarianism**, Hackett Publishing, Indianapolis, 2001.

¹⁰³ Jam i mendimit që pretendimi i Kantit për autonominë e moralit kundërshtohet me faktin “se për më të mirën” është e domosdoshme konsiderimi si postulat i ekzistencës së “Allahut, ahiretit dhe vullnetit të lirë”. Diskutimi mbi injorimin që Kanti ia bën këtij pretendimi e tejkalon natyrën e kësaj teme, prandaj do të mjaftohem vetëm me kaq.

situatë e papritur për ateistët-materialistët të cilët ontologjikisht nuk i dallojnë qeniet njerëzore nga qeniet e tjera të gjalla, nga ana tjetër është më se e pritur për teistët që pretendojnë se njerëzit kanë përgjegjësi të veçanta morale. Përveç kësaj, shpjegimi i pikëpamjes materialiste-ateiste se vetitë e formuara te njerëzit mund të fitojnë bazë racionale vetëm në prezencë të Zotit (si iluzion), nuk është më i mirë se shpjegimi teist, i cili thotë se këto veti mund të gjejnë bazë racionale vetëm duke iu referuar Zotit, sepse Ai është qenia e vetëdijshme që i ka krijuar këto. Ata që thonë se vetitë tona morale formohen përmes proceseve natyrore, gjithashtu thonë se proceset natyrore janë arsyeja që na bëjnë neve të kthehemi drejt Zotit. Kurse kjo qasje në vend të botëkuptimit materialist-ateist është e përputhshme me pritshmëritë e teistëve, të cilët proceset natyrore të Zotit i konsiderojnë si shkaqe instrumentale. Sipas pikëpamjes së mbështetur këtu, krijuesi i vetive tona morale të lindura, duke ia dhuruar njeriut vetitë e lartpërmendura, si duket e ka “vulosur” natyrshmërinë e njeriut me “markën” e tij. Prandaj në lidhje edhe me këtë argument teizmi duhet të preferohet si më i saktë në raport me materializmin-ateizmin.

NËNKAPITULLI I DHJETË (X)
ARGUMENTI I ARSYES

X

Argumenti i arsyes

Shumë aktivitete në jetën e përditshme si muhabeti rreth një çështje më të thjeshtë, mendimi mbi ndonjë qëllim tonin, marrja me shkencë në laborator dhe shpalosja e argumenteve të sofistikuara filozofike realizohen në saje të mundësisë së qenies sonë për “të arsyetuar”. Shpeshherë këto aktivitete i realizojmë pa e vërejtur fare ekzistencën “e arsyes” sonë, si diçka që është prej vetive më themelore të natyrshmërisë dhe përditshmërisë sonë.

Argumenti që do të paraqitet këtu ndërlidhet me transcedentalen tonë; me vetinë e arsyetimit si diçka që ndodhet te njeriu që nga momenti i lindjes. Nëse universi nuk do të kishte strukturë racionale, arsyeja nuk do ta kuptonte atë (argumenti i 2-të; argumenti për ekzistencën e ligjeve) dhe nga ana tjetër, çfarëdo qofshin karakteristikat e universit, arsyeja nuk do ta kuptonte atë nëse vet universi nuk do t’i posedonte disa veçori specifike. Përputhja mes universit të jashtëm dhe arsyes është një fenomen që kërkon përqëndrim të veçantë. E shoh të dobishme këtu që ta përmend edhe lidhshmërinë e afërm të “argumentit për vetëdijen dhe vetveten” dhe “ argumentit për vullnetin” me “ argumentin e arsyes”. Për shkak të lidhjes së ngushtë të arsyetimit të mendjes me vetëdijen dhe vullnetin, argumenti i paraqitur këtu do duhet të vlerësohet bashkë me “argumentin e vullnetit” dhe me “ argumentin e vetëdijes dhe vetvetes”. Pasi i bëra këto përkujtime tani le të kalojmë te prezantimi i argumentit të arsyes :

1. Për realizimin e proceseve të arsyetimit – bashkë me vetitë tjera – në mendje duhet të jenë edhe këto veti:
 - 1.1 Vetia për vullnetin
 - 1.2 Vetia për vetëdijen dhe vetveten
 - 1.3 Posedimi i koncepteve saktë-gabim dhe aftësia-mundësia për përdorimin e tyre
 - 1.4 Posedimi i rregullave të logjikës dhe logjikimi
2. Për shpjegimin se si erdhën në ekzistencë këto veti të arsyes, ekzistojnë dy pikëpamje themelore alternative :
 - 2.1 Nëse materia është tipi i vetëm ekzistues, siç pretendojnë materialistët-atelistët, atëherë këto veti të arsyes janë formuar si rezultat i ligjeve të natyrës.

2.2 Nëse ekziston Allahu, ashtu siç pretendojnë teistët, atëherë këto veti të arsyeshme janë formuar falë një qenie me arsye si Allahu.

3. Teizmi e shpjegon më mirë se materializmi-ateizmi ekzistencën e këtyre vetive të cilat e mundësojnë arsyetimin, sepse:

3.1 Vetitë e nevojshme për vullnetin teizmi i shpjegon më mirë se materializmi-ateizmi (do të tregohet në kapitullin e 11-të).

3.2 Vetitë e nevojshme për vetëdijen dhe vetveten, teizmi i shpjegon më mirë se materializmi-ateizmi (do të tregohet në kapitullin e 12-të).

3.3 Aftësinë e përdorimit të koncepteve saktë-gabim, teizmi e shpjegon më mirë se materializmi-ateizmi.

3.4 Logjikimin teizmi e shpjegon më mirë se materializmi-ateizmi.

3.4 Si rezultat, teizmi duhet të preferohet para materializmit-ateizmit.

Se vetitë e përmendura në pikën e parë bëjnë pjesë në kategorinë e domosdoshme për të arsyetuar, është një çështje që pranohet lehtësisht nga të gjithë. Nëse e refuzojmë pretendimin se jemi qenie me vullnet, të gjitha mendimet tona që shfaqen jashta dëshirës sonë, për shkak se nuk do të jenë ndryshe nga dukuritë fizike (siç është rasti me fryerjen e erës), atëherë nuk mund të themi se bëhet fjalë për mundësi të të arsyetuarit. Arsyetimi është kuptimplotë vetëm nëse ekziston vullneti, ngase ai që nuk ka mundësi të arsyetojë, nuk ka mundësi as të veprojë me vullnet. (Në kapitullin e 11 do të shtjellohet vullneti). Gjithashtu, edhe për një njeri që nuk ka vetëdije, nuk mund të themi se është i aftë të arsyetojë. Arsyetimi është kuptimplotë vetëm nëse jemi të vetëdijshëm për atë çfarë mendojmë dhe vetëm nëse si i tillë është specifik për çdo individ. (në kapitullin e 12 do të shtjellohet vetëdija dhe vetvetja).

Kur jemi te këto çështje, është mirë që t'i vlerësojmë dy pika tjera të rëndësishme të cilat nuk do të shtjellohen në dy kapitujt e ardhshëm, por që kanë të bëjnë me arsyetimin në jetën e përditshme. Për shembull, le ta shtjellojmë stilolapsin si diçka që shërben për të shkruar shkrime. Po të mos e kishim vlerësuar si “ të saktë “ shërbimin e stilolapsit për të shkruar shkrime dhe si “gabim” ngrënien e stilolapsit, atëherë për neve vetëm stilolapsi si i tillë nuk do të nënkuptonte asgjë. Fjalët marrin kuptim falë vlerësimeve në mendjet tona në kuadër të koncepteve “saktë“ dhe “gabim“ (veçori e ndërlidhur me konceptet saktë dhe gabim). Nëse nuk do ta kishim vlerësuar shkruarjen e shkrimit ose stilolapsin sipas rregullave themelore të logjikës dhe nëse nga përvojat

e mëhershme përmes të logjikuarit induktiv nuk do të kishim arritur në përfundimin se stilolapsi shërben si mjet për të shkruar, atëherë nuk do të kishim pasur dije as edhe për këtë informatë (karakteristikë e logjikës). Sidoqoftë, teistët nuk kanë kundërshti me materialistët-ateistët në çështjen e ekzistimit të këtyre vetive si gjëra themelore të arsyes, pra mund të themi se nuk ka ndonjë mosmarëveshje në lidhje me pikën e parë të argumentit. (Për të arsyetuar, përveç memories dhe kapacitetit të të folurit nevoiten edhe disa veçroi tjera; mirëpo këtu u morrën parasysh vetëm disa kushte, jo të gjitha)

Në pikën e dytë të argumentit u potencua që ekzistojnë dy qasje themelore për sqarimin e mënyrës se si u shfaq fenomeni i arsyes: e para prej këtyre është qasja materialiste-ateiste, që e mbron idenë e formimit të arsyes përmes proceseve të rastësishme të ligjeve të natyrës dhe që e pranon ekzistencën e pafund të materies. Ndërsa qasja e dytë është ajo teiste, në të cilën pretendohet se Zoti si qenie që ka vetëdije, arsye, vullnet dhe fuqi absolute disa prej krijesave të tija, qoftë edhe në nivel më të ulët, u dhuroi veti me të cilat ata do të mund të arsyetojnë. Konsiderimi i pikës së dytë të argumentit si “thelbësor” është bërë për shkak të mundësisë që dikush mund ta mbrojë edhe një alternativë të tretë jashta këtyre dyjave. Për shembull panpsishizmi (panpsychism), si një pikëpamje që pretendon për ekzistimin e vetëdijes në çdo pjesë të materies, mund të paraqitet si alternativë edhe para shoqërisë së gjërë, por edhe para komuniteteve shkencore.¹⁰⁴ Ky pretendim është në kundërshtim me përvojat tona se vetëdija nuk është diçka e përhapur gjithandej; por është një veti me tipar qëndror. Secili prej neve posedon mendime dhe veprime të cilat i realizon përmes arsyes-vullnetit-vetëdijes dhe të gjitha këto veti janë veçori autentike të qenies sonë; gjithashtu, kufij kanë edhe veprat të cilat i realizojmë përmes arsyes dhe menaxhimit që ajo ia bën trupit. Në këtë pikë nuk ka asnjë ngjasim me pikëpamjen panpsishizmike, e cila vetëdijen e parashikon si të shpërndarë gjithandej. Nëse pranohet panpsishizmi, aëtherë duhet shpjeguar se si ndodhi që nga një materie e këtillë të shfaqen vepra të arsyeshme, të vetëdijshme dhe të vullnetshme te njeriu. Me fjalë të tjera, në rast të ndonjë ndryshimi serioz të mendimit në lidhje me kuptimin e materies, këtu mund të ruhet struktura kryesore e argumenteve të mbrojtura. Për dikë tjetër që synon ndonjë pikëpamje tjetër të kuptimit të arsyes, të vullnetit dhe të vetëdijes, panpsishizmi mund të jetë si alternativë më ndryshe prej teizmit dhe materializmit-ateizmit. Por le ta lëmë mënjatë idenë se të gjitha grimcat e materies janë të vetëdijshme, ngase si ide nuk është

¹⁰⁴ Panpsişizm’i savunanlara örnek olarak David Skrbina verilebilir. Bakınız: David Skrbina, **Panpsychism In The West**, MIT Press, Cambridge Mass., 2005.

se ka treguar konkurrencë serioze. Megjithatë unë jam i mendimit se një pikëpamje e këtillë, që pretendon se në çdo grimcë të materies ekziston vetëdije, mund të mbrohet si ide vetëm nëse bashkohet me pikëpamjen teiste, në të cilën pretendohet se pas tërë materies ekziston një Fuqi me arsye, vullnet dhe vetëdije, e Cila këto veti të veta ia ka dhuruar të gjitha katrilion pjesëve të materies që Ai i ka krijuar. Prandaj nuk është kjo ndonjë qasje që mund të shtjellohet kundër teizmit. Mirëpo duke qenë se ky botëkuptim mbi materien nuk është i përputhshëm me botëkuptimin mbi materien të materializmit-ateizmit dhe pranohet më lehtë nga ana e teizmit, përsëri nuk është ndonjë pikëpamje themelore alternative të cilën mund ta vendosim në këtë rang. Ndonjëherë jashta dy atërnativave që marrin pjesë në këtë argument, është e mundur të diskutohen pretendime përjashtuese të tilla siç ishte rasti me mendimin se esenca e materies është krejtësisht e ndryshme nga ajo çfarë ne dijmë. Mirëpo qoftë kur analizohen qasjet në historinë e filozofisë, qoftë kur analizohen mendimtarët e spikatur të periudhës sonë, do të vërejmë se pjesa dërmuese e tyre bëjnë pjesë në njërin nga dy alternativat e paraqitura këtu. Pika në të cilën do të ketë kundërshtime nga ana e materialistëve-ateistëve është pika e tretë. Kurse pranimi i pikës së tretë na dërgon automatikisht te përfundimi. Kur të jenë të sakta premiset e parashtruara në argument, është më se e logjikshme që rezultati të dalë i tillë në mënyrë automatike, madje edhe këtu nuk ka diçka që mund të kundërshtohet nga ana e materialistëve-ateistëve. Ata do të deklarojnë se përfundimi do të ishte i saktë nëse propozimi në pikën e tretë do të ishte i saktë dhe se përfundimi është i rremë sepse propozimi është i tillë. Me pak fjalë, pika që meriton t'i kushtohet më shumë vëmendje është pika e tretë; për këtë arsye më poshtë do ta shtjellojmë këtë pikë. Kështu që, këtu do ta shtjellojmë se kush prej dy filozofive (materializmi-ateizmi apo teizmi) e bën shpjegimin më të mirë të këtij argumenti.

Siç thamë edhe më herët argumentet për vullnetin, vetveten dhe vetëdijen do të shtjellohen në kapitujt 11 dhe 12. Mirëpo për shkak që vullneti, vetëdija dhe vetvetja janë prej kushteve të domosdoshme pa të cilat nuk mund të paramendohet fenomeni i të arsyetuarit, edhe dy kapitujt e ardhshëm janë pjesë e këtij argumenti. Tani le t'i analizojmë dy karakteristikat diskutabile të argumentit.

Vlerësimi i pikës 3.3: Prej kushteve të cilat kanë rëndësi të veçantë në procesin e të arsyetuarit është edhe ekzistenca e koncepteve si “saktë dhe gabim” dhe aftësia për t'i përdorur këto. Kjo karakteristikë është prezente te çdo njeri dhe secili prej tyre sëpaku njëherë në jetën e vet ka pasur

mundësi të veprojë bazuar në këtë fenomen, qoftë edhe pa e vërejtur fare. Ashtu siç janë të pavetëdijshëm peshqit për praninë dhe domosdoshmërinë e ujit, njëjtë janë edhe njerëzit në raport me arsyen e tyre. Arsyetimin e realizojmë përmes përdorimit të gjuhës, e përdorimi i gjuhës varet nga dija dhe kuptimi i fjalëve dhe fjalive. Kurse kuptimi varet nga ajo se në çfarë kushtesh u japim fjalëve dhe fjalive kuptim prej “saktësie” ose “gabimi”. Thënë më shkurtë, kuptimi ose në këtë rast arsyetimi pa konceptet “saktë” dhe “gabim” është i pamundur. Vlerësimi me “i saktë” i karrikes si mjet që shërben për tu ulur dhe vlerësimi me “gabim” i basketbollit si diçka që shërben për të luajtur futboll varet nga kuptimi që ne ua kemi dhënë fjalëve. Ai i cili e din fjalën karrike por nuk e kupton se ajo është një mjet që shërben për tu ulur mbi të, nuk mund të themi se e ka kuptuar konceptin e fjalës karrike. Mirëpo derisa jemi duke folur mbi konceptin e karrikes, edhe pse nuk e bëjmë menjëherë dallimin si “saktë” ose “gabim”, këto informata ndodhen në nënvetëdijen tonë pa e vërejtur fare. Përdorimi i këtyre koncepteve pa këtë vetëdije nuk do të nënkuptonte asgjë.

Kur e vështrojmë natyrën do të shohim se asgjë nuk ka vlerë të tillë si “sakt” ose “gabim” dhe do të shohim se të gjitha këto koncepte janë pjesë e mendjes sonë. Le ta paramendojmë një ekspert të botanikës duke bërë përpjekje ta gjejë moshën e një druri. Ky ekspert për ta gjetur moshën e drurit duhet t’i analizojë qarqet në trungun e drurit. Nëse eksperti e parashikon gabimisht moshën e drurit, atëherë themi se gabimi qëndron te eksperti, jo te druri. Mirëpo për një moment le ta paramendojmë një lloj të atillë të bakteries, prania e së cilës do të shkakton matjen e gabueshme të moshës së drurit duke i prishur qarqet në të. Në këtë rast a mund të themi se gabimi qëndron te druri? Sigurisht se jo. Ne mund të themi se struktura e drurit është e rremë, e jo vet druri. Kurse gabimi i vërtetë qëndron te eksperti. Asnjë krijesë që s’ka mendje dhe asnjë produkt teknologjik njerëzor nuk është i vetëdijshëm për konceptet “saktë”, “gabim” dhe “kuptim”. Info-proceset e bëra nga ana e kompjuterëve kanë kuptim të “saktësisë” dhe të “gabimit” vetëm nëse shikohen nga këndi i mendjes sonë, përndryshe kompjuterët nuk janë të vetëdijshëm ndaj procesit të cilin janë duke e realizuar. Këtë mund ta ilustrojmë me shembullin e shkrimit të mendimeve tona në një fletore. Derisa shkrimet në fletore nuk i vështrojmë përmes një mendjeje, të shkruarat aty nuk janë gjë tjetër përveçse një grumbull pikash të dalura nga pena. Mirëpo kur ato shkrime bëhen pjesë e vlerësimit të mendjes, atëherë hyjnë në funksion konceptet si “saktë” dhe “gabim”.

Këto koncepte kaq themelore dhe të lindura prej fëmijërisë është e pamundur t'i reduktojmë në botën e biologjisë, kimisë ose fizikës dhe është e pamundur tu gjejmë një vend në atë botë.¹⁰⁵ Siç ka thënë C.S Lewis “ të qenit një pjesë e materies e drejtë”, kurse “një pjesë tjetër e materies e padrejtë”, kjo do të ishte një gjepur e madhe.¹⁰⁶ Mbrojtësit e ontologjisë materialiste e kanë shumë të vështirë shpjegimin e këtyre koncepteve që ndodhen në botën mendore të individëve dhe që nuk kanë ekzistencë objektive në universin material. Çifti materialist-ateist Patricia dhe Paul Churchland, me ta vërejtur vështirësinë në këtë çështje të filozofisë materialiste-ateiste, e patën paralajmëruar nevojën për tu përgatitur për mosekzistimin e koncepteve “saktë” dhe “gabim” në trurin e njeriut. Gjithashtu, Victor Reppert që i ka cituar këto pretendime të çiftit Churchland, kishte tërhequr vëmendjen në pamundësinë e plotësimit të vendit të këtyre koncepteve dhe kishte shtuar se “çmimi intelektual” i eliminimit të këtij parametri do të jetë shumë i shtrenjtë.¹⁰⁷ Megjithëse çifti në fjalë janë të vetëdijshtë për këtë, nga ana tjetër një pjesë e madhe e materialistëve-ateistëve edhe pse e kanë të vështirë që t'i pranojnë këto gjëra në mënyrë të qëndrueshme, përsëri vet çështja në fjalë nuk lejon për ndonjë diskutim. Konceptet “saktë dhe gabim” nuk kanë vlerë dhe ekzistencë objektive në botën materiale. Në fund të fundit, është absurde të pretendohet se vet struktura biokimike në trurin e njeriut mund të jetë “e saktë” ose “gabim” (njëjtë siç nuk mund të thoshim për qarqet në trungun e drurit se janë gabim ose saktë). Për materialistët-ateistët, siç është rasti me çiftin Churchland, shkuarja deri aty sa të injorohet realiteti i koncepteve “saktë” dhe “gabim” paraqitet si diçka që nuk ua kërcënon filozofinë atyre. Konceptet “saktë” dhe “gabim” janë koncepte themelore që i takojnë vetëm mendjes dhe është e pamundur të kuptohen përmes reduktimit të tyre në materie. Nëse fjalinë “Njerëzit mund të udhëtojnë me veturë” e kuptoni si të saktë, kurse fjalinë “Çdo njeri ka një veturë” e kuptoni si gabim dhe nëse mendoni se këto koncepte janë të kuptimshme, atëherë i bie që ju e pranoni ekzistencën reale të koncepteve që filozofia materialiste-ateiste nuk ka arritur ta sqarojë. Kurse këndvështrimi teist, universin dhe zanafillën e krijesave që kanë arsye e ndërlidhë me Zotin i cili

¹⁰⁵ Dallas Willard, “Knowledge and Naturalism”, **Naturalism: A Critical Analysis**, Ed: William Lane Craig ve James Moreland, Routledge, Londra, 2000, f. 26-48. ¹⁰⁷ C. S. Lewis, **Christian Reflections**, William B. Eerdmans Publishing Company, Grand Rapids, 1995

¹⁰⁶ C. S. Lewis, **Christian Reflections**, William B. Eerdmans Publishing Company, Grand Rapids, 1995.

¹⁰⁷ Paul M. Churchland, “On the Ontological Status of Observables”, **A Neuro-Computational Perspective: The Nature of Mind and the Structure of Science**, Bradford, Cambridge Mass., 1990, f. 150-151, Patricia Churchland, “Epistemology in the Age of Neuroscience”, **Journal of Philosophy**, No: 84, Ekim 1987, f. 548; Victor Reppert, i cili ka cituar nga këto dy burime , **C.S. Lewis’s Dangerous Idea**, IVP Academic, Downers Grove, f. 76-77.

gjithashtu posedon arsye. Prandaj, edhe në këtë pikë teizmi nuk ballafaqohet me probleme në sqarimin se si këto vetia të nevojshme për arsyetim u shfaqën në ekzistencë. Për këtë arsye themi se paradigma teiste është më e suksesshme sesa paradigma materialiste-ateiste në shpjegimin e mënyrës se si u shpërfaqën këto veçori.

Vlerësimi i pikës 3.4: Për ta futur në funksion arsyen nevoiten edhe disa rregulla të logjikës pa të cilat është e pamundur të logjikohet. Sipas Higgsit kjo veti e mendjes na ka mundësuar zbulimin, shpikjen dhe arsyetimin e gjërave të thjeshta dhe të komplikuara. Pa parimet logjike të njëjtësisë dhe moskontradikshmërisë, për mendjen fjalja “kjo është një karrike” nuk do të nënkuptonte asgjë. Në të njëjtën mënyrë, po të mos kishim ardhur në përfundim induktiv se karrikja shërben si mjet për tu ulur duke u bazuar në të dhënat që i kemi rreth saj, vështirë se do ta realizonim arsyetimin dhe dedukcionin se karrikja shërben për tu ulur. Kështu që mendja jonë procesin e të arsyetuarit e realizon përmes të dhënave nga e kaluara dhe vetive të lartpërmendura të logjikës. Përdorimi i arsyes nga ana e fiseve të izoluara përmes rregullave të njëjta të logjikës, përdorimi i rregullave të logjikës që nga mosha fëmijërore dhe fakti që fëmijët lindin me një strukturë mendore të përshtatshme për ta mësuar gjuhën ose fakti që mendimi pa rregullat e logjikës shkakton përdorime të pakuptimta të gjuhës; pra të gjitha këto na lënë të kuptojmë për ekzistimin e karakteristikave të logjikimit te njeriu që nga momenti i lindjes. Sipas Nagelit, ai njeri që bazohet në arsye, ka gjetur burimin universal autoritativ, përmes të cilit e tejkalon edhe veten, edhe shoqërinë. Nagel thotë se edhe shumë njerëz të edukuar hasin në vështirësi gjatë zbatimit të formës së arsyetimit të ashtuquajtur “modus tollendo tollens”, mirëpo kjo nuk e prishë karakteristikën e domosdoshme universale të këtij ligji. Kështu që edhe kjo është një prej argumenteve që tregon se ligjet e logjikës nuk mund të reduktohen në pranime shoqërore ose në situata psikologjike.¹⁰⁸ Edhe gjatë llogaritjes matematikore $3+2=5$, por edhe gjatë shumë zbatimeve tjera matematike dhe logjike, në mendjet tona e ndjejmë autoritetin universal të këtij fenomeni. Rregullat e logjikës nuk janë rregulla fizike, por janë gjëra tej-fizike dhe tej-kohore. Disa mendimtarë, e kanë refuzuar ekzistencën e vërtetë të numrave duke u nisur nga mos mundësia për të krijuar lidhshmëri shakore mes ekzistencës sonë dhe numrave të cilat kanë attribute të ngjajshme. (për shkak se janë abstrakte dhe për shkak që krijesat abstrakte nuk mund të bëhen pjesë e lidhshmërisë shkakore)

¹⁰⁸ Thomas Nagel, **The Last Words**, Oxford University Press, 2001, Oxford.

A nuk do duhej që një materialist fanatik të pretendonte njëjtë edhe për rregullat e logjikës, të cilat gjithashtu nuk bëhen dot pjesë e analizimit shkakor dhe reduktimit material? Sigurisht që duhej të vepronin ashtu, mirëpo të pakët janë ata materialistë-ateistë të cilët e kanë kuptuar këtë rezultat të logjikës së tyre. Mirëpo është e vërtetë se refuzimi i rregullave të logjikës do të sjellë shumë probleme me vete, bile këtë e ka potencuar edhe Aristoteli para mijëra viteve. Madje për vet refuzimin e rregullave të logjikës, sëpari duhet të pranohet saktësia e këtyre rregullave!¹⁰⁹ Në universin të cilin e ka përshkruar materializmi është e pamundur të gjehet një strukturë mbështetëse për rregullat e logjikës, sepse këmbëngulja në mbrojtjen e filozofisë ateiste do ta bënte të domosdoshme nevojën për t'i konsideruar këto rregulla si iluzione dhe mashtrime. Ndërsa ai materialist i cili vepron në këtë mënyrë, nuk do t'i linte vetes asnjë argument përmes të cilit do ta mbronte saktësinë e materializmit (sepse vet tentativa për të mbrojt diçka përmban në esencë prirjen drejt të "saktës" ose të "pasaktës").

Njeriu, është e pamundur ta përdorë arsyen pa prezencën e rregullave të logjikës. Mirëpo, këto rregulla janë ndryshe nga ligjet e fizikës, sepse logjikisht është e mundur të imagjinohet një univers me një set të ndryshëm të ligjeve të fizikës. (Për shembull mund të themi se është i mundshëm ekzistimi i një universi ku s'ka gravitet ose ku është e ndryshme fuqia e ndërveprimit të dobët mes atomeve.) Nga ana tjetër, ligjet e logjikës konsiderohen të jenë transcendentë, prandaj ato mbeten saktësisht të njëjta në çdo univers të mundshëm. Ekuacioni matematikor " $3 + 2 = 5$ " dhe fjalia "e madhja mund të përfshijë të voglën" janë të mundshme vetëm në këtë mënyrë në çdo univers të mundshëm. Pra parimet logjike si njëjtësia dhe moskontradikta do të mbesin të pandryshuara edhe në një univers fiktiv të qeverisur nga një set i ndryshëm ligjesh fizike. Nëse e analizojmë universin material do të shohim se asgjë nga bota e fizikës, biologjisë dhe kimisë nuk i ngjanë ligjeve universale të logjikës, madje gjithçka është rrënjësisht ndryshe prej këtyre ligjeve. Le t'i shtjellojmë molekulat biologjike në trurin tonë të formuara nga atomet e ndryshme. Asnjë gjendje në trurin tonë, e cila është formuar prej këtyre molekulave, nuk mund ta justifikojë shfaqjen e ndonjë rregulli logjik të përmendur këtu. Për sa i përket ateizmit materialist, duket e pamundur kalimi nga materia në ligjet e logjikës universale, pasi sipas tyre të gjitha gjendjet e mendjes përbëhen vetëm nga një formë e caktuar e molekulave biokimike. Pra, atomet e njëjta në esencë, është e pamundur ta realizojnë kalimin nga bota atomike në rregullat universale të logjikës. Kështu

¹⁰⁹ Victor Reppert, **C.S. Lewis's Dangerous Idea**, f. 81.

që është vështirë të shpjegohet mënyra se si u shpërfaqën këto veti, të cilat nuk kanë asnjë zanafillë në botën materiale. Çfarëdo qofshin kombinimet dhe komplekset e bëra përmes materies, kurrë nuk do të mund të ndërtohen themele mbi të cilat do të prodhoheshin ligje universale të logjikës. Ndërsa sipas teizmit meqë në krye të gjithçkaje qëndron Zoti si qenie me arsye, nuk është shumë problematike sqarimi dhe shpjegimi i mënyrës se si u erdhi në ekzistencë arsyeja. Prandaj edhe në këtë pikë teizmi është me më shumë avantazh.

Me fjal të shkurtëra, në këtë kapitull u fokusua më tepër në vetinë e të arsyetuarit, si një prej vetive që na jep tipare njerëzore. Gjithashtu, i shtjelluam shpjegimet e materializmit-atëizmit dhe teizmit për mënyrën se si u shpërfaqën këto karakteristika. Pamë se rregullat e logjikës dhe konceptet “saktë” ose “gabim”, nuk mund të shpjegohen përmes strukturës së materise dhe molekulave biokimike. Edhe pse këto struktura materiale janë të domosdoshme për ta realizuar procesin e arsyetimit, përsëri nuk janë shkaqe që e finalizojnë sqarimin e natyrës së tij. Përmes një shtjellimi konceptual dhe përmes një thellimi në gjërat e nevojshme për arsyetim, kuptuam se vetitë e lartpërmendura janë rrënjësisht ndryshe prej proceseve dhe strukturave materiale të përshkuara nga materializmi-atëizmi.

Në këtë hulumtim u pa që filozofia materialiste-atëiste është e pasuksesshme në shpjegimin se si u formuan vetitë e nevojshme për arsyetim, mirëpo nga ana tjetër u pa se e njëjta gjë nuk është aspak e vështirë për teizmin, që mbron idenë se pas tërë këtij universi qëndron një Krijues i cili përmban arsye dhe vetëdije. Si rezultat, përfundimi se të gjithë njerëzit lindin me veti të prirura për të arsyetuar, na bën që ta preferojmë teizmin më shumë sesa materializmin-atëizmin.

NËNKAPITULLI I NJËMBËDHJETË (XI)
ARGUMENTI I VULLNETIT

XI

Argumenti i vullnetit

Një prej vetive tipike njerëzore është edhe posedimi i vullnetit, si diçka që është pjesë e jona që nga momenti i lindjes. Vullneti përveçse në filozofi dhe fe, është një temë diskutimi dhe hulumtimi edhe në psikologji, në neurologji dhe në shkencat kognitive. Në këto fusha është diskutuar gjërë e gjatë prania e vullnetit te njeriu. Meqë është një çështje shumë diskutabile, në këtë kapitull do të mbrohet ekzistenca e vullnetit si diçka që është e pamundur të refuzohet. Më pastaj do ta shtjellojmë se kush prej teizmit apo materializmit-ateizmit e shpjegon më së miri këtë fenomen. Të gjithë jemi të vetëdijshëm për praninë e vullnetit gjatë aktiviteteve në jetën e përditshme; p.sh kur vendosim se cilën ngjyrë të maicës duhet ta veshim në mëngjes, ose kur vendosim se me çka të shkojmë në punë: me biçikletë apo me veturë. Në vend të maicës së kaltërt ose biçikletës, mund ta kishim zgjedhur maicën e kuqe ose veturën, por përsëri përcaktimin e çfarëdo qoftë vendimi ne e bëjmë me vullnetin tonë. Ashtu siç veprojmë gjatë vendimeve dhe përzgjedhjeve në jetën e përditshme, në mënyrë të njëjtë veprojmë edhe gjatë vendimeve dhe përzgjedhjeve në momentet më kritike të jetës sonë si martesë, puna dhe vendbanimi. Nëse mund ta paramendoni se këtë shkrim keni pasur mundësinë të mos e lexoni, por ju vet keni vendosur ta lexoni, atëherë ju veçse jeni dëshmitarë të ekzistencës së vullnetit. Pra ky është edhe kuptimi i vullnetit; të zgjedhësh me vullnetin tënd mes disa opsioneve të paraqitura.

Para se të paraqesim ndonjë argument për ekzistencën e vullnetit, duhet së pari ta qartësojmë dilemën e krijuar për çështjen e vullnetit; a ekziston vërtet kjo prirje te ne, apo është vetëm një iluzion? Personalisht mendoj se vullneti ekziston dhe këtu do të mundohem ta mbroj këtë mendim. Edhe teoritë filozofike dhe fizike që thonë se universi mbisundohet nga ana e determinizmit ose indeterminizmit, por edhe hulumtimet shkencore, janë shumë larg mundësisë për ta dëshmuar mos ekzistencën e vullnetit.¹¹⁰ Ndërsa më poshtë po e paraqes argumentin tim që dëshmon për pamundësinë e refuzimit të vullnetit:

¹¹⁰ Për më shumë detaje rreth kësaj teme shikoni në librin “Teoria Kuantike, Filozofia dhe Zoti” Caner Taslaman, Istanbul Yayınevi, Istanbul, 2015, f.121-168

1. Një propozim (ose parim) nuk mund të refuzohet bazuar në një përfundim të arritur nga i njëjti propozim (ose parim).
2. Propozimi i një argumenti filozofik ose preokupimi me ndonjë aktivitet shkencorë bazohet në “propozimin e heshtur” se ne posedojmë vullnet.
3. Asnjë aktivitet shkencorë dhe argument filozofik nuk mund ta refuzojë ekzistencën e vullnetit.

Për pikën e parë të argumentit mund të themi se është qartazi e kuptueshme. Nëse vini deri te një rezultat bazuar në një supozim të caktuar, kjo nënkupton se supozimi në fjalë qëndron gjithmonë si një element brenda atij rezultati dhe në momentin që e pranoni si të paqenë supozimin, atëherë edhe atë rezultat duhet ta konsideroni si të tillë. Për këtë arsye rezultati asnjëherë nuk mund të konsiderohet si pikënisje për ta bërë këtë supozim të pavlefshëm. Supozoni hipotetikisht se rezultati bëhet i pavlefshëm bazuar në hipotezën që e ka sjellur atë; atëherë në këtë rast ku hipoteza është e pavlefshme, edhe rezultati/konkluzioni duhet të bie poshtë, prandaj është e pamundur që në raste të këtilla rezultati të përdoret kundër hipotezës. Imagjinoni për një moment, se ju e mohoni supozimin duke e përdorur rezultatin: kur supozimi të bëhet i pavlefshëm; atëherë vet rezultati zhduket. Në këtë rast bëhet i pamundur përdorimi i rezultatit kundër supozimit. Thënë shkurt, nëse një rezultat bazohet në një supozim, atëherë supozimi duhet të jetë gjithmonë më kryesor sesa rezultati. (nuk duhet ngatërruar këtë me kontradiktën e brendshme “self contradiction”; te kontradikta e brendshme nuk pretendohet të përgënjeshtrohet supozimi mbi të cilën është ndërtuar rezultati i saktë) Paradoksi i gjyshit (grandfather paradox), i paraqitur për të treguar pamundësinë e udhëtimit në kohë (në të kaluarën) është i ngjashëm me këtë. Ne besojmë se e tashmja (rezultati) jonë është përcaktuar dhe përcaktohet nga ngjarjet e së kaluarës; kështu që sipas kësaj i bie që brenda së tashmes janë prezent edhe ngjarjet e së kaluarës dhe nisur nga sot, ne nuk mund t'i ndryshojmë ngjarjet e së kaluarës që kanë sjellur të tashmen. Për shembull, nipi nuk mund të udhëtojë në të kaluarën dhe ta mbysë gjyshin e tij, sepse edhe nëse supozojmë një gjë të tillë qoftë edhe imagjinarisht, nipi nuk do të ekzistonte dhe nuk do të mund ta vriste gjyshin. Edhe për argumentin e dytë mendoj se është e qartë. Për shembull, le të mendojmë pakës mbi eksperimentet e famshme të Libetit;¹¹¹ ku pjesmarrësit bashkë me Libetin dhe asistentët, në vend

¹¹¹ Benjamin Libet dhe të tjerët, “Time of Conscious Intention to Act in Relation to Onset of Cerebral Activity (Readiness-Potential)”, **Brain**, No: 106-3, 1983, f. 623–642.

të realizimit të këtij eksperimenti mund të merreshin me ndonjë lloj tjetër të eksperimentit; ose në vend të angazhimit me shkencë mund të luanin futboll. E njëjta gjë është e vlefshme edhe gjatë ndonjë pretendimi filozofik. Ata që merren me argumente filozofike me qëllim që të thonë diçka rreth vullnetit, në vend të këtij angazhimi mund të bëheshin gustatorë dhe mund të ndanin kohë për zbulimin e të gjitha llojeve të ushqimeve në botë; ose mund të merreshin vetëm me politikë, njëjtë sikurse një pjesë e madhe e shoqërisë. Të vendosësh mes disa opsioneve dhe alternativave është dëshmia më e qartë se vullneti ekziston. Nëse shkencëtarët dhe filozofët nuk do të presupozonin për ekzistencën e vullnetit, nuk mund të pretendonin për dallimin mes veprave të tyre dhe rrokullisjes së një shkëmbi. Siç u potencua më herët në kapitullin rreth arsyes; fenomenet e këtilla në lidhje me natyrën është e pamundur të bëhen pjesë e kalkulimeve “saktë” ose “gabim”; ashtu siç është absurde të jetë “i saktë” ose “gabim” rrotullimi i shkëmbinjëve në një formë të caktuar. Nuk mund të ekzistojë vullneti pa aftësinë e të arsyetuarit. Në momentin që thuhet se është i pamundur përdorimi i koncepteve “saktë” dhe “gabim”, pamundësohet edhe arsyetimi, edhe aktiviteti shkencor. Çdo aktivitet shkencor dhe argument filozofik përmban brenda vetes supozimin e ekzistimit të vullnetit.

Rezultati i paraqitur në pikën e tretë të argumentit është përfundim që del domosdoshmërisht pasi të vërtetohet saktësia e dy pikave të para. Meqë paraprakisht është vërtetuar saktësia e dy pikave të para, atëherë i bie që asnjë aktivitet shkencor ose argument filozofik nuk mund ta refuzojë ekzistencën e vullnetit. Ky rezultat nuk e pamundëson ekzistencën e një bote (imagjinarisht), në të cilën njerëzit që merren me shkencë dhe filozofi, të mos kenë vullnet. Logjikisht është e mundur një botë e këtillë, por kjo nuk nënkupton se në një botë të këtillë mund të vërtetohet mosekzistenca e vullnetit përmes aktiviteteve shkencore dhe argumenteve filozofike. Në një botë të këtillë iluzionare, meqë gjithçka ka përmbajtje iluzionare, është e pamundur të tregohet diçka konkrete dhe reale. Madje mbi të gjitha, vet tentimi për të treguar diçka përmban brenda vetes supozimin e vullnetit. Shkurtimisht mund të themi se ata të cilët e mbrojnë ekzistencën e vullnetit kundër atyre që tentojnë ta sfidojnë ekzistencën e vullnetit gjithmonë janë më të suksesshëm; kështu që sfida e atyre që kundërshtojnë është e pavlefshme mu në momentin që ata kanë vendosur të kundërshtojnë, sepse ata “e kundërshtojnë vullnetin duke supozuar për mosekzistimin e tij”. Kurse sa i përket atyre të cilët e mbrojnë ekzistencën e vullnetit, nuk ekziston ndonjë problem i ngjajshëm.

Të gjithë këto e sqarojnë pamundësinë për të sjellur argumente kundër ekzistimit të vullnetit. Nga ana tjetër kur pretendojmë se ekziston vullneti, përveç mendimit të mirë kemi edhe arsye të logjikshme. Le t'i shikojmë pakës të kaluarat akademike të njerëzve dhe historinë e tërë njerëzimit; nëse nuk e merrni parasysh vullnetin njerëzorë, atëherë e tërë ajo histori dhe bagazh arritjesh shkencore do ta humbë kuptimin aktual. Në momentin që e largoni prej njeriut vullnetin, gjithçka do të marrë pakuptimësi, që nga vendimet e Napoleonit gjatë luftërave e deri te përpjekja uaj për ta mësuar gjeografinë, sepse edhe lufta, edhe procesi i mësimi janë të zbatueshme vetëm nëse paraprakisht njeriu posedon vullnet. Nëse nuk e merrni parasysh vullnetin çdo e mësuar e humb kuptimin e saj dhe atëherë të mësuarat bëhen thujse të njëjta me proceset fizike. Nëse me vullnetin tonë nuk krijojmë efekt shkakor në univers, atëherë i gjithë procesi jonë edukativ do të fiton pakuptimësi, sepse në këtë rast formësimi i mendjes që është rezultat i edukimit nuk është se krijon ndonjë dallim në sjellje. Në këtë rast të gjitha ndërveprimet në universin pjesë e së cilit jemi edhe vet ne, do të jenë pa asnjë dallim të vetëm prej përplasjes së shkëmbinjëve; sepse këtu nuk merr pjesë vullneti! Nëse e heqim nga skena vullnetin, atëherë i bie që të gjitha gjërat në univers, nga karrikja e deri te televizori, nga libri e deri te kompjuterët, janë produkt i një rastësie të madhe ! Gjithashtu, nëse vullneti është iluzion që nuk shkakton asgjë, është e pamundur të shohim ndonjë arsye të përputhshme mes ngjarjeve që ndodhin dhe “vullnetit si ndjenjë iluzionare”, sepse edhe po të kishte pasur papërputhshmëri (për shembull të kishte lëvizur dora në momentin kur ta dëshironim ecjen ose të kishim kërcyer në qiell atëherë kur të kishim ndjenja vullnetare për tu ulur në karrike) mes ndjenjës sonë për vullnet dhe ngjarjeve që ndodhin, si dhe nëse vullneti jonë nuk do të shkaktoje asgjë, atëherë nuk do të kishim observuar asnjë problem në jetën tonë. Me fjalë të tjera, edhe nëse nuk ka asnjë arsye për të mos e vëzhguar një trup që vepron vazhdimisht kundër vullnetit tonë, ne përsëri vëzhgojmë koherencë midis vullneteve dhe veprimeve tona. Si rezultat, koherenca midis ndjenjës sonë të vullnetit dhe rezultateve që vëzhgojmë tregon se pretendimi për jorealitetin e vullnetit është edhe kundër logjikës, edhe kundër arsyes së shëndoshë.¹¹²

Përgjigjet të cilat i cekëm deri tani mund të paraqiten para materialistëve-ateistëve të cilët pretendojnë se nuk ekziston vullneti. (edhe faktet e thëna më poshtë rreth epifenomenalizmit janë përgjigje kundër refuzimit të vullnetit). Ndërsa tani do të vazhdoj ta paraqes argumentin që unë e

¹¹² Mund ta lexoni si një shembull që tregon se duhet të pritët nga materialistët-ateistët ta refuzojnë ekzistencën e vullnetit, **Free Will**, Free Press, New York, 2012.

quaj prova e vullnetit, si përgjigje ndaj materialistëve-ateistëve të cilët e pranojnë ekzistencën e vërtetë të vullnetit:

1. Vullneti i njerëzve ekziston bashkë me këto veti:
 - 1.1 Vetitë e nevojshme për arsye.
 - 1.2 Vetitë e nevojshme për vetëdije dhe vetvete
 - 1.3 Prirja për qëllim jete
 - 1.4 Mundësia për të vepruar kauzalisht
2. Ekzistojnë dy pikëpamje alternative që e shpjegojnë mënyrën se si u shpërfaqën këto veti të vullnetit:
 - 2.1 Nëse materia është tipari i vetëm ekzistencial, siç thonë materialistët-ateistët, atëherë këto veti të vullnetit janë krijuar në mënyrë të rastësishme.
 - 2.2 Nëse ka Zot, siç pretendojnë teistët, atëherë këto veti të vullnetit janë krijuar si rezultat i intervenimit nga ana e një qenie të arsyeshme dhe të vetëdijshme- Zoti.
3. Teizmi i shpjegon më mirë se materializmi-ateizmi këto veti të cilat e mundësojnë vullnetin:
 - 3.1 Për shkak se i shpjegon më mirë vetitë e nevojshme për arsyetim. (U shtjellua në kapitullin e 10-të)
 - 3.2 Për shkak se i shpjegon më mirë karakteristikat e nevojshme për vetëdije dhe vetvete (do të shtjellohet në kapitullin e 12-të)
 - 3.3 Për shkak se e shpjegon më mirë prirjen për qëllim.
 - 3.4 Për shkak se e shpjegon më mirë mundësinë për të vepruar kauzalisht.
4. Si përfundim, teizmi duhet të preferohet para materializmi-ateizmit.

Tani le ta analizojmë argumentin e vullnetit pikë për pikë. Saktësia e pikës së parë të argumentit të paraqitur në fillim të këtij kapitulli, tregoi se ekzistimi i vullnetit është më themelorë se aktivitetet shkencore dhe argumentet filozofike. Prandaj u vunë në pah të gjitha arsyet tjera për të besuar në ekzistimin e vullnetit. Secili prej elementeve në katër pikat, të cilat e bëjnë të mundur ekzistencën e vullnetit, janë kushte të domosdoshme për ekzistencën e vullnetit; kështu që ata që përpiqen ta shpjegojnë se si është shfaqur vullneti, duhet t'i shpjegojnë të gjitha. "Vullneti" i referohet një personi inteligjent dhe të vetëdijshëm që bën një zgjedhje dhe vepron kauzalisht me

zgjedhjen e tij. Për dikë që nuk është në rrjedha të debateve në filozofinë e mendjes, kjo gjë mund t'i duket si një përkufizim i thjeshtë, ndërsa ky përkufizim është mjaftueshëm i gjerë aq sa mund t'i përfshijë edhe debatet më themelore në filozofinë e mendjes. Arsyeja, e cila u shqyrtua në seksionin e mëparshëm dhe karakteristikat e vetëdijes e vetvetes të cilat do të diskutohen në seksionin tjetër janë, natyrisht, brenda këtij përkufizimi, së bashku me të gjitha kushtet e nevojshme që këto karakteristika të ekzistojnë. Këto janë kushtet për ekzistencën e vullnetit, vullneti ka nevojë për to që të ekzistojë, mirëpo nuk janë vetëm këto. Siç do të kuptohet, vullneti është karakteristikë e jona që ka shkaktuar debate më të vështira për sa i përket filozofisë së mendjes. Këtu, do të shqyrtohen dy karakteristika të nevojshme për ekzistencën e vullnetit, të cilat nuk u shtjelluan në dy kapitujt e mëhershëm. E para është qëllimi i vullnetit (1.3 dhe 3.3) dhe e dyta janë karakteristikat e efektit shkakor (1.4 dhe 3.4). Kushdo që e shqyrton historinë e mendimit lehtë mund të dëshmojë për saktësinë e temës së paraqitur në artikullin e dytë. Ateistët e njohur, të cilët kanë dalë në pah gjatë gjithë historisë, dhe shumica dërrmuese e ateistëve të famshëm të kohës sonë janë materialistë-ateistë. Të gjithë këta, e kanë mbrojtur mendimin se shkathtësitë si shikimi, dëgjimi, inteligjenca, dëshira dhe vetëdija në të gjitha gjallesat, janë formuar rastësisht si rezultat i ligjeve të vendosura në vet qeniet. Ka edhe ateistë-materialistë që e mohojnë ekzistencën e vullnetit; prandaj këtu do tu paraqitet argument vetëm atyre që e pranojnë ekzistencën e vullnetit. Pikëpamja kryesore rivale kundër kësaj qasje ka qenë teizmi; sipas këtij këndvështrimi, të gjitha vetitë e universit dhe qenieve të gjalla, siç është çështja e vullnetit, u krijuan falë Zotit, të Plotfuqishëm dhe të Gjithëfuqishëm.

Pika më kritike e këtij argumenti është pika e tretë. Kjo është pika në të cilën ateistët që e pranojnë ekzistencën e vullnetit do të përpiqen ta refuzojnë. Karakteristikat e nevojshme për mendjen u diskutuan në seksionin e mëparshëm (3.1), karakteristikat që ndërlidhen me vetëdijen dhe vetveten do të diskutohen në seksionin tjetër (3.2); sqarimi në ato kapituj se teizmi i shpjegon këto tipare më me sukses sesa ateizmi materialist është pjesë e argumentit të vullnetit që jemi duke e shtjelluar këtu. (shpjegimet e bëra në atë kapitull nuk do të përsëriten këtu) Karakteristikat e "të paturit një orientim të qëllimshëm" dhe "të paturit një efekt shkakor", të cilat janë të nevojshme për ekzistencën e vullnetit do të vlerësohen më poshtë. Kur të del në pah saktësia e pikës së tretë, automatikisht bëhet e qartë se teizmi duhet të preferohet para materializmit-ateizmit, ashtu siç edhe është theksuar në rezultat, që është pika e katërt. Tani do të kaloj në etapën për të shpjeguar se teizmi i tregon më mirë se materializmi-ateizmi çështjet kritike të potencuara në këtë argument.

Vlerësimi i pikës 3.3: Mendja mund të mendojë edhe rreth gjërave të qena, por edhe rreth gjërave të paqena.¹¹³ Një pjesë shumë e madhe e sjelljeve tona të vullnetshme gjatë përditshmërisë, të cilat mund të duken si të thjeshta, relizohen përmes vetisë së “qëllimshmërisë”. Për shembull le ta marrim shembullin e zierjes së çajit: uji për të pirë çaj zihet me qëllimin që të pihet çaji, i cili nuk është prezent. Pastaj, uji i zier përzihet me bimën e çajit, ashtu që çaji të bëhet i gatshëm për tu derdhur në gota të veçanta dhe tu shërbehet njerëzve. Mirëpo para se të ndodhin të gjitha këto, fillimisht, në mendje ekziston qëllimi për të pirë çaj, kurse dukuria e vullnetit vjen pas kësaj. Pra rezultati është përcaktuar si synim që në fillim, kurse shkaqet për realizimin e këtij qëllimi mund të realizohen më pas.

Universi sipas shkencave natyrore funksionon në sajë të proceseve mekanike. Kurse filozofët materialistë-ateistë dhe shkencëtarët thonë se universi dhe ligjet nuk kanë ndonjë zanafillë, prandaj është vështirë të përmendim praninë e ndonjë qëllimi në procesin mekanik të funksionimit të ligjeve. Në këtë qasje, universi është i përbërë prej ligjeve mekanike (që s’kanë qëllim) të cilat funksionojnë brenda për brenda materies që në zanafillë të saj. Sipas filozofëve dhe shkencëtarëve teistë, ekzistenca e këtij universi dhe ligjeve të tij u krijuan bazuar në një qëllim në mendjen e Zotit (në diturinë e Tij), por sipas tyre, vetë këto ligje nuk kanë ndonjë qëllim. Në fund të fundit, për çështjen se ligjet në vetvete nuk kanë qëllim, është diçka për të cilën pothuajse të gjithë shkencëtarët/dijetarët e sotëm janë pajtuar. Kur jemi këtu, le të përpiqemi ta shpjegojmë procesin e zierjes dhe përgatitjes së çajit edhe vetëm nga këndi i ligjeve natyrore, pa iu referuar mendjes. Atëherë, kjo do të na sjellë te përgatitja e çajit vetëm brenda kornizës së funksionimit mekanik të ligjeve. Mirëpo për dallim nga shembulli i parë, ku përgatitjes së çajit i paraprinte një qëllim në mendjen e subjektit, këtu ligjet të cilat marrin pjesë në zierjen e çajit nuk kanë ndonjë qëllim të caktuar. Në këtë proces, uji nxehet falë përçueshmërisë së nxehtësisë nga ana e metalit dhe falë rritjes së energjisë ndërmjet molekulave të ujit; kurse në kuadër të ligjeve të kimisë bëhet përzierja e ujit dhe bimës së çajit, pastaj si rezultat i ligjeve të lëvizjes dhe gravitacionit çaji ndalet në gotë dhe bartet nga një vend në tjetrin. Në një shpjegim të këtillë shkencor, në fillim ndodhin shkaqet, kurse vetë shkaqet ndodhin mekanikisht pa synuar ndonjë rezultat, mirëpo rezultati del

¹¹³ Në kapitullin e vetëdijes dhe vetvetes do të shtjellohet karakteristika e të diskutuarit rreth gjërave të ndryshme. Çështja e shtjelluar këtu bashkë me ndërlidhshmërinë me këtë temë, ka të bëjë edhe me fokusimin në prirjen për “qëllimshmëri”. Mendja mund të mendojë rreth diçkaje edhe pa praninë e prirjes për qëllim. Diskutimi rreth gjërave të ndryshme, si karakteristikë në vete, e përfshin brenda vetes edhe prirjen për qëllim në jetë.

vetvetiu dhe domsdoshmërisht pasi të ndodhin shkaqet. Qëllimi gjatë dëshirës dhe vullnetit për të pirë çaj dhe vet përgatitja e çajit nuk është kontradiktor me këtë shpjegim, por ky shpjegim qëllimor është rrënjësisht i ndryshëm nga shpjegimi mekanik fizik. Pra këto shpjegime nuk janë kontradiktore me njëri tjetrin, por janë të ndryshme. Prej se janë realizuar revolucionet shkencore nga shkencëtarët si Newtoni, Dekarti, Galileo dhe Njutoni (të gjitha këta mbronin idenë se Zoti universin bashkë me ligjet brenda tij i ka krijuar me një qëllim), nuk është parë më në fizikë t'i jipet hapsirë shkaqeve teleologjike. Prej asaj kohe universi është tentuar të kuptohet vetëm në kuadër të shkaqeve mekanike.¹¹⁴ Sidoqoftë, përkundër kësaj tabloje funksionuese mekanikisht të universit të përshkruar nga fizika, ne të gjithë jemi dëshmitarë të veprimeve tona qëllimore. Nëse nuk keni dyshime se këtë libër e lexoni me qëllim të përfitimit të diturive të reja ose se përgatitjen e çajit e bëni me qëllim që të pini çaj, atëherë kjo nënkupton se ju veçse jeni dëshmitarë të ekzistimit të qëllimshmërisë gjatë veprave tona. Kur të hyjmë ta shqyrtojmë kuptimin pasiv të materies në pikëpamjen materialiste-ateiste; askund nuk do të rastisim shenja të kalimit nga procesi mekanik në atë qëllimorë; këtë nuk e rastisim as në ligjet e fizikës të përbrendësuar në materie, as edhe në grimcat më themelore si elektronet dhe kuarkat, të cilat janë përbërëse e materies. Një objekt material afrohet ose largohet nga një objekt tjetër material si rezultat i lëvizjeve të realizuara brenda për brenda ligjeve të fizikës, por përderisa largohet nga një objekt tjetër material, nga ana tjetër nuk afrohet me "qëllimin" e të qëndruarit pranë një tjetri. Megjithatë, të kesh vullnet do të thotë të kryesh veprime të qëllimshme që nuk ndajnë aspak ngjajshmëri me lëvizjet në botën materiale siç përshkruhet në fizikë; sepse ne kur shkojmë pranë një personi me "qëllimin" për të qenë afër me një person, ne kryejmë një veprim vullnetar krejtësisht të ndryshëm nga lëvizjet e bëra nga grimcat ose objektet në natyrën materieve.

Të gjitha këto na lënë të kuptojmë se sa është e pamundur të shpjegohet dhe të kuptohet vetia qëllimore e vullnetit nga pikëpamja materialiste-ateiste. Vetia qëllimore, si diçka që është rrënjësisht e ndryshme nga funksioni mekanik i materies, është veti e ndryshme jo për nga gjendja shkallore, por për nga përmbajtja kuptimore. Ngjajshëm me qëndrimin e treguar në dilemat e kapitullit të kaluar, materialistët-ateistët edhe në këtë kapitull si duket ose vërtet nuk e kanë vërejtur, ose bëhen kinse nuk e kanë vërejtur tërë këtë problematikë. Kurse një numër i

¹¹⁴ Në këtë revolucion, libri i Njutonit i quajtur "Principia" ka luajtur një rol tepër të rëndësishëm; Isaac Newton, **The Principia: Mathematical Principles of Natural Philosophy**, Çev: Bernard Cohen ve diğ., The University of California Press, Berkeley, 1999.

konsiderueshëm i shkencëtarëve dhe filozofëve materialist-ateistë që i kuptuan këto probleme, janë rradhitur në linjën e atyre që e mohojnë ekzistencën e vullnetit. Ky është një shembull shumë i mirë që tregon se sa e madhe është fatura e një materialisti-ateisti, i cili përpiqet të jetë i qëndrueshëm në çështjen e vullnetit. Sipas teizmit, megjithëse krijimi i universit dhe gjallesave ndodhi si rezultat i një procesi të caktuar mekanik, me rëndësi është se "qëllimet" e Zotit u realizuan përmes këtij procesi dhe se funksionimi mekanik i këtij procesi nuk bie në kundërshtim me "qëllimin" e këtij procesi. Sipas teizmit, "qëllimi" në vullnetin e Zotit është një tipar që ka ekzistuar që nga kohërat më të lashta, pra nuk është një tipar derivativ, dhe për këtë arsye nuk ka asnjë problem në paradigmen teiste gjatë shpjegimit të kësaj vetie të nevojshme për veprime vullnetare, kurse nga ana tjetër ekzistojnë probleme të shumta në paradigmen materialiste-ateiste gjatë shpjegimit se si ndodhi kalimi nga procesi mekanik i funksionimit në veprimet qëllimore.

Vlerësimi i pikës 3.4: Kur e marrim biçikletën për të shkuar në një vend me vullnetin tonë, si pasojë, edhe biçikleta, por edhe trupi jonë material e ndryshojnë vendin. “Efekti shkakor vullnetar” shkakton ndryshime të observueshme në univers dhe të gjitha këto ndryshime ne i shohim edhe me sytë tanë. Në fakt fushat shkencore si antropologjia, sociologjia, shkencat politike dhe historia merren gjithmonë me rezultatet e “efektit shkakor vullnetar”. Në pikëpamjen materialiste kauzaliteti funksionon vetëm pasi struktura fizike të ndikojë mbi strukturën fizike. Brenda kësaj qasje filozofike është e pamundur që të zë vend “formimi i efektit shkakor me vullnetin e njeriut”.¹¹⁵ Një pjesë e madhe e materialistëve nocionin “përmbyllje fizike” (“physical closure” ose “completeness of the physical”) e komentojnë si përjashtim të efektit shkakor nga ana e vullnetit. Arsyeja përse ata e bëjnë këtë është se botëkuptimi materialist i materies e kërkon këtë.¹¹⁶

Përveç kësaj, nëse thuhet se gjendjet fizike që janë nën efektin kauzal ndodhin me vullnetin e personit, sipas disave, do të mbrohet pikëpamja e mbipërcaktimit (overdetermination), e cila thotë se më shumë se një shkak çon në një rezultat të vëzhguar në të njëjtën kohë. Meqë sipas një pjese të madhe kanë qenë të papranueshme gjendjet e këtilla mbipërcaktuese, ata kanë shkuar edhe deri te refuzimi i vërtetësisë së vullnetit. Shkaqet e cekura në fillim të këtij kapitulli në lidhje me atë se përse duhet të besojmë në ekzistencën e vullnetit, janë përgjigje ndaj atyre që

¹¹⁵ John Bishop, **Natural Agency**, Cambridge University Press, Cambridge, 1989, f. 40.

¹¹⁶ Kim Jaegwon, **Mind in a Physical World**, CMIT Press, Massachusetts, 1998.

thonë se vullneti nuk mund të ketë vend në qasjen materialiste. Tregimi i ekzistencës së vullnetit nënkupton që vullneti ka një efekt kauzal, kurse kjo na le të kuptojmë se botëkuptimi materialist i qasjes materialiste-ateiste është i gabuar.

Për një materialist, përveç ndikimit të mendjes në materie, një tjetër problem i madh lind atëherë kur një gjendje e vullnetit (dmth. Gjendja e mendjes) në mendjen tonë shkakton një gjendje tjetër të mendjes. Le të mendojmë pakës rreth vullnetit për të ngasur biçikletë, si një forcë që shkakton blerjen e biçikletës në mendjen tonë. Këtu, derisa gjendja e parë e shkakton gjendjen tjetër, arsyeja që është parakushti i vullnetit menjëherë fillon të funksionojë, kurse arsyetimi nënkupton edhe aktivizimin e rregullave të logjikës. Mirëpo në thelb ligjet e logjikës janë krejtësisht të ndryshme prej ligjeve të fizikës; përcaktimi logjik nuk mund të reduktohet në përcaktimin fizik. Për shembull le t'i supozojmë dy fjali : “Macet kanë katër këmbë” dhe “ Sable është mace”. Vetëm duke u bazuar në këto fjali dhe duke arsyetuar ne mund të konkludojmë se Sable i ka katër këmbë. Në çdo univers të mundshëm, nëse dy supozimet e paraprahe janë të sakta, atëherë saktësia e pikës së tretë vijon logjikisht. Derisa në këtë univers janë të vlefshme këto ligje të fizikës, në ndonjë univers tjetër logjikisht mundet të ekzistojnë ligje tjera të fizikës. Ekziston një dallim ontologjik shumë serioz mes ligjeve të logjikës dhe fizikës. Si pasojë, për tu realizuar efekti shkakor i vullnetit duhet të përdoret arsyeja gjatë përcaktimit të një gjendjeje mendore nga një tjetër. Mirëpo kur e bëjmë reduktimin e mendjes në struktura biologjike të trurit, ballafaqohemi me një qorrsokak sikur në rastin e reduktimit të logjikës në dukuri fiziko-biologjike. Pavarësisht se sa komplekse janë strukturat biologjike brenda qelizës, ato në esencë nuk ndajnë ndonjë strukturë fizike të ndryshme nga përplasja e topave të bilardos. Është e paimagjinueshme që përplasja e dy topave të bilardos të shkaktojë formimin e një rregulli logjik ose e një fjalie të kuptimtë; prandaj është larg logjikës dhe të kuptuarit të duhur që të mendohet se arsyetimi është formuar si rezultat i dukurive fizike në mendjen e njeriut, e jo si rezultat i rregullave logjike dhe dhënies së kuptimeve nga ana jonë. Siç mund të shihet, përveç sqarimit të efektit të vullnetit në botën materiale, përcaktimi i gjendjeve mendore nga gjendjet tjera mendore, i cili është një kusht i domosdoshëm për veprim vullnetar, gjithashtu paraqet problem serioz brenda qasjes materialiste. Me ta kuptuar këtë, shumë materialist-ateistë mohuan ndikimin kauzal përmes vetëdijes (p.sh. ekzistencën e vullnetit); të cilët ndryshe quhen edhe si epifenomenalistë.¹¹⁷ Në epifenomenalizëm,

¹¹⁷ Një shembull nga mbrojtja e epifenomalizmit: Daniel Wegner, **The Illusion of Conscious Will**, MIT Press, Cambridge, 2002

vetëdija shihet si produkt anësorë i proceseve fizike të zhvilluara në tru, prandaj pretendohet se materia e ka sjellur në ekzistencë dukurinë e vetëdijes. Mirëpo nëse materia mundka të ketë efekt saqë të jetë në gjendje ta sjellë në pah edhe vetëdijen; atëherë si mund të themi se vetëdija nuk mund të ketë efekt mbi materien, pra se nuk ekziston veprimi vullnetar? Si mund të thuhet kjo pas tërë kësaj dëshmie të brendshme?

Ata që e mohojnë ekzistencën e vërtetë të vullnetit, do të detyrohen të deklarojnë se vetëdija është një epifenomen ose një produkt anësorë pa efekt shkakor në proces. Ata që deklarojnë kështu do të dalin në mbrojtje të vetëdijes, si diçka që është formuar si rezultat i proceseve të rastësishme gjatë evolucionit. Mirëpo sipas teorisë së evolucionit, karakteristikat që sigurojnë avantazh për gjallesat përzgjedhen, kurse ato që nuk sigurojnë avantazh eliminohen. Nëse personi i vetëdijshëm nuk ka vullnet, atëherë ai nuk mund të formojë efekt shkakor në univers, kështu që vetëdija nuk është diçka që përgjedhet nëpërmjet selekcionimit natyror, sepse nuk sjell avantazh ekzistimi i vetëdijes që nuk sjell efekt shkakor. Nga ana tjetër, mund të ketë nga ata që thonë se vetëdija - jo e përzgjedhur nga selekcionimi natyrorë - është një nënprodukt i evolucionit. Mirëpo përkufizimi i vetëdijes përmes selekcionimit natyror si një “nënprodukt” mesa duket është një marrëzi e nivelit shumë të lartë. Epifenomenalizmi (mohimi i efektit shkakor të vullnetit) është një pozicion që nuk mund të justifikohet për shumë arsye të tjera të rëndësishme: Të pranosh këtë pozicion do të thotë që administratën shtetërore të Perandorisë Osmane, kompozicionet e Mozartit, prodhimin e celularëve e të fabrikave t’i shohësh si ngjarje fizike njëjtë siç është rrotullimi i botës (t’i shohësh si diçka që vullneti njerëzor nuk ka asnjë kontribut); por ky është një çmim i shtrenjtë që duhet të paguhet nga ana e atyre që e refuzojnë efektin shkakor. Gjithashtu, për ata që e mohojnë ekzistencën e vullnetit janë të pakuptimtë edhe vrasësit serik, edhe gjenocidet në Srebrenicë. Nëse edhe gjenocidin nuk arrijmë dot ta dallojmë prej përplasjes së topave të bilardos, a thua vallë çfarë tjetër duhet të ndëshkojmë dhe dënojmë? (Bazuar në përvojën time personale, mund të them se shumica e atyre që mbrojnë se vullneti nuk ka efekt shkakor nuk i kuptojnë pasojat logjike të pikëpamjeve të tyre.) Ata të cilët e përbrendësojnë pikëpamjen materialiste-ateiste nuk është se i kanë përzgjedhur këto nga të qenit kundër mendimit të mirë, mirëpo ontologjia që kanë përzgjedhur i ka detyruar të ndërmarrin një qëndrim të këtillë. Kjo gjë ka shkuar aq larg, saqë pa qenë të vetëdijshëm se në çfarë lumi janë duke lundruar, shpeshherë u ndodhë t’i refuzojnë vendimet dhe përzgjedhjet e tyre personale, të cilat besojnë se i kanë preferuar me dëshirën e tyre.

Sipas teizmit vullneti është prej karakteristikave më të rëndësishme të Zotit. Zoti gjallesat dhe universin i ka krijuar falë kësaj vetie të kahmotshme. Edhe pse kjo veçori te njeriu ndodhet në sasi të vogla, përsëri nuk është e paktë. Pritshmëria e materialistëve-atelistëve është që krijesat e shfaqura nga bashkimi i llojllojshëm i materies, të tregojë veçori të ngjajshme me botëkuptimin e materies në imagjinatën e tyre. Mirëpo përkundër kësaj, ekzistenca e vullnetit nuk është aspak e përputhshme me këtë pritshmëri, e kur jemi te teistët, kjo nuk shfaq ndonjë problem serioz. Mbi të gjitha, për një teist është më lehtë pranimi i një modeli në të cilin vullneti ndikon mbi materien, pra një model në të cilin vullneti i Zotit e ka krijuar universin. Zoti, me t’i dhënë njeriut veti përtej materiale (dualizëm), me shumë gjasa këtë veçori e ka bërë pjesë të brendshme të materies. Prandaj, një teist mund ta pranojë këtë edhe pa pasur nevojë ta mbrojë dualizmin. Kur të vjen materia në një formë të caktuar, është e mundur formimi i sistemit në të cilin shfaqet vullneti brenda për brenda materies. Teizmi, si pikëpamje që e konsideron materien si një substancë që i bindet dëshirave të Zotit, nuk ka ndonjë vështirësi në shpjegimin e botëkuptimit të materies e cila ofron surpriza kaq të vlefshme.

Me pak fjalë, vullneti është një prej cilësive tona më të rëndësishme, e cila i jep kuptimësi qenies njerëzore dhe me të cilën vazhdimisht ballafaqohemi.

Në këtë pjesë të librit, sëpari u diskutua pse duhet të besojmë në ekzistencën e vullnetit, kurse pastaj u shtjellua kjo çështje edhe nga këndvështrimi i zanafillës së vullnetit. Si gjithmonë, u përpoqëm t’i paraqesim argumentet tona, përmes të cilave mendojmë se teizmi është më i suksesshëm sesa materializmi-atelizmi në shpjegimin e këtyre fenomeneve. Të mos harrojmë për kushtet paraprake dhe pas, të cilat janë të domosdoshme kur flasim për këtë çështje. Theksuam se teizmi është më i suksesshëm se materializmi-atelizmi në shpjegimin e “prirjes për qëllim” dhe “veprimit me efekt shkakor”. Diskutuam gjërë e gjatë rreth pikës së tretë të këtij argumenti si një prej pikave më kritike. Saktësia e pikës së tretë të këtij argumenti në mënyrë automatike na dërgoi te konkluzioni se “teizmi është më i suksesshëm se materializmi-atelizmi”.

NËNKAPITULLI I DYMBËDHJETË
ARGUMENTE NGA VETËDIJA DHE VETVETJA (XII)

XII

Argumente nga vetëdija dhe vetvetja

Vetëdija dhe vetvetja janë vetitë më fundamentale të cilat na definojnë neve; asnjë individ në botë nuk mund të ekzistojë pa to. Shumë mendimtarë e konsiderojnë vetëdijen dhe vetveten si fenomenin më të rëndësishëm në univers. Vetëdija është formuar nga gjendja e të qenit i vetëdijshëm për perceptimet, ndjenjat dhe gjithçka e ndërlidhur me mendimet, reale ose imagjinare. Të gjitha llojet e vetëdijes (shikimi, dëgjimi, dhimbja, ndjenja e të ftohurit, imagjinimi etc), për praninë e të cilave jemi dëshmitarë nga zgjimi në mëngjes e deri në kohën e gjumit, si dhe ëndërrimi gjatë gjumit, janë tërësisht gjendje të ndryshme të vetëdijeve. Asnjë gjendje e vetëdijes nuk mund të mendohet se ekziston pa i përkatur një personi të caktuar (vetvetes). Gjendjet tona mendore dhjetë vjet më parë, dhjetë ditë më parë, dhjetë minuta më parë, dhjetë sekonda më parë ose pikërisht në këtë moment do të kenë një kuptim vetëm nëse i përkasin një "vetvete" (një vetvete ekzistenca e së cilës vazhdon pavarësisht ndryshimit të kohës dhe materialit në trup) i cili i posedon ato. Në të vërtetë, definimi i "vetvetes" si një veti duhet të konsiderohet thjesht një metaforë; sepse "vetvetja" korrespondon me "Un-in", i cili i përfshinë të gjitha vetitë tona. Vetëdija dhe vetvetja gjithashtu mund të vlerësohen veçmas, por meqenëse 'vetvetja' pa vetëdije - dhe vetëdija pa një 'vetvete' të caktuar - janë të pamundura, ne do t'i konsiderojmë ato së bashku si një pjesë integrale gjatë argumentit tonë. Këto elemente, të cilat formojnë bazën e ekzistencës sonë dhe të cilat na bëjnë të aftë të kuptojmë të gjithë ekzistencën ndaras prej vetvetes, përbëjnë tema të nxehta diskutimesh në shumë disiplina, veçanërisht në filozofi, teologji, psikologji, neurologji dhe shkencat njohëse. Vlen të përmendet që vetitë e tilla themelore, të cilat i bëjnë të mundshme të gjitha përvojat tona, janë tema të diskutimeve të thella. Vetitë themelore të arsyes dhe vullnetit, të cilat i kemi shtjelluar në kapitujt e mëparshëm, janë gjithashtu veti që mund të ekzistojnë vetëm në prani të vetëdijes dhe vetvetes. Për shembull, imagjinoni se kemi aftësinë për ta ndjerë të ftohtin, por jo edhe aftësinë për të arsyetuar ose për të dëshiruar; në këtë situatë fiktive, edhe pse nuk mund ta përdorim arsyen ose vullnetin, ekziston ende një "vetvete e vetëdijshme" që e ndjen të ftohtin. Me fjalë të tjera, vetëdija dhe vetvetja mund të imagjinohen edhe pa qenë e nevojshme prania e

arsyes dhe vullnetit, por nuk duhet të harrojmë se çdo gjendje e arsyes dhe vullnetit kërkon një "person të vetëdijshëm". Asnjë lloj arsyetimi ose veprimi i vullnetshëm nuk është i mundur pa qenë i vetëdijshëm ose pa i përkitur dikujt. Vetëdija dhe vetvetja ishin parakushte të fenomenit të arsyetimit dhe të vullnetit, mbi të cilat u diskutua në kapitujt 10 dhe 11. Si rezultat, argumentet e paraqitura këtu gjithashtu në thelb janë pjesë e atyre të paraqitura në kapitujt e lartpërmendur. Vetëdija dhe vetvetja janë më thelbësore se të gjitha vetitë tjera të lindura të natyrës sonë, për të cilat kemi diskutuar më parë. Vetëdija dhe vetvetja mund të mendohen pa vetitë e mësipërme, por vetitë e mësipërme nuk mund të mendohen pa vetëdijen dhe vetveten. Sa i përket aspekteve tjera të renditura në kapitullin "argumente nga natyra njerëzore" të këtij libri, megjithë rolin e tyre shumë themelor për ne, shumica prej nesh nuk kursejmë shumë kohë për të reflektuar mbi vetëdijen dhe vetveten. Posedimi i këtyre vetive që nga lindja nuk e ul rëndësinë e tyre. Përkundrazi, posedimi i këtyre elementeve më të mrekullueshëm në univers pa treguar ndonjë përpjekje serioze nga ana jonë, meriton një vëmendje dhe reflektim të veçantë. Pyetja më themelore kur meditojmë mbi këto veti është "Si u bë që këto veti të jenë në pronësinë tonë?" Këtu, ne do të mbrojmë një argument që tregon se përse teizmi e shpjegon më mirë këtë çështje. Le ta paraqesim argumentin:

1. Te njerëzit vetëdija dhe vetvetja shkojnë bashkë me vetitë e mëposhtme:
 - 1.1 Qëllimshmëria
 - 1.2 Subjektiviteti dhe qualia
 - 1.3 Uniteti/tërësia
2. Ne i mbrojmë dy shpjegime themelore në lidhje me vetëdijen dhe vetveten:
 - 2.1 Sipas materialistë-atheistëve, vetëdija dhe vetvetja formohen prej proceseve të rastësishme të dirigjuara nga ligjet e natyrës.
 - 2.2 Sipas teistëve, vetëdija dhe vetvetja janë krijuar nga Zoti, i cili gjithashtu posedon të njëjtat veti.
3. Teizmi e shpjegon vetëdijen dhe vetveten më mirë sesa materializmi-atheizmi, sepse:
 - 3.1 E shpjegon më mirë vetinë e qëllimshmërisë (intentionality)
 - 3.2 E shpjegon më mirë vetinë e subjektivitetit dhe qualia.
 - 3.3 E shpjegon më mirë vetinë e unitetit/tërësisë.
4. Si rezultat, teizmi duhet të preferohet para materializmit-atheizmit.

Sëpari le ta shtjellojmë çështjen e parë të argumentit. Edhe pse vetëdija është tërësisht e pranishme te të gjithë ne, disa materialistë-ateistë e refuzojnë ekzistencën e vetëdijes dhe vetvetes. Prandaj, ata nuk do të dakordohen me këtë pikë. Këta materialistë-ateistë thonë se është e pamundur të kalohet nga vetitë e materies në vetitë rrënjësisht të ndryshme të mendjes (arsyeja, vullneti, vetëdija, vetvetja). Madje të tjerët ose e kanë lënë pas dore ose e kanë neglizhuar këtë problem. Ata të cilët e kuptojnë këtë problem përpiqen ta zgjidhin atë duke i hedhur poshtë kategorikisht (duke eliminuar) të gjitha vetitë e përmendura të mendjes, të cilat nuk mund të përshkruhen nga vetitë e materies; të tillëve u thonë "materialistë eliminativë". ¹¹⁸ Kjo situatë tregon çmimin e shtrenjtë që një materialist-ateist duhet të paguajë për të qëndruar i qëndrueshëm në vetvete. Kushtoni vëmendje faktit se ajo që refuzohet këtu është përvoja jonë më evidente; madje vetëdija jonë është edhe më evidente sesa ekuacionet si " $2 + 2 = 4$ " ose fjalitë "Të gjithë njerëzit kanë një zemër", sepse të vërtetat e këtyre ekuacioneve dhe fjalive nuk mund të thuhet pa qenë në vetëdije. Nëse për momentin nuk keni dyshime se jeni duke menduar rreth këtij libri, atëherë i bie që nuk keni dyshime as edhe për lajthitjen e materializmit eliminativ. Arsyeja kryesore pse filozofët dhe shkencëtarët materialistë-ateistë si Patricia dhe Paul Churchland përpiqen ta mbrojnë materializmin eliminativ, është se ata tentojnë të krijojnë një ontologji pa e humbur besnikërinë e tyre ndaj paradigmës materialiste. ¹¹⁹ Sipas kësaj ontologjie, gjithçka në univers është formuar nga ndërveprimet mekanike të materies, kështu që brenda gjithë kësaj nuk ka ndonjë vend për vetëdijen dhe vetveten, pasi ato nuk i ngjajnë vetive të materies. Megjithatë, brendësia jonë është dëshmitari më i mirë për praninë e këtyre gjendjeve mendore, të cilat janë më se të dukshme. Edhe nëse për një moment mund të ndodhë që ta pranojmë si iluzion mendimin tonë për leximin e këtij libri dhe meqenëse iluzioni në vetvete është një gjendje e vetëdijes, ekzistenca e tij nuk mund të mohohet (eliminohet). Pavarësisht se çfarë bëjmë, është e pamundur ta mohojmë ekzistencën e vetëdijes. Gjendjet tona të vetëdijes janë më thelbësore se çdo gjë tjetër në univers; ne dimë gjithçka tjetër në univers falë vetëdijes sonë. Madje edhe përpjekja për ta refuzuar vetëdijen është e mundur vetëm nëse refuzuesi është i vetëdijshëm (kjo situatë është e ngjajshme me argumentin për ekzistencën e vullnetit, për të cilën u diskutua në kapitullin paraprak.) Një person që përpiqet të pretendojë diçka, në fakt a-priori supozon se ai dhe audienca e tij janë të vetëdijshëm; përndryshe,

¹¹⁸ Për më shumë rreth materializmit eliminativ, shiko: Ramsey, William, "**Eliminative Materialism**", The Stanford Encyclopedia of Philosophy (Summer 2013 Edition), Edward N. Zalta (ed.), URL = <https://plato.stanford.edu/archives/sum2013/entries/>

¹¹⁹ Për shembull, shiko: Paul Churchland, **Matter and Consciousness**, MIT Press, Cambridge, Mass. , 1999.

ai do të duhej t'i konsideronte fjalët e dalura nga goja e tij si pasojë e lëvizjeve të pavetëdijshme mekanike, njëjtë siç përplasen topat e bilardove. Është e pamundur t'i imagjinojmë lëvizjet e pavetëdijshme mekanike si pretendime. Për më tepër, nëse pretenduesi nuk e konsideron veten dhe audiencën e tij si "persona" (që janë vetja) dhe meqenëse pretendimi nuk i përket "dikujt" dhe nuk përdoret kundër "dikujt", atëherë ideja e "pretendimit" bëhet e pakuptimtë. Është e pamundur të ketë vullnet pa vetëdije dhe vetvete, por është i mundur imagjinimi i personit të vetëdijshëm pa vullnet. Për shembull, mund të bëhet imagjinimi i një personi që imagjiron vetëm për ngjyrën e kaltërt, por i cili nuk është në gjendje të bëjë ndonjë veprim vullnetar; mirëpo është e pamundur të mendosh që një person i cili e merr gotën e çajit për një gllënkë, ta bëjë këtë pa vetëdije dhe pa qenë vetvetja. Meqë ekzistenca e çdo vullneti tregon ekzistencën e vetëdijes dhe vetvetes në mënyrë absolute, përveç argumentit të mëparshëm (në Kapitullin e 11) që favorizon ekzistencën e vullnetit, diskutimet në kapitullin paraprak rreth dështimit të epifenomenalizmit janë mjaftueshëm dhe njëjtë të vlefshme për të treguar dështimin e materializmit eliminativ. Le të mos harrojmë, se nëse mohohet ekzistenca e vullnetit (rrjedhimisht vetëdija dhe vetvetja) dhe nëse efekti shkakor i njeriut në natyrë bëhet i pamundur, të gjitha proceset edukative, mësimet historike rreth veprave njerëzore dhe zhvillimeve teorike e teknologjike të shkencëtarëve bëhen të pakuptimta. Mund të them lehtësisht se materializmi eliminativ është një nga dështimet më të mëdha në historinë e filozofisë, kjo për arsye se ai hedh poshtë elementin më të dukshëm të mundshëm dhe sjell në pah një sasi të lartë të mospërputhjeve. Një lloj i këtillë i materializmit-ateizmit, me shqetësimin e vetëm, që është qëndrimi në mënyrë fanatike në vetvete, është vërtetë i "pakontradiktë".

Lidhur me çështjen e dytë në argument, pra në lidhje me historinë e filozofisë, dy alternativa kryesore shihen si kandidatë për të shpjeguar shfaqjen e vetëdijes dhe vetvetes. Vetëm filozofitë gjithëpërfshirëse ndaj gjenezës së jetës mund ta sqarojnë vetëdijen dhe vetveten. Sipas materializmit-ateizmit, pasi u shfaq jeta rastësisht nga proceset dhe ligjet e natyrshme, pas saj, nga po të njëjtat ligje natyrore, u formua edhe vetëdija dhe vetvetja. Nga ana tjetër, sipas teizmiz Zoti është Krijuesi i universit dhe jetës, Ai posedon vetëdije dhe vetvete dhe pastaj të gjitha këto veçori të Vetes ia dhuroi edhe njeriut (dhe qenieve tjera). Edhe pse këto veçori janë shfaqur prej proceseve

të caktuara, ato nuk janë të rastësishme, por rezultate të planit të Zotit.¹²⁰ Kurse agnostikët, në përgjithësi, preferojnë të mos paraqesin një argument më tjetër nga këto dy; përkundrazi, ata pretendojnë se e vërteta është e panjohur. Prandaj, prova për pavërtetësinë e filozofisë materialiste-ateiste është gjithashtu përgjigje ndaj agnosticizmit.

Çështja më thelbësore e argumentit që po shtjellojmë është pika e tretë. Edhe nëse disa ateistë-materialistë (materialistët eliminativë) mund ta kundërshtojnë pretendimin e artikullit të parë, përqëndrimi aktual i shumicës së ateistëve materialistë do të jetë mbi pikën e tretë. Prandaj, ne do ta sqarojmë veç e veç secilën pikë të këtij artikulli. Në diskutimin tonë, për të shpjeguar vetëdijen dhe vetveten ne gjithashtu do të kalojmë nëpër disa qasje filozofike më të shquara.

Vlerësimi i pikës 3.1: Një kusht paraprak i vetëdijes është aftësia për të menduar rreth diçkaje (aboutness) dhe për tu orientuar mendërisht drejt asaj gjëje (qëllimshmëria). Të gjithë njerëzit e kanë këtë aftësi, nga më inteligjenti e deri te më injoranti. Si mund ta kryejmë veprimin e leximit të këtij libri nëse nuk do të mund të mendonim "për" thëniet e tij dhe mendërisht ta "synojmë" leximin e tij? Aftësia për të menduar "rreth" diçkaje me "qëllim të caktuar" është si çimentoja. Tullat dhe pllakat e rezultateve të vetëdijes sonë (arsyetimi ynë, veprimet e vullnetshme, imagjinatat etj.), pra, vetëm këto nuk janë të mjaftueshme për të ndërtuar një shtëpi, por një shtëpi nuk mund të ndërtohet pa to. Një kopshtar kur përdor makinë për prejrjen e barit, ai vetë mund të mendojë rreth lëndinës, kurse makina është ajo që nuk mund të mendojë; ose një rojtar që pastron pluhurin nga Deep Blue mendon mbi këtë super kompjuter, por kjo makinë nuk mendon mbi lojën e shahut. Është e mundur të tregohet mënyra se si instalimi mekanik i makinës e bën prejen e barit dhe në të njëjtën mënyrë, edhe pse me më shumë komplikime, është e mundur të tregohet mënyra funksionale mekanike se si realizohet loja e shahut brenda kompjuterit. Neve nuk na ka ndodhur dhe as nuk do të na ndodhë ndonjëherë që të mendojmë për diçka tjetër përveç se në mendje. Bisedimi rreth kompjuterëve na përkujton filozofinë e funksionalizmit si një prej pikëpamjeve më të shquara në historinë e njerëzimit. Funksionalizmi merret me mendjen, jo me vetitë e blloqeve të saja ndërtuese, por me funksionet e saja, ose me rolin që ajo luan në sistemin ekzistues dhe me efektet e saja shkakësore. Bazuar në argumentet e funksionalistëve, disa filozofë pretendojnë se mendja është e ngjashme me një kompjuter dhe se edhe inteligjenca artificiale mund të tregojë

¹²⁰ Atributi "al-Hajj" i Zotit në Kuran e konstaton vetëdijen e Tij (Sureja El-Bekare 2-255); si dhe deklarata "(Zoti) Ai" (Sureja El-En'am, 6-54) e konstaton "Veten" e Tij.

vetëdije. Padyshim, kompjuterët mund të imitojnë shumë pjesë të sjelljeve njerëzore; madje ato mund të kryejnë funksione në mënyrë shumë më superiore, por kjo nuk do të thotë që kompjuterët kanë vetëdije dhe ndjenjë të vetvetes.

Eksperimenti i famshëm i mendimit “Dhoma Kineze”, e bërë nga John Searle, është demonstrim shumë i mirë. Searle e fillon eksperimentin e tij të mendimit duke imagjinuar për dikë që nuk di kinezisht dhe është i mbyllur në një dhomë. Pastaj, këtij personi i jepet një letër e shkruar me shkronja kineze dhe kërkohet prej tij t’i gjejë homologët e karaktereve të letrës brenda një libri tjetër në dhomë, të shkruar gjithashtu në kinezisht. Pasi t’i gjejë shkronjat, ai duhet t’i shkruajë ato në një letër dhe ta dërgojë letrën jashtë. Sa i përket letrës, aty mbase mund të ketë pyetje të ndryshme të shkruara në kinezisht, kurse te libri mund të jenë të shkruara përgjigjet e mundshme ndaj atyre pyetjeve. Personi në fjalë, vetëm duke i ndjekur udhëzimet mund t’i gjejë përgjigjet ose të përgjigjet; mirëpo kjo nuk nënkupton se ai e din kinezishten. Një observues i jashtëm, i cili nuk ka informacione paraprake për ekzistencën e udhëzimeve, do të mendonte se personi në fjalë e din edhe kinezishten, por edhe përgjigjet e pyetjeve. Thënë me fjalë të tjera, observuesi nga jashtë personin i cili e kryen këtë funksion nuk do ta dallonte nga një person tjetër që e din kinezishten. Pavarësisht saktësisë së përgjigjeve dhe diturisë së tij mbi kinezishten, personi në fjalë në çdo rast bën ndryshime të mëdha, e kjo është ajo që funksionalizmi nuk mundet ta shohë. Edhe funksionimi i kompjuterëve mund të konsiderohet i ngjajshëm. Kompjuterët gjatë përpunimit të informacioneve në përputhje me udhëzimet e dhëna, nuk janë të vetëdijshëm se çfarë vepre janë duke kryer.¹²¹ Edhe kur një kompjuter kryen saktësisht të njëjtin funksion si një njeri, përsëri ekziston një ndryshim kritik cilësor midis të dyve. Kompjuteri kurrë nuk mund të mendojë "në lidhje me" diçka ose të "synojë" të bëjë një veprim; për këtë arsye, është e pamundur që inteligjenca artificiale të realizojë/përvetësojë vetëdijen dhe vetveten e njerëzve. William Hasker në lidhje me këtë ka thënë : “ Kompjuteri, me fjalë të tjera, është thjesht një degëzim i racionalitetit të dizajnuesve dhe përdoruesve të tij; është burim i pavarur i depërtimit racional, aq sa është televizioni burim i pavarur i lajmeve dhe programeve argëtuese.”¹²²

Vlen të përmendet këtu "bihevizorizmi" si një qasje tjetër filozofike që përdoret për ta përshkruar vetëdijen dhe vetveten. Sot edhe pse nuk është pikëpamje e famshme mes

¹²¹ John R. Searle, **Minds, Brains and Science**, Harvard University Press, Massachusetts, 1985.

¹²² William Hasker, **Metaphysics**, InterVarsity Press, Downer’s Grove, 1983, f.49

materialistëve-ateistëve, dikur kjo ka qenë mjaft ndikuese.¹²³ Metodologjia e bihejviorizmit injoron subjektiven dhe merr parasysh vetëm "manifestimet e dukshme të vetëdijes". Për shembull, le ta mendojmë një njeri i cili është duke buzëqeshur dhe lexuar libër; në këtë pikëpamje përveç gjërave që shohim nga jashtë, ndjenjat subjektive brenda mendjes (si lumturia dhe dëshira) dhe elementet tjera ndaj të cilave dëshmon edhe vet brendësia jonë (siç është "mendimi" rreth libri; "synimi" për ta lexuar), nuk janë gjëra që merren në konsideratë. Edhe kjo është një qasje reduktuese ndaj vetëdijes, mirëpo këtu nuk kemi reduktim në nivel nervor, por në nivel të lëvizjeve trupore. Megjithatë, nuk duhet të harrohet se njeriu mund të qajë pa pasur dhimbje reale dhe gjithashtu mund të buzëqeshë pa qenë me të vërtetë i lumtur.¹²⁴ Atëherë kjo nënkupton që metodologjia bihejvioriste nuk mund ta bëjë dallimin mes dikujt që vërtetë ka dhimbje dhe dikujt që është duke u tallur. Kjo është e mjaftueshme për të na bërë me dije se kjo pikëpamje nuk është në gjendje t'i vlerësojë siç duhet vetitë e mendjes. Ende më keq, meqë bihejviorizmi e anashkalon "subjektivitetin" dhe "qëllimshmërinë" e mendjes, ai jo vetëm që i vlerëson gabim gjendjet e mendjes, por edhe e ngatërron vetëdijen me pavetëdijen. Imagjinojeni një robot në formë të njeriut, në të cilin janë instaluar zërat e njerëzve. Kur të guduliset ai fillon të qeshë, ndërsa kur të goditet fillon të qajë. Në këtë rast një bihejviorist nuk do ta bënte dallimin mes reagimit të vetëdijshëm të një njeriu dhe të një roboti në formë të njeriut. Ky shembull tregon se një njeri dhe një robot mund të manifestojnë sjellje krejtësisht identike në dukje, mirëpo kjo nuk nënkupton kuptim dhe përkapje thelbësore e çështjes në fjalë; ngase bihejviorizmi këtu dështon në kuptimin e dallimit rrënjësor (të qenit i vetëdijshëm ose jo) midis këtyre sjelljeve. Të gjitha këto na tregojnë se është e pamundur për bihejviorizmin ta kuptojë mendjen.

Le të përqendrohemi dhe le të reflektojmë mbi panoramën e materies të paraqitur nga fizika moderne: ekzistojnë grimca fundamentale siç janë elektronet dhe kuarkat; neutronet dhe protonet përbëhen nga kuarkat, kurse atomet përbëhet nga të gjitha këto. Protonet gjithmonë janë të ngarkuara me energji të njejtë dhe në këtë mënyrë e shtyjnë njëri tjetrin. Brenda bërthamës forcat e fuqishme nukleare i mbajnë ato të ngjitura. Kombinimet e protoneve dhe neutroneve në numra të ndryshëm formojnë tabelën periodike të elementeve dhe rrjedhimisht kiminë. Më pas kombinimet e ndryshme të atomeve formojnë detëra, karrige, kompjuterë, molekula të ndryshme

¹²³ Libri në vijim i Skinner-it, një behaviorist i spikatur, është burim i mirë rreth kësaj perspektive: B.F. Skinner, **About Behaviorism**, Vintage Books Edition, New York, 1976

¹²⁴ Ian Barbour, **Issues In Science And Religion**, Harper And Row Publishers, New York, 1971, f. 353-354.

organike dhe materiale gjenetike (siç është ADN). Si rezultat, fenomenet në univers formohen përmes grimcave dhe forcave themelore. Siç e shohim, të gjitha këto ndërveprime ndodhin në kuadër të ligjeve mekanike dhe këtu nuk rastisim askund në ndonjë gjurmë të qëllimshmërisë. Pa marrë parasysh komplikueshmërisë së ndërveprimit mes atomeve, me këtë qasje është e pamundur të kuptohet mënyra se si u shfaq qëllimshmëria. Krahas çështjes jo-intelektuale, jo të vullnetshme, jo të vetëdijshme të ateizmit materialist, teizmi ka Zotin intelektual, të vullnetshëm, të vetëdijshëm si Krijues të universit. Zoti mendon “rreth” krijesave të tij dhe realizon sipas “synimeve” të Tij. Në paradigmen teiste, këto veti janë të përjetshme (ato kanë ekzistuar edhe para se të ekzistonte universi) dhe krijimi i universit është i mundur përmes tyre. Nuk duhet të ketë vështirësi për të kuptuar se Zoti, si zotërues i niveleve absolute të këtyre vetive, u dha krijesave të Tij versione të nivelit më të ulët. Si rezultat, shfaqja e “qëllimshmërisë” që e bën të mundur vetëdijen (si dhe arsyen dhe vullnetin), është e pashpjegueshme në materializëm-ateizëm, ndërsa nga ana tjetër teizmi përfaqëson një pikëpamje ontologjike gjithëpërfshirëse që i shpjegon të gjitha këto çështje.

Vlerësimi i pikës 3.2: Subjektiviteti është një tjetër tipar i gjendjeve mendore; ai e përshkruan posedimin e gjendjes së vetëdijshme nga ana e “vetvetes” dhe gjithashtu, e përshkruan kyçjen/qasjen e veçantë të “vetvetes” në gjendjet e vetëdijes. Kurse Qualia përfshinë eksperiencat subjektive të vetëdijes të cilat rastisen nga vetvetja. Asnjë ekzistencë materiale në univers nuk përjeton “subjektivitet” dhe “qualia”, përveç personave me vetëdije. (njerëzit dhe ndoshta disa qenie tjera).

Një njeri i vetëdijshëm që lexon libër, krijon një perceptim mbi ndjenjat e perceptimit dhe mbi kuptimin e librit në botën e tij ose të saj subjektive, kurse ngazëllimet e shkaktuara prej imazheve të perceptuara në libër përshkruhen nga Qualia. Ndër vetitë kritike të vetëdijes që e dallojnë atë nga universi material (atomet, yjet, kompjuterët, çekanët, librat ...) janë : "subjektiviteti" i vetëdijes, pra eksperiencia jonë për gjendjet e vetëdijes brenda për brenda "Vetvetes" (përmes introspektivës) dhe perceptimi e ‘qualias’ përmes gjendjeve mendore. Megjithatë, ende nuk ka ndonjë ide për të menduar rreth ekzistencës së “Vetvetes” në atome, yje, kompjuterë ose libra, madje as nuk kemi mundësi ta dëshmojmë subjektivitetin e tyre. Kjo është arsyeja pse nuk mendojmë se shkatërrojmë një “person” kur ta hedhim në plehra një kompjuter. Sikur të mos kishin njohuri materialistët-ateistët për zbulimet dhe vlerësimet aktuale, a thua vallë cilën prej qasjeve filozofike do ta gjenin më të përputhshme me qasjen e tyre për shpjegimin e

vetëdijes dhe vetvetes? Me shumë qetësi do të thoja “materializmin reduktiv”.¹²⁵ Kjo pikëpamje njihet edhe si “teroria e identitetit”. Sipas kësaj, gjendjet subjektive të vetëdijes mund të reduktohen në disa gjendje të caktuara të trurit, kurse ato gjendje në grimca subatomike; pra vetëdija dhe vetvetja nuk janë më shume se këto grimca. Në këtë drejtim, nëse një materialist-ateist do të ishte në gjendje ta shpjegonte shfaqjen e materies dhe qenieve jo të vetëdijshme (nëse do të ishte në gjendje t’i hidhte poshtë argumentet nga universi të paraqitura në shtatë kapitujt e parë), atëherë nuk do duhej të haste probleme gjatë shpjegimit të arsyes, vullnetit, vetëdijes dhe vetvetes, të cilat duket qartë se kanë veti krejt të ndryshme prej materies. Megjithatë, edhe vetitë tjera që ndërlidhen me vetëdijen dhe vetveten, edhe subjektiviteti dhe qualia, nuk janë gjëra që tërësisht mund të reduktohen në tru, ose të përshkruhen nga grimcat subatomike.

Kur e hulumtojmë anatominë dhe fiziologjinë e trurit në dritën e zbulimeve të shkencës moderne, kuptojmë se gjatë të folurit aktivizohet lobi i majtë, kurse gjatë marrjes së vendimeve lobi i djathtë; gjithashtu, hulumtimet e tilla shkencore na bëjnë të mundur edhe mësimin e strukturës fizike dhe kimike të neuroneve. Mirëpo, prapëseprapë të gjitha këto janë rrënjësisht të ndryshme nga “subjektiviteti” dhe “qualia”. Imagjinoni se ju ndjeni kënaqësi gjatë notimit. Gjendjen tuaj të kënaqësisë mund ta përcaktojmë përmes zbulimit të një strukture në tru, ose përmes përcaktimit të një hormoni të sekretuar nga truri. Mirëpo edhe këtu, vëzhgimi i hormoneve dhe neuroneve është krejtësisht i ndryshëm nga “kënaqësia që (ne si vetvete) ndjejmë prej notit.” Fakti që kjo ndjenjë e kënaqësisë ndodh dhe realizohet përmes disa neuroneve dhe hormoneve, nuk e ndryshon këtë gjë.

Le të thellohem mëtej duke menduar mbi një eksperiment mendimi të cilin unë e quaj “Syzet e Melihase”. Imagjino që Melihaja dhe shoqëria e saj të bartin syze të pa dizajnuara veçanërisht dhe të pa nxjerrura, që prej momentit të lindjes. Le të supozojmë se xhami i syzeve zëvendësohet me xham tjetër pa e prekur fare kornizën e tyre. Gjithashtu, le të imagjinojmë se Meliha është e pavetëdijshme për ekzistencën e trurit dhe syrit, mirëpo din çdo detaj rreth ndryshimeve në syzet e saj. Me të ndryshuar parametrat dioptrik dhe ngjyra e xhameve, bashkë me to ndryshohet edhe forma dhe ngjyra e objekteve të cilat ajo i vëzhgon. Me fjalë të tjera, objektet jashtë saj ndryshohen në mënyrë identike me ndryshimet e ndodhura në syza. Me ndryshimin e syzave, objektet bëhen ose më të mëdha, ose më të mjegullta; ngjyrat e tyre bëhen

¹²⁵ Jaegwon Kim, **Mind in a Physical World: An Essay on the Mind-Body Problem and Mental Causation**, MIT Press, Cambridge, Mass., 1998.

roze ose të gjelbërta. Kur xhamet të jenë të zeza, edhe objektet bëhen më të padukshme..... Tani le ta parashtrojmë pyetjen: A duhet që ndryshimi i xhamit në mënyrë identike me ndryshimin e shikimit të Melihasë, ta bëjë atë të mendojë se pamja e saj është siguruar falë strukturave dhe ndryshimeve të realizuara në syza? Në opinionin tim, Meliha duhet të jetë e aftë të grumbullojë detaje nga përvoja e saj; siç është hulumti i strukturës së syzave dhe mendimi i kujdesshëm rreth përvojave subjektive të shikimit të saj (qualia). Gjithashtu, ajo duhet ta kuptojë se ekzistimi i ndonjë korelacioni (lidhshmërie) mes ndryshimit të xhamit dhe perceptimit (siç veprohet nga pikëpamja e teorisë identitare), nuk konkludon të vërtetën se shikimi realizohet përmes syzave. (nuk mund të bëhet një reduktim i këtillë). Pas hulumtimit të strukturës së xhamit bashkë me ndryshimet në të dhe pas studimit të perceptimit të shikimit të cilin ajo mund ta shohë edhe vetë përmes introspektivës, dhe duke i krahasuar këto të dyjat, ajo mund ta kuptojë dallimin thelbësorë mes tyre. Ata që thonë se “subjektiviteti dhe qualia” mund të reduktohen në reaksione kimike dhe neurone të trurit, nëse do të viheshin në vendin e Melihasë, do të pretendonin se shikimi duhet të reduktohet në syza. Kimikalet dhe neuronet në tru janë të ngjajshme me syzat, e jo me “subjektivitetin dhe qualian tonë”. Njëjtë siç janë syzat, edhe këto nuk shfaqin ndonjë veti speciale për të pasur qasje në gjendjet e mendjeve përmes subjektivitetit. Ato janë pjesë të proceseve fiziko-mekanike, mu ashtu siç janë syzat. Ato janë formuar nga një kombinim shumë kompleks i atomeve.

Për ta demonstruar se është e pamundur dhe e pakuptimtë që qualia të reduktohet në materien e përshkruar nga fizika, këtu do ta paraqes eksperimentin tjetër të ashtuquajtur “Meliha dhe fiqu”. Le të supozojmë se Meliha është ekspertja më e mirë në botë sa i përket ushqimit dhe proceseve që ndodhin pasi të hahet ushqimi. Prandaj, Meliha i di të gjitha detajet e fikut, që nga niveli subatomik e deri në nivelin molekular dhe qelizorë, e përveç kësaj, ajo i din edhe proceset kimike të cilat ndodhin në organizëm menjëherë pas ngrënies. Tani, le të imagjinojmë se Meliha, fikun të cilin e njeh nga të gjitha aspektet, ka vendosur ta konsumojë për herë të parë në jetën e saj. Në këtë rast, a thua vallë Meliha mëson diçka të re? Përgjigja është po, sepse Meliha edhe pse dinte gjithçka rreth fikut dhe ndikimit të tij në organizëm, ajo do të mësonte një përvojë të re; shijen që fiku lë në përvojën e saj subjektive, si një “quale” e re (qualia singulare). Nëse dituria mbi proceset materiale do të ishte stacioni i fundit i të gjitha dijeve të mundshme, ose thënë më ndryshe, nëse perceptimet tona subjektive do të mund të reduktoheshin në procese materiale dhe të kuptoheshin tërësisht, atëherë Meliha si eksperte e ditur rreth të gjitha llojeve të ushqimeve, nuk do të mësonte diçka të re pas ngrënies së fikut. Por meqë ajo fiton njohuri të reja me provimin e

fikut, ne konkludojmë se teoritë reduktuese kanë dështuar në shpjegimin e “subjektivitetit dhe qualias”¹²⁶. Shpjegimet objektive në lidhje me proceset fizike, nga natyra e tyre, nuk mund ta gjithëpërfshijnë subjektivitetin e vetëdijes. Kjo nënkupton se përvojat (qualia) në subjektivitetin e vetëdijes nuk mund të reduktohen në procese materiale; dhe se pikëpamjet filozofike si materializmi reduktiv, fizikalizmi reduktiv dhe teoria identitare janë të gabueshme.

Kështu që asgjë në botën e materies nuk i ngjanë “subjektivitetit dhe qualias”. Meqenëse materia është qenia e vetme që ekziston në ontologjinë materialiste-ateiste, për ata është një vështirësi e madhe shpjegimi i mënyrës se si u shfaqjen e vetitë e këtilla përtej materiale. Në teizëm, Zoti është i vetëdijshëm dhe i shikon proceset nga këndi i Tij. Madje edhe në mungesë të ndonjë qenie tjetër, Zoti subjektivisht e njeh ekzistencën e Tij; vetëdija e Zotit ka vetinë e subjektivitetit. Nga pikëpamja teiste subjektiviteti është i përjetshëm, dhe në këtë ontologji, Pronari i përjetshëm i kësaj vetie ua dhuron atë krijesave që dëshiron. Zoti, me vetinë e subjektivitetit, lehtë mund t’ia japë këtë veti kujtdo, ndërsa nga ana tjetër gjendja e përshkruar në pikëpamjen materialiste-ateiste, nuk na siguron subjektivitet, ose ndonjë veti tjetër të ngjajshme.

Vlerësimi i pikës 3.3: Një veti tjetër e rëndësishme për një person të vetëdijshëm është qëndrimi i tij në një vetëdije të tërësishëm kushtuar ndjenjave, mendimeve dhe perceptimeve të veçanta. Lexuesi i librit; brenda një kohe të njëjtë mund të lexojë, mund të ndjejë fortësi në fletat e librit, mund të ndëgjojë muzikë në prapaskenë, mund të ndjejë kënaqësi nga libri dhe mund të mendojë rreth librit. Mirëpo sidoqoftë, personi në fjalë, brenda kësaj tërësie ndjenjash, përsëri është një person i vetëm. Nuk është se ai të gjitha këto aktivitete i bën dhe i ndjen njëra pas tjetrës. Vetëdija rreth të gjithë këtyre gjërave bëhet brenda një tërësie të plotë. Edhe pse ndjesitë vijnë nga pjesë të ndryshme të trupit dhe përpunohen në pjesë të ndryshme të trurit, të gjitha ato perceptohen në një mënyrë integrale, në një unitet dhe brenda një subjektiviteti të një personi të vetëm. Është shumë e rëndësishme që ky unitet vepron edhe sinkronik edhe diakronik. (që ruhet në kohëra të ndryshme). Në filozofinë e mendjes, kjo çështje studiohet nën “unitetin e vetëdijes” dhe nën “problemin e detyrimit”. Shumë filozofë të famshëm, nga Dekarti e Locke, e deri te Leibniz dhe Kanti, kanë shprehur interesim për unitetin e vetëdijes.¹²⁷

¹²⁶ Për një eksperiment të ngjajshëm të mendimit, shiko në artikullin: Frank Jackson, “Epiphenomenal Qualia”, *Philosophical Quarterly*, No: 32, 1982, p. 127–136.

¹²⁷ Immanuel Kant, *The Critique of Practical Reason*, Tr.: Thomas Kingsmill Abbott, William Benton, Chicago, 1971.

Le të përqendrohemi në proceset që e përbëjnë vetëdijen tonë të perceptimeve si prekja, shikimi dhe dëgjimi. Kur prekim kopertinën e librit, ne pranojmë ndjesinë e ngurtësisë përmes sinjaleve të transmetuara nga nervat që ndodhen në majë të gishtave e deri në tru. Kur imazhi i librit përmes dritës formohet brenda syve tanë, ne e shohim librin nga sinjalet e dërguara prej nervave të syrit e deri në tru. Në të njëjtën mënyrë, ne dëgjojmë muzikë në prapaskenë përmes sinjaleve që shkojnë prej veshëve e deri në tru. Këto procese ndodhin para se ne të jemi në një vetëdije të tërësishme. Gjatë tërë këtyre perceptimeve, neuronet në trurin tonë (ne kemi rreth njëqind miliardë prej tyre) luajnë role shumë kritike. Edhe pse asnjë neuron i vetëm në vetvete nuk korrespondon me vetitë e vetëdijes si subjektiviteti dhe uniteti, përsëri ekzistojnë shumë njerëz që besojnë se lëvizjet e tyre komplekse bashkëpunuese mbartin veti të tilla. Kur shohim brenda trurit ne shohim neurone që funksionojnë brenda një sistemi të përcaktuar, megjithatë, e tërë kjo nuk është aq e arsyeshme aq ta përshkruajë se si këto neurone bashkëpunojnë dhe sjellin në pah "vetëdijen që percepton në tërësi dhe në subjektivitetin e saj".

Në filozofinë e mendjes, eksperimenti i famshëm "Kombi Kinez", mund të hedhë më tepër dritë mbi problemin në lidhje me shfaqjen e "vetëdijes në subjektivitet dhe unitet" përmes punës bashkëpunuese të shumë neuroneve. Le të supozojmë se çdo person që jeton në Kinë është i lidhur me njëri-tjetrin, në një mënyrë që i imiton rrjetet nervore në tru. Ata mund të kontaktojnë me njerëz të tjerë (modele neuronesh) duke përdorur udhëzime të veçanta.¹²⁸ Tani le të imagjinojmë se Kombi Kinet përpiket ta imitojë ndjenjën e eksitimit. Për ta bërë këtë, njerëzit që korrespondojnë me neuronet aktuale në tru, të cilat i rregullojnë ndjenjat, fillojnë të komunikojnë me njëri-tjetrin përmes telave. Pastaj, le të imagjinojmë se të gjitha proceset e tjera që ndodhin në tru gjatë leximit të ndonjë libri imitohen gjithashtu në mënyrë të ngjashme nga ky rrjet njerëzish. Në një skenar të këtillë, a mund të konkludojmë se "Vetëdija Kineze" rrjedh nga populli Kinez dhe se kombi Kinez "në subjektivitetin e vetëdijes dhe tërësisë Kineze" i ndjen të gjitha shqisat e njëjta të cilat i marrim nga leximi i një libri? Sigurisht, një pretendim i këtillë do të ishte i pakuptimtë. Pretendimi se "vetëdija e perceptuar në tërësi dhe në mënyrë subjektivitetin" është shfaqur nga një lëvizje bashkëpunuese mes neuroneve është krejt e ngjashme me pretendimin në eksperimentin e Kombit Kinez. Perceptimi i tërësishëm brenda botës subjektive është një çështje rrënjësisht e ndryshme nga funksioni i neuroneve si pjesë e një sistemi të caktuar.

¹²⁸ Ned Block, "Troubles with Functionalism", Minnesota Studies in The Philosophy of Science, No: 9, 1978, f. 261–325.

Në botën të cilën e ka përshkruar fizika, elektronet dhe protonet që e formojnë atomin e shfaqin natyrën e tyre në sjelljet si tërheqja-zmbrapsje dhe lëvizjet tjera përkatëse. Bota e Kimisë shfaqet prej lëvizjeve të atomeve në përbërjet e ndryshme. Në biologji, funksionimi i molekulave të caktuara siç janë enzimet dhe kombinimet e molekulave ose sjelljet e ndryshme si replikimi i ADN-së, janë të gjitha produkte të lëvizjeve të atomeve në thelb (në një shkallë më të komplikuar). Sjelljet e studiara në neuroshkencë, siç janë: korrelacionet nervore, komunikimi ndërmjet neuroneve, aktiviteti i sinapseve elektrike dhe kimike, pra, të gjitha mund të reduktohen në një lloj lëvizjeje. Sidoqoftë, "perceptimi i vetëdijshëm i një personi" nga ana e cilësisë, është i ndryshëm nga ato sjellje që në esencë e kanë lëvizjen. "Ngatërrimi", një prej fenomeneve më interesante të mekanikës kuantike, shpërfaq një tërësi të habitshme në nivelin atomik. Edhe pse nukleotidet e ADN-së janë anëtarë të kësaj strukture të veçantë të ADN-së, "vetia e tërësisë e vetëdijes" është plotësisht e dallueshme nga rastet e tilla të veprimit në tërësi dhe bashkëpunim. Në të gjitha rastet tjera, uniteti formohet prej kombinimit të grimcave të pavarura dhe pasive, të cilat në esencë janë të lëvizshme.

Në esencën e vetëdijes ekzistojnë edhe veti të tilla si : qëllimshmëria, subjektiviteti dhe tërësia e pandashme. Njëjtë si vetitë e vetëdijes dhe vetvetes të diskutuara më parë, edhe shfaqja e tërësisë së tyre është e pashpjegueshme nga këndvështrimi materialist-ateist i materies. Ndërsa në teizëm meqë vetëdija dhe vetvetja janë veti të përjetshme të Zotit, nuk haset në ndonjë vështirësi gjatë shpjegimit të këyre çështjeve.

Tani duhet të jetë e qartë se vetitë e mendjes siç janë arsyeja, vullneti, vetëdija dhe vetvetja nuk mund të shpjegohen përmes vetive të njohura të materies. Si pasojë, vetitë e mendjes arsyeja, vullneti, vetëdija dhe vetvetja nuk mund të reduktohen në nivel material. Mund të konkludohet se ato kanë lidhje me një gjenezë krejt të ndryshme nga materia. Meqë filozofia materialiste-ateiste nuk e pranon ekzistencën e ndonjë origjine tjetër përveç materies, diskutimi jonë tregon për pavërtetësinë e filozofisë materialiste-ateiste. Nga ana tjetër, bazuar në alternativën e dytë mund të thuhet se edhe pse vetitë e përmendura të mendjes nuk mund të reduktohen në materie, ato shfaqen kur struktura materiale arrinë të marrë një formë të caktuar. Sipas kësaj, e tërë shfaqja është më shumë se kombinim i pjesëve; vetitë të cilat shfaqen kur materia vjen në një formë të caktuar nuk mund të kuptohen duke u bazuar vetëm në pjesët individuale të formës.¹²⁹ Në këtë

¹²⁹ Ian Barbour, *Issues in Science and Religion*, f. 326.

drejtim, nënkuptojmë se nuk ka ndonjë substancë tjetër përveç materies, por prapëseprapë, materia ka një strukturë të tillë që kur e arrin formën e caktuar, shfaqen veti të caktuara të cilat nuk mund të shpjegohen duke u bazuar vetëm në blloqet ndërtuese të materies dhe në ndërveprimin mes tyre.¹³⁰ Prej perspektivës së një materialisti-ateisti fundamental (siç janë disa prej mendimtarëve të kësaj pikëpamje), as “dualizmi i substancës” (opinionit se materia dhe mendja/shpirti me vetitë e përmendura janë gjëra të ndryshme), e as “dualizmi i vetive” (opinionit se materia dhe mendja/shpirti me vetitë e përmendura janë gjëra të ndryshme) nuk pranohen si opinione të vlefshme. Pranimi i pikëpamjes së shfaqjes (së këtyre vetive) nënkupton pranimin e “dualizmit të vetive”.¹³¹

E shoh të dobishme ta theksoj një çështje shumë të rëndësishme: nga aspekti teist, nuk është e detyrueshme të mbrohet se shfaqja e vetive si arsyeja, vullneti, vetëdija dhe vetvetja kanë ndodhur përmes krijimit të “mendjes ose shpirtit” si një substancë veças prej materies. Shpërfaqja (e vetive të lartëpërmendura) pa iu drejtuar ndonjë substance jomateriale, ose thënë ndryshe, shpjegimi i këtyre vetive bazuar vetëm në terma të materies, është gjithashtu një qasje e pranueshme. Këtu gjithashtu mund të themi se materia është krijuar bashkë me aftësitë për ta bërë të mundur shfaqjen e këtyre vetive dhe pasi ajo ta marrë një formë të caktuar, atëherë materia është e gatshme të furnizohet me “mendje/shpirt”. Sipas dualizmit, vetitë e mendjes janë formuar atëherë kur materia është përzier me një tjetër lloj të qenies, ndërsa gjatë shfaqjes, këto veti të mendjes kanë ardhur në ekzistencë falë një potenciali të vendosur në materie. Në fakt, ka shumë teologë dhe filozofë Judaistë, të Krishterë dhe Muslimanë të cilët bëjnë pjesë në secilën prej këtyre ontologjive. Ata gjithashtu mbrojnë mendimin se vizioni monoteist i vetvetes njerëzore dhe ringjalljes pas kësaj bote, është koherent me të dy qasjet për “mendjen/shpirtin”.¹³²

Materialistët-ateistët gjithmonë kanë qëndruar larg pikëpamjeve dualiste. Derisa shfaqja (e këtyre vetive) është diçka e papritur në materializëm-ateizëm, në anën tjetër, ajo gjen shpjegim

¹³⁰ Për më shumë mbi shfaqjen, shiko: Philip Clayton, “**Neuroscience, The Person And God: An Emergentist Account**”, Ed: Robert John Russell et al., **Neuroscience And The Person**, Vatican Observatory Publications, Vatican, 2002, f. 181-214.

¹³¹ Frank Jackson, **From Metaphysics to Ethics: A Defence of Conceptual Analysis**, Clarendon Press, Oxford, 1998.

¹³² Unë personalisht e mbroj këtë pikë brenda kornizave të Islamit në librin tim : Caner Taslaman, **Modern Bilim, Felsefe ve Tanrı**, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2008, f. 107- 148. Për perspektivat në lidhje me Testamentin e Vjetër dhe të Ri, shiko në : Joel B. Green, “**Restoring The Human Person: New Testament Voices For A Holistic And Social Anthropology**”, Ed: Robert John Russell et al., **Neuroscience And The Person**, Vatican Observatory Publications, Vatican, 2002, p. 4-5.

mjaftë të arsyeshëm në teizëm, siç është theksuar nga ana e Howard Van Till.¹³³ Shpërfaqja e këtyre vetive është diçka që pritet të ndodhë në perspektivën teiste, aty ku edhe për materien konsiderohet se është krijuar me qëllim të caktuar. Një Zot inteligjent, i vullnetshëm, i vetëdijshëm, i plotfuqishëm ka krijuar materien dhe ky Krijues gjithashtu mund të ketë vendosur "surpriza" të tilla brenda materies. Megjithatë, siç e kam potencuar vazhdimisht në këtë libër, materializmi-ateizmi në lidhje me materien thotë se ajo është një substancë jo inteligjente, e pavullnetshme, e pavetëdijshme dhe e pa dizajnuar, që funksionon në kuadër të ligjeve mekanike. Nuk ka asnjë arsye racionale për të pritur surpriza në këtë ontologji të materies. Komplekset e formuara prej grimcave fundamentale të materies duhet të shfaqin veti të njëjta si ato; prandaj, të gjitha versionet e dualizmit substancial dhe dualizmit të vetive duhet të refuzohen. Siç do të kuptohet prej këtyre argumenteve, në paradigmen materialiste-ateiste, nuk ka asnjë shkak të vetëm që të pritet për shfaqjen e attributeve si arsyeja, vullneti, vetëdija, dhe vetvetja, rreth të cilave kemi diskutuar në tre kapitujt e fundit. Përkundrazi, sipas kësaj paradigme nuk duhet të presim për shfaqjen e këtyre attributeve. Kurse nga perspektiva teiste e krijimit të materies, Zoti, si posedues autentik i të gjitha këtyre attributeve, e ka krijuar materien në atë mënyrë që ajo të jetë vendpranimi i këtyre attributeve përtej materiale.

Me pak fjalë, vetëdija dhe vetvetja janë ndër vetitë më themelore që e definojnë njeriun. Edhe pse pyetja shumë ekstreme rreth asaj se si u shfaqën këto veti, është injoruar dhe menjanuar nga shumë njerëz; rëndësia e saj është shumë e qartë në drejtim të gjetjes së përgjigjeve për pyetjet si “kush jemi ne?” dhe “pse jemi ne këtu?”. Në këtë kapitull, i kemi parë shumë dështime të pikëpamjes materialiste-ateiste, përfshirë këtu edhe materializmin selektiv, materializmin reduktiv (teoria identitare), funksionalizmin dhe bihejviorizmin. Gjithashtu, ne konkluduar se dy shpjegimet e mbetuara rreth vetëdijes dhe vetvetes: dualizmi dhe shpërfaqja, janë më të pajtueshme me teizmin. Në kornizën materialiste-ateiste të materies; pamë se vetitë si qëllimshmëria (3.1), subjektiviteti, qualia (3.2) dhe uniteti, tërësia (3.3), është e pamundur të shpjegohen. Kurse në teizëm, një prej attributeve më të rëndësishme të Zotit të përjetshëm, është vetëdija si pjesë e qenies së Tij. Kjo gjë sjell deri te përfundimi se vetëdija ekziston përjetësisht dhe Zoti, si i tillë që është,

¹³³ Howard Van Till, “**Basil and Augustine Revised**: The Survival of Functional Integrity”, *Origins and Design*, No: 19, 1998, f. 1-12.

disa prej krijesave të Tij i ka furnizuar me veti të këtilla. Si përfundim, teizmi duhet të preferohet para materializmit-ateizmit.

PËRFUNDIMI

Ekzistenca e Zotit ka ndikim të thellë në perceptimin tonë ndaj vetes, universit, të dashurve dhe tërë ekzistencës. "Përse ekzistoj?" "Nga erdhën të gjitha këto?" "Pse jemi ketu?" "Çfarë do të ndodhë me ne pasi të vdesim?" Pra, ndaj këtyre dhe shumë pyetjeve të ngjashme, ekzistojnë përgjigje të lidhura me këtë gjykim. Ekzistenca e Zotit pasohet me krijimin e vetëdijshtëm të njerëzimit dhe të të gjitha qenieve. Zoti, u jep kuptim dhe qëllim atyre dhe nëse dëshiron Ai, ua mundëson atyre jetën pas vdekjes. Mos harroni se edhe gjatë leximit të këtij libri, shqetësimi juaj kryesor është shtjellimi i kësaj çështjeje shumë kritike. Shtjellimi i ekzistencës së Zotit, është tema më kryesore e të gjitha pyetjeve të ndryshme filozofike në lidhje me ontologjinë.

Sipas atyre që e refuzojnë ekzistencën e Zotit fetë janë falsifikime të njerëzve, dhe menjëherë pas vdekjes ne thjesht do të ndahemi nga jeta dhe të dashurit tanë, pa lënë mbrapa ndonjë mundësi tjetër, përveç "zhdukjes së pakuptimtë". Ndërsa nga ana tjetër, për besimtarin në Zot, destinacioni përfundimtar veçse është transmetuar nga ana e Zotit, madje brenda atij mesazhi ka edhe shtjellime të ndryshme të dimensionit të kuptimësisë, përmes së cilës, i marrim përgjigjet e ndryshme të pyetjeve se "pse jemi ketu?", "kush jemi ne?", "çfarë do të ndodhë me neve pas kësaj jete?" etj. Veç kësaj, për besimtarin, është shumë e lehtë që i Plotfuqishmi ta krijojë universin, botën, neve dhe të gjitha format tjera të jetës, e madje edhe të na ringjallë në botën tjetër. Argumentet e paraqitura në këtë libër kanë për qëllim trajtimin se përse e gjithë kjo është e lehtë për Zotin. Ai i cili e krijoi universin, jetën dhe njeriun e vetëdijshtëm me të gjitha vetitë e duhura, nuk ballafaqohet me asnjë vështirësi të vetme nëse i duhet ta realizojë ndonjë krijimtari të ngjajshme. Ajo që Zoti ka bërë, është tregues i asaj se çfarë Ai mund të bëjë. Vargjet vijuese të Kuranit na tërheqin vëmendjen në këtë pikë:

"Dhe (tani) ai (polemizon rreth Nesh,) mendon për Ne me krahasim dhe harron se si u krijua! (Dhe kështu,) ai thotë: "Kush mund t'u japë jetë eshtrave të bëra pluhur e hi?"

Thuaj: "Ai që i solli në fillim në jetë do t'u japë jetë (edhe një herë), duke patur parasysh se ka dije të plotë për çdo akt krijimi."

A nuk është, pra, në gjendje Ai që i ka krijuar qiejt dhe tokën të krijojë (sërish) si ata (që kanë vdekur)? Po, sigurisht, sepse vetëm Ai është Krijuesi i gjithëditur.”¹³⁴

Diskutimet tona gjatë gjithë këtij libri tregojnë se Zoti nuk e la universin në vetvete pas krijimit. Ai i vendosi të gjitha proceset e ardhshme sipas një rregulli të caktuar dhe krijoi jetën dhe natyrën e njeriut me të gjitha vetitë e duhura: me dëshirë, moral, arsye, vullnet dhe vetëdije. Prandaj, argumentet e paraqitura këtu e hedhin poshtë edhe "deizmin", i cili pretendon se Zoti është pasiv dhe i pavetëdijshëm në raport me universin.¹³⁵ Zoti nuk i din vetëm detajet e këtij universi, por edhe zërat që vijnë nga bota e brendshme dhe natyrshmëria e njerëzve. Ky botëkuptim ka një efekt të jashtëzakonshëm në konsideratat ontologjike, sepse e pasuron vëmendjen e njeriut ndaj gjithçkaje që e rrethon. Kjo gjithashtu do të thotë se Krijuesi ynë i gjithëfuqishëm na njeh më mirë se ç'ë njohim veten dhe Ai na kupton në mënyrë të përsosur, qoftë edhe nëse të gjithë ne keqkuptohemi me njëri tjetrin. Gjithashtu, ky Krijues është i fuqishëm përtej çdo potenciali dhe mund t'i zgjidhë problemet tona jetësore dhe të dashurve tanë. Çfarë tjetër mund të kishte vlerë më të madhe sesa kuptimi i ekzistencës së Zotit, i cili është i vetëdijshëm edhe për zhurmat dhe lutjet më të brendshme të njeriut? Gjithashtu, duhet të kihet parasysh se gjatë vlerësimit të përmbajtjes së këtij libri, edhe konkluzionet tona logjike janë njëjtë të lidhura ngushtë me diskutimet e tilla jetike ekzistenciale.

Në këtë libër, jemi përpjekur t'u përgjigjemi pyetjeve shumë jetike, të cilat mund ta ndryshojnë radikalisht vizionin tonë rreth universit, jetës dhe vdekjes. A ekziston Zoti? A ka ndonjë argument të fuqishëm për të besuar në Zot? Cilat janë themelet e një besimi të tillë? Këtu, gjithsej janë paraqitur 12 argumente si përgjigje konkrete ndaj këtyre pyetjeve. Shtatë prej tyre janë nxjerrur prej botës së jashtme, kurse 5 janë ekstraktime prej vetive të brendshme. Në të gjitha këto dymbëdhjetë argumente, qasja themelore është të dihen fenomenet në univers ose në natyrën tonë dhe të kërkohet nëse ato shpjegohen më mirë nga teizmi apo jo. Për ta bërë këtë, argumentet teiste janë krahasuar me ateizmin materialist, i cili është alternativa e vetme reale ndaj teizmit në historinë e filozofisë.

¹³⁴ Kaptina Jasin 36; ajetet 78,79 dhe 81.

¹³⁵ Nocioni "Deizëm" është përdorur edhe në kuptimin e lartëpërmendur, por edhe në kuptimin "e Zotit që nuk ka dërguar shpallje/fe te njerëzit". Ka pasur variacioni të ndryshme të përdorimit të këtij nocioni përgjatë historisë.

Argumentet e paraqitura këtu, bazohen në fenomenet të cilat shfaqen në univers dhe rradhitën si mëposhtë:

1. Universi ka një fillim
2. Në univers ekzistojnë ligje
3. Universi është i zbulueshëm (përmes shkencës).
4. Universi ka potencial të jashtëzakonshëm.
5. Konstantet dhe rregullimi preciz i ligjeve fizike
6. Rregullimi preciz i dukurive fizike në univers
7. Sfera e jetës dhe i gjithë diversiteti i saj

Në të gjithë këto pjesë, është treguar se teizmi e bën shpjegimin më të mirë të çështjes së materies. Gjithashtu, dua ta theksoj edhe njëherë pafuqinë e teorisë së evolucionit për shfuqizimin e argumentit tonë.

Në pesë argumentet e bazuara në natyrën njerëzore, janë sqaruar vetitë e lindura dhe përcaktuese të të gjithë njerëzve. Këto veti janë:

1. Dëshirat natyrore
2. Moraliteti i lindur
3. Arsyeja
4. Vullneti
5. Vetëdija dhe vetvetja

Edhe këtu, të gjitha pikat e përmendura kontribojnë në fuqizimin e argumentit tonë se teizmi duhet të preferohet para materializmit-ateizmit. Kam dëshirë të tërheq vëmendje të veçantë drejt këtyre pesë pikave të cilat unë i quaj “argumente të natyrshmërisë njerëzore”, sigurisht, duke u inspiruar nga kaptina Rum (30-33). Përkundër faktit që thëniat e ngjashme si "Islami është fe e natyrës njerëzore (fitrat)", "Natyra njerëzore është mjaft vitale që ta ndajë të mirën nga e keqja", "Besimi është i lindur në natyrën njerëzore" përdoren mjaft shpesh, praktikisht nuk ka detaje të studiuara (aq sa kam njohuri unë) se si natyra jonë përmban argumente mbështetëse të fundamenteve të besimit Islam. E unë shpresoj që të jem prej atyre që do ta plotësojë këtë zbrazëti. Sipas mendimit tim, “argumentet nga natyra njerëzore” të paraqitura këtu dhe në disa punime tjera të detajuara të mia, në një mënyrë janë si interpretime për ajetin e 30 të kaptinës Rum, e cila përqëndrohet në

natyrën njerëzore, si dhe për ajetin 53 të kaptinës Fusilet dhe 21 të kaptinës Dharijah, të cilat tregojnë për ekzistencën e provave brenda vetes sonë (fjalët e brendshme). Ajeti 30 i sures Rum tregon se të gjithë njerëzit kanë vlera të përbashkëta në natyrshmërinë e tyre. Kjo natyrshmëri përbëhet nga një strukturë që përputhet me mësimet fundamentale të religjioneve, pavarësisht faktit që shumica e njerëzve janë të pavetëdijshëm ose injorantë ndaj provës së kësaj natyre.

“Dhe kështu, drejtoje vendosshmërisht fytyrën nga besimi (gjithmonë i vërtetë), duke u shmangur nga gjithçka e rreme, në përputhje me tendencën natyrore me të cilën Allahu e ka mbrojtur njeriun, (sepse) nuk do të lejohet asnjë ndryshim ta prishë atë që Allahu ka krijuar kështu. Ky është (qëllimi i) besimit gjithmonë të vërtetë, por shumica e njerëzve nuk e dinë këtë.”¹³⁶

Pretendimet se provat për ekzistencën e Zotit e kanë marrë vendin në raftet me pluhur dhe se janë vjetruar (provat nga Hume, Kanti, filozofia Marksiste, pozitivizmi, qasja postmoderniste, ekzistencialistët ateistë ose fideistë), mendoj se janë qasje që u mungon njohuria dhe argumentimi i mjaftueshëm. Këtu unë i kam paraqitur të gjitha 12 argumentet në mënyrë të organizuar. Disa nga këto argumente janë shtjelluar edhe më thellë në punimet e mia. Sigurisht, disa pjesë mund të duken më bindëse se tjerat, por kjo varet nga lexuesi. Është e domosdoshme t’i kushtohet vëmendje faktit se secili prej argumenteve të paraqitura këtu e mbështet individualisht (argumentin) dhe arrin në të njëjtin përfundim, duke formuar kështu një argument të përgjithshëm integral, bindës dhe të fuqishëm.

¹³⁶ Kaptina Rum 30: ajeti 30.

BIBLIOGRAFI

Adams, Robert, **“Moral Arguments for Theistic Belief”**, Rationality and Religious Belief, Ed: C. Delaney, University of Notre Dame Press, Notre Dame, 1979.

Aydın, Mehmet S., **Din Felsefesi**, İzmir İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları, İzmir, 1999.

Barbour, Ian, **When Science Meets Religion**, Harper Collins Publishers, New York, 2000.

Barbour, Ian, **Issues in Science and Religion**, Harper And Row Publishers, New York, 1971.

Barrow, John ve Tipler, Frank, **The Anthropic Cosmological Principle**, Oxford University Press, Oxford, 1996.

Beverluis, John, **C. S. Lewis and the Search for Rational Religion**, Prometheus Books, New York, 2007.

Bishop, John, **Natural Agency**, Cambridge University Press, Cambridge, 1989.

Black, Donald, **“On the Origins of Morality”**, Evolutionary Origins of Morality: Cross-Disciplinary Perspectives, Ed: Leonard Katz, Imprint Academic, Thorverton, 2000.

Block, Ned, **“Troubles with Functionalism”**, Minnesota Studies in The Philosophy of Science, No: 9, 1978.

Bloom, Paul, **“The Moral Life of Babies”**, The New York Times, 5 Mayıs 2010

Butts, Robert E., **“William Whewell”**, The Cambridge Dictionary of Philosophy, Ed: Robert Audi, Cambridge University Press, Cambridge, 1999.

Carter, Brandon, **“Large Number Coincidences and the Anthropic Principle in Cosmology”**, Ed: John Leslie, Physical Cosmology and Philosophy, Macmillan Publishing, New York, 1990.

Churchland, Paul, **Matter and Consciousness**, MIT Press, Cambridge, 1999.

Clayton, Philip, **“Neuroscience, The Person and God: An Emergentist Account”**, Ed: Robert John Russell ve diğerleri, Neuroscience and The Person, Vatican Observatory Publications, Vatikan, 2002.

Collins, Robin, **“Tanrı, Tasarım ve İnce Ayar”**, Allah, Felsefe ve Bilim, Ed: Caner Taslaman ve Enis Doko, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2014.

- Craig, William Lane, **“Kelam Kozmolojik Kanıtı”**, Allah, Felsefe ve Bilim, Ed: Caner Taslaman ve Enis Doko, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2015.
- Craig, William Lane, **The Kalam Cosmological Argument**, Wipf and Stock Publishers, Eugene, 2000.
- Darwin, Charles, **The Origin of Species**, Penguin Classics, Londra, 1985.
- Davies, Paul, **God and The New Physics**, Simon and Schuster, New York, 1984.
- Davies, Paul, **The Accidental Universe**, Cambridge University Press, Cambridge, 1982.
- Davies, Paul, **The Last Three Minutes**, Basic Books, New York, 1994.
- Dawkins, Richard, **Climbing Mount Improbable**, W. W. Norton, New York, 1997.
- Dawkins, Richard, **Kör Saatçi**, Çev: Feryal Halatçı, TÜBİTAK, Ankara, 2002.
- Dawkins, Richard, **The God Delusion**, Black Swan, Londra, 2007.
- Dembski, William A., **No Free Lunch**, Rowman and Littlefield Publishers, Lanham, 2002.
- Denton, Michael J., **Nature’s Destiny**, The Free Press, New York, 1998.
- Dimion, M., Simion F. ve Caltran G., **“Can Newborns Discriminate Between Their Own Cry and the Cry of Another Newborn Infant”**, Developmental Psychology, Vol: 35/2, 1999.
- Dorman, Emre, **Deizm ve Eleştirisi**, Marmara Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, doktora tezi, İstanbul, 2009.
- Eddington, Arthur, **The Nature of the Physical World**, Macmillan, New York, 1929.
- Feuerbach, Ludwig, **Lectures on the Essence of Religion**, 1851,
<http://www.marxists.org/reference/archive/feuerbach/works/lectures/lec30.htm>
- Flew, Antony, **There Is A God: How The World’s Most Notorious Atheist Changed His Mind**, Harper Collins, New York, 2007.
- Freud, Sigmund, **The Origins of Religion**, Penguin, Londra, 1991.
- Freud, Sigmund, **The Standard Edition of the Complete Psychological Works of Sigmund Freud**, Vol: XXI (1927-1931): The Future of an Illusion, Civilization and its Discontents, and Other Works, The Hogarth Press and the Institute of Psycho-analysis, Londra, 1961.

- Gasking, Elizabeth, **Investigations into Generations**, Hutchinson and Co Publishers, Londra, 1967.
- Gazzali, **Filozofların Tutarsızlığı**, Çev: Mahmut Kaya ve Hüseyin Sarıoğlu, Klasik, İstanbul, 2005.
- Glass, John I. ve diğerleri, **“Essential Genes of a Minimal Bacterium”**, Proceedings of the National Academy of Sciences, 103/2, 2006.
- Gould, Stephen Jay, **Wonderful Life**, W. W. Norton and Company, New York, 2007
- Green, Joel B., **“Restoring The Human Person: New Testament Voices For A Wholistic and Social Antropology”**, Neuroscience And The Person, Ed: Robert John Russell ve diğerleri, Vatican Observatory Publications, Vatikan, 2002.
- Guillen, Michael, **Dünyayı Değiştiren Beş Denklem**, Çev: Gürsel Tanrıöver, TÜBİTAK Popüler Bilim Kitapları, Ankara, 2001.
- Haidth, J., **“The Emotional Dog and Its Rational Tail: A Social Intuitionist Approach to Moral Judgment”**, Psychological Review, No: 108, 2001.
- Harris, Sam, **Free Will, Free Press**, New York, 2012.
- Hasker, William, **Metaphysics**, Inter Varsity Press, Downer’s Grove, 1983.
- Hick, John, **Arguments for the Existence of God**, Herder and Herder, New York, 1971.
- Hume, David, **Dialogues and Natural History of Religion**, Ed: J.A.C. Gaskin, Oxford University Press, Oxford, 1993.
- Hutcheson, Francis, **A System of Moral Philosophy**, Continuum International Publishing Group, New York, 2005.
- Jackson, Frank, **“Epiphenomenal Qualia”**, Philosophical Quarterly, No: 32, 1982.
- Jackson, Frank, **From Metaphysics to Ethics: A Defence of Conceptual Analysis**, Clarendon Press, Oxford, 1998.
- Kant, Immanuel, **Fundamental Principles of the Metaphysics of Morals**, Çev: Thomas Kingsmill Abbott, William Benton, Chicago, 1971.
- Kant, Immanuel, **The Critique of Practical Reason**, Çev: Thomas Kingsmill Abbott, William Benton, Chicago, 1971.

Kant, Immanuel, **The Critique of Pure Reason**, Çev: J. M. D. Meiklejohn, William Benton, Chicago, 1971.

Kaufmann, Walter, **Portable Nietzsche**, The Viking Press, New York, 1954.

Kelemen, Deborah, “**Are Children Intuitive Theists? Reasoning about Purpose and Design in Nature**”,
Psychological Science, No: 15/5, 2004.

Kelemen, Deborah, “**The Scope of Teleological Thinking in Preschool Children**”, Cognition, No: 70, 1999.

Kim, Jaegwon, **Mind in A Physical World: An Essay on The Mind-Body Problem and Mental Causation**,
MIT Press, Cambridge MA, 1998.

Kindi, “İlk Felsefe Üzerine”, **İslam Filozoflarından Felsefe Metinleri**, Ed: Mahmut Kaya, Klasik, İstanbul,
2005.

Kreeft, Peter J. ve Tacelli, Ronald K., **Pocket Handbook of Christian Apologetics**, InterVarsity Press,
Downers Grove, 2003.

Leibniz, G. W., **New Essays on Human Understanding**, Ed: Peter Remnont ve Jonathan Bennett,
Cambridge University Press, Cambridge, 1996.

Leslie, John, “**Anthropic Principle, World Ensemble, Design**”, American Philosophical Quarterly, No: 19,
1982.

Leslie, John, **Universes**, Routledge, New York, 1989.

Lewis, C. S., **Christian Reflections**, William B. Eerdmans Publishing Company, Grand Rapids, 1995.

Libet, Benjamin ve diğerleri, “**Time of Conscious Intention to Act in Relation to Onset of Cerebral Activity (Readiness-Potential)**”, Brain, No: 106-3, 1983.

Lipton, Peter, **Inference to the Best Explanation**, Routledge, Londra, 2001.

Locke, John, **An Essay Concerning Human Understanding**, Prometheus Books, New York, 1995.

Lovell, Steven Jon James, **Philosophical Themes from C. S. Lewis**, Department of Philosophy University
of Sheffield, PhD Thesis, August 2003.

Marx, Karl ve Engels, Friedrich, **Felsefe İncelemeleri**, Çev: Sevim Belli, Sol Yayınları, İstanbul 1997.

Mayr, Ernst, **The Growth of Biological Thought**, The Belknap Press of Harvard University Press,
Cambridge, 1982.

- Mill, John Stuart, **Utilitarianism**, Hackett Publishing, Indianapolis, 2001.
- Monod, Jacques, **Chance and Necessity**, Çev: Austryn Wainhouse, Vintage Books, New York, 1972.
- Morris, Simon Conway, **Life's Solution: Inevitable Humans in A Lonely Universe**, Cambridge University Press, Cambridge, 2005.
- Morris, Simon Conway, **The Deep Structure of Biology**, Templeton Foundation Press, Pennsylvania, 2008.
- Nagel, Thomas, **The Last Words**, Oxford University Press, Oxford, 2001.
- Newton, Isaac, **The Principia: Mathematical Principles of Natural Philosophy**, Çev: Bernard Cohen ve diğ., The University of California Press, Berkeley, 1999.
- Nordenskiöld, Erik, **The History of Biology**, Çev: L. Bucknall Eyre, Tudor Publishing, New York, 1920.
- Nowacki, Mark, **The Kalam Cosmological Argument for God**, Prometheus Books, Amherst NY., 2007.
- Orgel, Leslie, "Evolution of the Genetic Apparatus", J Mol. Biol, 38/3, 1968.
- Pascal, Blaise, **Pensees**, Çev: A. J. Krailsheimer, Penguin Classics, Londra, 1966.
- Penrose, Roger, **Kralın Yeni Usu 3: Us Nerede**, Çev: Tekin Dereli, TÜBİTAK Popüler Bilim Kitapları, Ankara 2003.
- Penrose, Roger, **The Road to Reality**, Jonathan Cope, Londra, 2004.
- Politzer, Georges, **Felsefenin Başlangıç İlkeleri**, Çev: Enver Aytekin, Sosyal Yayınlar, İstanbul, 1997.
- Ramsey, William, "Eliminative Materialism", The Stanford Encyclopedia of Philosophy (Summer 2013 Edition), Edward N. Zalta (ed.), URL = <http://plato.stanford.edu/archives/sum2013/entries/materialism-eliminative> Rawls, John, A Theory of Justice, The Belknap Press of Harvard University Press, Massachusetts, 1999.
- Reid, Thomas, **Inquiry and Essays**, Ed: R. E. Beanblossom ve K. Lehrer, Hackett Publishing, Indianapolis, 1983.
- Reppert, Victor, **C.S. Lewis's Dangerous Idea**, IVP Academic, Downers Grove, 2003.
- Rose, Steven, **Lifelines**, Oxford University Press, Oxford, 1998.

- Ruse, Michael ve Wilson, Edward O., **“The Evolution of Ethics”**, Philosophy of Biology, Ed: Michael Ruse, Prentice Hall, New Jersey, 1989.
- Russell, Bertrand, **Mysticism and Logic and Other Essays: A Free Man’s Worship**, Longmans, Londra, 1918.
- Sartre, Jean-Paul, **Basic Writings**, Ed: Stephen Priest, Routledge, Londra, 2001.
- Schopenhauer, Arthur, **The World as Will and Representation**, Vol: 2, Çev: E. F. J. Payne, Harper and Row, New York, 1966.
- Searle, John R., **Minds, Brains and Science**, Harvard University Press, Massachusetts, 1985.
- Searle, John R., **Zihnin Yeniden Keşfi**, Çev: Muhittin Macit, Litera Yayıncılık, İstanbul, 2004.
- Shaftesbury, **Lord, Characteristics of Men, Manners, Opinions, Times**, Ed: Lawrence Klein, Cambridge University Press, Cambridge, 2001.
- Simner, M. L., **“Newborn’s Response to the Cry of Another Infant”**, Developmental Psychology, No: 5, 1971.
- Singer, Tania, **“The Neuronal Basis and Ontogeny of Empathy and Mind Reading: Review of Literature and Implications for Future Research”**, Neuroscience and Biobehavioral Reviews, No: 30, 2006.
- Skinner, B. F., **About Behaviorism**, Vintage Books Edition, New York, 1976.
- Skrbina, David, **Panpsychism in The West**, MIT Press, Cambridge Mass., 2005.
- Smith, Adam, **The Theory of Moral Sentiments**, Liberty Classics, Indianapolis, 1976.
- Suhler, Christopher ve Churchland, Patricia, **“The Neurobiological Basis of Morality”**, The Oxford Handbook of Neuroethics, Ed: Judy Illes ve Barbara J. Sahakian, Oxford University Press, Oxford, 2011.
- Swinburne, Richard, **Tanrı Var Mı?**, Çev: Muhsin Akbaş, Arasta Yayınları, Bursa, 2001.
- Swinburne, Richard, **The Existence of God**, 2. Baskı, Clarendon Press, Oxford, 2004.
- Taslaman, Caner ve Doko, Enis, **Kuran ve Bilimsel Zihnin İnşası**, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2015.
- Taslaman, Caner, **“Din Felsefesi Açısından Entropi Yasası”**, Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, Sayı: 30, İstanbul, 2006.

- Taslaman, Caner, **“Tanrı Parçacığı: Felsefi Bir Değerlendirme”**, Felsefe Dünyası, No: 56, 2012.
- Taslaman, Caner, **Arzulardan Allah’a Ulaşmak**, Etkileşim Yayınları, İstanbul, 2014.
- Taslaman, Caner, **Big Bang ve Tanrı**, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2014.
- Taslaman, Caner, **Evrenden Allah’a**, Etkileşim Yayınları, İstanbul, 2013.
- Taslaman, Caner, **Evrin Teorisi, Felsefe ve Tanrı**, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2014.
- Taslaman, Caner, **Kuantum Teorisi, Felsefe ve Tanrı**, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2015.
- Taslaman, Caner, **Modern Bilim, Felsefe ve Tanrı**, İstanbul Yayınevi, İstanbul, 2008.
- Till, Howard von, **“Basil and Augustine Revised: The Survival of Functional Integrity”**, Origins and Design, No: 19, Yaz 1998.
- Wegner, Daniel, **The Illusion of Conscious Will**, MIT Press, Cambridge, 2002
- Wigner, Eugene, **“The Unreasonable Effectiveness of Mathematics in the Natural Sciences”**, Communications in Pure and Applied Mathematics, Vol: 13, No: 1, Şubat 1960.
- Willard, Dallas, **“Knowledge and Naturalism”**, Naturalism: A Critical Analysis, Ed: William Lane Craig ve James Moreland, Routledge, Londra, 2000.
- Wilson, Catherine, **The Invisible World Early Modern Philosophy and the Invention of the Microscope**, Princeton University Press, Princeton, 1995.